FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 5

Tiranë – E mërkurë, 13 janar 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 146/2020, datë 17.12.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar	727
Dekret i Presidentit nr. 11904, datë 8.1.2021	Për shpallje ligji	728
Ligj nr. 147/2020, datë 17.12.2020	Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar	728
Dekret i Presidentit nr. 11905, datë 8.1.2021	Për shpallje ligji	729
Ligj nr. 148/2020, datë 17.12.2020	Për disa shtesa në ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"	729
Dekret i Presidentit nr. 11906, datë 8.1.2021	Për shpallje ligji	730
Ligj nr. 149/2020, datë 17.12.2020	Për një shtesë në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar	730
Dekret i Presidentit nr. 11907, datë 8.1.2021	Për shpallje ligji	731
Ligj nr. 150/2020, datë 17.12.2020	Për disa shtesa në ligjin nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"	731
Dekret i Presidentit nr. 11908, datë 8.1.2021	Për shpallje ligji	732
Ligj nr. 152/2020, datë 17.12.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, "Për armët"	732
Dekret i Presidentit nr. 11909, datë 8.1.2021	Për shpallje ligji	747
Ligj nr. 154/2020, datë 17.12.2020	Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare	747

Dekret i Presidentit nr. 11910, datë 8.1.2021	Për shpallje ligji	753
Akt Normativ i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.1.2021	Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet *Pfizer Export BV*, dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik, dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave anti-COVID-19 në Republikën e Shqipërisë, si dhe përdorimin e tyre në popullatë	753
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1121, datë 30.12.2020	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021	754
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1125, datë 30.12.2020	Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre	814
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1137, datë 16.12.2020	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit, 2021–2025, dhe të planit të veprimit 2021–2023	859
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1141, datë 24.12.2020	Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë	923
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1149, datë 24.12.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar", të ndryshuar	926
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 476, datë 16.12.2020	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë"	929
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1, datë 8.1.2021	Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë	930
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 1, datë 5.1.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 682, datë 21.12.2020, "Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Britaninë e Madhe"	957
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 5.1.2021	Për delegimin e kompetencave	957
Urdhër i drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 15, datë 11.1.2021	Për delegim kompetencash	958

LIGJ
Nr. 146/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, "KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja "d", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 52/a togfjalëshi "319/c dhe 328" zëvendësohet me togfjalëshin "dhe 319/c."

Neni 2

Pas nenit 52/a, shtohet neni 52/b, me këtë përmbajtje:

"Neni 52/b
Përjashtimi nga dënimi për krimet në fushën e zgjedhjeve

Personi që ka kryer një ose më shumë vepra penale të parashikuara në kreun X, të këtij Kodi, i cili bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale për hetimin, si dhe për zbulimin e personave të tjerë, bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale ose autorë të veprave të tjera të lidhura, përjashtohet nga dënimi për veprën penale të kryer prej tij.".

Neni 3

Pas nenit 154, shtohet neni 154/a, me këtë përmbajtje:

"Neni 154/a
Shkatërrimi i ndërtesave dhe objekteve të tjera

Kryerja me dashje e çdo veprimi tjetër, të ndryshëm me ato të parashikuara nga nenet e mësipërme të këtij seksioni, që mund të sjellë shkatërrimin e plotë ose të pjesshëm të ndërtesës, të objektit qytetar, të veprës industriale, të infrastrukturës apo të çdo objekti tjetër ose që mund të rrezikojë jetën ose shëndetin e njerëzve, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.".

Neni 4

Në nenin 199/a, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

"Po kjo vepër, e kryer për plotësimin e nevojave për strehim sipas ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.".

Neni 5

Neni 199/b, ndryshohet, si më poshtë:

"Neni 199/b
Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi ose kolaudimi i paligjshëm i ndërtimeve

Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi ose kolaudimi i punimeve të ndërtimit në kundërshtim me ligjin, dokumentet e planifikimit, standardet profesionale në fuqi ose në kundërshtim me lejen e zhvillimit ose të ndërtimit nga persona ndaj të cilëve janë marrë më parë masa administrative për këto shkelje, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Nxitja me ose pa shpërblim, ose detyrimi i projektuesit, mbikëqyrësit, zbatuesit ose kolauduesit të punimeve të ndërtimit për të shkelur rregullat që garantojnë kryerjen e ndërtimeve në përputhje me ligjin, dokumentet e planifikimit, standardet profesionale në fuqi ose në kundërshtim

me lejen e zhvillimit ose të ndërtimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.".

Neni 6

Në nenin 328 hiqet togfjalëshi "në kundërshtim me ligjin".

Neni 7

Në paragrafin e fundit të nenit 328/a hiqet togfjalëshi "në kundërshtim me ligjin dhe qëllimin e detyrës".

Neni 8

Në nenin 328/b hiqet togfjalëshi "në kundërshtim me ligjin".

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020

Shpallur me dekretin nr. 11904, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11904, datë 8.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 146/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 147/2020

PËR NJË SHTESË DHE DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7905, DATË 21.3.1995, "KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja "d", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 75/a, në shkronjën "a", pas fjalëve "dhe 319/e" shtohen fjalët ", si dhe nenet 328 dhe 328/b, të Kodit Penal".

Neni 2

Neni 189 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 189
Ruajtja e provave materiale

Provat materiale, që për shkak të natyrës së tyre mund të ndryshojnë, në qoftë se nuk mund t'u kthehen personave që u përkasin, ruhen e administrohen sipas legjislacionit të posaçëm nga organi administrues shtetëror, i cili detyrohet t'i kthejë të njëllojta ose të japë vlerën e tyre.".

Neni 3

Në nenin 214 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalia e dytë, ndryshohet, si më poshtë:

"Kur kjo nuk është e mundur ose e përshtatshme, organi procedues urdhëron që ato të ruhen pranë organit administrues shtetëror, duke përcaktuar mënyrën e ruajtjes.".

2. Pika 2, ndryshohet, si më poshtë:

"2. Organi administrues shtetëror ka për detyrë ruajtjen dhe administrimin e sendeve të sekuestruara, sipas legjislacionit të posaçëm për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe provave materiale, si dhe të paraqesë sendet kur kërkohen nga organi procedues.".

Neni 4

Në nenin 215, pika 3, ndryshohet, si më poshtë:

"3. Për sendet që mund të ndryshojnë, me kërkesë të organit administrues shtetëror ose kryesisht, organi procedues urdhëron, sipas rastit, tjetërsimin ose asgjësimin e tyre.".

Neni 5
Dispozitë kalimtare

1. Provat materiale, për të cilat vendimi përfundimtar i organit procedues nuk ka disponuar sipas pikës 1, të nenit 190, të Kodit të Procedurës Penale, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kalojnë në favor të organit administrues shtetëror dhe administrohen sipas legjislacionit të posaçëm për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe provave materiale.

2. Provat materiale, sipas pikës 1 të këtij neni, për të cilat kanë kaluar pesë vjet nga vendimi përfundimtar, asgjësohen, me urdhër të gjykatës, pas kërkesës së organit procedues, sipas pikës 6, të nenit 215, të Kodit të Procedurës Penale, duke ruajtur kampionet përkatëse.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020

Shpallur me dekretin nr. 11905, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11905, datë 8.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 147/2020, "Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, 'Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 148/2020

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 97/2016, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Në ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" bëhen shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 43, pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje:

"e) përgjigjet për hetimin e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të cilat janë kompetencë e prokurorisë që drejton.".

Neni 2

Pas nenit 107, shtohet neni 107/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 107/1
Marrëdhëniet me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, i japin KQZ-së informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, që nuk cenon ruajtjen e sekretit hetimor sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Informacioni jepet me të dhënat për çështjet penale, numrin e personave nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për ankimimin e vendimeve gjyqësore, shkakun e ankimimit, si dhe të dhënat për faktin nëse çështjet janë gjykuar në apel ose në Gjykatën e Lartë dhe rezultatin e këtij gjykimi. Pjesë e informacionit duhet të jetë edhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve.

2. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni përdoret nga KQZ-ja për nevojat e informimit publik për gjendjen dhe rezultatet e hetimeve penale për çështjet zgjedhore.

3. Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u përgjigjen kërkesave të KQZ-së për informacion jo më vonë se 15 ditë nga data e kërkesës.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020

Shpallur me dekretin nr. 11906, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11906, datë 8.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 148/2020, "Për disa shtesa në ligjin nr. 97/2016, 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë'".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 149/2020

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 96/2016, "PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 91, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Relatori përcakton dhomën dhe seksionin ku magjistrati ka ushtruar funksionin në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi dhe, në varësi të numrit të çështjeve për çdo kategori, përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen në mënyrë të barabartë për secilën kategori, duke përfshirë domosdoshmërish çështjet penale që lidhen më

veprat penale të parashikuara në kreun X, të Kodit Penal, për të cilat parashikohet dënimi në minimum jo më pak se një vit burgim, nëse magjistrati ka hetuar/gjykuar çështje të kësaj natyre gjatë periudhës së vlerësimit.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020

Shpallur me dekretin nr. 11907, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11907, datë 8.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 149/2020, "Për një shtesë në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 150/2020

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 60/2016, "PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Në ligjin nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" bëhen shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 3, pika 6, pas fjalëve "korrupsionit pasiv," shtohen fjalët "përfshirë edhe korrupsionin aktiv dhe/ose pasiv në zgjedhje,".

Neni 2

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 10/1
Njësia përgjegjëse në KQZ

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve krijohet dhe funksionon njësia përgjegjëse për marrjen dhe trajtimin e sinjalizimeve në fushën e korrupsionit aktiv dhe/ose pasiv në zgjedhje, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.
2. Njësia përgjegjëse në KQZ, në përfundim të hetimit administrativ, në rast se konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji për sinjalizimet në fushën e veprimtarisë zgjedhore, të cilat nuk përbëjnë vepër penale, vendos masë administrative me gjobë sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.
3. Nëse në përfundim të hetimit administrativ njësia përgjegjëse në KQZ arrin në përfundimin se veprimi ose praktika e dyshuar, e sinjalizuar, e korrupsionit aktiv dhe/ose pasiv në zgjedhje ka elemente të veprës penale, njofton menjëherë prokurorinë.".

Neni 3

Në pikën 2, të nenit 23, kudo pas emërtimit "ILDKPKI" shtohen fjalët "ose njësia përgjegjëse në KQZ".

Neni 4

Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që në përputhje me udhëzimet e ILDKPKI-së, brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë rregulloren e parashikuar në nenin 13, pika 10, të ligjit.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020

Shpallur me dekretin nr. 11908, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11908, datë 8.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 150/2020, "Për disa shtesa në ligjin nr. 60/2016, 'Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve'".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 152/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 74/2014, "PËR ARMËT"[1]

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 74/2014, "Për armët", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Shkronjat "a" dhe "ç" të nenit 1 ndryshohen si më poshtë:

"a) kushtet dhe kriteret për mbajtjen, ruajtjen, tregtimin, çaktivizimin, importimin, eksportimin, gjurmimin e transportimin e armëve, pjesëve kryesore e municioneve për përdorim civil, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas këtij ligji.

ç) veprimtarinë e prodhimit, demilitarizimit, çaktivizimit dhe riparimit të armëve.".

Neni 2

Pika 2 e nenit 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, dispozitat e tij nuk zbatohen për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe municioneve, importin, eksportin, tranzitin dhe veprimtaritë ndërmjetësuese të tyre, të cilat zhvillohen në bazë të ligjit për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, si dhe për municionet dedikuar për nevoja të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.".

Neni 3

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. "Armë zjarri" është çdo armë e transportueshme, me tytë, që realizon, është projektuar për të realizuar ose që mund të modifikohet lehtësisht për të realizuar të shtënë me plumb ose predhë nëpërmjet veprimit të barutit, përveç rasteve të mëposhtme:

a) është projektuar për alarmimin, sinjalizimin, shpëtimin e jetës, therjen e kafshëve, peshkimin me fuzhnjë ose për qëllime industriale e teknike, me kusht që të përdoret vetëm për qëllimin e cituar;

[1] Ky projektligj është përafruar pjesërisht, me:
- Direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991, "Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve", të ndryshuar". Numri CELEX 31991L0477, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 256, datë 13.9.1991, f. 51–58.
- Rregulloren (BE) nr. 258/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 mars 2012, "Për zbatimin e nenit 10 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve dhe përbërësve të tyre dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (Protokolli i Armëve të Zjarrit të OKB-së) dhe krijon autorizimin e eksportit dhe masat e importit dhe tranzitit për armët e zjarrit, pjesët dhe përbërësit e tyre dhe municionet". Numri CELEX 32012R0258, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 30.3.2012, f. 1–15.

b) konsiderohet si armë antike sipas përkufizimit të këtij ligji.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Një objekt konsiderohet i modifikuar për të realizuar të shtënë me plumb ose predhë nëpërmjet veprimit të barutit kur:

a) ka pamjen e një arme zjarri;

b) mund të modifikohet si rezultat i konstruksionit ose materialit nga i cili është prodhuar.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. “Armë qitjeje sportive pneumatike” është çdo lloj arme me tytë, që realizon një shkrepje ose nxjerr jashtë një saçmë nëpërmjet veprimit të forcave që nuk janë krijuar nga djegia e barutit. Konsiderohet armë qitjeje/pneumatike çdo armë, predha e së cilës ka një energji të matur gjatë fluturimit, të barabartë ose më të lartë se 7,5 J.”.

4. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. “Armë të qitjes me kapacitet të reduktuar” janë:

a) armët, predhat e të cilave kanë energji të matur gjatë fluturimit më të ulët se 7,5 J;

b) armët me mbushje nga gryka, me një shkrepje;

c) armët e destinuara të nxjerrin jashtë sfera plastike, të cilat përmbajnë vetëm lëng njollosës.”.

5. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. “Armë zjarri e shkurtër” është arma me tytë me gjatësi deri në 30 centimetra ose gjatësia e përgjithshme e së cilës nuk i kalon 60 centimetra.”.

6. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. “Armë zjarri e gjatë” është çdo armë zjarri e ndryshme nga arma e zjarrit e shkurtër.”.

7. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. “Armë zjarri automatike” është arma e cila mbushet automatikisht dhe realizon shkrepje/të shtëna të pandërprera me një tërheqje të këmbëzës së shkrepjes.”.

8. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. “Armë zjarri përsëritëse” është çdo armë zjarri, e cila pas çdo të shtëne është prodhuar për t’u rimbushur manualisht nga krehëri apo nga cilindri.”.

9. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. “Armë pneumatike” është arma e prodhuar për hedhjen e saçmave nëpërmjet presionit të ajrit apo gazeve të ngjeshura. Këto armë ndahen në tre tipa sipas fuqisë së burimit të tyre:

a) armë të cilat si burim fuqie përdorin bombola me dyoksid karboni të ngjeshur;

b) armë të cilat si burim fuqie përdorin ajrin e ngjeshur nëpërmjet veprimit të një suste;

c) armë të cilat si burim fuqie përdorin ajrin e ngjeshur nëpërmjet veprimit të një leve.”.

10. Pika 13 ndryshohet si më poshtë:

“13. “Armë për alarm dhe sinjalizim” është pajisja me mbajtëse fisheku e projektuar për të shkrepur vetëm fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose fishekë piroteknikë sinjalizues dhe që nuk mund të modifikohen për të realizuar një të shtënë, plumb ose predhë nga veprimi i barutit.”.

11. Pas pikës 13 shtohet pika 13/1 me këtë përmbajtje:

“13/1. “Armë për sinjalizim akustik” është arma e zjarrit e prodhuar në mënyrë të veçantë vetëm për përdorimin e shkrepjes së fishekëve të manovrës, për përdorim në shfaqje teatrale, sete fotografike, prodhime filmike dhe televizive, rikrijime historike, parada, aktivitete sportive dhe stërvitje.”.

12. Në pikën 14 fjala “eksplodimit” zëvendësohet me “shpërthimit”.

13. Në pikën 20 kategoria “D” hiqet.

14. Në pikën 25 viti “1890” zëvendësohet me “1899”.

15. Pika 29 ndryshohet si më poshtë:

“29. “Pjesë kryesore të armëve” janë tyta, shtrati/djepi, mekanizmi i shkrepjes, mulliri, shuli, krehëri, të cilat, duke qenë se janë objekte të veçanta, përfshihen në kategorinë e armëve të zjarrit, tek të cilat janë montuar ose do të montohen.”.

16. Pika 34 ndryshohet si më poshtë:

“34. “Armë zjarri të çaktivizuara” janë armët e zjarrit, të cilat janë bërë të papërdorshme në mënyrë të përhershme për shkak të çaktivizimit, duke garantuar që të gjitha pjesët kryesore të tyre janë bërë përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t’u hequr, zëvendësuar ose modifikuar në mënyrë të tillë që do të mundësonte riaktivizimin e armëve të zjarrit.”.

17. Pika 42 ndryshohet si më poshtë:

“42. “Gjurmimi i armëve, i pjesëve të armëve dhe municionit” nënkupton gjurmimin sistematik të armëve të zjarrit dhe, sipas rastit, të pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve nga prodhuesi te

blerësi, me qëllim asistimin e autoriteteve kompetente në zbulimin, hetimin dhe analizimin e prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm.".

18. Në pikën 45 kategoria "D" hiqet.

19. Pas pikës 47 shtohen pikat nga 48 deri në 71 si më poshtë:

"48. "Muze" është një institucion i përhershëm në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, i cili blen, pranon dhurata, ruan, bën kërkime dhe ekspozon armë zjarri, pjesë kryesore ose municione për qëllime historike, kulturore, shkencore, teknike, edukative, trashëgimore ose argëtuese dhe që njihet si i tillë.

49. "Koleksionist" është personi, fizik ose juridik i dedikuar, që merret me mbledhjen dhe ruajtjen e armëve të zjarrit, të pjesëve kryesore ose të municioneve për qëllime historike, kulturore, shkencore, teknike, edukative ose trashëgimore dhe që njihet si i tillë.

50. "Tregtar" është çdo person fizik ose juridik, tregtia ose aktiviteti i të cilit lidhet plotësisht ose pjesërisht me:

a) prodhimin, tregtimin, këmbimin, riparimin, modifikimin ose transformimin e armëve të zjarrit apo të pjesëve kryesore;

b) prodhimin, tregtimin, këmbimin, modifikimin ose transformimin e municioneve.

51. "Licencë" është akti administrativ që i lëshohet personit fizik apo juridik nga organi kompetent i përcaktuar me këtë ligj, me të cilin i njihet e drejta për të ushtruar aktivitete që kanë të bëjnë me armë, pjesë të armës dhe me municione, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

52. "Autorizim për mbajtje arme" është akti administrativ që i lëshohet personit fizik ose juridik nga organi kompetent i përcaktuar në këtë ligj, me të cilin i njihet e drejta e mbajtjes së armës, pjesëve të armës dhe municioneve.

53. "Autorizim për blerje arme" është akti administrativ që i lëshohet personit fizik ose juridik nga organi kompetent për blerje arme, pjesë arme dhe municione, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

54. "Prodhim i paligjshëm" është prodhimi ose montimi i armëve të zjarrit, i pjesëve kryesore të tyre ose i municioneve:

a) duke filluar nga çdo pjesë kryesore e këtyre armëve të zjarrit, të trafikuara në mënyrë të paligjshme;

b) pa autorizimin e lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit ku bëhet prodhimi ose montimi; ose

c) pa markimin standard në kohën prodhimit.

55. "Trafikim i paligjshëm" është importimi, eksportimi, tranzitimi, tregtimi, blerja, shitja, shpërndarja, lëvizja ose transferimi i armëve të zjarrit, i pjesëve kryesore të tyre ose i municioneve, me qëllim fitimin material ose çdo përfitim tjetër, nga ose nëpërmjet territorit të një shteti tjetër, nëse ky shtet nuk e autorizon atë në përputhje me këtë ligj, ose nëse armët e zjarrit, pjesët kryesore ose municionet nuk janë regjistruar në përputhje me nenin 10 të këtij ligji.

56. "Rezident" është personi, i cili konsiderohet i tillë dhe është i pajisur me dokument zyrtar që tregon vendbanimin e tij, si dhe identifikohet me pasaportë ose kartë identiteti, të cilat u paraqiten autoriteteve kompetente të një shteti ose një operatori ekonomik për verifikimin që bëhet gjatë blerjes ose mbajtjes së armës. Nëse adresa e personit nuk tregohet në dokumentin e identifikimit, vendbanimi i tij përcaktohet në bazë të një vërtetimi tjetër zyrtar, të njohur nga shteti ku bëhet blerja apo mbahet arma me autorizim.

57. "Transferim ndërkombëtar i armëve të zjarrit" është eksporti, eksporti i përkohshëm, importi, importi i përkohshëm, rieksporti, ndërmjetësimi, tranziti ose ringarkimi nëpër territorin shtetëror dhe çdo transferim tjetër jashtë apo brenda këtij territori, në të cilin janë përfshirë subjekte të ndryshme.

58. "Eksport" është procedurë:

a) eksporti në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) rieksporti në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, pa përfshirë armët e zjarrit në tranzit.

59. "Person" konsiderohet personi fizik ose juridik, që kryen veprimtari sipas këtij ligji.

60. "Eksportues" është:

a) çdo person fizik ose juridik, në emër të të cilit paraqitet deklarata doganore e eksportit ose personi që në kohën kur pranohet deklarata ka kontratën me marrësin e ngarkesës në vendin e huaj dhe ka autoritetin që të vendosë për dërgimin e armëve të zjarrit jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) personi që ka autoritetin të vendosë dërgimin e armëve të zjarrit jashtë territorit doganor të

Republikës së Shqipërisë, kur nuk është lidhur asnjë kontratë eksporti, apo nëse mbajtësi i kontratës nuk vepron në emër të vetë atij;

c) pala kontraktuese e vendosur në Shqipëri, e cila eksporton armë zjarri, sipas kontratës në të cilën është bazuar eksporti, në emër dhe për llogari të një personi të vendosur jashtë territorit shtetëror.

61. "Deklaratë eksporti" është akti me anë të të cilit një person shpreh, në formë dhe mënyrë të parashikuar, vullnetin për të vendosur armët e zjarrit, pjesët dhe përbërësit kryesorë të tyre dhe municionin në procedurë eksporti.

62. "Import" është procedurë importi në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

63. "Importues" është:

a) personi fizik ose juridik i licencuar, i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të të cilit bëhet një deklaratë importi, ose një person që në kohën e dhënies së licencës ka nënshkruar kontratë me marrësin e armëve të zjarrit brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) personi i autorizuar që të marrë armët e zjarrit brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, nëse nuk ka pasur kontratë për eksportin, apo nëse njëra nga palët në kontratë nuk vepron në emër të tij;

c) çdo person, i cili ka të drejtën për të çliruar armët e zjarrit në qarkullim të lirë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

64. "Deklaratë importi" është akti me anë të të cilit një person shpreh, në formë dhe mënyrë të parashikuar, vullnetin për të vendosur mallrat e kontrolluara nën procedurë importi.

65. "Tranzit" është transporti tokësor, detar, ajror dhe/ose transporti i kombinuar i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, që hyjnë dhe kalojnë përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, me destinacion një vend jashtë Shqipërisë dhe pa ndërruar pronësinë e mallrave, përfshirë artikujt:

a) që ndodhen të magazinuara përkohësisht dhe që rieksportohen drejtpërsëdrejti nga ambientet e magazinimit të përkohshëm;

b) që janë sjellë në territorin e Republikës së Shqipërisë me të njëjtin mjet lundrimi apo fluturimi që do t'i nxjerrë ato jashtë atij territori, pa i shkarkuar dhe nga e njëjta pikë doganore;

c) që i nënshtrohen ringarkimit brenda për brenda.

66."Ringarkim" është transferimi i ngarkesës nga një mjet transporti te një tjetër për tranzit të mëtejshëm për të përfunduar udhëtimin dhe për ta transportuar ngarkesën në destinacionin e fundit të saj, pa ndryshuar pronësinë e mallrave.

67."Person përgjegjës për tranzitin" është:

a) personi fizik ose juridik i caktuar, i cili vendos për tranzitimin;

b) personi fizik ose juridik përgjegjës për transportin, i cili vepron nëse nuk ka person fizik apo juridik të caktuar.

68."Eksport i përkohshëm i mallrave" konsiderohet lëvizja e armëve të zjarrit jashtë territorit doganor shtetëror, për t'u rikthyer në të njëjtin territor brenda 24 muajve.

69."Ndërmjetësues" është çdo person fizik ose juridik i licencuar, i ndryshëm nga një tregtar dhe që kryen veprimtari ndërmjetësimi.

70. "Veprimtari ndërmjetësimi" është negocimi apo organizimi i transaksioneve për blerjen, shitjen ose furnizimin e armëve të zjarrit nga një vend në cilindo vend tjetër të huaj, ose blerja, shitja apo organizimi i transferimeve të armëve të zjarrit që ndodhen në një vend drejt një vendi tjetër.

Shërbimet ndihmëse nuk do të konsiderohen veprimtari ndërmjetësimi në kuptim të këtij ligji. Këto shërbime përfshijnë transportin, shërbimet financiare, sigurimin, risigurimin, si dhe reklamimin e përgjithshëm ose promovimin.

71. "Certifikata e përdoruesit të fundit" është dokumenti në të cilin përdoruesi i fundit përcakton vendin ku do të përdoren/mbahen armët e zjarrit, qëllimin përfundimtar të përdorimit, si dhe garanton se armët e zjarrit nuk do të përdoren për ndonjë qëllim të ndryshëm nga ai i specifikuar në certifikatë, nuk do të transferohen te ndonjë subjekt tjetër në territorin e vendit të destinacionit, ose nuk do të rieksportohen pa leje nga vendi eksportues.

Kjo certifikatë do të konsiderohet e vlefshme kur është paraqitur pranë autoriteteve brenda 6 muajve nga data e lëshimit.

Certifikata e përdoruesit të fundit lëshohet nga autoritetet përgjegjëse në rastet kur personat fizikë apo juridikë kanë si qëllim të pajisen me licencë importi dhe kur kërkohet nga shteti eksportues.".

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5
Kategorizimi i armëve

1. Armët, sipas këtij ligji, kategorizohen si më poshtë:

1.1. Armët e kategorisë "A" janë:

a) predhat ushtarake plasëse dhe sistemet për lëshim (A1);

b) armët e zjarrit automatike (A2);

c) armët e zjarrit të kamufluara në formë të një mjeti tjetër (A3);

ç) municioni me shkallë të lartë depërtuese, municioni me predha shpërthyese, municioni me predha ndezëse, si dhe predhat për municion të tillë (A4);

d) municioni për pistoleta dhe revolver me predhë shpërndarëse dhe hapëse, si dhe predhat për municion të tillë, përveç në rastet e armëve për gjueti apo ato sportive të personave që kanë të drejtë t'i përdorin ato (A5);

dh)armë zjarri me zhurmëzbutës të montuar (A6);

e) armë zjarri me tytë të vjaskuar me kalibër mbi 12.7 milimetra (A7);

ë) mjete plasëse dhe pjesët e tyre (A8);

f) armë për përdorim të agjentëve kimikë dhe municionit të tyre (A9);

g) pajisja e veçantë për armë zjarri, e cila mundëson ndryshimin e saj në kategori tjetër (A10);

gj) armë paralizuese elektrike (A11);

h) municion blindshpues, gjurmëlënës, djegës (A12);

i) armë e drejtuar me energji ADE (A13).

1.1.1. Armë zjarri automatike të modifikuara në armë zjarri gjysmautomatike me ndezje qendrore si më poshtë:

a) armë zjarri e shkurtër, që shkrep më shumë se 21 fishekë pa rimbushje, nëse:

i. krehëri me kapacitet mbi 20 fishekë është pjesë e kësaj arme (A14);

ii. krehëri i çmontueshëm me kapacitet mbi 20 fishekë futet në këtë armë (A15);

b) armë zjarri të gjata që shkrepin më shumë se 11 fishekë pa rimbushje, nëse:

i. krehëri me kapacitet mbi 10 fishekë është pjesë e kësaj arme (A16);

ii. krehëri i çmontueshëm me kapacitet mbi 10 fishekë futet në këtë armë (A17).

1.1.2. Armë zjarri të gjata gjysmautomatike, të cilat mund të reduktohen në një gjatësi nën 60 cm pa humbur funksionalitetin, me anë të një baze me palosje ose teleskopike, apo një baze që mund të hiqet pa përdorur vegla të tjera (A18).

1.1.3. Armë zjarri në këtë kategori, e cila është e modifikuar, funksioni i mëparshëm i të cilës ka qenë lëshimi i fishekëve të manovrës, substancave irrituese, fishekëve piroteknikë dhe sinjalizimi akustik (A19).

1.2. Armë zjarri të kategorisë "B", për të cilat kërkohet autorizim, janë:

a) armë zjarri të shkurtra me përsëritje (B1);

b) armë zjarri të shkurtra me një qitje, me ndezje qendrore (B2);

c) armë zjarri të shkurtra me një qitje, me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme nën 28 cm (B3);

ç) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike me krehër dhe fole, që mund të mbajnë së bashku më shumë se 3 fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje anësore dhe më shumë se tre, por më pak se dymbëdhjetë fishekë, në rastin e armëve të zjarrit me ndezje qendrore (B4);

d) armë zjarri të shkurtra gjysmautomatike, që nuk janë përfshirë në shkronjën "a" të pikës 1.1.1 të kategorisë A (B5);

dh) armë zjarri të gjata gjysmautomatike të renditura në shkronjën "b" të nënpikës 1.1.1 të kategorisë "A", me krehër dhe fole fishekësh që së bashku mund të pranojnë deri në tre fishekë, kur krehëri i tyre çmontohet, ose kur nuk është e sigurt që këto armë mund të modifikohen me mjete të zakonshme në një armë krehëri dhe foleja e fishekëve të së cilës pranon së bashku më tepër se tre fishekë (B6);

e) armë zjarri të gjata me përsëritje dhe gjysmautomatike me tytë të pavjaskuar, me gjatësi deri në 60 cm (B7);

ë) armë zjarri në këtë kategori, e cila është e modifikuar, funksioni i mëparshëm i së cilës ka qenë lëshimi i fishekëve të manovrës, substancave irrituese, fishekëve piroteknikë dhe sinjalizimi akustik (B8);

f) armë zjarri gjysmautomatike për përdorim civil, të ngjashme me armë me mekanizma

automatikë, përveç atyre të renditura në pikat 1.1.1, 1.1.2 dhe 1.1.3 të kategorisë "A" (B9);

g) armë zjarri pneumatike, me energji të predhës mbi 7,5 J dhe kalibër mbi 4,5 mm (B7).

1.3 "Armë zjarri të kategorisë "C", të cilat janë objekt autorizimi, si më poshtë:

a) armë zjarri e gjatë me përsëritje, e cila nuk përfshihet në shkronjën "e" të pikës 1.2 të kategorisë "B" (C1);

b) armë zjarri të gjata me tytë të vjaskuar (C2);

c) armë zjarri e gjatë gjysmautomatike, që nuk përfshihet në kategorinë "A" ose "B" (C3);

ç) armë zjarri të shkurtra me një qitje me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme jo më pak se 28 cm (C4);

d) armë zjarri në këtë kategori, e cila është modifikuar, funksioni i mëparshëm i së cilës ka qenë lëshimi i fishekëve të manovrës, i substancave irrituese, i fishekëve piroteknikë dhe sinjalizimi akustik (C5);

dh)armët e zjarrit të klasifikuara në kategorinë "A" ose "B" ose në këtë kategori, të cilat janë çaktivizuar në përputhje me standardet dhe teknikat e çaktivizimit të miratuara me rregullore;

e) armë zjarri e gjatë me një qitje me tytë të pavjaskuar (C7);

ë) armë pneumatike me energji të predhës deri në 7,5 J dhe kalibër deri 4,5 mm (C8).".

1.4 Armët e kategorisë "D" janë:

a) armët e zjarrit antike (D1);

b) armët me hark apo me tojë (D2);

c) armët e ftohta (D3), të cilat ndahen në:

i) armë prodhim fabrike;

ii) armë artizanale.

Neni 5

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Armët e kategorisë "A", në kuptim të këtij ligji, janë vetëm pronë e shtetit, me përjashtim të armëve të zjarrit për qëllime të shërbimeve të sigurisë, koleksionit, muzeut.".

Neni 6

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8

Regjimi juridik për kategoritë e armëve

1. Në kategorinë "A" përfshihen armë të cilat nuk lejohen të përdoren dhe për të cilat nuk lëshohet autorizim.

1.1. Përjashtim nga pika 1, e këtij neni, bëhet vetëm për qëllime të sigurisë, të koleksionit dhe muzeve. Autoriteti kompetent pajis me autorizim për përdorim armë zjarri dhe pjesë kryesore të armëve të zjarrit të klasifikuara në kategorinë "A", si më poshtë vijon:

a) shërbimet e sigurisë fizike lejohet të përdorin armë zjarri të kategorive "A16","A17".

b) koleksionistët lejohet të përdorin armë zjarri të kategorisë "A", që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, përjashtuar municionet. Autorizimi për këtë kategori lëshohet në raste individuale, në mënyrë përjashtimore dhe të argumentuar.

c) muzetë lejohen të përdorin armë zjarri të kategorisë "A", për qëllime historike, kulturore, shkencore, teknike, edukative ose trashëgimore, përjashtuar municionet.

1.2. Subjektet fizike e juridike, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 1.1 të këtij neni, pajisen me autorizim, me kusht që më parë të kenë garantuar masa për ruajtje e nivel sigurie të lartë, që është në raport me rreziqet që lidhen me aksesin e paautorizuar të këtyre artikujve.

1.3. Subjektet tregtare të licencuara lejohet të blejnë armë zjarri të kategorisë "A", pjesë kryesore dhe municione, vetëm në rastet kur blihen për Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, Ministrinë e Drejtësisë ose autoritetet publike.

1.4. Armët e zjarrit, pjesët kryesore dhe municionet e klasifikuara në kategorinë "A", të mbajtura në mënyrë të paligjshme, konfiskohen.

2. Në kategorinë "B" përfshihen armë, për të cilat lëshohet autorizim si më poshtë:

a) lejohet të pajisen me autorizim për armë të shkurtra të kategorisë "B" personat që për shkak të detyrës shtetërore ose të rrethanave personale të veçanta janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën dhe u njihet e drejta e mbrojtjes së veçantë, si dhe personat që plotësojnë kriteret për mbajtjen e armës;

b) lejohet të pajisen me autorizim për armë të shkurtra të kategorisë "B5" dhe armë të gjata të kategorisë "B" subjektet që për shkak të

veprimtarisë së sigurisë fizike u lind e drejta e mbajtjes së armës sipas këtij ligji;

c) lejohet të pajisen me autorizim për armë të shkurtra të kategorisë "B" dhe armë zjarri të gjata me ndezje anësore "B4" qitësit sportivë.

3. Në kategorinë "C" përfshihen armët me cilësi teknike të kufizuara, për të cilat lëshohet autorizim nga Policia e Shtetit për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, për qëllime gjuetie dhe sportive, sipas dispozitave të këtij ligji. Për armët e kategorisë "C" me vjaska lëshohet autorizim nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në raste individuale në mënyrë të argumentuar.

4. Për armët e koleksionit të kategorive "B" e "C", që plotësojnë kriteret për t'u quajtur armë zjarri dhe që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, lëshohet autorizim nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

5. Municionet, pjesët kryesore të armëve të zjarrit, pajisjet mbushëse të armëve gjysmautomatike (krehërave), që mund të mbajnë më shumë se 20 fishekë ose më shumë se 10 fishekë në rastin e armëve të gjata të zjarrit, shiten njëlloj si armët e zjarrit vetëm për personat që kanë autorizim për mbajtje arme zjarri përkatëse.

6. Brenda territorit të vendit të huajt rezidentë mund të blejnë një armë zjarri të klasifikuar në kategoritë "B" e "C" vetëm me autorizim. Një autorizim i tillë i jepet një shtetasi të huaj rezident me miratimin paraprak të vendit të tij. Shtetasi i huaj verifikohet periodikisht për përmbushjen e kushteve për mbajtjen e armës, për afatet maksimale të përcaktuara në këtë ligj.

7. Armët për alarm dhe sinjalizim shiten me autorizimin përkatës të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit.

Neni 7

Pas nenit 8 shtohen nenet 8/1 dhe 8/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 8/1
Arsyet për blerjen e armës

1. Arsyet për blerjen e armës, pjesëve të armës dhe municionit nga personi fizik janë vetëm për mbrojtje fizike, gjah, sportin e qitjes ose për qëllime koleksioni, të cilat vendosen në kërkesën e aplikuesit për blerje arme.

2. Rastet e veçanta të mbrojtjes së sigurisë fizike, për të cilat lejohet blerja e armës sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Arsyet për blerjen e armës, të pjesëve të armës dhe të municionit nga personi juridik janë për import, trajnime në poligone të licencuara, qitjen sportive, shërbime sigurie, koleksionim, muze, xhirime filmi.

Neni 8/2
Rastet për mbrojtje fizike

1. Personi mund të blejë dhe mbajë armë për mbrojtjen fizike kundrejt pajisjes me autorizim për blerje/mbajtje arme në vendbanim dhe mbajtje arme në lëvizje nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

2. Mbrojtja fizike, për shkak të rrezikut të aktivitetit shtetëror ose rrethanave personale të veçanta, i jep të drejtën personit të kërkojë të pajiset me autorizim të posaçëm për mbajtje arme në lëvizje.

3. Vlerësimi i rrezikut për jetën shqyrtohet nga komisioni qendror për vlerësimin e rrezikut të personave në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 8

Pas pikës 7 të nenit 9 shtohen pikat 8, 9 dhe 10 me këtë përmbajtje:

"8. Armët e zjarrit dhe pjesët kryesore të tyre, të importuara nga Bashkimi Evropian, duhet të kenë mbi to të shënuar një markim të dukshëm, të përhershëm dhe unik.

9. Markimi unik përfshin emrin e prodhuesit ose markën, shtetin ose vendin e prodhimit, numrin e serisë dhe vitin e prodhimit, si dhe modelin nëse nuk është pjesë e numrit të serisë.

10. Municionet e prodhuara e të importuara detyrimisht duhet të përmbajnë markimin e plotë në çdo pako, në mënyrë të tillë që të tregojnë emrin e prodhuesit, numrin e identifikimit të partisë (lotit), kalibrin dhe llojin e municioneve.".

Neni 9

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10
Regjistrimi i armës së zjarrit

1. Për regjistrimin e armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municionet, personi fizik ose juridik, i autorizuar apo i licencuar, paraqitet në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit ku ka vendbanimin ose ushtron aktivitetin, me dokumentet përkatëse të blerjes/shitjes, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes në pronësi të tyre.

2. Regjistrimi i armëve, i pjesëve kryesore e municioneve të tyre bëhet në format elektronik në sistem të informatizuar, i cili menaxhohet nga Policia e Shtetit. Sistemi i informatizuar i menaxhimit të armëve u lejon akses strukturave të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe gjykatës.

3. Sistemi i ruajtjes së të dhënave regjistron të gjitha informacionet për armët e zjarrit të nevojshme për t'i gjurmuar dhe identifikuar ato, duke përfshirë:

a) llojin, markën, modelin, kalibrin, numrin e serisë së çdo arme zjarri dhe markimin e vendosur në pjesën kryesore për çdo armë zjarri;

b) numrin e serisë ose markimin unik të vendosur në pjesët kryesore të çdo arme zjarri, në rastin kur ndryshon nga markimi në skeletin ose djepin e armës së zjarrit;

c) emrat dhe adresat e furnitorëve dhe të personave që blejnë ose mbajnë një armë zjarri, së bashku me datën ose datat përkatëse;

ç) çdo modifikim që i bëhet armës së zjarrit dhe që çon në ndryshimin e kategorisë apo nënkategorisë së saj, duke përfshirë çaktivizimin ose shkatërrimin e certifikuar të saj, si dhe datën ose datat përkatëse.

4. Sistemi i informatizuar i menaxhimit të armëve ndërtohet në mënyrë të tillë që të garantojë masat për sigurinë e të dhënave personale, parimin e mjaftueshmërisë dhe të proporcionalitetit për përpunimin e të dhënave, si dhe evidentimin e gjurmimit të të dhënave.

5. Të dhënat për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore, të përmendura në pikën 3 të këtij neni, si dhe të dhënat personale përkatëse mund të aksesohen nga autoritetet kompetente:

a) për lëshimin ose revokimin e autorizimeve e licencave për një periudhë prej 10 vjetësh pas shkatërrimit të armës së zjarrit ose pjesëve kryesore në fjalë;

b) për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale për një periudhë prej 30 vjetësh pas shkatërrimit të armës së zjarrit ose pjesëve kryesore në fjalë.

6. Të dhënat personale fshihen nga sistemi i ruajtjes së të dhënave pas përfundimit të periudhave të specifikuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 5 të këtij neni. Kjo do të bëhet pa cenuar rastet kur të dhëna personale specifike janë transferuar te një autoritet kompetent për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe përdoren në atë kontekst specifik, ose tek autoritete të tjera kompetente për një qëllim të përshtatshëm të parashikuar nga legjislacioni i brendshëm. Në këto raste përpunimi i këtyre të dhënave nga autoritetet kompetente do të kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë së tyre, tregtarët dhe ndërmjetësit e armëve të zjarrit e të gjahut janë të detyruar të mbajnë regjistër, ku të regjistrohet çdo armë zjarri dhe pjesë kryesore, që është objekt i këtij ligji dhe që merret ose asgjësohet prej tyre, së bashku me detajet që mundësojnë identifikimin dhe gjurmimin e armës së zjarrit, ose pjesëve kryesore, në veçanti të llojit, markës, modelit, kalibrit dhe numrit të serisë, emrat dhe adresat e furnizuesve dhe të blerësve. Pas përfundimit të aktiviteteve të tyre, tregtarët dhe ndërmjetësit dorëzojnë regjistrin tek organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, që është përgjegjës për sistemet e ruajtjes së të dhënave.

8. Operatorët ekonomikë dhe ndërmjetësit duhet t'i raportojnë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit transaksionet që përfshijnë armët e zjarrit ose pjesët kryesore dhe municionet, pa vonesa të pajustifikuara, në çdo rast dhe sa herë kërkohet. Komunikimi i operatorëve ekonomikë dhe ndërmjetësve bëhet në formë shkresore ose elektronike.

9. Rregullat për krijimin, aksesin, funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 10

Në nenin 12 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën "a" pas fjalës "eksportin" shtohen fjalët "ndërmjetësimin, tranzitin".

2. Në shkronjën "e" pas fjalës "çaktivizimin" shtohet fjala "demilitarizimin".

Neni 11

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13
Licencimi

Licencimi i veprimtarive të lejuara me armë përfshin:

a) regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe të ndërmjetësve, që veprojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) licencimin për të drejtën e fillimit të ushtrimit të aktiviteteve të operatorëve ekonomikë dhe të ndërmjetësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) autorizimin për kryerjen e një ose disa aktiviteteve të operatorëve ekonomikë dhe të ndërmjetësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

ç) kontroll të besueshmërisë dhe të aftësive përkatëse të operatorit ekonomik ose ndërmjetësit në fjalë. Në rastin e një personi juridik, kontrolli do të kryhet si për subjektin juridik, ashtu dhe për personat fizikë që menaxhojnë sipërmarrjen.".

Neni 12

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14
Llojet e licencave

1. Në kuptim të këtij ligji, llojet e licencave janë:

a) licencë për import/eksport, ndërmjetësim, tranzit, prodhim dhe demilitarizim për armët e kategorive "A" dhe "B", pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre;

b) licencë për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre;

c) licencë për poligon civil qitjeje të hapur, të mbyllur, me pjatel;

ç) licencë për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën;

d) licencë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil;

dh)licencë për import dhe tregtim të armëve të kategorisë "C" (gjahut) dhe "D" (sportive), pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.

2. Licenca e prodhimit dhe e demilitarizimit, e përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, lëshohet nga Ministria e Mbrojtjes sipas procedurave dhe kritereve të posaçme të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Licencat e tjera, të përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, lëshohen nga Ministria e Mbrojtjes/struktura përgjegjëse sipas procedurave dhe kritereve të posaçme të përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm në fuqi për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake.

4. Licencat e përcaktuara në shkronjat "b", "c", "ç", "d" dhe "dh" të pikës 1 të këtij neni lëshohen nga komisioni qendror në Policinë e Shtetit sipas procedurave dhe kritereve të posaçme të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 13

Neni 15 shfuqizohet.

Neni 14

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe bëhet "Licenca për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre".

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Licenca për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.".

3. Në pikat 2 dhe 3 pas fjalës "pjesëve" shtohet fjala "kryesore".

Neni 15

Në nenin 17 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe bëhet "Licenca për poligon civil qitjeje të hapur, të mbyllur, me pjatel".

2. Në pikën 1 fjalët "të hapur ose të mbyllur" zëvendësohen me fjalët "të hapur, të mbyllur, me pjatel".

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Në poligonin civil të qitjes, të hapur ose të mbyllur, lejohet mbajtja dhe përdorimi i armëve të kategorive "B" dhe "C", ndërsa në poligonin civil të qitjes me pjatel lejohet vetëm mbajtja dhe përdorimi i armëve të gjahut.".

4. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Kushtet e sigurisë për ndërtimin dhe mënyrën e funksionimit të një poligoni civil qitjeje, si dhe kushtet dhe rregullat që duhet të plotësojë licenca për poligonin civil të qitjes të hapur, të mbyllur, me pjatel, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 16

Pas nenit 18 shtohen nenet 18/1 dhe 18/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 18/1

Licenca për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil

1. Për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.

2. Licenca për këtë veprimtari i jepet çdo personi fizik ose juridik, që plotëson kushtet dhe kriteret sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore. Procesit të çaktivizimit i nënshtrohen armët në pronësi të personit fizik ose juridik, me kërkesën e tyre, për t'i mbajtur në pronësi si relike.

3. Standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të garantuar që të gjitha pjesët kryesore të këtyre armëve të zjarrit të bëhen përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t'u hequr, zëvendësuar ose modifikuar, në një mënyrë të tillë që do të mundësonte riaktivizimin e mundshëm të armëve të zjarrit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Për kontrollin e çaktivizimit të armëve të zjarrit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ngrihet dhe funksionon Komisioni i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta, për të garantuar që modifikimet e kryera në armët e zjarrit i bëjnë të gjitha pjesët kryesore të tyre përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t'u hequr, zëvendësuar ose modifikuar. Ky komision lëshon vërtetim për armën e zjarrit të çaktivizuar dhe të markuar.

Neni 18/2

Licenca për import dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre

1. Për veprimtarinë e importit dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.

2. Licenca për këtë veprimtari i jepet çdo personi fizik ose juridik, që plotëson kushtet dhe kriteret sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore.

3. Kushtet dhe rregullat që duhet të plotësojë subjekti për këtë veprimtari përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 17

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 fjalët "e parashikuara në nenet 15, 16, 17 dhe 18 të këtij ligji" zëvendësohen me fjalët "e transportit, poligonit dhe aftësimit teorik e praktik".

2. Në shkronjën "a" të pikës 1 pas fjalës "subjekt" shtohet fjala "juridik".

3. Pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

"5. Kriteret për licencat e parashikuara për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil, importin dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, sipas këtij ligji janë si më poshtë:

a) subjekti të jetë i regjistruar si subjekt fizik ose juridik dhe ta ketë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) drejtuesi ose i punësuari në veprimtarinë e tregtimit të armëve të gjahut dhe pjesëve kryesore e municioneve duhet të jetë i pajisur me dëshmi për aftësimin teorik dhe praktik për armën nga subjekti që kryen kursin e trajnimit, sipas këtij ligji;

c) drejtuesit për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil duhet të jenë specialistë të armatimit, të diplomuar në shkolla ushtarake ose të trajnuar e pajisur me certifikatë nga Policia e Shtetit

si specialistë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil.

6. Procedura e certifikimit dhe formati i certifikatës miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.".

Neni 18

Pas nenit 19 shtohen nenet 19/1, 19/2, 19/3 dhe 19/4 me këtë përmbajtje:

"Neni 19/1
Procedurat dhe kontrolli i importit të armëve të gjahut dhe sportive

1. Importimi i armëve të gjahut dhe sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, kryhet me autorizim përkatës, të lëshuar në përputhje me formularin e miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Ky autorizim lëshohet nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.

2. Nëse armët e gjahut dhe sportive, pjesët kryesore dhe municionet e tyre gjenden në një ose më shumë shtete të ndryshme nga ai ku është bërë aplikimi për autorizim importi, ky fakt duhet të paraqitet në aplikimin në fjalë. Policia e Shtetit, ku është bërë aplikimi për autorizim importi, konsultohet menjëherë me autoritetet kompetente të shtetit ose të shteteve të tjera.

3. Para lëshimit të autorizimit për importin e armëve të gjahut dhe sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, Policia e Shtetit verifikon që:

a)vendi eksportues të ketë autorizuar importin përkatës;

b)vendet e treta të tranzitit, nëse ka, të kenë njoftuar me shkrim, të paktën para dërgesës, se nuk kanë asnjë kundërshtim në lidhje me tranzitin. Kjo dispozitë nuk zbatohet për dërgesat në rrugë ajrore ose detare dhe përmes porteve ose aeroporteve të vendeve të treta, me kusht që të mos ketë ndryshim të mjeteve të transportit dhe në rastin e eksporteve të përkohshme për qëllime të ligjshme të verifikueshme, të cilat përfshijnë gjuetinë, qitjen sportive, vlerësimin, ekspozimet pa shitje dhe riparimet.

Neni 19/2
Autorizimi i importit dhe eksportit të armëve të gjahut dhe sportive

Për qëllime gjurmimi, autorizimi për eksport dhe licenca e importit ose autorizimi i importit, si dhe dokumentacioni shoqërues duhet të përmbajnë së bashku informacionet që përfshijnë:

a) datën e lëshimit dhe skadimit të certifikatës;

b) vendin e lëshimit;

c) vendin e eksportit;

ç) vendin e importit;

d) sipas rastit, vendin ose vendet e treta të tranzitit;

dh) marrësin;

e) përdoruesin fundor, nëse dihet në kohën e dërgesës;

ë) të dhënat që mundësojnë identifikimin e armëve të zjarrit, pjesëve dhe të komponentëve kryesorë të tyre dhe municioneve, si dhe sasinë e tyre, duke përfshirë të paktën para dërgimit markimin e vendosur në armët e zjarrit.

Neni 19/3
Transferimi i përkohshëm i armëve dhe i municioneve të tyre

Procedurat e thjeshtuara për eksportin e përkohshëm ose rieksportin e armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve kryesorë të tyre, si dhe municioneve, zbatohen si më poshtë:

a) Policia e Shtetit pajis me autorizim të përkohshëm për import dhe eksport gjuetarët ose qitësit sportivë, si pjesë e objekteve të tyre personale shoqëruese, gjatë një udhëtimi në një shtet të tretë ose hyrjes në Republikën e Shqipërisë;

b) autorizimi jepet me kusht që subjektet e përmendura në shkronjën "a" t'u vërtetojnë autoriteteve kompetente arsyet e udhëtimit, bashkëlidhur ftesën ose një provë tjetër të aktiviteteve të gjuetisë apo aktiviteteve sportive në vendin e tretë të destinacionit, për:

i. një ose më shumë armë zjarri;

ii. pjesët kryesore të tyre, të cilat janë të markuara;

iii. municionet që lidhen me aktivitetin, me një kufizim prej maksimumi 800 fishekë për gjuetarët dhe maksimumi 1200 fishekë për qitësit sportivë.

Neni 19/4
Tranzitimi i armëve të zjarrit, i pjesëve përbërëse dhe i municioneve të tyre

Tranzitimi i armëve të zjarrit, i pjesëve përbërëse dhe i municioneve të tyre, në rrugë tokësore ose ujore, nga dogana/pika e hyrjes deri në doganë/pikën e daljes realizohet bazuar në licencën e lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.".

Neni 19

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23
Inspektimi

1. Ushtrimi nga personat fizikë dhe juridikë i veprimtarisë së licencuar/autorizuar i nënshtrohet inspektimit të rregullt nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, gjatë të cilit zbatohen dispozitat e ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe dispozitat e tjera të zbatueshme në fuqi.

2. Policia e Shtetit inspekton subjektet fizike e juridike dhe mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve ligjore, përfshirë masat e sigurisë, shitjen dhe blerjen e armëve, pjesëve kryesore e municioneve, trajnimin dhe pajisjen e personave fizikë me dëshminë e aftësimit teorik e praktik të armëve, mbajtjen e regjistrave, shitjen e municioneve, rregullat e regjistrimit të shtetasve në poligone.

3. Personat fizikë dhe juridikë të autorizuar/licencuar janë të detyruar të mundësojnë kryerjen e mbikëqyrjes, të kontrollit të armëve dhe municionit, të vendosin në dispozicion dokumentacionin përkatës dhe të ofrojnë të dhënat dhe njoftimet e nevojshme. Kjo përfshin të drejtën e organit kompetent të lejohet të hyjë në ambientet ku kryhet aktiviteti me armë, pjesë të armëve dhe municionit.".

Neni 20

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:
1. Në pikën 1 shkronja "ç" shfuqizohet.

Neni 21

Fjalia e parë e nenit 25 ndryshohet si më poshtë:

"Kanë të drejtë të pajisen me autorizim për blerje arme zjarri e municione përkatëse, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, këta persona juridikë:".

Neni 22

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:
a) në fjalinë e parë, pas fjalës "përcaktimeve" shtohen fjalët "të regjimit juridik për kategoritë e armëve";
b) pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:
"d) qitësit sportivë dhe gjuetarët.".
Pika 2 shfuqizohet.

Neni 23

Pas pikës 4 të nenit 27 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:
"5. Mbajtja e armëve për alarm, sinjalizim, pneumatike dhe paralizuesit elektrikë lejohet sipas qëllimit të caktuar në autorizim.".

Neni 24

Në nenin 32 bëhen shtesat e mëposhtme:
1. Në pikën 1, në fund të fjalisë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:
"Për qëllime të përdorimit skenik dhe kinematografik, armët e zjarrit të kategorive "A", "B", "C" dhe "D", kundrejt tarifës dhe me autorizim të organit përgjegjës të Policisë së Shtetit, mund të merren për këtë veprimtari edhe nga subjektet e licencuara për tregtimin e armëve në Republikën e Shqipërisë.".
2. Në pikën 2 pas emërtimit "Policisë së Shtetit" shtohen fjalët "ose të punonjësve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike të kontraktuar nga përdoruesi".

Neni 25

Neni 33 shfuqizohet.

Neni 26

Në nenin 34 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) të ketë mbushur moshën 25 vjeç dhe të mos jetë mbi 70 vjeç në kohën e aplikimit për t'u pajisur me autorizim për mbajtje arme".

b) pas shkronjës "b" shtohet shkronja "b/1" me këtë përmbajtje:

"b/1) ndaj tij të mos jetë caktuar masë sigurie ose të mos jetë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve të ndryshme;"

c) Shkronja "ç" ndryshohet si më poshtë:

"ç) të mos ketë qenë i evidentuar për raste të kundërshtimit me dhunë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, nëpunësit publik, për veprat penale të dhunës në familje, për çështje me objekt të hakmarrjes ose gjakmarrjes, si dhe për sjellje që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet.";

ç) pas shkronjës "ë" shtohet shkronja "f" me këtë përmbajtje:

"f) të mos jetë revokuar licenca/autorizimi me një afat jo më të vogël se 3 vjet".

2. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 27

Në nenin 35 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 në fund të fjalisë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Përjashtim bëjnë punonjësit aktivë të strukturave shtetërore të armatosura.".

3. Në pikën 2 afati "3-mujor" zëvendësohet me afatin "6-mujor".

Neni 28

Neni 38 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 38
Lëshimi i autorizimeve

1. Kërkesa për lëshimin e autorizimit për blerje dhe mbajtje arme, që përfshihen në kategoritë "B" ,"C" dhe "D", sipas këtij ligji, miratohet me akt administrativ të organeve përgjegjëse të Policisë së Shtetit.

2. Autorizimi për mbajtje arme zjarri lëshohet nga struktura vendore e policisë me afat 5-vjeçar, sipas formatit të miratuar, kundrejt pagesës së tarifës.

3. Personat që mbajnë autorizime për armë zjarri të kategorisë "B", të parashikuara në këtë ligj, nuk kanë nevojë të aplikojnë për autorizim blerje për armët e kategorisë "C" dhe "D", por pajisen me autorizim blerje nga komisioni përgjegjës pas kërkesës së personit në strukturën përgjegjëse të Policisë së Shtetit.

4. Autorizimet e parashikuara në këtë ligj rishikohen periodikisht, por jo para mbarimit të afatit 5-vjeçar, përveç autorizimit të posaçëm për mbajtje arme zjarri, i cili lëshohet nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me afat vlefshmërie bazuar në vlerësimin e ekzistencës së kërcënimit dhe rrezikut për jetën.

5. Personat fizikë për nevoja të sigurisë fizike kanë të drejtë të pajisen vetëm me një armë zjarri të shkurtër gjysmautomatike dhe me 50 fishekë për armë.

6. Personat fizikë për nevoja të gjuetisë kanë të drejtë të pajisen me një armë gjahu:

a) me vjaska;

b) gjysmautomatike;

c) me përsëritje;

ç) çifte;

d) teke.

7. Personat fizikë, që kërkojnë të pajisen me armë mbi numrin e lejuar në pikën 6 të këtij neni, detyrohen të paguajnë pesëfishin e vlerës së tarifës të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

8. Personat fizikë, që ushtrojnë qitjen sportive, kanë të drejtë të pajisen me jo më shumë se dy armë për çdo model, sipas përcaktimit të nenit 8 të këtij ligji.

9. Personat fizikë të autorizuar si koleksionistë kanë të drejtë të pajisen me jo më shumë se dy armë për çdo model, sipas përcaktimit të nenit 8 të këtij ligji.

10. Subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike kanë të drejtë të blejnë me të njëjtin autorizim armë dhe 50 fishekë për armët e shkurtra dhe 100 fishekë për armë të gjata.

11. Armët e kategorive "B" dhe "C" dhe "D", sipas këtij ligji, të cilat u dhurohen shtetasve që plotësojnë kriteret e këtij ligji, regjistrohen dhe administrohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.".

Neni 29

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 39
Tjetërsimi në kushtet e përdorimit vetjak të armës

1. Subjekteve të licencuara për tregtim u lejohet t'u shesin armët e zjarrit, pjesët e armës dhe municione vetëm personave fizikë dhe juridikë, të pajisur me autorizim të vlefshëm nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

2. Çdo transferim i mëtejshëm i armëve të zjarrit të kategorisë "C" u lejohet vetëm personave të pajisur me autorizim blerje nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit për këtë kategori armë zjarri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Shitja e armëve të zjarrit midis personave fizikë dhe juridikë, të pajisur me autorizim për mbajtje arme/licence, dhe subjekteve me autorizim për blerje arme bëhet me kontratë të vërtetuar tek noteri, e cila përmban llojin, markën, numrin e serisë dhe kalibrin e armës, të dhënat e personit shitës dhe blerës, që përfshihen në autorizimin për mbajtjen e armës/licencës dhe autorizimin e blerjes. Regjistrimi dhe çregjistrimi i armës se zjarrit bëhet brenda 5 (pesë) ditëve në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit, në juridiksion territorial, duke kryer edhe procedurat e dërgimit të formularit të balistikës nga organi përkatës i policisë vendore në Policinë Shkencore.

4. Këmbimi i armëve të zjarrit midis personave fizikë/juridikë, të pajisur me autorizim për mbajtje arme/licencë, kryhet në organin e policisë vendore ku është regjistruar njëra armë, duke deklaruar me shkrim nga dy pronarët, pa akt noterial. Pas dorëzimit të deklarimeve ata kryejnë regjistrimin, secili në organin përkatës të policisë vendore.

5. Blerja dhe shitja e armëve të gjahut të kategorisë "C" lejohet vetëm me autorizim brenda ose jashtë vendit. Shitja e armëve të gjahut një shtetasi të huaj bëhet me kusht që blerësi të jetë i pajisur me autorizim dhe dokumente identifikuese, të përkthyera e të noterizuara. Kur kryhet një transferim i tillë, organi përgjegjës i policisë përkatëse lëshon një leje transferimi, e cila e shoqëron armën e gjahut deri në mbërritjen në destinacion. Arma e zjarrit duhet të shoqërohet me një dokument, i cili përfshin të gjitha të dhënat e përmendura në pikën 3 të këtij neni. Për transferimin e armës njoftohet vendi pritës, sipas adresës së autorizimit për blerje.

6. Ndalohet shitblerja e armëve, pjesëve të armës dhe municionit nga personat fizikë dhe juridikë përmes rrjeteve elektronike.".

Neni 30

Pas shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 40 shtohet shkronja "ë" me këtë përmbajtje:

"ë) punonjësit e misioneve policore të huaja për zhvillimin e operacioneve të përbashkëta me Policinë e Shtetit në territorin e Republikës së Shqipërisë.".

Neni 31

Në nenin 41 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Për të minimizuar rrezikun që armët e zjarrit dhe municionet të përdoren nga persona të paautorizuar, personat që janë autorizuar të mbajnë armë ose municione, kanë detyrimin për mbikëqyrjen e duhur të armëve të zjarrit dhe municioneve, si dhe rregullave për ruajtjen e duhur në mënyrë të sigurt.".

2. Pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7, 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

"6. Armët e zjarrit dhe municionet e tyre nuk ruhen së bashku, por mbahen veçmas. Arma e shkurtër ruhet me kyç bllokimi, duke mos qenë lehtësisht e aksesueshme.

7. Personi që disponon në mënyrë të ligjshme armën e zjarrit ose municionin në fjalë, detyrohet të kryejë mbikëqyrjen e saj dhe të kontrollojë veprimet gjatë mbajtjes, transportit ose përdorimit.

8. Niveli i shqyrtimit të imtësishëm i këtyre masave të ruajtjes duhet të pasqyrojë numrin dhe kategorinë e armëve të zjarrit dhe municioneve në fjalë.

9. Kriteret e sigurisë së armëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 32

Në nenin 43 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Armët e zjarrit, pjesët kryesore dhe municionet, sipas pikës 1 të këtij neni, ato të

grumbulluara me ligj nga Policia e Shtetit, të gjetura në terren, si dhe armët stok nga ristrukturimi i armatimit të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit Informativ të Shtetit i kalojnë Ministrisë së Mbrojtjes, me urdhër të përbashkët të titullarëve të autoriteteve përgjegjëse dhe ministrit të Mbrojtjes.".

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

"2/1. Ministrisë së Mbrojtjes, për armët, pjesët kryesore dhe municionet e tyre, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, i lejohet të kryejë procedura të demilitarizimit, asgjësimit të tyre dhe shitjes për skrap. Procedurave të demilitarizimit, asgjësimit dhe shitjes për skrap u nënshtrohen edhe armët e gjetura nëpër hotspote nga strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2/2. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni, ministri i Mbrojtjes me urdhër mund të vendosë ruajtjen e armëve të caktuara, të cilat kanë vlera muzeale.".

Neni 33

Pika 6 e nenit 45 ndryshohet si më poshtë:

"6. Armët e koleksionit që përbëjnë objekte të trashëgimisë kulturore, si dhe armët e shpallura pasuri kulturore u nënshtrohen parashikimeve të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore, sa u përket ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të tyre.".

Neni 34

Pas shkronjës "c" të nenit 51 shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç) me kërkesë të titullarit për të hequr dorë nga licenca.".

Neni 35

Pas shkronjës "c" të nenit 53 shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç) kur nxjerr armën nga vendbanimi pa autorizim.".

Neni 36

Pas nenit 56 shtohet neni 56/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 56/1
Autoritetet kompetente për dhënien e masave

1. Masat administrative, sipas neneve 52, 53, 56, pikat 2 dhe 3, jepen nga drejtori vendor i Policisë së Shtetit.

2. Masat administrative, sipas neneve 50, 51, 56, pikat 4 dhe 5, jepen nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.".

Neni 37
Dispozitë kalimtare

1. Karakteristikat grupore, llojet dhe parametrat teknikë të armëve të ftohta, për të cilat organi kompetent lëshon autorizim për mbajtjen nga shtetasit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Licencat e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të vlefshme deri në përfundimin e afatit të përcaktuar.

3. Autorizimi për mbajtje arme, i lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, për shtetasin mbi 70 vjeç, është i vlefshëm. Shtetasi që ka mbushur moshën 70 vjeç rinovon autorizimin për mbajtjen e armës çdo tre vjet.

Neni 38
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8/1, pika 2; 8/2, pika 3; 10, pika 9; 14, pikat 2 dhe 4; 17, pika 4; 18/1, pika 3; 18/2, pika 3, dhe 41, pika 9, të ligjit dhe nenit 37, pika 1, të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin udhëzimin në zbatim të pikës 7 të nenit 38 të ligjit.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë urdhër në zbatim të pikës 2 të nenit 43.

4. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë urdhër në zbatim të pikës 6 të nenit 19 të ligjit.

Neni 39
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11909, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11909, datë 8.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 152/2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, 'Për armët"'.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 154/2020

PËR REGJISTRIN QENDROR TË LLOGARIVE BANKARE[2]

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe i rregullave për krijimin e administrimin e Regjistrit Qendror të Llogarive Bankare dhe kasetave të sigurisë, si një bazë e të dhënave shtetërore, si dhe detyrimin e institucioneve financiare për të raportuar të dhënat sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë, për pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, për parandalimin e financimit të terrorizmit, si dhe për lehtësimin e procedurave të mbledhjes së detyrimeve tatimore, taksave apo tarifave, në nivel qendror apo vendor.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet nga të gjitha institucionet financiare, të cilat veprojnë në Republikën e Shqipërisë dhe ofrojnë shërbimet e llogarive bankare ose të kasetave të sigurisë për klientët e tyre.

Neni 4
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Regjistri" është Regjistri Qendror i Llogarive Bankare dhe i kasetave të sigurisë, si një bazë e të dhënave shtetërore, në të cilin regjistrohen e ruhen të dhënat, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në formë elektronike. Përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen në mënyrë të automatizuar, me ndërveprim, nëpërmjet një sistemi kompjuterik, që lejon identifikimin në

[2] Ky ligj është përafruar pjesërisht me:
- Direktivën (BE) 2018/843 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 30 maj 2018 që ndryshon Direktivën (BE) 2015/849 "Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit" dhe që ndryshon direktivat 2009/138/KE dhe 2013/36/BE. Numri CELEX 32018L0843, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 156, datë 19.6.2018, f. 43–74.
- Direktivën (BE) 2019/1153 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 qershor 2019 që vendos rregullat që lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacioneve të tjera për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të disa veprave penale dhe që shfuqizon vendimin e Këshillit 2000/642/DÇB. Numri CELEX 32019L1153, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 186, datë 11.7.2019, f. 122–137.

kohën e duhur të çdo individi, personi fizik ose juridik, që ka ose kontrollon llogari bankare të identifikuar nga IBAN dhe kasetat e sigurisë të mbajtura nga një institucion financiar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. "Llogari bankare" është llogaria e mbajtur nga një institucion financiar për një klient individ, person fizik ose juridik, e cila përfshin llogari depozitë, llogari rrjedhëse, llogari për kartë krediti, llogari pagese apo çdo lloj llogarie tjetër të ofruar nga një institucion financiar, pavarësisht statusit të saj: aktive, e bllokuar ose e fjetur.

3. "Kasetë sigurie" është kutia e sigurt, e vendosur zakonisht pranë një kasete bankare apo në një zonë sigurie të posaçme, me qëllim mbajtjen e sendeve me vlerë nga klientët.

4. "Mbajtës i llogarisë bankare" është individi, personi fizik ose personi juridik në emër të të cilit është e regjistruar llogaria bankare pranë një institucioni financiar.

5. "Institucion financiar" është çdo bankë ose subjekt financiar jo bankë, i cili, sipas legjislacionit në fuqi për bankat dhe për institucionet financiare jobankare në Republikën e Shqipërisë, ofron kontrata të llogarive bankare apo shërbimin e kasetave të sigurisë dhe ka detyrimin për raportim sipas këtij ligji.

6."IBAN" është numri identifikues ndërkombëtar i llogarisë bankare, i cili identifikon në mënyrë të qartë një llogari bankare individuale, elementet e së cilës përcaktohen nga standardet ndërkombëtare.

7. "Organizime ligjore" ka të njëjtin kuptim si në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

8. "Pronar përfitues" ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për pronarët përfitues.

9. "Person i autorizuar" është çdo person, i cili në bazë të një marrëveshjeje ose akti përfaqësimi mund të kryejë veprime në emër të mbajtësit të llogarisë apo të kasetës së sigurisë.

10."Subjektet e interesuara" janë subjektet që kanë akses në regjistër sipas niveleve të përcaktuara në këtë ligj ose në aktet nënligjore të tij si më poshtë:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;

b) Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm;

c) Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

d) Byroja Kombëtare e Hetimit;

dh)Shërbimi Informativ Shtetëror;

e) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;

ë) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

f) drejtoritë e taksave dhe tarifave pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;

g) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

11."Subjekte që kanë të drejtë të marrin informacion" janë personat fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, të cilët, me kërkesë të argumentuar pranë institucionit administrues të regjistrit, kanë të drejtë të marrin informacion nga regjistri. Këto subjekte janë:

a) shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror ose privat;

b) institucionet financiare;

c) çdo autoritet publik tjetër, që legjislacioni i posaçëm i jep të drejtën për të pasur informacion në regjistër.

12."Vigjilenca e duhur" ka të njëjtin kuptim si në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Neni 5

Regjistri Qendror i Llogarive Bankare

1. Regjistri krijohet si një bazë të dhënash shtetërore, ku grumbullohet në formë të organizuar informacioni i ruajtur në formë elektronike për çdo mbajtës të llogarive bankare dhe të kasetave të sigurisë, në të cilin regjistrohen të dhënat e raportuara nga institucionet financiare.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka akses të plotë, të menjëhershëm dhe të pafiltruar në të dhënat e regjistrit.

3. Subjekteve të tjera të interesuara u garantohet e drejta e aksesit vetëm për ato të dhëna të regjistrit që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale sipas legjislacionit të zbatueshëm.

4. Niveli i aksesimit, sipas pikës 3 të këtij neni, për subjektet e interesuara të përcaktuara në pikën 10 të nenit 4 të këtij ligji, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.

5. Informacioni i ruajtur në regjistër nuk është i disponueshëm për publikun.

Neni 6
Krijimi dhe administrimi i regjistrit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është institucioni administrues i regjistrit.

2. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është përgjegjëse për krijimin e sistemit, në mënyrë që të garantojë masat e përshtatshme për sigurinë e të dhënave, si dhe parimet e mjaftueshmërisë e proporcionalitetit lidhur me përpunimin e të dhënave.

Neni 7
Roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në zbatim të këtij ligji, është përgjegjëse për:

a) vënien në dispozicion të aksesit të regjistrit për subjektet e interesuara;

b) mbikëqyrjen e përputhshmërisë së institucioneve financiare me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj;

c) dhënien e informacionit për subjektet që kanë të drejtë të marrin informacion me kërkesë, sipas pikës 11 të nenit 4 të këtij ligji;

ç) kryerjen e veprimtarive në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Kërkesa dhe dhënia e informacionit, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, realizohen sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Subjektet që kanë të drejtë të marrin informacion me kërkesë duhet të ruajnë të dhënat e përdorura, sipas kësaj pike, për një periudhë 10-vjeçare.

Neni 8
Të dhënat e regjistrit

1. Regjistri përmban të dhënat e mëposhtme për mbajtësit individualë të llogarive bankare dhe kasetave të sigurisë:

a) emrin e mbiemrin e mbajtësit/mbajtësve të llogarisë bankare ose të individit, i cili ka apo i është vënë në dispozicion kaseta e sigurisë;

b) numrin e llogarisë bankare dhe kodin IBAN të llogarisë në rastet kur është llogari bankare;

c) numrin e identifikimit ose kodin identifikues të saj në rastet kur është kasetë sigurie;

ç) emrin e institucionit financiar që mban llogarinë bankare ose kasetën e sigurisë;

d) datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë dhe adresën e përhershme të mbajtësit të llogarisë bankare ose qiramarrësit të kasetës së sigurisë;

dh)emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e përhershme të çdo personi, që vepron në emër të mbajtësit të llogarisë bankare ose qiramarrësit të kasetës së sigurisë;

e) emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e përhershme të çdo individi që ka përfitim në llogari dhe/ose që është person i lidhur me mbajtësin e llogarisë, kasetat e sigurisë ose qiramarrësit e tyre;

ë) numrin personal të identifikimit për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe ekuivalentin e tij për shtetasit e huaj, nëse ka;

f) statusin e llogarisë bankare ose të kasetës së sigurisë;

g) datën e hapjes së llogarisë bankare ose të kasetës së sigurisë;

gj) datën e mbylljes, nëse llogaria ose kaseta e sigurisë është mbyllur; dhe

h) numrin e llojin e dokumentit të identifikimit të vlefshëm të përdorur në institucionin financiar gjatë procesit të vigjilencës së duhur.

2. Regjistri përmban të dhënat e mëposhtme kur një person fizik, person juridik ose organizim ligjor është mbajtës i llogarisë bankare ose qiramarrës i një kasete sigurie:

a) emrin e mbajtësit të llogarisë ose të qiramarrësit të kasetës së sigurisë;

b) numrin e llogarisë bankare dhe kodin IBAN të llogarisë në rastet kur është llogari bankare;

c) numrin e identifikimit ose kodin identifikues të saj në rastet kur është kasetë sigurie;

ç) emrin e institucionit financiar që mban llogarinë bankare ose kasetën e sigurisë;

d) selinë e regjistruar të personit fizik, të personit juridik ose të organizimit ligjor dhe, nëse

është e ndryshme, vendin kryesor të ushtrimit të aktivitetit;

dh)numrin unik të identifikimit të subjektit për personat juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, si dhe ekuivalentin e tij për subjektet e huaja;

e) emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e përhershme të çdo personi që është i autorizuar të veprojë në emër të mbajtësit të llogarisë ose të qiramarrësit të kasetës së sigurisë;

ë) emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e çdo individi pronar përfitues në llogarinë ose mbajtësin e llogarisë, kasetës së sigurisë ose qiramarrësit të saj;

f) emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e themeluesit, të përfituesve dhe të personit të autorizuar/të besuarit në rastet kur është një organizim ligjor;

g) numrin personal të identifikimit për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe ekuivalentin për shtetasit e huaj, nëse ka, për pronarët përfitues, themeluesit, përfituesit dhe personat e autorizuar;

gj) statusin e llogarisë bankare ose të kasetës së sigurisë;

h) datën e hapjes së llogarisë bankare ose të kasetës së sigurisë;

i) datën e mbylljes nëse llogaria është mbyllur; dhe

j) numrin e llojin e dokumentit të identifikimit të vlefshëm të përdorur në institucionin financiar gjatë procesit të vigjilencës së duhur.

3. Për qëllime të administrimit të regjistrit, të dhënat e tij klasifikohen në të dhëna parësore e dytësore si më poshtë:

a) të dhëna parësore konsiderohen:

i. numri identifikues në regjistër i llogarisë;

ii. numri identifikues në regjistër i institucionit financiar;

b) të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni.

4. Regjistri nuk përmban të dhëna për gjendjen e llogarive bankare dhe përmbajtjen e kasetave të sigurisë. Institucionet financiare nuk raportojnë të dhëna për gjendjen e llogarive bankare dhe përmbajtjen e kasetave të sigurisë.

Neni 9
Raportimi i të dhënave

1. Institucionet financiare duhet të krijojnë dhe të administrojnë sisteme që sigurojnë raportimin e të dhënave, siç përcaktohet në nenin 8 të këtij ligji, në kohë reale, pas përfundimit të veprimeve me mbajtësit e llogarisë bankare ose të kasetave të sigurisë.

2. Institucionet financiare i raportojnë të dhënat në regjistër në mënyrë elektronike, duke përdorur mekanizmin qendror të automatizuar sipas formatit të skedarit të raportimit.

3. Formati i skedarit të raportimit të të dhënave përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat, i cili hartohet në konsultim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Neni 10
Mbikëqyrja e zbatimit të detyrimit për raportim

1. Mbikëqyrja e zbatimit të detyrimit për raportim dhe e përputhshmërisë së të dhënave bankare të raportuara nga institucionet financiare realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Drejtoria nuk e delegon këtë kompetencë pranë degëve të saj rajonale.

2. Mbikëqyrje, sipas këtij ligji, është verifikimi i procesit të raportimit kur institucionet financiare nuk raportojnë të dhënat dhe verifikimi i saktësisë së të dhënave kur konstatohet mospërputhje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo kur kjo e fundit ka dijeni për mospërputhje nga burime të ligjshme.

3. Për qëllimet e këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve:

a) mbikëqyr përputhshmërinë e veprimtarisë së institucioneve financiare me kërkesat e këtij ligji;

b) kërkon nga çdo institucion financiar akses dhe vënien në dispozicion të çdo lloj informacioni dhe dokumenti, përfshirë kopje të tyre, që ka të bëjë me të dhënat sipas nenit 8 të këtij ligji, që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të institucioneve financiare në zbatim të këtij ligji;

c) mbikëqyr mënyrën e saktësinë e raportimit të të dhënave nga institucionet financiare;

ç) mund të urdhërojë institucionet financiare të ndërpresin çdo praktikë që është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 11
Detyrimi për ruajtjen e të dhënave

1. Të gjitha të dhënat e administruara nga regjistri dhe dokumentacioni tjetër ligjor ruhen të plota nga institucionet financiare për 10 (dhjetë) vjet nga mbyllja e llogarisë bankare ose e kasetës së sigurisë.

2. Në përfundim të afatit të ruajtjes së të dhënave personale, këto të dhëna fshihen nga regjistri.

3. Përpunimi i të dhënave personale dhe informimi i subjektit të të dhënave personale nga ana e institucioneve financiare kryhet sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 12
Marrja e të dhënave për qëllime statistikore

1. Organet publike që janë përgjegjëse për publikimin e statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për statistikat zyrtare, mund të kërkojnë informacion nga regjistri për t'u përpunuar për qëllime statistikore.

2. Informacioni i kërkuar, sipas pikës 1 të këtij neni, jepet vetëm në formë të anonimizuar.

Neni 13
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave në regjistër

1. Institucionet financiare janë përgjegjëse për saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të raportuara në bazë të këtij ligji dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për këtë qëllim. Nëse institucionet financiare zbulojnë se ndonjë prej të dhënave të raportuara për qëllim të këtij ligji është e pasaktë ose e paplotë, njoftojnë menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë, njësinë përgjegjëse për regjistrin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, duke marrë masa njëkohësisht për korrigjimin e të dhënave të pasakta ose të paplota dhe duke i raportuar ato sërish.

2. Nëse organet që kanë akses në të dhënat e këtij regjistri vërejnë se të dhënat e raportuara apo të mbajtura në regjistër janë të pasakta apo të paplota, njoftojnë pa vonesë njësinë përgjegjëse për regjistrin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila merr masa për komunikimin me institucionin financiar raportues e korrigjimin e pasaktësive të konstatuara.

Neni 14
Përdorimi i të dhënave të marra në regjistër

Të dhënat e mbajtura në regjistër përbëjnë sekret bankar e profesional dhe duhen trajtuar e ruajtur si të tilla nga të gjitha autoritetet që kanë akses në to.

Neni 15
Përjashtim nga e drejta për informim

Legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit në Republikën e Shqipërisë nuk është i zbatueshëm për informacionin e mbajtur në regjistër dhe përdorimin e tij nga autoritetet përgjegjëse.

Neni 16
Publikimi i të dhënave vjetore për përdorimin e regjistrit

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon brenda tremujorit të parë të çdo viti raportin publik vjetor për vitin pararendës për përdorimin e regjistrit. Raporti duhet të përfshijë edhe statistika të hollësishme të anonimizuara për numrin e organeve, të cilat kanë aksesuar në regjistër, duke përfshirë numrin e personave të kërkuar prej tyre.

Neni 17
Kundërvajtjet administrative

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) mosdërgimi i informacionit dhe i të dhënave në mënyrën e përcaktuar në pikën 2 të nenit 9 të këtij ligji, ose raportimi i të dhënave të rreme në regjistër nga institucionet financiare dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë;

b) mosmarrja e masave nga ana e institucioneve financiare për korrigjimin e gabimeve në të dhënat e raportuara në regjistër, qofshin këto të konstatuara vetë apo të evidentuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë;

c) përdorimi i të dhënave nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj, në kundërshtim me nenin 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë;

ç) përdorimi i paautorizuar i të dhënave nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj ose përdorimi i të dhënave në kundërshtim me qëllimin e dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tij nënligjore, dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Gjoba vendoset nga titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Formati i modelit të gjobës sipas këtij neni përcaktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

4. Kundër vendimit të dhënë për vendosjen e gjobës mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën administrative kompetente, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 18

Përgjegjësia në rastin e forcave madhore

1. Institucionet financiare nuk mbajnë përgjegjësi për mospërmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, që vijnë si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, të luftërave, të trazirave të tjera civile dhe fatkeqësive natyrore.

2. Institucioni financiar që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet në përputhje me këtë ligj për shkaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, njofton me shkrim menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për shkakun e shkallën e problemit që e ka penguar atë në përmbushjen e detyrimeve, si dhe bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të rifilluar përmbushjen e detyrimeve sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 19

Dispozitat e fundit

1. Institucionet financiare të identifikojnë, të krijojnë e të mbajnë dokumentet përkatëse për mbajtësit e llogarive bankare brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit ndërton regjistrin brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Institucionet financiare duhet të transmetojnë të dhënat e kërkuara nga ky ligj për mbajtësit e llogarive bankare dhe të kasetave të sigurisë jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga krijimi i regjistrit.

4. Raportimi i parë i institucioneve financiare duhet të përfshijë edhe të dhënat për llogaritë bankare ose kasetat e sigurisë të mbyllura 5 vitet e fundit. Përjashtimisht, për llogaritë e mbyllura përpara datës 1.1.2020, institucionet financiare raportojnë ato të dhëna që disponojnë.

Neni 20

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë udhëzimin në zbatim të pikës 3 të nenit 9 të këtij ligji.

3. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë urdhrin në zbatim të pikës 3 të nenit 17 të këtij ligji.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11910, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11910, datë 8.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 154/2020, "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

AKT NORMATIV
Nr. 1, datë 10.1.2021

PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË MARRËVESHJES, PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN, NGA DHE NDËRMJET *PFIZER EXPORT BV*, DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN, AUTORIZIMIN E PROCEDURËS PËR LEJIMIN E HYRJES DHE ADMINISTRIMIT TË VAKSINAVE ANTI-*COVID-19* NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, SI DHE PËRDORIMIN E TYRE NË POPULLATË

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i tekstit të marrëveshjes

Miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet Pfizer Export BV, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2
Aprovimi i përdorimit të vaksinës në popullatë

Vaksinat anti-*COVID-19* aprovohen për përdorimin në popullatë bazuar në aprovimin e *Food and Drugs Administration* të Shteteve të Bashkuara (FDA) të Amerikës dhe/ose *European Medicine Agency* (EMA) të Bashkimit Evropian.

Neni 3
Detyrimet e organeve shtetërore

1. Autorizohen ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Instituti i Shëndetit Publik të nënshkruajnë marrëveshjen për blerjen e vaksinës anti-*COVID-19* (*Pfizer-BioNTech COVID-19 Vaccine*) me Pfizer BV, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

2. Autorizohet Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të lëshojë menjëherë lejen e importit për vaksinat anti-*COVID-19*, si për sasinë dhe llojin e përcaktuar në këtë marrëveshje ashtu dhe për çdo sasi dhe lloj tjetër jashtë kësaj marrëveshjeje, sipas kushteve dhe dokumentacionit të prodhuesit, duke përjashtuar produktin nga detyrimi për t'u shkruar paketimi në gjuhën shqipe dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga legjislacioni për barnat.

3. Autorizohet Instituti i Shëndetit Publik të administrojë procesin e transportit, të ruajtjes, të magazinimit, të shpërndarjes, të përdorimit në popullatë të vaksinës anti-*COVID-19* dhe fushatën e vaksinimit, si për sasinë dhe llojin e përcaktuar në këtë marrëveshje ashtu dhe për çdo sasi dhe lloj tjetër jashtë kësaj marrëveshjeje, sipas kushteve të përcaktuara nga prodhuesi, duke lidhur kontrata direkte me kontraktorët për mallra, punë dhe/ose shërbime për plotësimin e këtyre detyrimeve.

4. Autorizohet Instituti i Shëndetit Publik të kryejë parapagimet e dozave të vaksinave dhe pagesat respektive, sipas kushteve të cituara në marrëveshjen e lidhur ndërmjet palëve.

5. Policia e Shtetit të marrë masa për të garantuar sigurinë gjatë transportit dhe sigurinë e ambienteve ku do të ruhet dhe administrohet vaksina anti-*COVID-19*.

Neni 4
Përjashtimi nga detyrimet

1. Të gjitha procedurat për mallra punë dhe/ose shërbime, si transporti, magazinimi, ruajtja, shpërndarja, përdorimi në popullatë i vaksinës anti-*COVID-19* dhe fushata e vaksinimit, si për sasitë dhe llojin, të përcaktuara në marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ, apo për çdo sasi dhe lloj tjetër jashtë kësaj marrëveshjeje, përjashtohen nga parashikimet e legjislacionit aktual për prokurimet publike, si dhe çdo akti nënligjor, që kërkon miratim të posaçëm të kontratës së nënshkruar.

2. Të gjitha transaksionet që lidhën me përfitimin e vaksinës anti-*COVID-19*, të përcaktuara në marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ, apo për çdo sasi dhe lloj tjetër jashtë kësaj marrëveshjeje, si dhe palët respektive, përjashtohen nga të gjitha detyrimet fiskale.

3. Marrëveshja për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet *Pfizer Export BV* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga *Pfizer Export BV* nuk do të publikohet në asnjë *website* të institucioneve apo në Fletoren Zyrtare.

4. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit apo janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

Neni 5
Efektet financiare

Efektet financiare që rrjedhin nga marrëveshja bashkëlidhur këtij akti normativ, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2021.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1121, datë 30.12.2020

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRGJITHSHËM ANALITIK TË PROJEKTAKTEVE, QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE GJATË VITIT 2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" , me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2021

Ministria e Mbrojtjes

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017–2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për rezervat materiale të shtetit"	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori I	Përshtatja me ndryshimin e përgjegjësisë administrative nga MB-ja të MM-ja. Gjithashtu, përshtatja me ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" .	Mirëpërcaktimi i kompetencave të të Rezervave Materiale të Shtetit dhe bashkëpunimit me organet e tjera shtetërore.	Jo	Jo	N/A	Po
2	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9047, datë 10.7.2003, "Për shërbimin ushtarak në RSH"	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori I	Rishikimi i pjesshëm i ligjit.	Ndryshimi i moshës për shërbimin ushtarak në rezervë.	Jo	Jo	N/A	Po
3	"Për përcaktimin e specialiteteve në FA"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori I	Përcaktimi i specialiteteve në Forcat e Armatosura të RSH, me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes	Përcaktimi i specialiteteve në Forcat e Armatosura të RSH-së.	Jo	Jo	N/A	Jo
4	"Për përcaktimin e listën e aerodromeve civile, që mund të caktohen si aeroporte rezervë të Forcave të Armatosura gjatë gjendjeve, për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori I	Me qëllim përcaktimin paraprak të aeroporteve civilë që do të përdoren nga FARSH gjatë situatave ku kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme.	Miratimi i listës së aeroporteve civile që do të përdoren nga FARSH gjatë situatave ku kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme.	Jo	Jo	N/A	Jo
5	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 694, datë 21.11.2018, "Për miratimin e modelit të uniformës, gradave dhe shenjave që mbahen në uniformë, si dhe stemave"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori I	Rishikimi i modelit të uniformës, gradave dhe shenjave që mbahen në uniformë.	Përfshirja e albumit të modelit të stemave të strukturave dhe flamujve dekorativë që mbajnë FARSH, rregullime dhe ndryshime në të gjitha albumet ekzistuese.	Jo	Jo	N/A	Jo
6	"Mbi zhvillimin e stërvitjes së përbashkët "Defender Europe 21"	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori I	Me qëllim marrjen e autorizimit nga Kuvendi i RSH për hyrjen e trupave të huaj në RSH është e nevojshme dërgimi për miratim i projektligjit.	Marrja e autorizimit dhe zhvillimi i stërvitjes në territorin e RSH.	Jo	Jo	N/A	Jo
7	"Për miratimin e stemës dhe flamurit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori I	Pika 2 e nenit 6 përcakton se Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka stemën dhe flamurin e vet, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.	Miratimi i stemës dhe flamurit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes	Jo	Jo	N/A	Jo
8	"Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori I	Përcaktimi i rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe përfarimi i pjesshëm i Direktivës 2009/81/KEE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 13 korrik	Përcaktimi i rregullave për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.	Po, Kapitulli 5	Jo	N/A	Jo

					2009, për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të caktuara të punëve, kontratave të mallrave dhe kontratave të shërbimit përmes institucioneve ose enteve kontraktore në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, dhe ndryshimin e Direktivës 2004/17/KE dhe 2004/18/KE					
9	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 13/2015 'Për policinë ushtarake në Forcat e Armatosura të RSH-së'"	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori II	Rishikim i pjesshëm i ligjit.	Mirëpërcaktimi i kompetencave dhe ndarjes së detyrave.	Jo	Jo	N/A	Po
10	"Për krijimin dhe mënyrën e administrimit të Bazës së të Dhënave të humbjeve nga Fatkeqësitë"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori II	Pika 2 e nenit 48 përcakton se Baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë krijohet dhe funksionon pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas përcaktimit për mënyrën e mbledhjes dhe administrimit të dhënave të humbjes nga fatkeqësitë, të bërë me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.	Krijimi dhe përcaktimin i mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të Bazës së të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë.	Jo	Jo	N/A	Jo
11	"Për miratimin e flamurit, stemës dhe uniformës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori II	Neni 23, pika 2, e ligjit nr. 45/2019, ka përcaktuar se Agjencia ka flamurin, stemën dhe uniformën e saj, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile.	Përcaktimi i stemës, flamurit dhe uniformës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.	Jo	Jo	N/A	Jo
12	"Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori II	Neni 40, pika 3, e ligjit nr. 45/2019 parashikon se kriteret dhe procedurat për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile.	Përcaktimi i procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.	Jo	Jo	N/A	Jo
13	"Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori II	Neni 65, pika 3, e ligjit nr. 45/2019, ka parashikuar se procedurat dhe kriteret e ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.	Përcaktimi i procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile	Jo	Jo	N/A	Jo
14	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin 305, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e shpenzimeve të atasheve ushtarakë, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes, që shërbejnë në shtabet e NATO-s e në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, dhe të ushtarakëve shqiptarë dhe personelit civil, që shërbejnë pranë organizatave ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare" , i ndryshuar"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori II	Nëpërmjet Projektvendimit synohet të përmirësohen aspektet e trajtimit financiar dhe përballimit të shpenzimeve të personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të emëruar jashtë vendit, si dhe të familjarëve që e shoqërojnë këtë personel.	Përmirësimi i trajtimit financiar dhe përballimit të shpenzimeve të personelit ushtarak dhe civil të MM/FA, të emëruar jashtë vendit, si dhe të familjarëve që shoqërojnë këtë personel.	Jo	Jo	N/A	Jo
15	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004,	Projektligj	Ministri i	Katërmujori II	Rishikim i pjesshëm i ligjit.	Të njihet si vjetërsi në punë e	Jo	Jo	N/A	Po

	"Për statusin e ushtarakut të FA-së"		Mbrojtjes			ushtarakut të Forcave të Armatosura, për efekt pensioni, periudha nga data e hyrjes në shërbim të Forcave të Armatosura, si ushtar me pagesë/profesionist, kursant (nënoficer), student në shkollat e larta ushtarake dhe student të diplomuar në shkollat civile të dërguara si kontingjent në interes të Ministrisë së Mbrojtjes.				
16	"Për miratimin e 'Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Turqisë për trajnimin dhe bashkëpunimin në fushën e shëndetit ushtarak"'	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori II	Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për trajnimin, teknikat dhe bashkëpunimin shkencor në fushat ushtarake, e datës 29 korrik 1992, me dëshirën për të vendosur bashkëpunimin në fushën e shëndetit në sferën ushtarake, palët dakordësohen për nënshkrimin e këtij protokolli	Qëllimi i këtij Protokolli është vendosja e kushteve sipas të cilave Palë bashkëpunojnë në fushat e specifikuara në këtë Protokoll, brenda përgjegjësisë së autoriteteve kompetente, duke zhvilluar bashkëpunimin. Bashkëpunimi bëhet në bazë të reciprocitetetit, duke pasur parasysh interesat dhe nevojat e ndërsjella të Palëve.	Jo	Siguria Kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale	N/A	N/A
17	"Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Polonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes"	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori II	Projektakti është propozuar për t përcaktuar kornizat ligjore dhe dispozitat e përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet palëve për çështjet e mbrojtjes.	Projektakti parashikon në vija të përgjithshme bashkëpunimin në fushat e operacioneve të kërkim-shpëtimit, stërvitjet e përbashkëta ushtarake, trajnimin dhe edukimin e personelit civil dhe ushtarak, industrinë e mbrojtjes, shkencën dhe teknologjinë etj.	Jo	Siguria Kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale	N/A	N/A
18	Për tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore ose degraduese	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Synon të përafrojë pjesërisht Rregulloren e BE-së, CELEX 02005R1236 të 27 qershorit 2005, "Për tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese" , ndryshuar me Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (EU) 2016/2134, datë 23 nëntor 2016.	Përcaktimi i kritereve për import-eksportin e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese.	Po, Kapitulli 30	Politika e Jashtme dhe e Sigurisë	N/A	Po
19	"Për ngritjen e sistemit të gjurmimit të artikujve piroteknikë"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 2014/58/EU e datës 16 prill 2014, e cila, në vijim të Direktivës 2007/23/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, krijon sistemin e gjurmimit të artikujve piroteknikë.	Ngritja e sistemit të gjurmimit të artikujve piroteknikë	Po, Kapitulli 1	Siguria Kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale	N/A	Jo

20	"Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2019/2199 e 17 Tetorit 2019 që ndryshon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 428/2009 për krijimin e një regjimi Komunitar për kontrollin e eksporteve, transferimin, ndërmjetësimin dhe tranzitin e artikujve me përdorim të dyfishtë dhe Lista e Përbashkët e Bashkimit Evropian e Miratuar nga Këshilli më 17 Shkurt 2020 (Pajisje që mbulohen nga Vendimi i përbashkët i Këshillit 2008/944/CFSP që përcakton rregulla të përbashkëta për eksportin e pajisjeve dhe teknologjisë ushtarake) (përditësim dhe zëvendësim i listës së BE-së e miratuar nga Këshilli në 18 Shkurt 2019).	Përcaktimi i listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare	Po, Kapitulli	Siguria Kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale	N/A	Jo
21	"Për miratimin e listës së mallrave të cilët mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Anekset II-III-IV të Rregullores (BE) 2019/125 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 Janarit 2019 në lidhje me tregtinë e mallrave të caktuara që mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues	Përcaktimi i listës së mallrave të cilët mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese	Po, Kapitulli 30	Politika e Jashtme dhe e Sigurisë	N/A	Jo
22	"Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Pika 3 e nenit 38 përcakton se trajtimi i vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.	Trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive.	Jo	Jo	N/A	Jo
23	"Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numri dhe mënyra e përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Pika 4 e nenit 50 përcakton se llojet e sinjaleve të alarmit, numri dhe mënyra e përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.	Përcaktimi i llojeve të sinjaleve të alarmit, numri dhe mënyra e përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive.	Jo	Jo	N/A	Jo
24	"Për miratimin e rregullave për bashkëpunimin ndërmjet strukturave shtetërore dhe subjekteve private për paralajmërimin e hershëm, monitorimin, njoftimin dhe alarmin në rast fatkeqësie"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Pika 3 e nenit 51 përcakton se kriteret për identifikimin e subjekteve private, strukturat përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullat për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.	Përcaktimi i kritereve për identifikimin e subjekteve private, strukturave përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullave për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre.	Jo	Jo	N/A	Jo
25	"Për përbërjen dhe detyrat e sektorëve të mbrojtjes civile në ministritë e linjës" .	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Neni 22, pika 4, e ligjit nr. 45/2019, parashikon se në ministritë e linjës do të ketë pozicione pune deri në	Përcaktimi i përbërjes dhe detyrave të sektorëve të mbrojtjes civile në ministritë	Jo	Jo	N/A	Jo

					nivel sektori për mbrojtjen civile.	e linjës.				
26	"Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjen civile" .	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Neni 23, pika 6, germa "d" , e ligjit nr. 45/2019, ka përcaktuar se AKMC-ja planifikon fonde për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile, kriteret dhe procedurat e akordimit të të cilave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.	Përcaktimi i kritereve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar	Jo	Jo	N/A	Jo
27	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 439, datë 13.5.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumentit "Politikat dhe procedurat e funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)" , të ndryshuar.	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Me qëllim përmirësimin e punës dhe bashkëpunimit midis institucioneve është i nevojshëm rishikimi i vendimit me qëllim mirëpërcaktimin e kompetencave dhe detyrave të secilit institucion në varësi të fushës së përgjegjësisë.	Mirëpërcaktimi i kompetencave dhe detyrave të secilit institucion në varësi të fushës së përgjegjësisë.	Jo	Jo	N/A	Jo
28	"Për organizimin dhe funksionimin e IGJIU-së"	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Me qëllim rregullimin e veprimtarisë së IGJIU-së pas miratimit të strukturës së re organizative, ku Institutit Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë iu bashkua Instituti i Studimeve dhe Projektimit të Mbrojtjes (ISPMb) është e domosdoshme të bëhet ndryshimi i ligjit ekzistues me një ligj të ri.	Përcaktimi i qartë i ndarjes se kompetencave dhe detyrave në përputhje me strukturën e re organizative të IGJIU-së.	Jo	Jo	N/A	Po
29	"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga implementimi i projekteve për kthimin e Bazës Ajrore Kuçovë në Bazë Ajrore Taktike (TACAIR) të NATO-s/Paketa e Kapaciteteve CP9A1385- Kuçova Airbase"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Me qëllim vijimin e procedurave për implementimin e projekteve për kthimin e Bazës Ajrore Kuçovë në Bazë Ajrore Taktike (TACAIR) të NATO-s/Paketa e Kapaciteteve CP9A1385- Kuçova Airbase duhet të realizohet shpronësimi i pronës private dhe kalimi i tyre në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.	Shpronësimi, për interes publik i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private dhe kalimi në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes të këtyre pasurive me qëllim implementimin e projekteve për kthimin e Bazës Ajrore Kuçovë në Bazë Ajrore Taktike (TACAIR) të NATO-s/Paketa e Kapaciteteve CP9A1385- Kuçova Airbase" .	Jo	Jo	N/A	Jo
30	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 121/2015 'Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit (PAZH) të FA 2016–2025'"	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Rishikimi i PAZH duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit në FARSH.	Përditësimi i PAZH me ndryshimet e viteve të fundit.	Jo	Jo	N/A	Jo
31	"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për ndërtimin e vendprehjeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, "Për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë" , ratifikuar me ligjin nr.	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Zbatimi i detyrimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë "Për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë Luftës Greko-Italiane të viteve 1940–1941 dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta	Shpronësimi, për interes publik, i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit për ndërtimin e vendprehjeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë Luftës Greko-Italiane të viteve 1940–1941	Jo	Jo	N/A	Jo

	10256, datë 25.3.2010"				brenda territorit të Republikës së Shqipërisë" , ratifikuar me ligjin nr. 10256, datë 25.3.2010.					
32	"Për Memorandumin e Mirëkuptimit lidhur me funksionimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe personelin e Qendrës së Përbashkët të Informacionit të NATO-s (NIFC)"	Projektligj	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Memorandumi i propozuar është rishikimi nga fillimi i NIFC pasi termat, teknologjitë, mënyrat efikase të organizimit dhe funksionimit ndër vite kanë ndryshuar dhe evoluar si dhe shfuqizimi i MOU që aktualisht është në fuqi.	Qëllimi i memorandumit është vendosja e parimeve për organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe plotësimin me personel të IFC-së, si dhe për ndarjen e buxhetit shumëkombësh ndërmjet pjesëmarrësve.	Jo	Siguria Kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale	N/A	N/A
33	"Për Memorandumin e Mirëkuptimit (MoU) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në lidhje me dhënien e pajisjeve dhe shërbimeve të sigurisë për komunikimin në kuadrin e infrastrukturës së menaxhimit të çelësave kriptografik, të koduar në Organizatën e Traktatit Atlantik Verior (NATO KMI)"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Në kuadër të masave për modernizimin e mbrojtjes kriptografike në Sistemin e Komunikimit dhe të Informacionit me vendet anëtare dhe strukturat e veta, NATO-ja ka planëzuar që të zëvendësojë Sistemin aktual të Shkëmbimit Elektronik të Çelësave Kriptografik (DEKMS) me një sistem të ri, të emërtuar "Infrastruktura e Menaxhimit të Çelësave të NATO-s (DKMI)" .	Ky Memorandum Mirëkuptimi (MoU) ka për qëllim lehtësimin e ngritjes së një sistemi menaxhimi të koduar elektronik të sigurt dhe modern, ndërmjet Shteteve të NATO-s dhe organeve civile dhe ushtarake të NATO-s, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve të Agjencisë Kombëtare të Sigurisë/Shërbimi Qendror i Sigurisë, Departamenti i Mbrojtjes, nëpërmjet Agjencisë së Shpërndarjes së Kontabilitetit të Komitetit Ushtarak të NATO-s (DACAN) i jep në huapërdorje një komplet pajisjesh elektronike të njohura si Infrastrukturë e Menaxhimit të Çelësave Kriptografik të NATO-s (DKMI) Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Drejtoria e Shifrës e Ministrisë së Mbrojtjes.	Jo	Siguria Kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale	N/A	N/A
34	"Përcaktimin e rregullave të prokurimit për kontratat për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Sipas shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 5 përcaktohet përbërja, mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komisionit të klasifikimit do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.	Përcaktimi i rregullave të prokurimit për kontratat për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e	Jo	Jo	N/A	Jo

						organizimit dhe të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave.				
35	"Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Pika 1 e nenit 10 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" përcakton se Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.	Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.	Jo	Jo	N/A	Jo
36	"Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Pika 4 e nenit 14 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" përcakton se Plani Kombëtar për Emergjencat Civile miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.	Miratimi i Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.	Jo	Jo	N/A	Jo
37	"Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Pika 3 e nenit 47 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" përcakton se ngritja dhe funksionimi i sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112 miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit përgjegjës për emergjencat civile dhe të ministrit përgjegjës për punët e brendshme.	Ngritja dhe funksionimin i sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente.	Jo	Jo	N/A	Jo
38	"Për vlerësimin e riskut në nivel qendror"	Projektvendim	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Pika 3 e nenit 9 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" përcakton se vlerësimi i riskut në nivel qendror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.	Realizimi i vlerësimit të riskut në nivel qendror.	Jo	Jo	N/A	Jo

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2021										
Ministria e Brendshme										
Nr.	**Titulli i projektaktit**	**Lloji i projektaktit**	**Ministri propozues**	**Katër mujori**	**Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit**	**Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti**	**A është parashikuar projektakti në PKIE?** **Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës**	**Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017-2021** **Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program**	**Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale** **Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë**	**Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore** **Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse**
1	Projektligji "Për prefektët"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Përmirësimin e ligjit organik duke qartësuar dhe rritur rolin e prefektit të qarkut. (Dërguar në KM 2020)	Projektligji ka si qëllim rritjen e rolit të prefektit të qarkut duke saktësuar mënyrën e verifikimit të realizimit të funksioneve nga ana e pushtetit vendor, të përgjegjësive të deleguara nga pushteti qendror dhe përdorimin e fondeve të parashikuara për këto funksione.	Jo	3. Shërbimet publike	Ndërthuret me Strategjinë e Decentralizimit dhe Vetëqeverisjes Vendore	Po
2	Për një ndryshim në VKM-në nr. 421, datë 13.5.2015, "Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ky projektvendim propozohet të ndryshohet në kuadër të procesit të deregulimit.	Lehtësimin i ofrimit të shërbimeve ndaj personave fizikë dhe juridikë që kërkojnë të licencohen për të zhvilluar veprimtari të lejuara me armët në zbatim të ligjit nr. 74/2014 "Për armët"	Jo	3.1.1 Administrata Publike dhe Digjitalizimi	Strategjia për kontrollin e AVL	Po
3	Për disa ndryshime në VKM-në nr. 275, datë 1.4.2015 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ky projektvendim propozohet të ndryshohet në kuadër të procesit të deregulimit.	Lehtësimin i ofrimit të shërbimeve.	Jo	3.1.1 Administrata Publike dhe Digjitalizimi	Strategjia për kontrollin e AVL	Po
4	Për disa ndryshime në VKM-në nr. 94, datë 4.2.2015 "Për procedurat për armët në rastet e vdekjes, deklarimit të mbylljes ligjore të aktivitetit, për qëllime studimore, të humbjes së armës, vjedhjes së saj apo dokumentit/autorizimit"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ky projektvendim propozohet të ndryshohet në kuadër të procesit të deregulimit.	Lehtësimin i ofrimit të shërbimeve.	Jo	3.1.1 Administrata Publike dhe Digjitalizimi	Strategjia për kontrollin e AVL	Po
5	Për disa ndryshime në VKM-në nr. 95, datë 4.2.2015 "Për procedurat për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut për jetën dhe pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje armë"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ky projektvendim propozohet të ndryshohet në kuadër të procesit të deregulimit.	Lehtësimin i ofrimit të shërbimeve.	Jo	3.1.1 Administrata Publike dhe Digjitalizimi	Strategjia për kontrollin e AVL	Po
6	Për disa ndryshime në VKM-në nr. 96, datë 4.2.2015, "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të deklarimit, ruajtjes, regjistrimit dhe aftësimit për armët e koleksionit"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ky projektvendim propozohet të ndryshohet në kuadër të procesit të deregulimit.	Lehtësimin i ofrimit të shërbimeve.	Jo	3.1.1 Administrata Publike dhe Digjitalizimi	Strategjia për kontrollin e AVL	Po
7	Për miratimin e llojeve të armatimit, municionit dhe pajisjeve mbrojtëse të përdorimit të forcës për pajisjen e Policisë së Shtetit	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ndryshimet në ligjin nr. 74/2014 "Për armët" , kryesisht në kategorizimin e armëve e municioneve dhe përcaktimit të tyre që përdoren në kompletim të strukturave shtetërore, duhet të reflektohen dhe në aktet për armët, municionet dhe pajisjet në kompletim të PSH-së	Rishikimi dhe ristrukturimi tabelave organik të kompletimit të strukturave të PSH-së me armatim, municion dhe pajisje mbrojtëse të përdorimit të forcës.	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Jo	Po
8	Për disa ndryshime në VKM-në nr. 348, datë 29.4.2015, "Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ky Projektvendim propozohet të ndryshohet në kuadër të procesit të deregulimit.	Lehtësimin i ofrimit të shërbimeve.	Jo	3.1.1 Administrata Publike dhe Digjitalizimi	Jo	Po

	me armë të kategorive "B" , "C" , e "D" në territorin e Republikës së Shqipërisë"									
9	Për një ndryshim në VKM-në nr. 153, datë 7.4.2004, "Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ndryshimet e Rregullores janë rrjedhim i ndryshimeve të mundshme të Kodit Rrugor	Ndryshimet do të prekin normat e sjelljes dhe disa nga normat e kapitullit të lejeve të drejtimit dhe të mjeteve	Jo	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	Po	Po
10	"Kushtet minimale të jetesës dhe kushtet e jetës sociale"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë"	Rregullon Kushtet minimale të jetesës dhe kushtet e jetës sociale të azilkërkuesve	**Jo**	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Jo	Po
11	"Për kriteret e emërimit, shkaqet e lirimit apo të shkarkimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë"	Rregullon organizimin dhe funksionimin e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatë	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Jo	Po
12	"Organizimi dhe funksionimi i Qendrës së Pritjes për Azil"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për azilin në Republikën e Shqipërisë"	Mënyra si do të organizohet dhe rregullohet QKPA	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Jo	Po
13	"Për disa ndryshime në VKM-në nr. 895, datë 21.12.2016 "Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njehsimin me funksionet korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Kjo VKM propozohet të ndryshohet për shkak problematikave gjate zbatimit të praktik	Kjo VKM parashikon të ndryshojë tabelën e gradave, duke e rishikuar për më mirë motivimin e personelit në ecurinë e tyre në karrierë, sidomos për pozicionin e shefit të MZSH të bashkive të vogla.	Jo	Jo	Nuk ka	Po
14	"Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të policisë së burgjeve, të policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Reformimi i SHÇBA-së në Agjenci tërësisht civile kërkon që punonjësit e Agjencisë të ruajnë statusin e njëjtë siç dhe e kishin me pare, ndërkohë që gjithë punonjësit të përfitojnë statusin e njëjtë me subjektet që ata mbikëqyrin.	Ndryshimi I emrit nga Shërbimi I Kontrollit të Brendshëm në Agjenci e Mbikëqyrjes Policore si dhe përcaktimi që statusin e përfitojnë të gjithë punonjësit e Agjencisë	Jo	II.2 Lufta kundër korrupsionit	Nuk ka	Po
15	Për miratimin e Rregullores "Mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në Ministrinë e Brendshme"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Në kuadër të ndryshimeve që do të miratohen në ligjin 70/2014 "Për shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme" . Ndryshimet e këtij ligji sjellin nevojën e përshtatjes së rregullores së Shërbimit, në zbatim të tij. Miratimi I projektligjit të ri kërkon sinkronizimin e akteve nënligjore në zbatim të tij.	Kjo rregullore është e përbërë nga tri pjesë, organizimi dhe funksionimi, rregullore e personelit dhe rregullores e disiplinës. Përshtatja e tyre me ndryshimet ligjore do të bëjë më efektiv zbatimin e këtij ligji	Jo	II.2 Lufta kundër korrupsionit	Nuk ka	Po
16	"Për një ndryshim në VKM-në nr. 793, datë 24.9.2010, "Për zbatimin e ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Reformimi i SHÇBA-SE në Agjenci tërësisht civile kërkon që punonjësit e Agjencisë të ruajnë statusin e njëjtë siç dhe e kishin me pare, ndërkohë që gjithë punonjësit të përfitojnë statusin e njëjtë me subjektet që ata mbikëqyrin.	Përfitimi i statusit nga të gjithë punonjësit e Agjencisë, kërkon ndryshimin e përcaktimin në VKM në të cilin përcaktohen se statusin e përfitojnë vetëm punonjësit me grada.	Jo	II.2 Lufta kundër korrupsionit	Nuk ka	Po

	(ndryshuar me VKM-së nr. 252, datë 9.2.2011 dhe nr. 657, datë 10.10.2019)									
17	"Për miratimin e Strukturës organike dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve të Gardës së Republikës dhe përcaktimin e gradës korresponduese për funksion"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për Gardën e Republikës"	Ndryshimi i emërtimeve të strukturave dhe funksioneve	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Nuk ka	Po
18	"Për përcaktimin e objekteve që ruan dhe mbron Garda e Republikës"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për Gardën e Republikës"	Shfuqizimin e disa VKM-ve dhe hartimin e një VKM-je të vetme për objektet në ruajtje nga Garda	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Nuk ka	Po
19	"Për përcaktimin e personaliteteve shtetërore dhe banesave të tyre që ruhen nga Garda e Republikës dhe kohëzgjatja e ruajtjes"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për Gardën e Republikës"	Shfuqizimin e disa VKM-ve dhe hartimin e një VKM-je të vetme për personalitetet në ruajtje nga Garda	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Nuk ka	Po
20	"Për trajtimin financiar të punonjësve të Gardës së Republikës gjatë marrëdhënieve të punës"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për Gardën e Republikës"	rregullimin e trajtimit financiar	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Nuk ka	Po
21	"Për trajtimin financiar të familjarëve të punonjësve të Gardës së Republikës që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për Gardën e Republikës"	rregullimin e trajtimit financiar	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Nuk ka	Po
22	"Për përcaktimin e llojit të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese, të mjeteve e pajisjeve të tjera kufizuese për përdorimin e forcës nga Garda e Republikës"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për Gardën e Republikës"	ligjërimin e përdorimit të të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese, të mjeteve e pajisjeve të tjera kufizues, dispozita ligjore të munguara në dispozitat aktuale	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Nuk ka	Po
23	"Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për Gardën e Republikës"	Rregullimi i Veprimtarisë së Gardës duke implementuar në një Rregullore të vetme Rregulloren e personelit, disiplinës etj.	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Nuk ka	Po
24	"Për mënyrën e kontrollit dhe monitorimit të zbatimit të projekteve sektoriale në qark që zhvillohen me fonde të qeverisë apo fonde të kushtëzuara"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim në rast të miratimit të projektligjit "Për prefektët"	Prefekti i qarkut si përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave dhe përgjegjës për monitorimin e zbatimit të programit të qeverisë në qark, ushtron kontroll mbi afatet e përdorimit të fondeve mbi projektet sektoriale, për monitorimin e plotë të politikave në qark, dhe propozon te autoritetet vendimmarrëse marrjen e masave përkatëse. Mënyra e kontrollit dhe monitorimit të zbatimit të politikave në qark, sipas kësaj pike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Nuk ka	Po
25	Për përcaktimin e kritereve, procedurave, të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Rregullat e reja të lëshimit të dokumentacionit për hyrjen qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSH, sipas ndryshimeve të pëson ligji për të huajt në përputhje me përafrim me legjislacionin e BE	Rregullon kriteret, procedurat, dokumentacion për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë	**Po**	3. Shërbimet publike	Nuk ka	Po
26	Formati i aplikimit për vizë nga i huaji	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	përcaktimi I formatit të dokumentit të aplikimit për të huajin, me ndryshimet e ligjit për të huajt	Vetëm formatin e aplikimit për vizë për të huajin	**Po**	3. Shërbimet publike	Nuk ka	Po
27	Ngritja dhe funksionimi i regjistrit elektronik për të huajt	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Për ngritjen e regjistrit elektronik kombëtar për të huajt, si dhe parashikimin për mënyrën e funksionimit të tij ndërmjet ministrive përgjegjëse të ngarkuara sipas ligjit për të huajt.	Autoritetet përgjegjëse shtetërore për trajtimin e të huajve do të mbledhin dhe administrojnë të dhënat personale për të huajt nga organet shtetërore, subjektet private, shtetas shqiptarë apo të huaj, banorë në Republikën e Shqipërisë, si dhe nga vetë i huaji. Këto të dhëna regjistrohen në regjistrin elektronik	**Jo**	3. Shërbimet publike	Nuk ka	Po

						kombëtar për të huajt.				
28	"Marrëveshjen për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit për çështje që lidhen me migracionin, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Australisë"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Përafrimi i legjislacionit për migracionin me legjislacionin e BE.	Përcaktimin e rregullave të ripranimit të shtetasve me qëndrim të parregullt në territoret respektive të dy shteteve.	Jo	Jo	STRATEGJIA KOMBËTARE PËR MIGRACIONIN 2019-2022	Po
29	VKM "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2021–2023"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Përfundimi i afatit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018-2020 (VKM nr. 770, datë 26.12.2018)	Plani i Veprimit përbën dokumentin më të rëndësishëm në fushën antitrafikim dhe, është një instrument, i cili bën bashkë të gjithë aktorët e interesuar shtetërorë dhe joshtetërorë, si edhe partnerët ndërkombëtarë, në një dakordësi mbi situatën e trafikimit të personave, sfidat e hasura dhe mënyrat e mjetet për t'i përballuar ato. Dokumenti hedh bazat për një qasje të frytshme dhe të harmonizuar ndërinstitucionale dhe ndërsektoriale, pasi krijohet kuadri për bashkërendimin dhe bashkëpunimin mes të gjithë aktorëve, si dhe roleve e përgjegjësive të tyre	Po	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2020 (6.3 Masat kundër emigracionit të paligjshëm, azilkërkimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore)	Strategjia ndërsektoriale kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme, 2021–2026	Po
30	Projektligj për disa ndryshime në Kodin Penal, Nr. 7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar, në Nenin 183 "Falsifikimi i monedhave" dhe Nenin 185 "Prodhimi mjeteve për falsifikim"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Direktiva Këshillit të BE-së 2014/62/EU datë 15 Maj 2014, për mbrojtjen e monedhave euro dhe të tjera kundër falsifikimit prej Kodit Penal, duke zëvendësuar Direktivën Kuadër të Këshillit të BE-së 2000/383/JHA, sipas Konventës Gjenevës të vitit 1929. Ratifikimi i "Konventës së Gjenevës" , nga Parlamenti me ligjin nr. 77/2019, datë 11.11.2019 "Për miratimin e Konventës Ndërkombëtare për luftën kundër falsifikimit të monedhave" . Kërkohet që Amendimet e Kodit Penal të Shqipërisë lidhen me përafrimin e mëtejshëm me atë të legjislacionit evropian, konkretisht me Direktivën Kuadër të Këshillit të BE-së 2000/383/JHA, mbi rritjen e mbrojtjes së parave nga falsifikimi nëpërmjet rritjes së dënimit minimal nga 5 vjet sikurse aktualisht parashikohet në paragrafin e pare të nenit 183 të Kodit Penal, në 8 vjet, sikurse e parashikon direktiva e sipërpërmendur. Gjithashtu, Kodi Penal i Shqipërisë duhet të përafrohet me dispozitat e Direktivës 2000/383/JHA edhe në përcaktimin e veprës penale të importit, eksportit, transportit të parave të falsifikuara.	Direktiva e Këshillit të BE-së 2014/62/EU, përmban tri propozime kryesore: - Përmirësimin e niveleve të sanksioneve të dënimit për veprën penale të falsifikimit të monedhave nëpërmjet. a-Rritjes së dënimit minimal nga 5 vjet sikurse aktualisht parashikohet në paragrafin e parë të nenit 183 të Kodit Penal, në 8 vjet, sikurse e parashikon direktiva. b-Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë duhet të përafrohet me dispozitat e Direktivës 2000/383/JHA edhe në përcaktimin e veprës penale të importit, eksportit, transportit të parave të falsifikuara. - Përdorimin e mjeteve për investigimit (si dhe i teknikave speciale si për veprat e tjera serioze penale). - Qendrës Kombëtare të Analizës së Monedhave në Bankën e Shqipërisë i kërkohet që nga të gjitha strukturat të dërgohen për ekspertize, pa vonese mostra nga monedhat e falsifikuara sekuestrua prej tyre me qëllim të analizës teknike dhe klasifikimit të falsifikimit të identifikuar për çdo rast.	Po	PKIE 2021-2023, kapitulli 24, "Liria, siguria dhe drejtësia, për nënkapitullin mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi" .	Kapitulli 24, "Liria, siguria dhe drejtësia, për nënkapitullin mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi"	Po
31	Plani i Veprimit 2022–2024 i Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Përfundimi i afatit të Planit të Veprimit 2019-2021 i Strategjisë për kontrollin e armëve të vogla, të lehta, municioneve dhe eksplozivëve 2019 – 2024 (VKM nr. 50, datë 6.2.2019)	Masat kryesore në zbatim të Strategjisë për kontrollin e armëve të vogla, të lehta, municioneve dhe eksplozivëve 2019 – 2024	Po	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re, Rendi dhe Siguria Publike	Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019 – 2024	Po
32	Projektligji "Për gjendjen civile"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Ky akt propozohet në zgjidhje të amendimeve të shumta që ka pësuar ligji nr. 10129, datë 11.5.2009. Risitë e ligjit synojnë të sanksionojnë më mirë veprimtarinë e Gjendjes Civile dhe të përcaktojnë norma për që kryesisht kanë të bëjnë me deklarimin e vendbanimit kryesor të shtetasve, si mjeti kryesor i identifikimit, lidhjes së individit me terrenin, një ndër veprimtaritë kryesore në	Synohet përmirësimi i aspekteve të ligjit aktual nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile" , të ndryshuar, që lidhen kryesisht me: deklarimin e të dhënave të vendbanimit të shtetasve, proces i cili do të finalizohet dhe me ngritjen e një strukture të posaçme nën mbikëqyrjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, si dhe i një rrjeti të posaçëm informatik që do të mbikëqyret nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	Jo	3. Shërbimet publike	Nuk ka	Po

					fokus të Ministrisë së Brendshme.					
33	Projektligji "Për sistemin e adresave"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Ky akt propozohet me qëllim miratimin e një akti të ri që do të zëvendësojë ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 dhe do t'i jap zgjidhje problematikës së ndeshur gjatë zbatimit të tij, që kryesisht ka të bëjë me procesin e papërfunduar nga bashkitë/njësitë administrative për emërtimin e pjesëve të territorit publik, numërtimin e ndërtesave/hyrjeve/apartamenteve në Republikën e Shqipërisë.	Përfundimi i procesit të emërtimit të pjesëve të emërtimit publik në Republikën e Shqipërisë, rrugëve, bulevardeve, shesheve dhe parqeve ekzistuese të paemërtuara, numërtimin e ndërtesave/hyrjeve/apartamenteve dhe përcaktimin e organeve kompetente për përmbushjen e këtij detyrimi, duke përcaktuar afatet përkatëse, me qëllim një sistem të plotë dhe të saktë të adresave.	Jo	3. Shërbimet publike	Nuk ka	Po
34	Projektligji "Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Kriminalistikës"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Akreditimi i institutit dhe pozicionimi me i mire i tij në kuadër të procesit penal	Përcaktimi i statusit, mbështetjes financiare, rritjes së profesionalizimit me punonjës shkencorë.	Jo	Përputhen me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2021	Strategjia e luftës kundër krimit të organizuar	Po
35	Projektligjit "Për policinë bashkiake"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Rishikimi i organizimit dhe funksionimit të Policisë Bashkiake, duke e harmonizuar me kuadrin ligjor në fuqi të miratuar që nga periudha e krijimit të këtij dhe harmonizimi dhe unifikimi i kompetencave policisë bashkiake, me Policinë e Shtetit, në fushën e kundërvajtjeve administrative. (Dërguar në KM 2020)	Organizimi, funksionimi dhe përcaktimi i përgjegjësive të Policisë Bashkiake, varësia administrative dhe trajtimi financiar.	Jo	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re, Rendi dhe Siguria Publike	Po, Strategjia e Decentralizimit dhe Vetëqeverisjes Vendore	Po
	në ligjin nr. 110/2018, "Për noterinë"		Drejtësisë		projektligjin në fjalë, është nevoja për të kontrolluar lidhjet kriminale të noterëve dhe garantimi i masave efektive për të parandaluar depërtimin e elementëve kriminalë në këtë profesion, si dhe veçanërisht i elementëve të cilët janë të dyshuar, në hetim, gjykim apo të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprave penale që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Përmes këtyre parashikimeve në këtë projektligj synohet të adresohet problematika e ngritur nga MONEYVAL, si dhe të garantohet integriteti i lartë moral e profesional dhe besueshmëria e figurës së noterit.	lidhjet kriminale të subjekteve të licencuar si noterë si dhe të garantohen masa efektive për të parandaluar depërtimin e elementëve kriminalë në këtë profesion. Me ndryshimet në ligjin nr. 110/2018 synohet që të kontrollohet jo vetëm gjendja gjyqësore e kandidatëve për noter dhe zëvendësnoterëve përpara licencimit të tyre, por edhe nëse ata po personat e lidhur me ta janë të dyshuar, në hetim, gjykim apo të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një kategori të përcaktuar të veprave penale, përpara marrjes së statusit si kandidat për noter, zëvendësnoter apo licencimit të tyre.			
17	Për kriteret për dhënien dhe kohëzgjatjen e pushimeve	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Miratimi i këtij Projektvendimi është diktuar nga hyrja në fuqi e ligjit me nr. 80/2020 "Për Policinë e Burgjeve"	Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtën e pushimit të paguar edhe për rastet e martesës, të lindjes së fëmijës, sëmundjes së rëndë ose vdekjes së bashkëshortit/ bashkëjetuesit/ bashkëjetueses, paraardhësve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë të tij, pësimit të dëmtimeve nga fatkeqësitë natyrore, ndërrimit të banesës, ndërrimit të vendbanimit të përhershëm për shkak të detyrës, përgatitjes dhe mbrojtjes së titujve akademikë për punën që kryen. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtë që në raste të veçanta të kërkojë leje pa të drejtë page për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin/bashkëshorten ose prindërit. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara brenda një viti kalendarik nuk mund të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar.	JO	JO	JO	JO
18	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Nga hyrja në fuqi e KP deri aktualisht, janë ndërmarrë një sërë nismash për ndryshimin e tij, të cilat kanë prekur si pjesën e përgjithshme, ashtu edhe pjesën e posaçme të Kodit. Deri tani ky Kod ka ndryshuar 20 herë. Kjo shpeshtësi ndryshimesh përbën shkak për prishjen e balancës dhe rrjedhës logjike që duhet të ekzistojë ndërmjet dispozitave dhe vendos "në rrezik" unitetin e Kodit Penal. Kodi Penal i 1995-s u hartua me shpejtësi, për shkak të kërkesave lidhur me harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së, si dhe pa pasur një studim të mirëfilltë dhe një proces të plotë dhe efikas lidhur me përsosjen që në gjenezë të tij, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta që i janë bashkëlidhur këtij Kodi deri aktualisht. Për këtë shkak, është e nevojshme hartimi i një kodi të ri penal, që reflekton standardet më të mira ndërkombëtare por njëkohësisht	Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre.	Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore"	JO	JO	JO

					edhe zhvillimin e së drejtës penale në vend.					
19	Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Ligji për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor shtetëror është miratuar në vitin 2001. Nga ky vit, shërbimi përmbarimor ka pësuar ndryshime thelbësore, duke pasur në konsideratë që tashmë vepron edhe shërbimi përmbarimor shtetëror privat.	Ky ligj përcakton: a) rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor; b) kriteret që duhet të përmbushin shtetasit që të emërohen përmbarues gjyqësorë; c) statusin dhe procedimin disiplinor të përmbaruesit gjyqësor; ç) marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.	JO	JO	JO	Po
20	"Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave"	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Riorganizimi i hartës gjyqësore dhe shpërndarjen e gjykatave në përputhje me ndarjen e re territoriale, numrin e popullsisë dhe numrin e çështjeve të pazgjidhura gjyqësore me qëllim forcimin e rolit dhe funksionimit të gjykatave dhe për të siguruar qasje në drejtësi.	Me anë të miratimit të këtij vendimi synohet krijimi i një sistemi gjyqësor me gjykata eficiente në cilësi dhe në afate gjykimi, duke ruajtur të pacenuar të drejtën e çdo individi për akses në drejtësi.	JO	JO	JO	JO
21	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 26/2019 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat"	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Nga zbatimi në praktikë i ligjit të përmbarimit gjyqësor privat, strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë, por edhe institucionet e tjera shtetërore, kanë konstatuar problematika me zbatimin të një sërë çështjesh që lidhen me funksionimin e rregullt të këtij shërbimi, rolit të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat, përcaktimin e përgjegjësive të përmbaruesve gjyqësor privat, kur kryejnë veprimtari në kundërshtim me ligjin si dhe ushtrimin e rregullt të veprimtarisë mbikëqyrëse nga Ministria e Drejtësisë mbi këtë profesion, me qëllim që të garantohet përgjegjshmëria dhe cilësia në ushtrimin e këtij profesioni.	Funksionimin e rregullt të shërbimi të përmbarimit gjyqësor privat, rolit të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat, përcaktimin e përgjegjësive të përmbaruesve gjyqësor privat, kur kryejnë veprimtari në kundërshtim me ligjin si dhe ushtrimin e rregullt të veprimtarisë mbikëqyrëse nga Ministria e Drejtësisë mbi këtë profesion.	JO	JO	JO	Po
22	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve"	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Në vijim edhe të studimeve të kryera nga organizatat e shoqërisë civile, ka lindur nevoja për ndryshime në ligjin për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me qëllim garantimin e rolit të ndërmjetësimit për uljen e ngarkesave në gjykata, uljen e kostove për qytetarët si dhe zgjidhjen e shpejtë të mosmarrëveshjeve.	Forcimi i rolit të ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, nëpërmjet referimit nga gjykata, si dhe krijimi i kushteve për përdorimit gjerësisht të këtij mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve	JO	JO	JO	Po

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK TË PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2021
MINISTRIA E KULTURËS

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017-2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për projektimin, zbatimin e punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e tyre	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , pika 3 e nenit 72	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në fushën e licencave për zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse në monumentet e kulturës	JO	JO	JO	JO
2	Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , pika 1 e nenit 82	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në lidhjen me normat teknike që lidhen me ndërhyrjet në objektet pasuri kulturore me qëllim ruajtjen e tyre	JO	JO	JO	JO
3	Për kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe të kuotizacionit vjetor për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore. (Tregtia e pasurive kulturore)	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" pika 3, e nenit 116	Ky projektakt plotëson kuadrin ligjor në fushën e licencimit për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore, konkretisht përcaktohen kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe tarifa e kuotizacionit vjetor.	JO	JO	JO	JO
4	Për procedurat e krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , pika 1 e nenit 130	Ky projekakt rregullon kuadrin ligjor të krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura	JO	JO	JO	JO
5	Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , pika 3, e nenit 11	Ky projektakt do të përcaktojë masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në situata jonormale siç janë: fatkeqësitë natyrore ose konfliktet e armatosura	JO	JO	JO	JO
6	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to"	Projektligj	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në nenin 73 të saj "Të drejtat e pronësisë intelektuale" , Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016–2020. Direktiva 2012/28/KE, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012, "Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa	Ky projektakt rregullon krijimin e një kuadri ligjor për mundësimin e digjitalizimit dhe të përhapjes së veprave dhe të materialeve të tjera që mbrohen nga e drejta e autorit ose të drejta të tjera të lidhura me të për të cilat nuk ka mbajtës të së drejtës të identifikuar ose për të cilat mbajtësi i së drejtës edhe kur identifikohet, nuk mund të gjendet - të ashtuquajturat vepra pa autor - përbën një masë themelore të planit digjital për Evropën. Synohet të zgjidhet problemin konkret të përcaktimit ligjor të statusit të	Ky akt është parashikuar në PKIE 2019-2021, Kapitulli 7 "E Drejta e Pronësisë Intelektuale"	JO	JO	PO/Kulturor, Social, Financiar

					autor" ,	veprës pa autor dhe të pasojave përkatëse në lidhje me përdoruesit dhe përdorimet e lejuara të veprave apo të fonogrameve që konsiderohen si vepra pa autor.				
7	Për kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqërues, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , pika 3 e nenit 139	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në fushën e lejeve për hulumtime arkeologjike	JO	JO	JO	JO
8	Për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurisë kulturore	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , shkronja "c" e pikës 3 e nenit 171	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor për dhënien në administrim të pasurisë kulturore publike personave fizike apo juridike, publik apo private, nëpërmjet procedurave publike	JO	JO	JO	JO
9	Për përcaktimin e funksionimit, organizimit dhe veprimtarisë së Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , pika 9 e nenit 29	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në lidhjen me mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së institucionit	JO	JO	JO	PO/ financiare
10	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096, datë 21.3.1996, "Për kinematografinë" , i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Grupet e interesit	Synon të nxisë veprimtarinë e kineastëve. Rregullimin e organeve kolegjiale vendimmarrëse, si dhe veprimtarinë e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit	JO	JO	JO	PO/financiare, sociale dhe kulturore
11	Për përcaktimin e tarifave për shpërblim të arsyeshëm nga riprodhimi i veprave për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim Ligjor, ligji nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" , pika 1 e nenit 31	Ky projektakt rregullon përkufizimin e tarifës për shpërblim të arsyeshëm, përcaktimin e palëve të cilët do të jenë subjektet që do t'i nënshtrohen aplikimit të tarifës. Përcaktohen pajisjet dhe të gjitha mjetet e tjera që nevojiten për regjistrimin vizual dhe zanor, që bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal. Afatet e pagesës të kësaj tarife, dokumentacioni që importuesit dhe/ose prodhuesit vendas duhet të vendosin në dispozicion të Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit	JO	JO	JO	Ka impakt në ekonomi në masën 0.5 % të pajisjeve që prodhohen për herë të parë ose importohen në RSH
12	Për riorganizimin e Muzeut Kombëtar të Arsimit "Mësonjëtorja e Parë"	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , neni 202, pika 1 e nenit 214	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në lidhjen me riorganizimin e institucionit (pasi ekziston, por funksionimi i tij duhet të rregullohet sipas kuadrit të ri ligjor për muzetë)	JO	JO	JO	JO
13	Për miratimin e marrëveshjes së administrimit të Parkut Arkeologjik Butrint lidhur midis Ministrisë Kulturore dhe Fondacionit të Posaçëm	Projektligj	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , pika 5 e nenit 172	Ky projektakt rregullon kuadrin kuadrin ligjor të marrëveshjes të lidhur midis palëve, ku përcaktohet afati, tarifat dhe kushtet e veçanta për administrimin e pasurisë kulturore	JO	JO	JO	PO/ sociale dhe kulturore
14	Për miratimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Kombëtar për	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në lidhjen me mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të	JO	JO	JO	PO/ financiare

	Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore				dhe muzetë" , pika 4 e nenit 27	veprimtarisë së institucionit				
15	Për krijimin e Muzeut të Pavarësisë Vlorë	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , neni 202, pika 1 e nenit 214	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në lidhjen me krijimin dhe mënyrën e funksionimit e zhvillimit të veprimtarisë së institucionit	JO	JO	JO	PO/financiare
16	Për deklarimin e qendrave historike/parqeve arkeologjike, përcaktimin e zonave mbrojtëse të tyre dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , pika 3 e nenit 9, pika 3 e nenit 62 dhe pika 1 e nenit 96	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor me qëllim përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin	JO	JO	JO	JO
17	Për miratimin e zonave arkeologjike, si dhe planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , pika 3 e nenit 53	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor me qëllim përcaktimin e zonave arkeologjike si dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave	JO	JO	JO	JO
18	Për përcaktimin e kufijve të Parqeve Arkeologjike	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" , pika 1 e nenit 142	Ky projektakt ka për qëllim te përcaktojë kufijtë e Parqeve Arkeologjike	JO	JO	JO	JO
19	Projektligji "Për krijimin dhe funksionimin e zonës së veçantë të zhvillimit artistik dhe kulturor në Pallatin e Brigadave	Projektligj	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Qëllimi i këtij projektligji është promovimi i investimeve në fushën kulturore dhe artistike në territorin shqiptar dhe hapja e vendeve të reja të punës në këtë sektor. Nxitja dhe zhvillimi i sektorit të punësimit në fushën e artit dhe kulturës	Qëllimi i këtij projektligji është promovimi i investimeve në fushën kulturore dhe artistike në territorin shqiptar dhe hapja e vendeve të reja të punës në këtë sektor. Ky ligj rregullon themelimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e një zone të veçantë të zhvillimit artistik dhe kulturor në Pallatin e Brigadave, të drejtat dhe detyrimet e institucioneve përgjegjëse, Fondacionin "Pallati i Brigadave" , operatorëve dhe përdoruesve, të cilët veprojnë në këtë zonë.	JO	JO	PO; Strategjia Kombëtare e Kulturës, 2019-2025	PO/ financiare, sociale dhe kulturore

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2021

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017–2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e përcaktimit të produkteve të duhanit me shije karakteristike"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori I	Detyrim ligjor, neni 11 i Ligjit nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" të ndryshuar.	Përcaktimi i produkteve të duhanit me shije karakteristike	Jo	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit i cili është në përputhje me programin e qeverisë, kap. 3.3, Shëndetësia dhe kujdesi social, "Mbulimi shëndetësor universal"	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit i cili është në përputhje me objektiva strategjikë, pika 1.1.1 "Krijimi i kushteve më të mira për shëndetin.	Jo
2	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave të shpenzimeve për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike të nevojshme për kontrollin e kripës së jodizuar përballohen nga subjektet prodhuese ose importuese të kripës së jodizuar."	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori I	Detyrim ligjor, neni 12, pika 4, i ligjit nr. 9942, datë 26.6.2008, "Për parandalimin e çregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut" , të ndryshuar.	Përcaktimi i tarifave lidhur me mbulimin e shpenzimeve për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike nga institucionet shëndetësore, për përcaktimin e nivelit të jodit të kripës ushqimore të jodizuar, përpara se ajo të tregtohet.	Jo	Jo	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit i cili është në përputhje me objektiva strategjikë, pika 1.1.1 "Krijimi i kushteve më të mira për shëndetin.	Po, ndikime ekonomike për subjektet private, në përcaktimin e tarifave
3	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2021–2030"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori I	Detyrim ligjor, neni 10, pika 1 e Ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri" . Në kuadër të këtij detyrimi ligjor SKBGJ 2016- 2020 e miratuar dhe hartuar me parë ka përfunduar në afatin e veprimit të saj.	Hartim dhe zbatim i politikes, masave dhe veprimeve që synojnë fuqizimin e grave dhe zvogëlimin e dhunës me baze gjinore, për avancimin drejt barazisë gjinore.	PO. Kapitulli 19 "Punësimi dhe politikat sociale, nënfusha: Shanset e barabarta "	Kapitulli 3.3. "Shëndetësia dhe kujdesi social"	Strategjia për Zhvillim dhe Integrim. Nënkapitulli "Barazia Gjinore"	Po, ndikime sociale dhe ekonomike
4	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për mekanizmin e koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR)"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori I	Detyrim ligjor, pika 8, neni 8, i ligjit nr. 9669/2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" , i ndryshuar; problematikat e dala në praktikë dhe nevoja e përshtatjes me Konventën e Stambollit dhe kërkesën e Nënkomisionit Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e dhunës ndaj gruas	Rishikimi i institucioneve dhe anëtarëve të tjerë si dhe ndarja e duhur e përgjegjësive; Përgatitja e disa anekseve të cilat duhet të përmbajnë formate tip të marrëveshjes që nënshkruhet nga të gjithë anëtarët; Përgatitja e rregullores së funksionimit; Përgatitja e protokolleve të menaxhimit të rasteve etj.	Jo	Kapitulli 3.3. "Shëndetësia dhe Kujdesi Social"	Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2016–2020 Qëllimi Strategjik 3	Po, ndikime sociale (forcim të mekanizmave institucionalë)
5	VKM "Për miratimin e Planit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë	Katërmujori I	Detyrim ligjor, neni 14, pika 1 e ligjit nr. 93/2014, "Për	Plani ndikon në përmirësimin fuqizimin e personave me aftësi	PO. Kapitulli 19 "Punësimi dhe	Kapitulli 3.3. "Shëndetësia dhe Kujdesi	Plani Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar 2016–	Po, ndikime sociale

	2021–2025”		dhe mbrojtjes sociale		përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” . Plani është në ndjekje të Planit të mëparshëm 2016–2020, I cili ka përfunduar afatin e miratimit të tij.	të kufizuar, marrjen e masave të veçanta për ta në gjithë fushat e përfshirjes sociale dhe aksesueshmërisë dhe garanton si dokument strategjik të drejtat dhe shërbimet në nivel ndërsektorial për aftësinë e Kufizuar	politikat sociale, nënfusha: Shanset e barabarta “	Social”	2020	
6	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për procedurën e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale”	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori I	Detyrim ligjor, neni 20, pika 3, shkronja c e Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”	Procedurën e kryerjes së kontrollit për zbatimin e ligjit të miratuar	Jo	Kapitulli 3 “Shërbimet Publike” , seksioni 3.3 “Shëndetësia dhe Kujdesi Social”	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2021–2025	Jo
7	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komitetit të Etikës”	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori II	Detyrim ligjor, NENI 11, pika 4.1, i ligjit nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore” , të ndryshuar	Çështje të organizimit dhe funksionimit të Komitetit të Etikes	Jo	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit i cili është në përputhje me programin e qeverisë, kap. 3.3, Shëndetësia dhe kujdesi social “Mbulimi shëndetësor universal”	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit i cili është në përputhje me objektiva strategjikë, pika 1.3.2 “Shëndeti në të gjitha politikat” ; pjesa II, Prioritetet Strategjike dhe Qëllimet	Jo
8	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit ë Veprimit për Personat e LGBTI-së në Shqipëri 2021–2027”	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori II	Detyrim ligjor, pika 4, neni 102, i Kushtetutës. Në kuadër të këtij detyrimi ligjor Planit të Veprimit për Personat LGBTI në Shqipëri 2016–2020 i miratuar dhe hartuar me pare ka përfunduar në afatin e veprimit të tij.	Hartim dhe zbatim i politikes, masave dhe veprimeve që synojnë mbrojtjen nga diskriminimi të personave LGBTI në Shqipëri	Jo	Jo	Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale	Po, ndikime sociale dhe ekonomike
9	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2025”	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori II	Detyrim ligjor i pikës 2, germa “b” të nenit 38 të ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” . Në kuadër të këtij detyrimi ligjor ka përfunduar afati i veprimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020.	Hartim dhe zbatim i politikës, masave dhe veprimeve që synojnë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, gjithëpërfshirjen dhe mbrojtjen e tyre nga të gjitha format e dhunës.	Jo	Kapitulli 3.3. “Shëndetësia dhe kujdesi social” Kujdesi Social”	Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale	Po, ndikim social ekonomik
10	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025”	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori II	Detyrim ligjor, pika 4, neni 102, i Kushtetutës. Në kuadër të këtij detyrimi ligjor Plani Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020 i miratuar dhe hartuar me parë ka përfunduar në afatin e veprimit të tij.	Hartim dhe zbatim i politikes, masave dhe veprimeve që synojnë mbrojtën e këtyre pakicave kombëtare nga të gjitha format e diskriminimit, si edhe aksesin në çdo fushë të jetës sociale, ekonomike, arsimit dhe në shërbime	Jo	Kapitulli 3.3. “Shëndetësia dhe kujdesi social” , Kujdesi Social”	Dokumentin Politik për Përfshirjen Sociale	Po, ndikim social ekonomik
11	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për treguesit statistikorë të vlerësimit e monitorimit të asistencës sociale”	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori II	Detyrim ligjor, neni 19, pika 3 e ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”	Përcaktohen treguesit statistikorë të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar në përputhje me zhvillimet e legjislacionit dhe SMI-ve	Jo	Kapitulli 3 “Shërbimet Publike” , seksioni 3.3 “Shëndetësia dhe Kujdesi Social”	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2021–2023	Jo
12	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë	Katërmujori II	Strategjia do të jetë në përgatitje dhe përfundim të	Strategjia do të përcaktojë prioritetet strategjike për	Jo	Kapitulli 3.3. “Shëndetësia dhe Kujdesi	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	Jo

	Shëndetësisë 2021–2025"		dhe mbrojtjes sociale		kohëzgjatjes së aktit aktual	periudhën e ardhshme		Social"		
13	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Social Shtetëror"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori III	Detyrim ligjor, neni 20, pika 2 e ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH"	Çështje të organizimit dhe funksionimit të SHSSH sipas ligjit të miratuar	Jo	Kapitulli 3 "Shërbimet Publike" , seksioni 3.3 "Shëndetësia dhe Kujdesi Social"	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2021–2024	Jo
14	VKM "Për rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve për jetesë të pavarur"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori III	Detyrim ligjor, neni 6, pika 3 e ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"	Rregullimi i ofrimit të shërbimeve ndërsektoriale për PAK sipas konceptit të jetesës së pavarur. Organizimi i shërbimeve që ofrohen për jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuar.	Jo	Kapitulli 3.3. "Shëndetësia dhe Kujdesi Social	Plani Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar 2016–2020	Po, ndikime ekonomike, sociale
15	VKM "Për shërbimet e vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori III	Detyrim ligjor, neni 7, pika 3 e Ligjit Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"	Rregullimi i shërbimit të vendimmarrjes së mbështetur. Përcaktimi i modaliteteve për vendimmarrjen e mbështetur	Jo	Kapitulli 3.3. "Shëndetësia dhe Kujdesi Social:	Plani Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar 2016–2020	Po, ndikime ekonomike, sociale
16	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 105/2014 'Për barnat në shërbimin farmaceutik'" , të ndryshuar	Projektligj	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori III	Përshtatja e ligjit nr. 15/2014 me direktivat e BE	Ndryshimet kryesore që synohen të arrihen janë: Formati tip për recetën mjekësore, përafrimi i rregullave për fletudhëzuesin me Direktivat e BE; Kriteret për hapjen e farmacive të rrjetit të hapur farmaceutik; tregtimi në distancë i barnave; përgatesat galenike; parafarmacitë; reklamimi i barnave	Po. Kapitulli 28 "Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik"	Kapitulli 3.3. "Shëndetësia dhe Kujdesi Social: Mbulimi shëndetësor falas"	Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2016–2020, Prioriteti Strategjik 2: Mbulimi shëndetësor universal për të gjithë" , Objektivi 2.4.	Po, ndikime ekonomike, sociale
17	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8876, datë 4.4.2002, "Për shëndetin riprodhues" , të ndryshuar	Projektligj	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori III	Ndryshimet e fundit të teknologjisë dhe të të rejave në shëndetin riprodhues	Ndryshimet synojnë përmirësimin e sistemit shëndetësor në shëndetin riprodhues duke u përshtatur me praktikat me të mira ndërkombëtare për ndryshimet e fundit të teknologjisë dhe risive në fushën e shëndetit riprodhues	Jo	Kapitulli 3.3. "Shëndetësia dhe Kujdesi Social: Mbulimi shëndetësor falas"	Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2016–2020, Prioriteti Strategjik 1: Investimi në shëndetin e njerëzve gjatë gjithë ciklit të jetës. Objektivi 1.1.1.2.1.3 dhe 1.5. dhe Prioriteti Strategjik 3 "Fuqizimi i sistemit shëndetësor, duke vendosur në qendër të sistemit njerëzit" , objektivi 3.5	Po, ndikime ekonomike, sociale
18	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të etiketimit dhe instruksionet për përdorimin e pajisjeve mjekësore"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori III	Detyrim ligjor, neni 20, pika 3 e ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore" , të ndryshuar	Rregullat për etiketimin dhe instruksionet e përdorimit të pajisjeve mjekësore	Jo	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit I cili është në përputhje me programin e qeverisë, kap. 3.3. Shëndetësia dhe Kujdesi Social "Mbulimi shëndetësor universal"	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit i cili është në përputhje me objektiva strategjikë, pika 1.3.2 "Shëndeti në të gjitha politikat" ; Pjesa II, Prioritetet Strategjike dhe Qëllimet	Po, social
19	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për	Projektvendim	Ministri i	Katërmujori III	Detyrim ligjor, neni 21, pika	Kriteret për kushtet e ruajtjes	Jo	Po si akt nënligjor në	Po si akt nënligjor në	Jo

	përcaktimin e kritereve për kushtet e ruajtjes dhe transportit të pajisjeve mjekësore të prodhuara në Republikën e Shqipërisë"		shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale		6, e ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore" , të ndryshuar	dhe transportit të pajisjeve mjekësore		zbatim të ligjit i cili është në përputhje me programin e qeverisë kap. 3.3, Shëndetësia dhe Kujdesi Social, "Mbulimi shëndetësor universal"	zbatim të ligjit I cili është në përputhje me objektiva strategjikë, pika 1.3.2 "Shëndeti në të gjitha politikat" ; pjesa II, Prioritetet Strategjike dhe Qëllimet;	
20	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve të licencimit për prodhuesit në Republikën e Shqipërisë"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori III	Detyrim ligjor, Neni 21, pika 5 e ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore" , të ndryshuar	Kriteret për licencimin e prodhuesve të pajisjeve mjekësore në vend	Jo	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit i cili është në përputhje me programin e qeverisë kap. 3.3, Shëndetësia dhe Kujdesi Social, "Mbulimi shëndetësor universal"	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit I cili është në përputhje me objektiva strategjikë, pika 1.3.2 "Shëndeti në të gjitha politikat" ; pjesa II, Prioritetet Strategjike dhe Qëllimet	Jo
21	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve të licencimit për tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore në Republikën e Shqipërisë"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori III	Detyrim ligjor, neni 22, pika 1, e ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore" , të ndryshuar	Kriteret për licencimin e tregtuesve me shumicë të pajisjeve mjekësore në vend	Jo	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit i cili është në përputhje me programin e qeverisë kap. 3.3, Shëndetësia dhe Kujdesi Social, "Mbulimi shëndetësor universal"	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit I cili është në përputhje me objektiva strategjikë, pika 1.3.2 "Shëndeti në të gjitha politikat" ; pjesa II, Prioritetet Strategjike dhe Qëllimet;	Jo
22	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e procedurës së rimbursimit të pajisjeve mjekësore nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori III	Detyrim ligjor, neni 23/1, pika 1 e ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore" , të ndryshuar	Procedura e rimbursimit të pajisjeve mjekësore nga FSDKSH	Jo	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit i cili është në përputhje me programin e qeverisë kap. 3.3, Shëndetësia dhe Kujdesi Social, "Mbulimi shëndetësor universal"	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit I cili është në përputhje me objektiva strategjikë, pika 1.3.2 "Shëndeti në të gjitha politikat" ; pjesa II, Prioritetet Strategjike dhe Qëllimet	Po. Financiare
23	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të publicitetit të pajisjeve mjekësore që tregtohen në Republikën e Shqipërisë"	Projektvendim	Ministri i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale	Katërmujori III	Detyrim ligjor, Neni 23/2, pika 1, e ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore" , të ndryshuar	Rregullat e publicitetit të pajisjeve mjekësore që tregtohen në vend	Jo	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit i cili është në përputhje me programin e qeverisë" kap. 3.3. Shëndetësia dhe Kujdesi Social "Mbulimi shëndetësor universal"	Po si akt nënligjor në zbatim të ligjit I cili është në përputhje me objektiva strategjikë, pika 1.3.2 "Shëndeti në të gjitha politikat" ; pjesa II, Prioritetet Strategjike dhe Qëllimet	Jo

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2021

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017-2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për disa ndryshime në VKM-në nr. 171, datë 27.3.2019, 'Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"'	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Akti propozohet me qëllim krijimin e një klime të favorshme për zbatimin e standardeve dhe kushteve të sigurisë fizike të higjienës dhe për aksesueshmerinë e turistëve në plazhe. për përmirësimin e kushteve të sigurisë në hapësirën ujore pranë plazheve dhe në zonën e plazhit	Menaxhimin e plazheve sipas standardeve bashkëkohore.	jo	Po. Pika 2.6 Turizmi si prioritet/Vendosje e rregullt në treg e të gjithë operatorëve ekonomikë në fushën e turizmit dhe 2.6 Infrastrukture-Transporti detar-Monitorimi i ujërave të detit	Po, lidhet me strategjinë e zhvillimit të Turizmit/projekt.	jo
2	"Për miratimin e kritereve të vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të bregëzimit të mjeteve lundruese"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Akti propozohet me qëllim stabilizimin e një infrastrukture mbarëkombëtare që krijon kushtet e zhvillimit dhe rritjes së lundrimit turistik, bregëzimit dhe rritjes së përfitimeve ekonomike nga banorët lokalë ku zhvillohen këto stacione.	Kriteret teknike për stacionet sezonale të ankorimit/bregëzimit, që përfshijnë fortësinë strukturore, mbrojtjen e mjedisit, furnizimin me energji elektrike dhe ndriçimin, furnizimin me ujë të pijshëm dhe industrial, shërbimet higjienike, shërbimet mjekësore, trajtimin e mbetjeve dhe sinjalistikën detare. Kushtet e dhënies me qira të pronës së paluajtshme shtetërore për zhvillimin e këtyre projekteve dhe procedurën e hollësishme të dhënies më qira duke përfshirë autoritetin përgjegjës, dokumentacionin e aplikimit, administrativo ligjor dhe teknik, procedurën e vlerësimit dhe afatet etj.	jo	Po, pika 2.6 Turizmi si prioritet.	Po, lidhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2024.	Ekonomike-Po Financiare-Jo Sociale-Po Mjedisore-Jo
3	"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 687/2015 'Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"'	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Akti propozohet pasi VKM-ja aktuale për statistikat e mbetjeve ka hapur vetëm një dritare, ku ka përcaktuar aktorët dhe rrymat mbetjeve, për të cilat ata duhet të raportojnë, por nuk ka qartësuar me detaje se si duhet të gjenerohen këto të dhëna, duke marrë në konsideratë situatën e ofrimit të shërbimit në njësitë lokale në vend.	Objektivi I këtij akti lidhet me nevojën për amendimin e VKM 687/2015, duke shtuar si aneks një metodologji për mënyrën e gjenerimit të të dhënave të mbetjeve, duke lehtësuar mjaft punën e njësive vendore, duke unifikuar burimin e të dhënave dhe metodologjinë për gjenerimin e tyre, si dhe duke i dhënë mundësinë bashkive të kenë një databazë të unifikuar për të dhënat për kategoritë e ndryshme të mbetjeve që gjenerohen, grumbullohen, transportohen dhe trajtohen në territorin e tyre.	jo	Po. Pika 2,4 "Mjedisi" , f. 12.	Po, lidhet me Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Mbetjeve" .	jo
4	"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 99, datë 18.2.2005, 'Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve"'	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Të përditësojë katalogun e mbetjeve në përputhje me katalogun evropian të mbetjeve.	Objektivi i këtij akti lidhet me shtimin e kodeve të reja në përputhje me kodet e përcaktuara në katalogun evropian të mbetjeve.	jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me strategjinë sektoriale të mbetjeve	Jo nuk ka ndikim të asnjë lloj natyre.
5	"Për miratimin e listës e llojeve të huaja ose llojeve të huaja invazive dhe përcaktimin e procedurave për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Projektvendimi përcakton se cilat do të jenë llojet invazive në vend dhe impakti që kanë këto të fundit në llojet endemike të vendit.	Projektvendimi do të listojë listën e llojeve të faunës dhe florës invazive në vend.	Po, Kapitulli 27 "Mjedisi" .	Po, pika 2.1 "Mjedisi" , f. 12.	Po, projektakti lidhet me Dokumentin e Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.	Po Projektvendimi ka ndikim social dhe mjedisor.

6	"Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve shtazore, që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Të përcaktojë rregullat për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu, në mënyrë që të parandalojë dhe minimizojë rreziqet ndaj shëndetit të njeriut dhe kafshëve që vijnë nga këto produkte dhe në veçanti të mbrojë sigurinë e ushqimit dhe zinxhirit ushqimor në vend.	Ky vendim do të zbatohet për nënproduktet kafshëve dhe produktet e përftuara prej tyre të cilat janë përjashtuar nga konsumi njerëzor.	jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me strategjinë sektoriale të mbetjeve.	po ka ndikim mjedisor, pasi krijohet një mjedis me pak I ndotur nga nënproduktet shtazore
7	"Për miratimin e listës së substancave kandidate"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Objektivi i këtij Projektvendimi është përmbushja e detyrimeve sipas Ligjit 27/2016, lidhur me: a)komunikimin e informacionit mbi kimikatet që gjenden në artikuj, nga furnizuesi të marrësi/konsumatori; b)nxjerrjen e akteve ligjore të parashikuara nga ligji 27/2016.	Ky Projektvendim synon: 1. Të miratojë listën e substancave kandidate bazuar në Listën aktuale sot në BE, publikuar në faqen elektronike të Agjencisë Evropiane të Kimikateve (ECHA), https://echa.europa.eu/candidate-list-table; 2. plotësimin e akteve nënligjore që rrjedhin në bazë të ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve" .	Jo, ky Projektvendim nuk synon të transpozojë legjislacionin e Bashkimit Evropian.	Po. Pika 2,4 "Mjedisi" , f. 12.	Po lidhet me strategjinë ndersektoriale të mjedisit.	Po ka ndikim social dhe mjedisor pasi rrit komunikimin e informacionit mbi kimikatet që gjenden në artikuj, nga furnizuesi të marrësi/konsumatori.
8	"Për kostot e përllogaritura për pyllëzimin kompensues përkatës, përfshirë kostot e mirëmbajtjes së nevojshme pas mbjelljes që garanton zënien efektive të tyre"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Projektvendimi ka si qëllim të kornizojë të gjitha veprimtaritë mbi fondin pyjor, llogaritja e kostove dhe ato të mirëmbajtjes pas mbjelljes që detyrohen të kryejnë pyllëzime në funksion të parimit të zëvendësimit.	Krijimi i një kuadri ligjor kombëtar që qartëson procedurat dhe kostot për subjektet që detyrohen të pyllëzojnë në funksion të parimit të zëvendësimit.	Jo	Po. Pika 2,4 "Mjedisi" f. 12.	Po, lidhet Dokumentin e Politikave Pyjore në Shqipëri 2019–2030.	Po ka ndikim financiar mbi subjektet që detyrohen të zëvendësojnë e kompensojnë fondin pyjor të dëmtuar si shkak I aktivitetit të miratuar mbi to.
9	'Për miratimin e masave të nevojshme që çdo person juridik a fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte (prodhuesi i produktit) mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Akti propozohet si nevojë për të ngritur sistemin e Përgjegjësive të Zgjeruara të prodhuesit në mënyrë transparente dhe për të vendosur përgjegjësi të qarta, të sigurojë incentiva për të gjitha palët e interesuara dhe për të vendosur rezultate të matshme, pa shkatërruar tregun.	Objektivi i këtij akti lidhet me nevojën e ngritjes së sistemit të Përgjegjësive të Zgjeruara të Prodhuesit, duke qartësuar përgjegjësitë e gjithsecilit që do të jetë pjese e sistemit me qëllim menaxhimin e disa rrymave të mbetjeve duke synuar uljen e depozituar të mbetjeve në pikën fundore.	Po, ky Projektvendim synon të transponojë legjislacionin e Bashkimit Evropian.	Po. Pika 2,4 "Mjedisi" , f. 12.	Po lidhet me strategjinë ndersektoriale të mjedisit.	Po ka ndikim social dhe mjedisor pasi rrit komunikimin e informacionit mbi kimikatet që gjenden në artikuj, nga furnizuesi të marrësi/konsumatori.
10	"Për përcaktimin e kritereve për hartimin e planeve të menaxhimit, si dhe përcaktimin e ekosistemeve, të habitateve dhe llojeve të faunës së egër me status mbrojtjeje"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Projektvendimi detajon se cilat do të jenë kriteret për hartimin e planeve të menaxhimit për llojet të cilat kanë status të veçantë mbrojtje.	Projektvendimi qartëson se si duhet të bëhet mbrojtja e habitateve, e rrugëve të shtegtimit dhe e kushteve të shumimit të llojeve të cilat kanë status të veçantë të mbrojtjes.	Po, Kapitulli 27 "Mjedisi" .	Po, pika 2.1 "Mjedisi" , f. 12.	Po, projekakti lidhet me Dokumentin e Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.	Po Projektvendimi ka ndikim social dhe mjedisor. Nuk ka ndikim financiar.
11	"Për Strukturën e RKFP-së, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyra e mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal dhe qendror, informacioni që duhet regjistruar, si dhe afatet e përgatitjes e të raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Projetvendimi kornizon mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave, përditësimet, shtesat dhe pakësimet që ndodhin mbi fondin pyjor kombëtar.	Projektvendimi qartëson strukturën e këtij regjistri, mënyrën e mbajtjes së tij dhe detyrimet e grupeve të lidhura për të raportuar dhe përditësuar këtë regjistër.	Jo	Po. Pika 2,4 "Mjedisi" f. 12.	Po, lidhet Dokumentin e Politikave Pyjore në Shqipëri 2019–2030.	jo
12	"Për kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Projektvendimi detajon kriteret për ndarjet dhe shkeljet mbi fondin pyjor dhe rregullimin e penaliteteve financiare për këtë qëllim.	Projektvendimi qartëson strukturimin e shkeljeve mbi fondin pyjor dhe masat financiare si penalitet.	Jo	Po. Pika 2,4 "Mjedisi" , f. 12.	Po, lidhet Dokumentin e Politikave Pyjore në Shqipëri 2019–	jo

									2030.	
13	"Për gazet serrë të Fluorinuara" (F-Gazet)	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Projektakti propozohet me synimin: 1. për të arritur përputhshmërinë më direktivat përkatëse evropiane; 2. për të plotësuar detyrimet e vendit në nivel ndërkombëtar. 3. Rregullon procedura që lindin për herë të parë (licencimi dhe kuotimi FGaseve).	Ky ligj do të: a) përcaktojë rregulla për kontrollin, përdorimin, rikuperimin dhe shkatërrimin e gazeve serrë të fluorinuara dhe për masat ndihmëse b) vendosë kushte për vendosjen në treg të produkteve dhe pajisjeve specifike që përmbajnë, ose funksionimi i të cilave mbështetet në gaze serrë me efekt të fluorinuar c) vendosë kushte për përdorime specifike të gazeve serrë me efekt të fluorinuar; dhe d) rregullojë kufijtë sasiorë për vendosjen në treg të hidrofluorokarboneve.	Po, kap 27.	Po. Pika 2,4 "Mjedisi" f. 12.	Po, lidhet me strategjitë sektoriale të Ndryshimeve Klimatike; Strategjinë e menaxhimit të cilësisë së ajrit;	Po ka ndikim social, ekonomik dhe mjedisor
14	"Për miratimin e listës së llojeve të mbrojtura të vendit"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Projektvendimi detajon listën e llojeve të mbrojtura të vendit.	Projektvendimi do të listojë listën e llojeve të mbrojtura të vendit ku do të ndalohet Kapja, marrja, mbajtja dhe përdorimi i individëve të llojeve të kafshëve dhe bimëve të mbrojtura janë të ndaluara.	jo	Po. Pika 2,4 "Mjedisi" , f. 12	Po, lidhet me Dokumentin e Politikave Strategjike për ruajtjen e biodiversitetit në Shqipëri	jo
15	"Për miratimin e dokumentacioni shoqërues të formularit, afatet dhe procedura e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me deklaratë si dhe deklarata për arritjen e fazës së zhvillimit përfundimtar të kërkimit shkencor"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Projektvendimi ka si qëllim të rregullojë llojet të cilat janë të listuara si llojeve të mbrojtura përdorimi i tyre mund të lejohet vetëm për qëllime shkencore, kulturore, dhe edukimi.	Projektvendimi rregullon mënyrën e pagesës për tarifën e përdorimit të faunës së egër.	Jo	Po. Pika 2,4 "Mjedisi" , f. 12	Po, lidhet me Dokumentin e Politikave Strategjike për ruajtjen e biodiversitetit në Shqipëri.	jo
15	Për organizimin dhe funksionimi i Institutit të Veterinarisë dhe Sigurisë Ushqimore	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Dhënia e kompetencave shtesë lidhur me kryerjen e vlerësimeve në fushën e veterinarisë	Ky projektakt rregullon organizimi dhe funksionimi e Institucionit të Veterinarisë dhe Sigurisë Ushqimore si qendër kombëtare e referencës laboratorike.	Jo	Po, 50	Jo	Po (financiare)
16	"Institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehërues"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Detyrim i plotësimit të ligjit nr. 17/2020 "Për produktet plehërues" me akte nënligjore	Projektakti përcakton institucionin përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehërues	Jo	Jo	Jo	Jo
17	Tarifat e shërbimeve e të analizave, që kryhen nga laboratori i referencës dhe laboratorët e miratuar.	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Detyrim i plotësimit të ligjit nr. 17/2020 "Për produktet plehërues" me akte nënligjore	Projektakti përcakton tarifat e shërbimeve e të analizave, që kryhen nga laboratori i referencës dhe laboratorët e miratuar.	Jo	Jo	Jo	Jo
18	"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 712, 31.7.2013 Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Përqasja me Kodin e Procedurave Administrative	Projektvendimi rregullon procedurën e ankimit dhe shqyrtimit të ankesës ndaj vendime të komisioneve.	Jo	Jo	Jo	Jo

	drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore" , të ndryshuar"									
19	Projektvendimin "Për disa ndryshime në vendimin nr. 407, të Këshillit të Ministrave, datë 8.5.2013, 'Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim'"	Projektvendim	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Mbështetje në sektorin e peshkimit	Karakter teknik për shtyrje afati.	JO	Jo	Jo	Po, ekonomike sociale
20	Për miratimin dhe kompetencat e trupave certifikues	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Detyrim ligjor. Përcaktuar në nenin 23, pika 4, të ligjit "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore"	Kritere të hollësishme për miratimin dhe kompetencat e trupave certifikues që kryejnë verifikimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore me specifikimet e produkteve	Jo	Po. 19	SNBZHR 2014–2020, pika 3.1.1 Masa 4: Skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimet	Jo
21	Përbërja, funksionimi, organizimi dhe detyrat e Komisionit për miratimin dhe auditimin e trupave certifikues	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Detyrim ligjor. Përcaktuar në nenin 24, pika 3, të ligjit "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore" .	Përcakton mënyrën, e funksionimit, të organizimit dhe detyrat e Komisionit për Miratimin dhe Auditimin e Trupave Certifikues.	Jo	Po. 17, 19, 36	SNBZHR 2014–2020, pika 3.1.1 Masa 4: Skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimet	Po. Efekt financiar
22	Për zonat e përcaktuara për akuakulturë	Projektvendim	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori II	Përcakton zonat ekskluzive ku do të zhvillohet akuakultura ujore detare dhe tokësore.	Përcakton vendndodhjen e subjekteve që do të ushtrojnë aktivitetin e akuakulturës ujore detare dhe tokësore (koordinatat).	Po. Kapitulli 13	Po. 2.3	Po. Strategjia kombëtare e Peshkimit 2016–2021	Po. Efekte ekonomike, sociale, mjedisore

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2021
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017-2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për miratimin në parim të Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë të Arabisë Saudite mbi njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Në bazë të marrëveshjes, secila palë do të njohë dhe shkëmbejë/konvertojë lejen e drejtimit të vlefshme të lëshuar nga pala tjetër, sipas moshës dhe kategorive të kërkuara, për ata qytetarë që mbërrijnë në territoret përkatëse, si për qëllime rezidenciale, ashtu edhe për qytetarët që mbërrijnë për qëndrim të përkohshëm. Palët, për shkëmbimin e lejeve të drejtimit të lëshuar nga pala tjetër do të përjashtojë aplikantët nga testi i teorisë dhe praktikës.	Kjo marrëveshje i vjen në ndihmë komunitetit shqiptar që jeton në Arabinë Saudite, si dhe shtetasit e të dyja vendeve që udhëtojnë për qëllime turistike, të cilët janë të interesuar dhe ju shërben njohja e ndërsjellë dhe shkëmbimi/konvertimi i lejeve kombëtare të drejtimit. Gjithashtu ky akt synon përmirësimet në legjislacionin shqiptar mbi lejet e drejtimit synojnë përputhshmërinë e plotë me direktivën 2006/126/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 20 dhjetor 2006, më konkretisht: • Vendimi nr. 940 datë 18.11.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në VKM-në nr. 153, datë 7.4.2000, "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" , të ndryshuar. • Udhëzimi nr. 628/4, datë 1.4.2016 "Për aktivitetin e autoshkollave, pajisjen e kandidatëve me leje drejtimi, kualifikimin e instruktorëve të autoshkollave dhe specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor" .	JO	JO	JO	JO
2	Për përcaktimin e strukturës përgjegjëse dhe metodologjinë për verifikimin e plotësimit të kritereve të qëndrueshmërisë	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Detyrim i nenit 10 në rast miratimi të p/ligjit, "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport" , si dhe përafrim i Nenit 18 të Direktivës 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009, "Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e energjive të rinovueshme" , e cila shfuqizon Direktivën 2001/77/KE dhe dhe Direktivën 2003/30/KE (*Verification of compliance eith the sustainability criteria for biofuels and bioliquids)*	Do të miratojë strukturën përgjegjëse që do të verifikojë nëse operatorët ekonomikë kanë respektuar kriteret e qëndrueshmërisë. Do të përcaktojë mënyrën e verifikimit të Kritereve të Qëndrueshmërisë së Biokarburanteve të detyrueshme për operatorët ekonomikë a) Të lejojnë që sasi të lëndëve të para ose biokarburante me karakteristika të ndryshme qëndrueshmërie të përzihen; b) Të informojnë mbi karakteristikat e qëndrueshmërisë dhe mbi volumet e përzierjeve të përmendura në piken a) dhe t'i mbajnë ato të pandryshuara. c) Të sigurojnë që shuma e sasive të përdorura nga përzierja të ketë njëjtat karakteristika të qëndrueshmërisë, sa shuma e të gjithave volumeve që i janë shtuar përzierjes	Është parashikuar në procesin e hartimit të PKIE 2021–2023, kapitulli 15	2.2 Energjia dhe Burimet natyrore "Politika e Qeverisë në këtë mandat të ri do të vazhdojë të orientohet drejt rritjes të sigurisë së furnizimit me energji të konsumatorëve, duke pasur për objektiv mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet rritjes së punësimit dhe promovimit të energjisë së rinovueshme dhe eficiencës së energjisë, duke stimuluar konkurrencën në treg, duke siguruar stabilitet dhe minimizuar kostot për konsumatorët shqiptarë, si dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit." Si akt nënligjor i parashikuar të dalë pas miratimit të p/ligjit Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport"	VKM nr. 480, datë 31.7.2018 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030" , si akt nënligjor i parashikuar të dalë pas miratimit të p/ligjit Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport"	po
3	Marrëveshja për zgjidhjen e kontratës me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Kjo marrëveshje ka përfunduar "de fakto" dhe duhet të mbyllet edhe "de juro" , dhe për këto arsye ky bllok vazhdon të jetë I bllokuar.	Do të kalojë Bllokun Joni-5 në gjendje të lirë për të mundësuar më tej realizimin e operacioneve hidrokarbure për kërkimin dhe prodhimin e tyre në këtë zonë me interes.	JO	2.2 Energjia dhe Burimet natyrore "Politika e Qeverisë në këtë mandat të ri do të vazhdojë të orientohet drejt rritjes të sigurisë së furnizimit me energji të konsumatorëve, duke pasur për objektiv	JO	PO

	dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, Blloku "Joni-5" në det, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe *Orion Albania Limidet me pare (CAPRICORN Albania Limited)*							mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet rritjes së punësimit dhe promovimit të energjisë së rinovueshme dhe eficiencës së energjisë, duke stimuluar konkurrencën në treg, duke siguruar stabilitet dhe minimizuar kostot për konsumatorët shqiptarë, si dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit."		
4	Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2018 për projektin "Programi i Investimeve për Zhvillim të integruar Rajonal"	Projektligj	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Ratifikimi i kësaj Marrëveshjeje, do të bëjë të mundur fillimin e zbatimit të programit të Investimeve për Zhvillim të Integruar Rajonal.	Programi i investimeve për Zhvillim të integruar Rajonal ka për qëllim të mbështesë investimet në infrastrukturë dhe shërbime publike, si dhe harmonizimin e nevojave sociale, ekonomike dhe mjedisore përmes planifikimit dhe menaxhimit të duhur të aseteve dhe burimeve.	jo	jo	jo	jo
5	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin, 802 datë 30.9.2015 të Këshillit të Ministrave "Për vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG), nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridori i sistemit të gazsjellësit, të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)"	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Qëllimi për të cilin ndërmerret hartimi dhe miratimi i këtij akti nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore që mundësojnë kompletimin e punimeve të Projektit TAP në lidhje me infrastrukturën mbi tokë të projektit TAP. Në përputhje dhe zbatim të përcaktimeve të Marrëveshjes me Qeverinë e Vendit Pritës ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, datë 15.4.2013, të ndryshuar, pika 27.1 "Përfaqësuesi i Shtetit" , Pika 16 "Toka e Projektit" por dhe pjesa e parë "Toka e kërkuar e projektit" dhe pjesa e tretë "Konteksti i tokës së projektit" të shtojcës 1 të po kësaj Marrëveshjeje, mbi bazën e projektit teknik të gazsjellësit TAP (miratuar me vendimin e KKT-së nr. 1, datë 8.4.2014), janë përcaktuar edhe sipërfaqet e tokave që preken nga ndërtimi i	Si qëllim final, ky projektakt synon plotësimin tërësor të kuadrit ligjor për sa i përket aksesit të projektit TAP në tokën shtetërore nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm për sipërfaqet e tokave shtetërore në Seksionin Tokësor të projektit TAP, të cilat nuk janë prekur nga tri ndryshimet që i janë bërë më pas kësaj traseje, por ku janë bërë përditësimet përkatëse kadastrale, për parcelat e tokës shtetërore, si dhe për sipërfaqet e reja të tokave shtetërore që u përkasin pjesëve që lidhen me tri ndryshimet që i janë bërë trasesë së gazjellësit TAP dhe ku janë bërë edhe përditësimet përkatëse kadastrale, për të tri ndryshimet e Korridorit të Ndërtimit dhe Ndërtimi i Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit	JO	Vendimi nr. 87, datë 14.2.2018 "Miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare"	Vendim nr. 480, datë 31.7.2018 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030"	Projektvendimi do të prodhojë efekte financiare, Ka ndikim në mjedis.

					korridorit të ndërtimit dhe Korridori i Sistemit të Gazsjellësit, të projektit TAP, referuar trasesë së përcaktuar sipas Lejes Zhvillimore Komplekse miratuar me Vendimin e KKT nr. 1, datë 8.4.2014, "Për miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)" , sipërfaqe të cilat janë vënë në dispozicion të shoqërisë TAP AG nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm, sipërfaqe në të cilat përfshihen edhe tokat shtetërore. Pikërisht për marrëdhëniet financiare për marrjen në përdorim të sipërfaqeve të tokave shtetërore është miratuar VKM nr. 802, datë 30.9.2015 "Për vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG), nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridori i sistemit të gazsjellësit, të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)"					
6	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 803, datë 30.9.2015 të këshillit të ministrave "Për vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline Ag (TAP AG), nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm të sipërfaqeve të tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i infrastrukturës mbi tokë të projektit të gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)"	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Qëllimi për të cilin ndërmerret hartimi dhe miratimi i këtij akti nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore që mundësojnë realizimin e punimeve të Projektit TAP në lidhje me infrastrukturën mbi tokë të projektit TAP	Si qëllim final, ky projektakt synon plotësimin e kuadrit ligjor për sa i përket aksesit të projektit TAP në tokën shtetërore nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm për sipërfaqet e tokave shtetërore në infrastrukturën mbi tokë të projektit TAP ku janë bërë përditësimet përkatëse kadastrale, për parcelat e tokës shtetërore.	JO	Vendimi nr. 87, datë 14.2.2018 "Miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare"	Vendim nr. 480, datë 31.7.2018 për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030	Projektvendimi do të prodhojë efekte financiare, ka ndikim në mjedis
7	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 281,	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe	Katërmujori I	Qëllimi për të cilin ndërmerret hartimi dhe miratimi i këtij akti për ndryshimi të Vendimit nr.	Në kuptim dhe zbatim të këtij qëllimi, projektit TAP do t'i mundësohen të drejtat e përdorimit mbi pasuritë rrugë automobilistike dhe	JO	Vendimi nr. 87, datë 14.2.2018 "Miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe	Vendim nr. 480, datë 31.7.2018, Për miratimin e	Projektvendimi nuk do të prodhojë efekte financiare, Ka ndikim

	datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, "Për vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline Ag (TAP AG), nëpërmjet marrjes në përdorim, të sipërfaqeve të tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i rrugëve hyrëse të projektit të gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)" ndryshuar me VKM-së nr. 618 datë 7.7.2015		Energjisë		281 datë 1.4.2015 ndryshuar me vendimin nr. 618, datë 7.7.2015 nga ana e qeverisë, është se në projektin e rrugëve hyrëse për arsye objektive të terrenit kanë ndodhur ndryshime, kjo ka sjellë dhe ndryshime në sipërfaqen që preket nga rrugët e Projektit TAP.	sipërfaqet ujore (lumë, përrua, liqen dhe rezervuar) pa shpërblim për periudhën e nevojshme të përfundimit të ndërtimit të rrugëve hyrëse për aq kohë sa do të jetë e nevojshme për realizimin, zbatimin dhe përfundimin e projektit, sipas listës dhe hartave bashkëlidhur Projektvendimit të propozuar.		identifikimin e projekteve prioritare"	strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030"	në mjedis
8	Për sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit e trajtimit të ujërave të ndotura urbane	Projektligj	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Ky ligj ka si qëllim: a. krijimin e mekanizmave që sigurojnë kushtet optimale dhe garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban; b. ndërtimi i kornizës institucionale, në nivel kombëtar e vendor, ku përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion në kuadrin e përmbushjes së funksioneve politikëbërëse, rregullatore, menaxheriale dhe operacionale; c. ngritjen e mekanizmave që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimit të burimeve ujore në kuadër të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban; d. krijimin e mekanizmave, që mundësojnë ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, si dhe promovimin e mbrojtjes së interesave të konsumatorit.	1. Ky ligj përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat institucionale lidhur me politikat e zhvillimit dhe rregullimit, të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban dhe zbatohet për të gjitha shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, të licencuara, që ofrojnë këto shërbime, si dhe për çdo subjekt të këtij ligji, që ofron këto shërbime, pavarësisht formës së organizimit.	Jo	2.5 Infrastruktura, infrastruktura ujore	jo	Po
9	Strategjia Kombëtare e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2020–2030	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Qëllimi i Strategjisë së Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është të përmirësojë ofrimin cilësor të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për qytetarët e Shqipërisë dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit,	Objektivat strategjikë që synohen të arrihen janë specifike, të matshme në mënyrë që të arrihen në afatet kohore të parashikuara. • Përmirësimi i cilësisë saktësisë dhe konsistencës së të dhënave të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime. • Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit të shërbimeve ujësjellës dhe kanalizime për	Jo	Infrastruktura ujore Për ne është domosdoshmëri ndjekja e një qasjeje sektoriale për ujin nëpërmjet ndërtimit të një sistemi të integruar qeverisjeje dhe menaxhimi. Për jetësimin e kësaj qasjeje, mbështetur në parimet e gjithëpërfshirjes dhe transparencës, do	jo	Jo

					bazuar në kryerjen e një shërbimi kryesor të infrastrukturës.	popullsinë. • Rritja e eficiencës dhe cilësisë në ofrimin e shërbimeve UK. • Forcimi i qëndrueshmërisë financiare dhe përballueshmërisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime ndaj parimeve të kontrollit të kostos dhe mbulimit të plotë të kostos. • Forcimi i kapaciteteve të forcës së punës në sektor. • Përmirësimi i qeverisjes dhe kuadrit ligjor/rregullator të sektorit. • Hartimi dhe zbatimi i një programi për agregimin e shoqërive UK.		të hartohet dhe zbatohet një Program Kombëtar Sektorial afatgjatë (2018–2030), në të cilin do të synohet të harmonizohen veprimet dhe nismat që do të ndërmerren nga qeverisja qendrore dhe qeverisja vendore (tashmë në kuadër të decentralizimit të shumë funksioneve), sikurse dhe me të gjithë aktorët të tjerë, duke përfshirë partnerët zhvillimorë, shoqërinë civile, sipërmarrjen private etj.		
10	Projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 741, datë 9.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare"	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Saktësim i çështjeve të nevojshme për t'u adresuar nga zbatimi në praktikë I ligjit	Projektvendimi propozohet me qëllim rregullimin e procedurës për paraqitjen e projektit të rehabilitimit të mjedisit dhe llogaritjen e garancisë së investimit, për lejet minerare të dhëna sipas ligjit të vjetër nr. 7796, datë 17.2.2004, "Ligji minerar i Shqipërisë" , si dhe vlerësimin e garancive mjedisore të përgjithshme e vjetore për këto leje .Gjithashtu qëllim kryesor i këtij Projektvendimi është vendosja e një lehtësie për subjektet minerare që kanë leje minerare zbulimi.	Jo	Jo	Jo	Jo
11	Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për Bashkëpunim Financiar 2019 për projektin "Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës"	Projektligj	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Ratifikimi i kësaj Marrëveshjeje do të bëjë të mundur fillimin e zbatimit të programit të Rehabilitimit të Hidrocentralit të Fierzës.	Projekti do të ndikojë për përmirësimin e sistemit elektroenergjetik, sepse Hidrocentrali i Fierzës përbën njësinë gjeneruese më të rëndësishme të sistemit elektroenergjetik shqiptar, i cili prodhon 1328 GËh/vit dhe luan rolin e rregulllatorit 1-vjeçar të Kaskadës së Drinit. Projekti do të ndikojë në rehabilitimin e agregatëve të Hidrocentralit të Fierzës të cilat janë instaluar 39 vjet më parë dhe janë në gjendje kritike dhe kjo ndërhyrje është e domosdoshme dhe urgjente.	jo	jo	jo	jo
12	Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale	Projektligj	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Ratifikimi i kësaj Marrëveshjeje do të bëjë të mundur fillimin e zbatimit të programit për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve.	Objektivi i përgjithshëm i këtij programi, është dhënia e kontributit për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta, përmes investimeve në infrastrukturën e mbetjeve të ngurta dhe mbështetjen institucionale, për dhënien e një shërbimi të përmirësuar në zonat e ndryshme të mbetjeve. Në këtë mënyrë, mbështetet zbatimi i planit të investimeve, të	jo	jo	Ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011, "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" , të ndryshuar, VKM, nr. 418, datë 27.5.2020, "Për miratimin e dokumentit të	jo

	të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2018 për projektin "Programi për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve					parashikuara në "Studimin Sektorial mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri, (Masterplani i Mbetjeve të Ngurta)" ,			Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035" .	
13	Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2019 për projektin "Transport i qëndrueshëm në Tiranë (DKTI)"	Projektligj	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Ratifikimi i kësaj Marrëveshjeje do të bëje të mundur fillimin e zbatimit të programit "Transport i qëndrueshëm në Tiranë (DKTI)" ,	Qëllimi i tij është t'i japi mundësi implementimit të një sistemi të transportit publik me kapacitet të lartë (BRT) në qytetin e Tiranës mbështetur në fizibilitetin dhe projektin teknik që do të mundësohen nga studimi i konsulencës që po hartohet në Bashkinë e Tiranës me mbështetjen e KFW "Fizibiliteti dhe studimi i zhvillimin të projektit për sistemin BRT (Bus Rupid Transit) të Tiranës" .	jo	jo	jo	jo
14	Projektligj "Për miratimin e ndryshimeve në ligjin për komunikimet elektronike në linjë me EEC-në"	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Përafrim me legjislacionin përkatës të BE	Çështjet kryesore që parashikon projektakti janë të lidhura me 3 fusha kryesore, 1. Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit, 2. Komunikimet Elektronike dhe 3. Politika Audiovizuale.	Po, kapitulli 10, "Shoqëria e informacionit dhe media"	JO	JO	Po
15	Projektvendim i KM-së "Për miratimin e rregullores për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian, për Sigurinë e Aviacion -	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Ndryshime, kryesisht që kanë të bëjmë me kalimin nga Organ Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/incidenteve ajrore në Aviacionin Civil, në një autoritet, në mënyrë që të jetë në përputhje me rregulloren e BE.	Ndryshimet vijnë në mënyrë që të jenë në përputhje me kodin e ri Ajror të miratuar me ligjin 96/2020.	PO, kapitulli 14	JO	JO	JO
16	Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores për sistemin e monitorimit dhe të informacionit të trafikut të anijeve (VTMIS)"	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Hartimi i një rregullore për funksionimin e një sistemi për Montimin e Informacionit dhe Trafikut të Anijeve në përafrim të plote me direktivën 2002/59/EC i ndryshuar.	Krijimi i një sistemi monitorimi të trafikut të mjeteve lundruese në RSH: Rritja e sigurisë detare dhe mbrojtja e mjedisit detar të deteve Adriatik dhe Jon nga ndotja; Forcimin e bashkëpunimit me shtetet e tjera të rajonit dhe shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit për monitorimin e trafikut detar.	PO, kapitulli 14	JO	JO	JO

17	Projektvendim "Për statistikat e energjisë"	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Statistikat në fushën e energjisë, të cilat përbëjnë bazën për hartimit e dokumenteve strategjike të energjisë, duhet të jenë në përputhje me Rregulloren (EC) nr. 1099/2008 të parlamentit dhe Këshillit të Evropës të datës 22 tetor 2008 mbi statistikat e energjisë	Krijon kuadrin e përbashkët në nivel evropian të prodhimit, transmetimit, vlerësimit dhe shpërndarjes së statistikave të krahasueshme të energjisë	PO, kapitulli 15	2.2 Energjia dhe Burimet natyrore "Politika e Qeverisë në këtë mandat të ri do të vazhdojë të orientohet drejt rritjes të sigurisë së furnizimit me energji të konsumatorëve, duke pasur për objektiv mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet rritjes së punësimit dhe promovimit të energjisë së rinovueshme dhe eficiencës së energjisë, duke stimuluar konkurrencën në treg, duke siguruar stabilitet dhe minimizuar kostot për konsumatorët shqiptarë, si dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit."	Strategjia Kombëtare e Energjisë (2018-2030) miratuar me Vendimin Nr. 480, datë 31.7.2018, të Këshillit të Ministrave.	JO
18	Projektvendim "Për miratimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës"	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (PKEK) për periudhën 2021-2030, hartohet në zbatim të detyrimeve të vendit ndaj Marrëveshjes së Parisit të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr. 75/2016 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit, në kuadër të Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike" dhe Rekomandimit të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë 2018/01/MC-EnC. Hartimi i këtij plani është parashikuar gjithashtu edhe në Strategjinë Kombëtare të Energjisë (2018-2030) miratuar me Vendimin Nr. 480, datë 31.7.2018, të Këshillit të Ministrave.	Procesi i hartimi të këtij plani do të kryhet në përputhje me pesë dimensionet e përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe Udhëzuesi i Politikave 03/2018-ECS, për periudhën 2021-2030, përkatësisht: • Sigurinë e energjisë; • Integrimin e plotë në tregun rajonal dhe në vazhdimësi në atë Evropian; • Eficiencën e energjisë që kontribuon në moderimin e kërkesës; • Dekarbonizimin e ekonomisë; • Hulumtimin, inovacionin dhe konkurrueshmërinë. Plani do të përcaktojë mbi bazën e një metodologjie të dakordësuar me Komunitetin e Energjisë, objektivat sasiorë që lidhen me sigurinë e energjisë, eficiencën e energjisë, energjitë e rinovueshme dhe reduktimin e gazeve me efekt serrë. Për çdo objektiv të përcaktuar, mbi bazën e modeleve dhe projeksioneve të energjisë dhe klimës do të hartohen skenarët bazë dhe skenarët e politikave, në bazë të së cilëve do të përcaktohen masat për arritjen e objektivave.	Po, kapitulli 15	2.2 Energjia dhe burimet natyrore "Politika e qeverisë në këtë mandat të ri do të vazhdojë të orientohet drejt rritjes të sigurisë së furnizimit me energji të konsumatorëve, duke pasur për objektiv mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet rritjes së punësimit dhe promovimit të energjisë së rinovueshme dhe eficiencës së energjisë, duke stimuluar konkurrencën në treg, duke siguruar stabilitet dhe minimizuar kostot për konsumatorët shqiptarë, si dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit" .	Strategjia Kombëtare e Energjisë (2018-2030) miratuar me vendimin nr. 480, datë 31.7.2018, të Këshillit të Ministrave.	Projektvendimi do të prodhojë efekte financiare, dhe ka ndikim pozitiv në mjedis dhe ndryshimet klimatike
19	Për miratimin e normave teknike të instalimeve të impianteve të prodhimit për depozitimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme dhe për realizimin e përzierjes së biokarburanteve me nënprodukte të naftës bruto	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Përafrim me legjislacionin përkatës të BE	Transpozon nenin 13.1 i Direktivës 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009, "Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e energjisë të rinovueshme" , e cila shfuqizon Direktivën 2001/77/KE dhe dhe Direktivën 2003/30/KE	PO, kapitulli I 15	JO	JO	JO
20	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove postare	Projektvendim	Ministri I Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Përafrim me legjislacionin përkatës të BE	Promovimi i tregtisë elektronike, rritja e transparencës për tarifat postare ndërkufitare.	PO, kapitulli 3	JO	JO	JO

VENDIM
Nr. 1125, datë 30.12.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROJEKTIMIT, ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRHYRJEVE RUAJTËSE E MBROJTËSE NË PASURITË KULTURORE MATERIALE, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 72, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në përcaktimin e rregullave për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, në fushën e:

a) projektimit;

b) zbatimit të punimeve;

c) mbikëqyrjes;

ç) kolaudimit.

II. PËRKUFIZIME

Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Kolaudator" është subjekti që finalizon kontrollin e punimeve të zbatimit të projektit për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse. Kolaudatori mund të jetë institucioni shtetëror i specializuar në fushën e trashëgimisë kulturore ose subjekti i licencuar në kolaudim, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

b) "Mbikëqyrës" është subjekti që ndjek dhe kontrollon zbatimin e projektit për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasurinë kulturore materiale. Mbikëqyrës mund të jetë institucioni shtetëror i specializuar në fushën e trashëgimisë kulturore ose subjekti i licencuar në mbikëqyrje, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

c) "Mbikëqyrja e punimeve" është procesi i kontrollit, i mbarëvajtjes së zbatimit të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse, në përputhje me projektin e miratuar nga KKTKM-ja në çdo objekt që është pasuri kulturore materiale, në zbatim të akteve në fuqi të mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore.

ç) "Projektues" është subjekti që harton projektin për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale. Projektues mund të jetë institucioni shtetëror i specializuar në fushën e trashëgimisë kulturore ose subjekti i licencuar në projektim, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

d) "Zbatim i punimeve" është procesi nëpërmjet të cilit realizohen punimet ruajtëse e mbrojtëse në pasuri kulturore materiale, sipas projektit të miratuar.

dh) "Zbatues i punimeve" është subjekti që realizon punimet për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuri kulturore materiale, sipas projektit të miratuar. Zbatues i punimeve mund të jetë institucioni shtetëror i specializuar në fushën e trashëgimisë kulturore ose subjekt i licencuar në zbatim, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

e) "Zhvillues" është autoriteti publik apo subjekti privat që financon realizimin e zbatimit të projektit për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse mbi pasurinë kulturore materiale.

III. PROJEKTIMI I NDËRHYRJEVE RUAJTËSE E MBROJTËSE NË PASURITË KULTURORE III. PROJEKTIMI MATERIALE

1. Projektet për kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore (DRTK), njësitë e administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike (NJAKPA) ose nga subjektet e licencuara, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Hartimi i projekteve për kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, në varësi të llojit dhe shkallës së ndërhyrjeve, përfshin:

a) studimin e pasurisë kulturore materiale;

b) analizat laboratorike të materialeve ekzistuese të pasurisë kulturore, sipas rastit;

c) paraqitjen grafike të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse;

ç) relacionin teknik;

d) relacionin e specifikimeve teknike;

dh) preventivat e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasurinë kulturore;

e) grafikun e punimeve.

3. Studimi i pasurisë kulturore përmban:

a) njohjen dhe analizën e dokumentacionit historik të pasurisë kulturore në aspektin historik, kontekstin ose mjedisin rrethues në të cilën është ndërtuar, destinacionin fillestar dhe ndryshimet përgjatë ekzistencës së tij në kohë; arkitekturën, konstruksionin dhe materialet e përdorura nëpërmjet:

i. dokumentacionit arkivor historik;

ii. dokumentacionit teknik, si: harta, planimetri, fasada të pasurisë nga arkivi teknik i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Arkivi Qendror Teknik, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Instituti i Arkeologjisë;

iii. dokumentacionit fotografik ose filmimeve historike nga arkivi teknik i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Arkivi Qendror i Shtetit, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Arteve;

iv. dokumentacionit bibliografik dhe revistave shkencore.

b) dokumentacionin që vërteton statusin juridik të pasurisë. Në rastin e pasurive kulturore materiale të paluajtshme, përfshin edhe dokumentacionin hartografik të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës;

c) njohjen dhe analizën në terren të pasurisë kulturore, me qëllim analizimin e gjendjes ekzistuese së pasurisë kulturore, strukturës, identifikimit të shkaqeve të degradimit nëpërmjet:

i. rilevimeve me metodë direkte dhe indirekte;

ii. analizave të detajuara mbi strukturën, gjendjen statike dhe materialet e përdorura;

iii. sondazheve apo hetimeve jodestruktive në sipërfaqe të vogla të veshjes, ngjyrosjes, suvatimit dhe në elementet e fshehura me vlerë të pasurisë kulturore për marrjen e kampioneve për analiza laboratorike;

iv. sondazheve ose gërmimeve arkeologjike për pjesë të humbura të pasurisë kulturore të fshehura në shtresën kulturore që rrethon pasurinë kulturore apo që gjenden nën të, pas marrjes së miratimit të KKTKM-së;

v. fotografimeve të gjendjes ekzistuese.

4. Paraqitja grafike e tërësisë së ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse që projektuesi propozon të realizohen përmban:

a) vendndodhjen e pasurisë kulturore;

b) pozicionimin në raport me zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore;

c) statusin e objektit;

ç) gjendjen e shkallës së degradimit të objektit në planimetri, fasada, detaje;

d) ndërhyrjet e propozuara, të pasqyruara në mënyrë të detajuar në projektin arkitektonik dhe detaje teknike konstruktive, mënyrat dhe teknikat e zbatimit.

5. Relacioni teknik përmban:

a) përshkrimin në mënyrë të detajuar të të gjitha fazave të ndjekura për hartimin e projektit;

b) konkluzionet e nxjerra gjatë studimit;

c) radhën e ndërhyrjeve dhe mjetet e nevojshme për realizimin e tyre mbi bazën e vlerësimit shkencor dhe estetik të pasurisë kulturore;

ç) vlerësimin që restauratori u bën shtesave në kohë të pasurisë kulturore, pjesëve të humbura të tij, elementeve të dëmtuara, materialeve të degraduara gjatë ekzistencës shekullore të monumentit dhe mënyrave të trajtimit e përforcimit të tij.

6. Relacioni i specifikimeve teknike përmban në mënyrë të detajuar normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve për çdo ndërhyrje ruajtëse dhe mbrojtëse, të parashikuara në projekt.

7. Preventivat e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasurinë kulturore:

a) hartohen referuar çmimeve të manualit të restaurimit në fuqi;

b) në rast të zërave të rinj të paparashikuar në manualin e restaurimit, preventivat shoqërohen me analizat teknike të çmimeve referuar çmimeve të tregut për materialet e përdorura;

8. Fondi rezervë në preventivat e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasurinë kulturore materiale parashikohet deri në masën 20% të vlerës së preventivit.

9. Subjekti projektues, shtetëror apo privat, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të punimeve restauruese, të cilat jepen në preventiv.

IV. ZBATIMI I PUNIMEVE PËR NDËRHYRJET RUAJTËSE E MBROJTËSE NË PASURITË KULTURORE MATERIALE

1. Financimi i punimeve për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse realizohet nga zhvilluesi i punimeve. Financimi bëhet nga:

a) buxheti i shtetit;

b) çdo subjekt privat, vendës apo i huaj, që ofron kontributin e tij në ruajtjen e mbrojtjen e pasurisë kulturore materiale;

c) pronari ose poseduesi i pasurisë kulturore materiale.

2. Zhvilluesi kontrakton si zbatues të punimeve për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale vetëm subjekte të licencuara në zbatim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Zbatues të punimeve për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale mund të jenë:

a) IKTK-ja, DRTK-të, NJAKPA-të;

b) subjektet e licencuara në zbatim, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Kur ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale realizohen nga IKTK-ja, DRTK-të, NJAKPA-të:

a) punimet kryhen nga specialistët dhe punëtorët e institucionit;

b) drejtuesi teknik përcaktohet me vendim të titullarit të institucionit sipas tipologjisë së projektit.

5. Kur ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale realizohen nga subjekte të licencuara në zbatim sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore, kryhen sipas kushteve të mëposhtme:

a) çdo subjekt i licencuar në zbatim për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi vetëm në kategoritë përkatëse, që ka të përcaktuar në licencën e tij;

b) drejtuesit ligjorë dhe teknikë të zbatuesit të punimeve janë përgjegjës përpara institucioneve shtetërore të specializuara dhe zhvilluesit për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasurinë kulturore, në zbatim të projektit të miratuar në KKTKM-ja, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi;

c) Dokumentacioni administrativo-teknik dhe tekniko-financiar që i bashkëlidhet kontratës së nënshkruar midis zhvilluesit dhe zbatuesit të punimeve, në origjinal, përfshin:

i. lejen për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, miratuar me vendim të KKTKM-së;

ii. projektin e plotë të zbatimit, përfshirë relacionin teknik dhe specifikimet teknike të miratuar në KKTKM;

iii. planin e organizimit të punimeve;

iv. grafikun e punimeve;

v. preventivin final me çmimet e detajuara, i cili duhet të përputhet me zërat dhe volumet e miratuara në KKTKM.

6. Dokumentacioni administrativo-teknik dhe financiar i dorëzohet zyrtarisht zbatuesit të punimeve nga zhvilluesi.

7. Zbatuesi i punimeve administron dokumentacionin e parashikuar në shkronjën "c", të pikës 5, të këtij kreu, dhe nuk lejon kalimin e tyre te persona të paautorizuar.

8. Zhvilluesi i dorëzon zbatuesit të punimeve me anë të procesverbalit të dorëzimit objektin, pasuri kulturore materiale, në tërësi ose pjesërisht, sipas kushteve të kontratës apo gjendjes faktike.

9. Zbatuesi i punimeve, përpara fillimit të punimeve, njofton mbikëqyrësin e punimeve, IKTK-në dhe DRTK-në përkatëse dhe, kur është rasti, organet kompetente, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për datën e fillimit të punimeve, afat i cili përcaktohet në kushtet e kontratës së lidhur me zhvilluesin referuar vendimit të KKTKM-së. Ky njoftim shoqërohet me:

a) dokumentacionin e parashikuar në shkronjën "c", të pikës 5, të këtij kreu;

b) listën e punonjësve të siguruar dhe makinerive në kantier.

10. Zbatuesi i punimeve është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore nga momenti i marrjes në dorëzim të objektit deri në dorëzimin e punimeve. Gjatë kësaj periudhe, zbatuesi i punimeve mbulon me shpenzimet e veta çdo defekt, ndërhyrje tjetër të diktuar nga zhvillimi i ndërhyrjeve, si dhe përgjigjet për çdo dëmtim që shkaktohet nga paaftësia, neglizhenca, të metat në zbatim, mungesa e masave mbrojtëse e sinjalizuese, e përfaqësuesve dhe punonjësve në:

a) pronën, pasuri kulturore dhe/ose në mjedisin në afërsi, sipas parashikimeve në kontratën e zbatimit të punimeve;

b) rrjetin e infrastrukturës së zonës, në kantier e në afërsi, sipas parashikimeve në kontratën e zbatimit të punimeve;

c) rrethimin e kantierit, që bëhet sipas pozicionimit të objektit dhe vendndodhjes së tij, në

përputhje me kushtet urbane, të përcaktuara nga organet përgjegjëse;

ç) vendosjen e tabelave të identifikimit të punimeve në vende të dukshme në kantier, me të dhënat për pasurinë kulturore, destinacionin, lejen për ndërhyrje në pasuri kulturore materiale, zhvilluesin, projektuesin, mbikëqyrësin dhe zbatuesin e punimeve, vlerën e investimit dhe afatet e punimeve për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse.

11. Zbatuesi i punimeve ka përgjegjësinë të sigurojë në kantier:

a) punëmarrës të kualifikuar, të pajisur me leje, dëshmi apo autorizime të veçanta për ushtrim profesioni, si: murator, elektricist, hidraulik, karpentier, specialist çatije sipas tipologjisë, nga organet e autorizuara me ligj, shoqëruar me raportin mjekësor për aftësi në punë;

b) punonjës të kualifikuar dhe të autorizuar prej tij për instruktimin teknik dhe mbrojtjen në punë;

c) rregullore, urdhra e udhëzime në fuqi për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë;

ç) librin e sigurimit teknik të punonjësve;

d) mbrojtjen e detyrueshme të skelave, të daljeve të jashtme të objektit, si dhe mbrojtjen e mekanizmave e të pajisjeve nga goditjet e rrymave elektrike;

dh) materiale, pajisje, mjete mbrojtëse, kolektive e individuale, si dhe tabela paralajmëruese;

e) mirëmbajtjen dhe kontrollin periodik të makinerive e të mekanizmave të instaluar në objekt, për punë me rrezik.

12. Zbatuesi i punimeve është i detyruar të zëvendësojë menjëherë përfaqësuesit e vet dhe punonjësit e tjerë të kantierit, kur kjo kërkohet në mënyrë të arsyetuar nga zhvilluesi apo mbikëqyrësi i punimeve.

13. Zbatuesi i punimeve është përgjegjës për kontrollin dhe respektimin e kërkesave të kontratës, si dhe për cilësinë e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale. Ai kryen të gjitha provat dhe inspektimet e detyrueshme nga specifikimet teknike të projektit të miratuar, si dhe shtesat e kërkuara e të gjykuara të nevojshme nga mbikëqyrësi.

14. Zbatuesi i punimeve kryen punime të veçanta, të parashikuara në kontratë me nënkontraktim, vetëm me miratim paraprak të zhvilluesit. Marrëdhëniet dhe kushtet e nënkontraktimit rregullohen me marrëveshje dypalëshe, e cila, në asnjë rast, nuk duhet të jetë në kundërshtim me detyrimet kontraktore të zbatuesit të punimeve. Zbatuesi i punimeve është përgjegjës ndaj zhvilluesit për punimet e nënkontraktimit dhe dokumentacionin administrativo-teknik dhe financiar. Në çdo rast, nënkontraktuesi i punimeve të veçanta duhet të plotësojë kushtet e një subjekti të licencuar për zbatim të punimeve me licencën përkatëse në objektin e kontratës së nënkontraktimit. Nënkontraktuesi realizon punimet e nënkontraktimit nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e drejtuesit teknik të zbatuesit të punimeve, i licencuar në restaurim.

15. Kur zhvilluesi ose mbikëqyrësi i punimeve konstatojnë që nënkontraktuesi shkel kushtet e kontratës, lajmërojnë me shkrim zbatuesin e punimeve për zgjidhjen e marrëveshjes dhe largimin nga kantieri të nënkontraktuesit.

16. Drejtimi teknik i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale në kantier realizohet drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik në restaurim i zbatuesit të punimeve. Drejtuesi teknik i restaurimit ka këto të drejta dhe detyra:

a) ndjek çdo ditë në kantier punimet për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse të pasurisë kulturore materiale dhe është përgjegjës për zbatimin e tyre sipas projektit të miratuar;

b) instrukton çdo fillim muaji të gjithë punonjësit në përputhje me programin mujor të punës;

c) instrukton punonjësit e rinj, që fillojnë punë për herë të parë, skuadrat e individëve që vijnë rishtazi në kantier, ata që fillojnë një proces të ri pune apo që vendosen në punime të veçanta me shkallë vështirësie;

ç) kërkon nga zbatuesi i punimeve largimin menjëherë nga puna në kantier të çdo punonjësi që nuk zbaton masat e sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë, si dhe pezullon punën kur nuk garantohen masat mbrojtëse;

d) verifikon saktësinë e kryerjes së ndërhyrjeve. Ai është përgjegjës për zbatimin me përpikëri të projektit, sipas vizatimeve, përshkrimeve teknike e ndryshimeve të miratuara prej tyre, në përputhje me specifikimet teknike të kontratës dhe sipas radhës të punimeve të përcaktuara në grafikun e punimeve;

dh) njofton menjëherë mbikëqyrësin e punimeve për pasaktësitë, mospërputhjet, mungesat e të dhënave në vizatimet, përshkrimet e

specifikimet teknike, paraqet propozimet e veta dhe pret udhëzimet e tij;

e) merr kampione për materialet me standarde të detyrueshme dhe njihet me rezultatet e testimit të tyre, të cilat ia referon mbikëqyrësit dhe zhvilluesit. Kur rezultatet janë më të ulëta se kërkesat e projektit dhe se standardet, mbikëqyrësi dhe zhvilluesi njoftojnë menjëherë zbatuesin e punimeve për vlerësimin e pasojave dhe korrigjimin e defekteve;

ë) korrigjon brenda afatit të caktuar, me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, punimet që rezultojnë me shkelje të kushteve teknike të zbatimit, standardeve e specifikimeve teknike të konstatuara nga mbikëqyrësi.

17. Zbatuesi i punimeve mban procesverbale të shoqëruara me materiale fotografike ose filmike për të gjithë zërat e ndërhyrjeve, veçanërisht për punimet e maskuara. Kopje e këtij dokumentacioni i dorëzohet mbikëqyrësit çdo javë.

18. Zbatuesi i punimeve nuk mund të ndryshojë më nismën e vet projektin ose përshkrimet teknike të tij.

19. Zbatuesi i punimeve i paraqet zhvilluesit kërkesëpropozimet për korrigjime, plotësime apo situata të paparashikuara gjatë zbatimit të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale. Zhvilluesi i kërkon mbikëqyrësit dhe projektuesit vlerësimin dhe miratimin e këtyre kërkesëpropozimeve, brenda një afati të caktuar nga palët. Në rastet kur kërkesëpropozimet ndikojnë në ndryshimin e projektit fillestar, ato paraqiten për shqyrtim në KKTKM dhe, pas miratimit me vendim, vijohet me realizimin e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse. Vendimi i KKTKM-së për ndryshimet e projektit fillestar është i detyrueshëm për zbatim.

20. Në rastet kur gjatë zbatimit të punimeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurisë kulturore materiale paraqiten të nevojshme ndërhyrje të paparashikuara në kontratë, mbikëqyrësi i punimeve, pas miratimit të projektuesit, i paraqet zhvilluesit propozimet për ndërhyrjet e paparashikuara. Pas konfirmimit nga zhvilluesi, këto propozime paraqiten për miratim edhe në KKTKM.

21. Gjatë zbatimit të punimeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurisë kulturore materiale, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni i nevojshëm, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve. Drejtuesi teknik mban dhe plotëson dokumentacionin e zbatimit të punimeve, i cili konfirmohet edhe nga mbikëqyrësi i punimeve. Ky dokumentacion përfshin:

a) Dokumentacionin administrativo-teknik, si më poshtë vijon:

i. dokumentacioni administrativo-ligjor për zbatuesin e punimeve, si subjekt juridik, ku përfshihen: licenca e drejtuesit teknik, licenca e personit fizik ose juridik, lejet e restaurimit, kontrata e lidhur mes zbatuesit dhe investitorit;

ii. projekti i miratuar nga KKTKM-ja;

iii. preventivi i fillimit të punimeve/preventivi i ofertës, përditësimet e ndryshimet, të miratuara gjatë zbatimit të punimeve, përshkrimet dhe specifikimet teknike;

iv. akti i dorëzimit të objektit, pasuri kulturore materiale, nga zhvilluesi te zbatuesi, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi;

v. procesverbali i fillimit të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili nënshkruhet nga mbikëqyrësi i punimeve, zhvilluesi/ përfaqësuesit e autorizuar prej tij, si dhe nga drejtuesi ligjor e teknik i zbatuesit të punimeve;

vi. libri i kantierit, me detyrat e pasqyruara nga mbikëqyrësi i punimeve dhe/ose specialistët e autorizuar për vëzhgimin e punimeve. Personat e autorizuar të zhvilluesit, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve, monitoruesi, që kanë të drejtë kontrolli, shënojnë në librin e kantierit vërejtje për zbatimin e punimeve, akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe lënë detyra e kontrollojnë zbatimin e tyre. Drejtuesi i kantierit merr masa për ndreqjen e të metave dhe bën shënimet përkatëse në libër. Libri i kantierit përbëhet nga fletë të numëruara e të vulosura nga zbatuesi i punimeve;

vii. ditari i objektit pasqyron veprimtarinë restauruese ditore. Ditari i objektit jep të dhëna për motin, temperaturat, punimet e kryera, burimet njerëzore e teknike të përdorura, kontrollet për sasinë dhe cilësinë e punës së kryer, defektet e korrigjimet e tyre, punimet dhe proceset e ndërmjetme, marrë në dorëzim nga zbatuesi sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi. Ditari i objektit përmban ndryshimet, testimet dhe rezultatet, masat suplementare për ndreqjen e defekteve dhe rastet kur punimet kryhen në kushte të veçanta. Ditari i objektit firmoset çdo ditë nga drejtuesi teknik;

viii. libri i sigurimit teknik të punonjësve, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi. Libri i sigurimit teknik të punonjësve hapet menjëherë me fillimin e punimeve dhe mbahet në çdo kantier ose objekt ku kryhen ndërhyrje ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale, sipas përcaktimit që bën zbatuesi. Në libër pasqyrohen procesverbalet e instruktimit, emrat e punonjësve të instruktuar, atyre të aksidentuar, mbledhjet për sigurimin dhe mbrojtjen në punë, kontrollet, detyrat dhe masat e marra për zbatimin e tyre. Rregullat për sigurimin teknik të punonjësve mbështeten në legjislacionin e punës dhe rregullat në fuqi. Libri i sigurimit teknik të punonjësve përmban fletë të numëruara e të vulosura nga zbatuesi. Personat e autorizuar të zhvilluesit dhe mbikëqyrësi i punimeve kanë të drejtë kontrolli, shënojnë në librin e instruktimit vërejtje për zbatimin e punimeve dhe masat e marra nga zbatuesi i punimeve;

ix. procesverbalet e punimeve të maskuara pasqyrojnë në mënyrë të hollësishme proceset e kryera të punës, shoqëruar me foto/video;

x. procesverbalet plotësuese, të shoqëruar me foto të punimeve;

xi. certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve të përdorura, testimet dhe rezultatet e tyre;

xii. kërkesë për shtesë kontrate nga zbatuesi i punimeve dhe mbikëqyrësi drejtuar zhvilluesit, nëse del e nevojshme, shoqëruar me projektpreventivin;

xiii. miratimi i kërkesës për shtesë kontrate nga zhvilluesi;

xiv. preventivi i shtesës së kontratës, i miratuar nga KKTKM-ja;

xv. kontrata shtesë midis zbatuesit të punimeve dhe zhvilluesit shoqëruar me projektpreventivin e miratuar;

xvi. njoftimi i përfundimit të punimeve nga zbatuesi i punimeve drejtuar mbikëqyrësit të punimeve;

xvii. njoftimi i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi, drejtuar zhvilluesit;

xviii. deklarata teknike e punimeve për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse nga zbatuesi i punimeve, sipas formatit bashkëngjitur këtij vendimi, e cila i dorëzohet mbikëqyrësit, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i punimeve;

xix. relacioni përfundimtar i detajuar i hartuar nga mbikëqyrësi i punimeve ku përfshihen dhe skica e foto të punimeve, në format shkresor dhe elektronik;

xx. akti i kolaudimit të punimeve të ruajtjes e mbrojtjes së pasurive kulturore materiale, sipas formatit bashkëngjitur këtij vendimi;

xxi. certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të objektit nga zhvilluesi, sipas formatit bashkëngjitur këtij vendimi;

xxii. procesverbalet për ndreqjet e të metave gjatë periudhës së garancisë së punimeve, sipas formatit bashkëngjitur këtij vendimi;

xxiii. certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të objektit, sipas formatit bashkëngjitur këtij vendimi.

b) Dokumentacionin tekniko-financiar, si më poshtë vijon:

i. libreza e masave, ku pasqyrohen volumet faktike të punimeve. Libreza e masave mbahet për çdo objekt pasuri kulturore materiale, që ka preventiv dhe është dokumenti bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve dhe skica gradualisht me zhvillimin e tyre;

ii. tabela e rakordimeve, shoqëruar me relacionin shpjegues të punimeve që shtohen dhe zbriten;

iii. procesverbali për ndryshimet e volumeve, nëse ka;

iv. kërkesë për përdorimin e fondit rezervë, nëse del e nevojshme, shoqëruar me relacionin argumentues;

v. miratimi i përdorimit të fondit rezervë nga zhvilluesi;

vi. situacionet pjesore progresive të punimeve;

vii. preventiv i rishikuar i punimeve, ku pasqyrohen volumet faktike referuar librezës së masave;

viii. situacioni përfundimtar i punimeve.

21. Në rast ndryshimi të drejtuesit teknik të punimeve ruajtëse e mbrojtëse, dokumentacioni teknik i dorëzuar deri në këtë moment i kalohet me procesverbal drejtuesit teknik pasardhës, në prani të zbatuesit të punimeve. Kjo procedurë pasqyrohet në ditarin e objektit.

22. Dosja e objektit hartohet në jo më pak se katër kopje origjinale. Pas kolaudimit të punimeve zbatuesi i punimeve i dorëzon, të paktën, një kopje zbatuesit të punimeve, një kopje zhvilluesit, dy kopje mbikëqyrësit të punimeve. Mbikëqyrësi i

punimeve dorëzon një nga kopjet e plota të dosjes pranë arkivit të IKTK-së.

23. Certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të objektit pasuri kulturore materiale lëshohet pas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, sipas kontratës, por jo më pak se 1 vit nga marrja e përkohshme në dorëzim.

24. Dokumentet, që ndodhen në dosjen teknike të objektit, konsiderohen dokumente me rëndësi historike kombëtare dhe u nënshtrohen rregullave të arkivimit, sipas legjislacionit për arkivat. Këto dosje ruhen në arkivin e IKTK-së.

V. MBIKËQYRJA E PUNIMEVE PËR NDËRHYRJET RUAJTËSE E MBROJTËSE NË PASURITË KULTURORE MATERIALE

1. Mbikëqyrja e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurisë kulturore materiale kryhet nga IKTK-ja, DRTK-të, NJAKPA-të ose subjekte të licencuara për mbikëqyrjen e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse. Mbikëqyrësi nuk duhet të jetë në kushtet e konfliktit të interesit me zbatuesin e punimeve.

2. Kur ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse janë miratuar edhe sipas legjislacionit për planifikimin e territorit, caktohet edhe mbikëqyrës dhe kolaudator i licencuar në fushat specifike, sipas legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

3. Caktimi i mbikëqyrësit bëhet para fillimit të zbatimit të punimeve nga:

a) autoriteti publik, me procedurë konkurrimi në rastet e kryerjes së investimeve me fonde publike në pasurinë kulturore;

b) titullari i IKTK-së, për mbikëqyrësit që janë pjesë e stafit të institucioneve shtetërore të specializuara;

c) subjekti privat, vendës apo i huaj, ose nga pronari apo poseduesi, i cili njofton me shkrim IKTK-në për mbikëqyrësit e kontraktuar.

4. Detyrat e mbikëqyrësit të punimeve janë, si më poshtë:

a) Përpara fillimit të zbatimit të punimeve:

i. verifikon dokumentacionin e licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, projektin e miratuar, preventivin e ofertës;

ii. verifikon kontratën ndërmjet zhvilluesit dhe zbatuesit, si dhe të gjitha aktet administrative që lidhen me të;

iii. verifikon dokumentacionin për sigurimin teknik të punonjësve, të nënshkruar nga punonjësit pas instruktimit të tyre në kantier;

iv. merr pjesë dhe nënshkruan procesvarbalin e fillimit të punimeve pas njoftimit nga zbatuesi;

v. verifikon ngritjen e kantierit dhe vendosjen e tabelës nga zbatuesi i punimeve;

vi. merr pjesë dhe nënshkruan aktin e dorëzimit të sheshit nga zhvilluesi së bashku me zbatuesin e punimeve;

vii. merr pjesë dhe nënshkruan procesverbalin e fillimit të punimeve së bashku me zhvilluesin dhe zbatuesin e punimeve;

viii. verifikon çdo proces të ndërhyrjeve që realizohen në pasurinë kulturore materiale dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të restaurimit, realizimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore, lejen për ndërhyrje, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit;

ix. verifikon zbatimin e ndërhyrjeve sipas grafikut të punimeve;

x. verifikon mbarëvajtjen e procesit të restaurimit, cilësinë e punimeve, materialet dhe teknikën e përdorur, si dhe zbatimin e punimeve në përputhje me projektin e miratuar në KKTKM;

xi. informon në mënyrë periodike zhvilluesin mbi ecurinë e punimeve të restaurimit;

xii. harton relacione shpjeguese që shoqërojnë situacionet pjesore progresive dhe përfundimtare, ku vërtetohet që punimet e paraqitura në situacion janë realizuar konform projektit të miratuar dhe akteve në fuqi të mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore materiale;

xiii. njofton inspektoratin përgjegjës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në rastin kur zbatuesi i punimeve del jashtë projektit të miratuar nga KKTKM-ja apo kur vazhdon punimet pa miratimet përkatëse pavarësisht nga njoftimet e bëra nga ana e institucioneve shtetërore të specializuara;

xiv. merr miratimin e zhvilluesit në rastet e ndryshimit të projektit, të miratuar nga KKTKM-ja;

xv. përgjigjet, së bashku me zbatuesin e punimeve, për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit të mbajtur në objekt;

xvi. mban dosjen e mbikëqyrjes së punimeve, ku pasqyrohen të gjitha aktet dhe procesverbalet e mbajtura gjatë zbatimit të punimeve.

b) Në fazën e zbatimit të punimeve:

i. jep instruksione dhe urdhra me shkrim për zbatuesin e punimeve, sa herë që e sheh të nevojshme. Zbatuesi i punimeve ka të drejtë t'ia drejtojë me shkrim zhvilluesit vërejtjet e tij (në rast se ka) për instruksionet dhe urdhrat e mbikëqyrësit të punimeve;

ii. kërkon verifikimet përkatëse, kur mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve. Kur nga verifikimet provohen defektet në zbatim, shpenzimet janë në ngarkim të zbatuesit të punimeve;

iii. pezullon përkohësisht punimet, kur gjatë ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse konstatohen defekte të rënda, dëmtime apo punime të realizuara ndryshe nga projekti i miratuar në KKTKM;

iv. pezullon punimet kur konstaton zbatim teknik të gabuar, devijim apo paaftësi teknike në zbatimin e projektit. Kur konstaton raste të ndryshimit të projektit njofton zhvilluesin dhe inspektoratin përgjegjës;

v. propozon largimin nga kantieri të një ose të disa personave nga personeli i zbatuesit të punimeve, nëse konstaton shkelje disiplinore sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi. Për këtë, i drejtohet me shkrim drejtuesit ligjor të zbatuesit të punimeve, duke shpjeguar arsyet;

vi. miraton materialet që përdoren në kantier, në përputhje me specifikimet teknike të projektit. Materialet e ardhura, si dhe pajisjet e siguruara nga zbatuesi i punimeve, por që nuk pranohen nga mbikëqyrësi, zëvendësohen me të tjera, me shpenzimet e zbatuesit të ndërtimit. Ky proces dokumentohet me procesverbal;

vii. kërkon kryerjen e provave fiziko-kimike të materialeve të restaurimit të vendosura në objekt/pasuri kulturore, kur cilësia e materialeve të përdorura nga zbatuesi i punimeve nuk është sipas specifikimeve teknike të miratuara. Shpenzimet janë në ngarkim të zbatuesit të punimeve;

viii. kontrollon punimet e maskuara, të mbuluara dhe të betonuara dhe miraton realizimin e tyre me procesverbalet e hartuara nga zbatuesi i punimeve, duke lejuar vijimin e proceseve të tjera sipas grafikut të punimeve;

ix. kontrollon volumet e pasqyruara në librezën e masave dhe konfirmon saktësinë e tyre;

x. miraton situacionet e punimeve dhe harton relacionin shpjegues;

xi. kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë të preventivuar me miratim të përfaqësuesit të zhvilluesit, në rast se ndryshimet në volume nuk prekin thelbin e projektit. Në rast se ndryshimet në volume prekin thelbin e projektit, miratimi i ndryshimeve të projektit merret edhe në KKTKM. Në rastin kur gjatë punimeve dalin punime të paparashikuara, zbatuesi i punimeve dhe mbikëqyrësi hartojnë procesverbalin e konstatimit të këtyre punimeve bashkë me preventivin dhe ia paraqesin për miratim zhvilluesit. Ky i fundit, nëse ka vërejtje, njofton zbatuesin e punimeve dhe problemi zgjidhet ndërmjet tyre.

5. Zhvilluesi kërkon zëvendësimin e mbikëqyrësit të punimeve vetëm në rastet e mëposhtme:

a) për ndërprerje të paarsyeshme të punimeve dhe/ose zgjatje të pajustifikuar të tyre;

b) për mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet ose lejimin e përdorimit të materialeve me vlera mbi ato të preventivuara apo jocilësore.

6. Në rast të zëvendësimit të mbikëqyrësit, mbahet procesverbali i dorëzimit të dosjes së punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e zëvendësimit të tij.

7. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të mëparshëm i dorëzohet mbikëqyrësit të ri me procesverbal. Mbikëqyrësi i mëparshëm mban përgjegjësi për punimet e realizuara nën mbikëqyrjen e tij dhe gjithë dokumentacionin e objektit deri në zëvendësimin e tij.

8. Zbatuesi i punimeve njofton me shkrim mbikëqyrësin dhe zhvilluesin për përfundimin e punimeve. Brenda 30 ditëve kalendarike nga njoftimi i përfundimit të punimeve, i paraqet mbikëqyrësit deklaratën e zbatimit të punimeve në lidhje me realizimin e punimeve, në përputhje me projektin e miratuar dhe normave teknike të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore.

9. Mbikëqyrësi harton raportin përfundimtar të punimeve të restaurimit, me përfundimin e punimeve restauruese dhe para firmosjes së situacionit përfundimtar, brenda afatit kohor 30 ditë kalendarike. Raporti përfundimtar përmban:

a) punimet e realizuara, sipas radhës së realizimit të tyre;

b) gjetjet dhe rezultatet shkencore të përfituara gjatë restaurimit.

10. Mbikëqyrësi merr pjesë në kolaudimin e punimeve, i përgjigjet kolaudatorit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e kolaudimit, si dhe firmos aktin e kolaudimit.

11. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën e punimeve dhe dokumentacionin e objektit, përcakton vlerën përfundimtare të punimeve, e cila i njoftohet zbatuesit të punimeve, si dhe i përcillet për likuidim zhvilluesit.

12. Mbikëqyrësi i punimeve, me përfundimin e ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, udhëheq rilevimin dhe fotografimin përfundimtar të objektit.

13. Mbikëqyrësi i punimeve, me përfundimin e ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, si edhe pas përpilimit të certifikatës së marrjes në dorëzim të objektit, ka për detyrë arkivimin e të gjithë dokumentacionit të objektit në arkivin e IKTK-së.

VI. KOLAUDIMI I PUNIMEVE PËR NDËRHYRJET RUAJTËSE DHE MBROJTË-SE NË PASURITË KULTURORE MATER-IALE

1. Të gjitha ndërhyrjet ruajtëse dhe mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale i nënshtrohen kolaudimit.

2. Kolaudimi i punimeve kryhet nga IKTK-ja, DRTK-të, NJAKPA-të ose subjekte të pajisura me licencën përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me mbikëqyrësin dhe zbatuesin e punimeve.

3. Caktimi i kolaudatorit/grupit të kolaudatimit bëhet brenda 5 ditësh pune nga përfundimi i punimeve ose gjatë zbatimit të punimeve kur ato janë komplekse/të vështira nga:

a) autoriteti publik me procedurë konkurrimi, në rastet e kryerjes së investimeve me fonde publike në pasurinë kulturore;

b) nga titullari i IKTK-së, për kolaudatorët që janë pjesë e stafit të institucioneve shtetërore të specializuara;

c) nga subjekti privat vendës/i huaj ose nga pronari/poseduesi, i cili njofton me shkrim IKTK-në për mbikëqyrësit e kontraktuar.

4. Detyrat e kolaudatorit janë, si më poshtë vijon:

a) të vlerësojë nëse ndërhyrjet ruajtëse dhe mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale janë realizuar në përputhje me kriteret restauruese dhe projektin e miratuar nga KKTKM-ja;

b) të vlerësojë përputhjen e dokumenteve me të dhënat faktike, formën, sasinë dhe cilësinë;

c) të vlerësojë përputhjen e vlerës së preventivuar me atë në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse në rastet e mospërputhjes;

ç) të vendosë detyra për punimet që do të kryhen, duke përcaktuar dhe afatet e përfundimit të tyre, kur gjatë verifikimeve vërehen defekte.

5. Në përfundim të kolaudimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse në pasuritë kulturore hartohet procesverbali i kolaudimit, i cili firmoset nga kolaudatori/grupi i kolaudimit, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve dhe zhvilluesi. Procesverbali përmban:

a) emërtimin e pasurisë kulturore në të cilën është kryer restaurimi dhe vendndodhja e saj;

b) vendimin e miratimit të projektit nga KKTKM-ja, si dhe ndryshimet e bëra në të, kur është rasti;

c) vlerën e restaurimit sipas preventivit;

ç) vlerën e restaurimit sipas situacionit;

d) kohën e kryerjes së kolaudimit;

dh) paraqitjen e verifikimeve të bëra mbi dokumentet dhe realizimin faktik, si dhe përfundimet e punës restauruese.

6. Pas përfundimit të procesit të kolaudimit të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore, hartohet certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve. Në rastet e investimeve nga autoriteti publik, hartohet urdhri për caktimin e grupit të punës për marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve. Kjo procedurë kryhet brenda një afati 5-ditor pas kryerjes së kolaudimit.

7. Garancia e punimeve në ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse mbahet në masën 5% të vlerës së situacionit përfundimtar. Periudha e garancisë së punimeve fillon nga data e marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve dhe kohëzgjatja përcaktohet në kontratë. Periudha e garancisë së punimeve mund të jetë e njëjtë për të gjithë zërat e punimeve ose e ndryshme kur objekti i kontratës është shumë specifik.

8. Zhvilluesi ose personi i autorizuar prej tij njofton zyrtarisht zbatuesin e punimeve për çdo defekt të ndodhur në vepër gjatë periudhës së garancisë. Zbatuesi është i detyruar të ndreqë

defektin brenda periudhës së garancisë dhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

9. Në përfundimin e periudhës së garancisë, përfaqësuesi i zhvilluesit, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe përfaqësuesi i zbatuesit të punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë, zhvilluesi llogarit ndreqjen e kostos së tyre dhe i zbret nga vlera e garancisë së punimeve.

10. Pas përfundimit të periudhës së garancisë dhe të kontrollit teknik të objektit hartohet certifikata e përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve. Në rastet e investimeve nga autoriteti publik, hartohet urdhri për caktimin e grupit të punës, në të cilin duhet të jenë dhe përfaqësues nga autoriteti përfitues për marrjen në dorëzim të punimeve ruajtëse e mbrojtëse në pasurinë kulturore. Kjo procedurë kryhet brenda një afati 5-ditor pas kryerjes së kontrollit teknik.

VII. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Ngarkohen Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore, çdo subjekt i licencuar, si dhe çdo subjekt që kryen veprimtari për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale për zbatimin e këtij vendimi.

2. Me hartimin e certifikatës përfundimtare të marrjes në dorëzim të punimeve, një kopje e saj, një kopje e aktit të kolaudimit dhe situacionit përfundimtar dërgohen në IKRTK për procedimin me regjistrimin e vlerës së ndërhyrjeve në regjistrat kombëtarë të trashëgimisë kulturore për pasurinë kulturore përkatëse, për ta inventarizuar ose kontabilizuar atë nga llogaritë e zhvilluesit, në rastin kur ky i fundit është institucion shtetëror.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AKT DORËZIMI I OBJEKTIT PASURI KULTURORE MATERIALE
me objekt _____, (fshati,bashkia,qyteti)

I mbajtur sot më datë ___/___/___ mbi dorëzimin e objektit pasuri kulturore materiale me objekt: _____, me adresë: _____ në prezencë të:

ZHVILLUESIT: _____
përfaqësuar nga z/znj. _____

ZBATUESIT TE PUNIMEVE: Shoqëria _____ sh.p.k përfaqësuar nga:

1.Drejtues Ligjor: _____
2.Drejtues teknik: _____

MBIKQYRËS I PUNIMEVE: _____
përfaqësuar nga _____

Nga verifikimi në vend u konstatua se objekti pasuri kulturore, i cili do ti nënshtrohet ndërhyrjeve mbrojtëse dhe ruajtëse është i lirë dhe shoqëria zbatuese e punimeve "_____" sh.p.k. merr në dorëzim objektin: "_____" për realizimin e punimeve sipas kontratës, nr. _____ Prot., datë ___/___/___, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor / Zhvilluesit dhe Kontraktorit / Zbatuesit të punimeve për objektin.

Objekti kufizohet :

1. Nga Jugu - _____
2. Nga Veriu- _____
3. Nga Lindja - _____
4. Nga Perëndimi - _____

Gjatë zbatimit të ndërhyrjeve mbrojtëse e ruajtëse shoqëria zbatuese "_____" sh.p.k. do të zbatojë me përpikmëri kushtet e kontratës, projektin e miratuar në KKTKM me Vendim nr._____, datë ___/___/_____, si dhe normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore. Shoqëria "_____" sh.p.k të depozitojë pranë mbikqyrësit të punimeve kopje të kontratës, grafikun e punimeve, listat e stafit, makineritë dhe mjetet që do të punojnë për realizimin e kësaj kontrate.

Akt dorëzimi mbahet në 4 (katër) kopje origjinale me përmbajtje identike si më poshtë vijon:

-Një kopje për Autoritetin Kontraktor/Zhvilluesin:_____,

-Një kopje për Mbikqyrësit e Punimeve: _____

-Një kopje për Zbatuesin e Punimeve - Shoqëria "_____" sh.p.k.

-Një kopje për Arkivën e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore - IKTK

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE:
Përfaqësuar nga:

_____

ZBATUESI I PUNIMEVE
Shoqëria "_____" sh.p.k

DREJTUES LIGJOR:
_____

DREJTUES TEKNIK:
_____

ZHVILLUESI/AUTORITETI KONTRAKTOR:

_____

Përfaqësuar nga:

_____

Zbatuesi i Punimeve: _____ sh.p.k
Adresa: _____

Nr. _____ Prot. Dt. _____

Lënda: **Njoftim mbi fillimin e ndërhyrjeve mbrojtëse dhe ruajtëse në objektin _____**

Drejtuar: **Zhvilluesit (Autoritetit Kontraktor),**
_____

Të nderuar,

Në përputhje me Kontratën e Restaurimit nr. _____ prot., dt._____, të lidhur ndërmjet Zhvilluesit / Autoritetit Kontraktor "_____" dhe Zbatuesit të punimeve /kontraktorit "_____" sh.p.k, ju njoftojmë se nga ana e jonë janë marrë gjithë masat e nevojshme dhe jemi gati për fillimin e ndërhyrjeve mbrojtëse dhe ruajtëse në objektin "_____".

Të dhënat kryesore te kësaj kontrate janë si më poshtë:

Objekti:	"_____",
Vlera e Objektit:	_____ lekë me TVSH
Zhvilluesi:	_____
Zbatuesi i punimeve:	"_____" sh.p.k
Projektuesi:	_____
Mbikqyrësi i Punimeve:	_____
Leja e Restaurimit:	Vendim KKTKM, Nr._____, dt._____ Vendim KKT, Nr._____, dt._____/Leje Ndërtimi Nr. _____, dt. _____
Data e fillimit të punimeve:	_____
Afati i Realizimit të Punimeve:	_____ nga lidhja e kontratës

Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni:

- Licencën e shoqërisë "_____" sh.p.k, R.SH._____, licencën e drejtuesit teknik të restaurimit z/znj. _____ R.P. _____ / licencën e drejtuesit të punimeve të artit z/znj. _____ R.P._____.
- Pasqyrën e realizimit të punimeve, metodologjinë dhe grafikun e punimeve të restaurimit.
- Plan organizimin e kantierit.
- Listën e mjeteve dhe pajisjeve teknike.
- Listën e stafit përgjegjës, të pranishëm në objekt.

ZBATUESI I PUNIMEVE TË RESTAURIMIT
" _____ " sh.p.k

Drejtues Ligjor
_____ (firma, vula)

LIBREZË MASASH

Objekti: _____

Zbatuesi i Punimeve: _____

Autoriteti Kontraktor / Zhvilluesi: _____

Mbikqyrësi i punimeve: _____

Zëri sipas preventivit _____

Skica	Nr. i fletës	Zëri i Punimeve	Njësia	Sasia	Faktorët			Sip. Mesatare	Prodhimi		Shuma
					Gjatësi	Gjerësi	Lartësi		Pozitiv +	Negativ -	
					m	m	m	m^2			
	Shuma Totale										

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE:

Përfaqësuar nga:

ZBATUESI I PUNIMEVE - Shoqëria " _____ " sh.p.k

DREJTUES LIGJOR: _____

DREJTUES TEKNIK: _____

TABELAVE E RAKORDIMEVE DHE BALANCIMIT TË VOLUMEVE

Objekti: _____

Zbatuesi i Punimeve: _____

Nr.	An.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	PREVENTIVI I OFERTËS			Punime që hiqen		Punime që shtohen		PREVENTIV I RISHIKUAR Situacion perf.		
				Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia sipas faktit	Çmimi	Vlera e rishikuar
		Punime prishje											
		Shuma I									**Shuma I**		
		Punime restaurimi											
		Shuma II									**Shuma II**		
		Shuma I+II+…..											
		Fond rezervë 20 %											
		Shuma e plotë											
		T. V. SH 20%											
		VLERA E PLOTË E RESTAURIMIT											

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE:

Përfaqësuar nga:

_____

ZBATUESI I PUNIMEVE - Shoqëria " _____ " sh.p.k

DREJTUES LIGJOR: _____

DREJTUES TEKNIK: _____

AUTORITETI KONTRAKTOR:

Përfaqësuar nga:

" _____ " sh.p.k
Adresa: _____

më ___/___/_____

Lënda: **Kërkesë mbi miratimin e punimeve shtesë nga fondi rezervë**

Objekti: _____

Drejtuar: **Mbikqyrësit të punimeve,**

_____

Për dijeni: **Autoritetit Kontraktor**

_____

Të nderuar,

Në lidhje me projekt-preventivin e kontratës së restaurimit të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor _____ dhe shoqërisë zbatuese "_____" sh.p.k, Nr. ___ Prot., datë _____, me objekt "_____", ju bëjmë me dije se gjatë zbatimit të punimeve në objekt mbështetur në hartimin e librezave të masave për zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, janë rakorduar volumet e punimeve që hiqen dhe volumet e punimeve që shtohen (bashkëlidhur tabela e rakordimeve).

Kërkojmë nga ana juaj, **ndjekjen e procedurave të miratimit të preventivit të punimeve shtesë nga fondi rezervë**, për të vijuar me plotësimin e dokumentacionit përfundimtar të dosjes së objektit.

Bashkangjitur këtij propozimi do të gjeni preventivin e rishikuar dhe rakorduar të punimeve dhe dokumentacionin e nevojshëm për miratim në përputhje me:
- Kontratën e Restaurimit nr. _____ prot., dt._____,
- Miratimit të projektit dhe preventivit të rishikuar _____ me Vendim KKTKM Nr. ___, dt._____ (Kur ndryshimet në volume prekin thelbin e projektit)
- Procesverbalin për miratimin e çmimeve njësi për zërat e rinj nr. _____ prot., dt. _____ (kur nga fondi rezervë ka zëra të rinj).

Mbas hartimit të librezave të masave, mbi bazën e matjeve faktike në objekt, si dhe tabelës së rakordancave, dokumenta të cilat i gjeni bashkëlidhur kësaj kërkese, punimet që shtohen në total kanë vlerën _____ lekë pa TVSH. Këto punime pjesërisht mbulohen nga punimet që zbriten në vlerën _____ lekë pa TVSH dhe pjesa e mbetur kërkojmë të përballohet nga fondi rezervë në vlerën _____ lekë pa TVSH.

Kërkesa jonë mbështetet në VKM nr. _____ datë _____ "*Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre* ".

Mbetemi në pritje të miratimit nga ana juaj!

ZBATUESI I PUNIMEVE:
"_____" SH.P.K.

DREJTUES LIGJOR
_____ (firma, vula)

PROCES VERBAL

MBI FILLIMIN E NDËRHYRJEVE RUAJTËSE E MBROJTËSE

Objekti "_____"

I mbajtur sot më datë __/__/____, mbi fillimin e punimeve të restaurimit / ndërhyrjeve mbrojtëse e ruajtëse në objektin: "_____", në bazë të kontratës së restaurimit dt. __/__/____, nr. ____ prot., të lidhur midis Autoritetit Kontraktor / Zhvilluesit _____, përfaqësuar nga _____ dhe Kontraktorit / Zbatuesit të punimeve shoqërisë "_____" sh.p.k, përfaqësuar nga _____.

Ndodhen prezent në objekt:

Autoriteti Kontraktor: _____
përfaqësuar nga z/znj. _____

Zbatuesi i i Punimeve: Shoqëria "_____" sh.p.k
përfaqësuar nga
1.Drejtuesi Ligjor: _____
2. Drejtuesi teknik: _____

Mbikqyrësi i Punimeve: _____

Punimet do të realizohen konform projektit të restaurimit "_____", të miratuar me vendimin nr. _____, dt. __/__/____ të KKTKM, si dhe në mbështetje të nenit 72, të ligjit nr. 27/2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".

Zbatuesi i punimeve, Shoqëria "_____" sh.p.k, depozitoi pranë Mbikqyrësit të punimeve:

1. Kopjen e kontratës,
2. lejen për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, miratuar me vendim të KKTKM-së,
3. Projektin e plotë të zbatimit, përfshirë relacionin teknik dhe specifikimet teknike të miratuar në KKTKM,
4. Preventivin e ofertës fituese, i cili duhet të përputhet me zërat dhe volumet e miratuara në KKTKM,
5. Grafikun e punimeve,
6. Planin e organizimit të punimeve,
7. Listën e stafit teknik të objektit poshtëshënuar,
8. Listën e makinerive poshtëshënuar,

Zbatuesi i punimeve "_____" sh.p.k, ka caktuar përgjegjës për kryerjen e punimeve në objektin pasuri kulturore:

Stafin e përbërë nga:

1. Drejtues Teknik i punimeve të restaurimit	Ing/ark. _____- Licensë _____
2. Restaurator arti	Rest. Arti _____ - Licensë _____
3. Inxhinier kantieri	
4. Karpentier	
5. Murator	
6. Elektricist	
7. Specialist çatije	
8. Hidraulik	
9. Punëtor	
10. Punëtor	

Makineritë dhe mjetet:

1. _____ copë _____
2. _____ copë _____
3. _____ copë _____
4. Skela
5. Kazma, lopata, mistri, çekiç, bisturi, etj.
6. Tabela sinjalistike punimesh - copë _____

Data e fillimit të punës për punimet restauruese në objektin pasuri kulturore _____ është data __/__/____.

- Zbatuesi i punimeve "_____" sh.p.k, të hapë ditarin e objektit, librin e kantierit, librezën e masave, si dhe të mbajë procesverbalet përkatëse me realizimin e proceseve të punës dhe ndërhyrjeve mbrojtëse dhe ruajtëse.
- Fillimi i punimeve të nisë nga rilevimi i objektit dhe verifikimi i dimensioneve të projektit. Të përcaktohen nëse ka ndryshime në dimensione dhe pasi të kontrollohen të aprovohen nga Mbikqyrësite Punimeve. Të hartohet proces verbali përkatës, ku të jenë të pasqyruara matjet fizike dhe në rast se nuk ka ndryshime nga projekti, të vazhdohet me punimet e tjera sipas grafikut të punimeve.

Fillimi i punimeve do të jetë në përputhje me grafikun e punimeve të hartuar nga zbatuesi i punimeve "_____" sh.p.k.

"Proces Verbali" mbahet ne 4 (katër) kopje origjinale me përmbajtje identike si më poshtë vijon:

-Një kopje për Autoritetin Kontraktor/Zhvilluesin:_____,

-Një kopje për Mbikqyrësit e Punimeve:_____

-Një kopje për Zbatuesin e Punimeve - Shoqëria "_____" sh.p.k.

-Një kopje për Arkivën e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore - IKTK

MBIKQYRËSIT E PUNIMEVE:
Përfaqësuar nga:

_____

ZBATUESI I PUNIMEVE
Shoqëria "_____" sh.p.k

DREJTUES LIGJOR:
_____

DREJTUES TEKNIK:
_____

ZHVILLUESI/AUTORITETI KONTRAKTOR:

_____

Përfaqësuar nga:
_____

DITARI I OBJEKTIT: _____

"_____"

Data: ____/____/ ____

I.

MOTI				TEMPERATURA	
Kohë me diell	**Kohë me diell dhe vranësira**	**Kohë e vrenjtur**	**Kohë me shi**	**MIN.**	**MAX.**

II. PUNOJNË NË OBJEKT:

Personel Drejtues Teknik

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Specialistë dhe Punëtorë

1. Specialistë_____
2. Punëtorë_____
3. Murator_____
4. Karpentier_____
5. _____

III. Makineri e pajisje:

_____
_____

IV. U kryen këto procese pune:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

V. U mbajtën këto dokumentacione teknike:

1. Ditari i Punimeve
2. Libreza e Masave
3. _____
4. _____

Drejtues Teknik

_____

Shënime të Mbikëqyrësit të Punimeve:

_____
_____
_____
_____
_____
_____

PROCESVERBAL

Mbi ndryshimin e volumeve

Objekti: "_____"

I mbajtur sot më datë ___/___/_____ në objektin: "_____", në prani të:

Autoritetit Kontraktor: _____
përfaqësuar nga _____

Zbatuesi i Punimeve: Shoqëria "_____" sh.p.k përfaqësuar nga:

1.Drejtuesi Ligjor: _____
2.Drejtuesi Teknik: _____

Mbikqyrësi i Punimeve: _____
përfaqësuar nga _____

Nga ana e Zbatuesit të punimeve restauruese me objekt kontrate "_____", Nr.___ Prot., datë __/__/____, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor _____ dhe shoqërisë "_____" sh.p.k, është paraqitur Kërkesa nr. ___ prot., dt.___/___/____ drejtuar mbikqyrësit të punimeve – për miratim të përdorimit të fondit rezervë dhe ndryshim të volumeve të punimeve– punime që shtohen dhe punime që zbriten.

Kjo kërkesë është, mbeshtetur në:
Udhëzimin Nr. 2, datë 13.05.2005, pika 3.4, ku theksohet shprehimisht: *"Sipërmarrësi brenda një afati të pranuar nga palët paraqet kërkesë-propozimet për korigjime plotësime apo përmirësime në projekt. Kërkesë-propozimet i paraqiten mbikqyrësit nga sipërmarrësi, gjatë zhvillimit të punimeve sa herë gjykohet e arsyeshme prej tij"*;
VKM Nr. ____ datë _____për "Rregullat e projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre"
dhe është në përputhje me:

- Kontratën e Restaurimit nr. _____prot., dt._____,
- Miratimin e projektit dhe preventivit të rishikuar me Vendim KKTKM Nr.____, dt._____ *(nëse ndryshimet në volume prekin thelbin e projektit)*
- Procesverbalin për miratimin e çmimeve njësi për zërat e rinj nr.____prot., dt. _____ *(nëse ka zëra të rinj që duhet të miratohen cmimet njësi nga Autoriteti Kontraktor – me anë të tre ofertave dhe ku komisioni i zhvilluesit aprovon ofertën më të përshtatshme)*

Mbikqyrësi i punimeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe verifikoi në vend me matje faktike zë për zë punimet e dhëna në preventiv ka kostaton se janë të nevojshme disa

ndryshime në disa volume. Ndryshimet në volume pasqyrohen qartë në librezat e masave ku volumet janë përllogaritur në bazë të matjeve faktike.

Më poshtë pasqyrohen volumet e punimeve që zbriten :

Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
SHUMA				489,600

Janë punime që zbriten nga preventivi fillestar (shiko tabelën e punimeve që shtohen dhe zbriten) me vlerë _____ lekë pa TVSH.

Më poshtë pasqyrohen volumet e punimeve që shtohen:

Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
SHUMA I				
Punime të paparashikuara që shtohen (të cilat përballohen nga fondi rezervë)				
SHUMA II				
SHUMA I+II				

Janë punime që shtohen nga preventivi fillestar (shiko tabelën e punimeve që shtohen dhe zbriten) me vlerë _____ lekë pa TVSH, brenda fondit limit të preventivit fillestar.

Në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë :

Preventivi i ofertës ekonomike fituese nga zbatuesi i punimeve "_____" sh.p.k	_____ lekë pa TVSH.
Punime faktike	_____ lekë pa TVSH.
Shtohen	_____ lekë pa TVSH.
Zbriten	_____ lekë pa TVSH.
Diferenca +	lekë pa TVSH.

Sic shihet nga vlera e dy preventivave kostoja e punimeve që shtohen përballohet pjesërisht nga punimet që zbriten dhe pjesa e mbetur e punimeve që shtohen në vlerën _____ lekë pa TVSH kërkohet të përballohet nga fondi rezervë i preventivit të punimeve të objektit, pa ndryshuar vlerën e fondit limit.

Palët hartuese të këtij proces-verbali, pasi shqyrtuan edhe një herë kërkesat e ardhura për ndryshimet në volumet e preventivit, ranë dakort sa më poshtë:

- **Miratimin e preventivit të punimeve të rishikuar me të gjitha zërat që shtohen dhe ato që zbriten.**
- **Miratimin e e përdorimit të fondi rezervë për punimet shtesë në bazë të volumeve që dalin nga rakordimi i volumeve të punimeve që shtohen dhe zbriten në bazë të matjeve faktike.**

Ky procesverbal do të depozitohet pranë autoritetit kontraktor nga ana e mbikqyrësit të punimeve për miratimin final të tij. Në situacionin përfundimtar të punimeve do të shënohen edhe volumet e punimeve shtesë nga fondi rezervë sipas zërave përkatës dhe ky i fundit do të shoqërohet edhe me situacion punimesh nga fondi rezervë.

Ky "Proces Verbal" mbahet në 4 (katër) kopje origjinale me përmbajtje identike si më poshtë vijon:

-Një kopje për Autoritetin Kontraktor/Zhvilluesin:_____,

-Një kopje për Mbikqyrësit e Punimeve: _____

-Një kopje për Zbatuesin e Punimeve - Shoqëria "_____" sh.p.k.

-Një kopje për Arkivën e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore - IKTK

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE:
Përfaqësuar nga:

_____

ZBATUESI I PUNIMEVE

Shoqëria "_____" sh.p.k

DREJTUESI LIGJOR:

_____

MIRATOHET
AUTORITETI KONTRAKTOR
Përfaqësuar nga

_____*(firma, vula)*

DREJTUES TEKNIK:

_____

VULA E ZBATUESIT TË PUNIMEVE

SHOQËRIA "_____" SH.P.K

LIBËR REGJISTRIMI PËR INSTRUKTIMIN MBI SIGURIMIN TEKNIK NË PUNË

Objekti "_____"

Sot, më datë: __/__/___, u instruktuan mbi sigurimin teknik në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi: "Rregullore për Sigurinë në Kantier" miratuar me Vendim Nr. 312, datë 05.05.2010, specialistët dhe punonjësit e shoqërisë "_____" sh.p.k, të cilët do të kryejnë punimet e restaurimit dhe ndërhyrjet mbrojtëse dhe ruajtëse për proceset si më poshtë:

_____

Në objektin pasuri kulturore _____me vendndodhje_____.
Gjatë instruktimit teknik u prezantuan dhe u shpjeguan me hapa gjithë masat e marra për sigurinë dhe shëndetin në punë. Prezantimi filloi me mbëritjen në kantier, bazën ligjore mbi "Sigurinë në kantier", aksesin dhe rregullat në kantier, ngjitja dhe depozitimi në skela, përdorimi i elementëve kimikë, puna në lartësi, kujdesi kundrejt energjisë elektrike, kujdesi ndaj rreziqeve të mundshme që kantieri mund të përmbajë etj.
Specialistët që do të marrin pjesë në procesin e restaurimit të këtij objekti janë instruktuar që mbajtja e mjeteve mbrojtëse personale (kasketë, këpucë ndërtimi, jelek fosforeshent, syze mbrojtëse, dorashka, rripa sigurimi, etj.) është e detyrueshme në kantier gjatë orarit të punimeve. Ata do të pajisen me veglat e punës të nevojshme sipas proceseve të punës që do të kryejnë.

Nr.	Emri/Mbiemri	Profesioni	Data e instruktimit	Firma	Vërejtje/komente
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					

MBIKQYRËSIT E PUNIMEVE:

_____

ZBATUESI I PUNIMEVE
Shoqëria "_____" sh.p.k

DREJTUES TEKNIK:

_____

| më ___/___/_____

Lënda: **Kërkesë për miratim të përdorimit të fondit rezervë dhe punimeve shtesë, në objektin "_____"**

Drejtuar: **Autoritetit Kontraktor**

_____

Për dijeni: **Zbatuesi i punimeve**

Shoqëria "_____" sh.p.k

_____

I nderuar z. Znj. _____,

Nga ana e zbatuesit të punimeve restauruese me objekt kontrate "_____", Nr. ____ Prot., datë _____, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor _____ dhe shoqërisë zbatuese "_____" sh.p.k, është paraqitur Kërkesa me nr. ____ prot., dt._____ – për miratim të përdorimit të fondit rezervë dhe punimeve shtesë të miratuara, në objektin sipërpërmendur.

Kërkesa e tyre është, mbeshtetur në:

- Udhëzim Nr. 2 datë 13.05.2005, ku në pikën 3.4;

- VKM Nr. ____ datë _____ për "Rregullat e projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre";

në përputhje me:

- Kontratën e Restaurimit nr. ____ prot., dt._____,

- Miratimin e projektit dhe preventivit të rishikuar _____ me Vendim KKTKM Nr. ___, dt._____ (Kur ndryshimet në volume prekin thelbin e projektit)

- Procesverbalin për miratimin e çmimeve njësi për zërat e rinj nr. ____ prot., dt. _____ (kur nga fondi rezervë ka zëra të rinj).

Mbas hartimit të librezave të masave, mbi bazën e matjeve faktike në objekt, si dhe tabelës së rakordancave punimet që shtohennë total kanë vlerën _____ lekë pa TVSH. Këto punime pjesërisht mbulohen nga punimet që zbriten në vlerën _____lekë pa TVSH dhe pjesa e mbetur përballohet nga fondi rezervë në vlerën _____lekë pa TVSH, pa ndryshuar vlerën e fondit limit.

Dokumentacioni i paraqitur u shqyrtua dhe u verifikua nga ana jonë, në prani të zbatuesit të punimeve, u mbajt procesverbali mbi ndryshimin e volumeve të cilin e gjeni bashkëlidhur kësaj kërkese. Në këto kushte e gjykojmë të nevojshëm vlerësimin dhe miratimin nga ana juaj të këtyre fakteve, për të konkluduar më pas me miratimin nga ana juaj të preventivit të rishikuar.

Bashkëlidhur gjeni **për miratim nga ana e juaj preventivin e rishikuar të punimeve** shtesë që përballohen nga fondi rezervë dhe punime që shtohen dhe atyre që zbriten si dhe relacionin teknik shpjegues mbi ndryshimin e volumeve.

Për sa më sipër, **kërkohet miratimi i përdorimit të fondit rezervë prej 20%** të objektit, si dhe miratim i tabelës së punimeve qe shtohen dhe atyre qe zbriten sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të miratimit Tuaj,

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE

_____

MIRATOHET

AUTORITETI KONTRAKTOR:

_____

Përfaqësuar nga:

_____(firma, vula)

PROCESVERBAL

mbi përfundimin e punimeve

I mbajtur sot më datë _____, në kantierin e restaurimit të objektit "_____" pas njoftimit nga ana e zbatuesit të punimeve, shoqëria "_____" sh.p.k më datë _____, midis:

Autoriteti Kontraktor: _____ përfaqësuar nga _____

Zbatuesi i i Punimeve: Shoqëria "_____" sh.p.k , përfaqësuar nga

Drejtuesi Ligjor: _____

Drejtuesi teknik: _____

Mbikqyrësi i Punimeve: _____

Mbi kontrollin e punimeve të restaurimit dhe ndërhyrjeve mbrojtëse dhe ruajtëse në zbatim të kontratës nr. _____Prot., datë _____ me objekt: "_____", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor _____ dhe shoqërisë zbatuese "_____" sh.p.k.

Mbahet ky proces verbal midis palëve, i cili konstaton se pas kontrollit në vend të zbatimit të punimeve të restaurimit në përputhje me projektin e restaurimit të miratuar nga KKTKM dhe kontratës së sipërcituar, rezulton se ato kanë përfunduar. Objekti është i gatshëm të vijojë me procedurat e kolaudimit dhe marrjes në dorëzim nga ana e Autoritetit Kontraktor.

"Proces Verbali" mbahet në 4 (katër) kopje origjinale me përmbajtje identike si më poshtë:
-Një kopje për Autoritetin Kontraktor/Zhvilluesin:_____,
-Një kopje për Mbikqyrësit e Punimeve: _____
-Një kopje për Zbatuesin e Punimeve - Shoqëria "_____" sh.p.k.
-Një kopje për Arkivën e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore - IKTK

MBIKQYRËSIT E PUNIMEVE:

Përfaqësuar nga:

_____

ZBATUESI I PUNIMEVE

Shoqëria "_____" sh.p.k

DREJTUES LIGJOR:

_____

DREJTUES TEKNIK:

_____

AUTORITETI KONTRAKTOR:

_____

Përfaqësuar nga:

_____

PROCES VERBAL
NR.

PUNIME TË MASKUARA NË STRUKTURAT BETON-ARME
(Punime betoni dhe kallëpe)
(Punime betoni dhe armature)

I mbajtur sot më datë __ /__ /____ mbi ecurinë e punimeve të restaurimit në objektin: "_____".

Ndodheshin prezent në objekt:

Zbatuesi i Punimeve: Shoqëria "_____" sh.p.k përfaqësuar nga:

1. Drejtuesi Teknik në restaurim: _____
2. Drejtues i objektit: _____

Mbikqyrësit e Punimeve: _____
përfaqësuar nga:
_____

Emërtimi i elementit:
_____
_____

U kontrollua gjendja e punimeve të betonit dhe beton armesë dhe rezultoi si më poshtë:

1. Struktura u betonua prej datës _____deri në datë_____ dhe u përdor beton i klasës _____ i përgatitur nga _____. Ngjeshja u krye me vibrator sipas kërkesa teknike në specifikime.

2. Gjatë procesit të betonimit të betonit u konstatua ecuria e mëposhtme dhe u morën masat:
   2.1 _____
   2.2 _____
   2.3 _____
3. Ndërprerjet e procesit të betonimit u bënë në pozicionet _____ dhe rifillimi i këtij procesi u krye sipas rregullave e specifikimeve teknike dhe standarteve në fuqi të zbatimit.
4. Trajtimi dhe mbrojtja e betonit në strukturë_____
5. Heqja e kallëpeve dhe skelave mbajtëse të tyre filli në datën _____dhe përfundoi në datën _____.
6. Gjatë kontrollit të strukturës mbas çlirimit të pykave rezultoi:
   _____

7. Zgavrat, plasaritjet dhe hekurat e zhveshura u riparuan në përputhje me rregullat dhe specifikimet teknike, si dhe standarteve në fuqi të zbatimit nr.____, datë __/__/_____.
8. Nga kontrolli i kuotave, akseve dhe përmasave të strukturës rezultoi se ato janë brenda largimeve të lejuara sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr.____, datë __/__/_____, me përjashtim të _____.
   Për të sjellë strukturën në kushtet e projektit janë kryer punimet e mëposhtme:
   _____
   _____
   _____
   Në mbështetje të rezultateve të mësipërm, struktura merret në dorëzim dhe autorizohet vazhdimi i punimeve _____.

"Proces Verbali" mbahet ne 4 (katër) kopje origjinale dhe përmbajtje identike si më poshtë vijon:

- Një kopje për Autoritetin Kontraktor - _____,
- Një kopje për Mbikqyrësin e Punimeve: _____,
- Një kopje për Zbatuesin e Punimeve - Shoqëria " _____" sh.p.k,
- Një kopje për Arkivën teknike të IKTK-së _____

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE:

_____

Përfaqësuar nga:

_____

ZBATUESI I PUNIMEVE

Shoqëria " _____ " sh.p.k

DREJTUESI TEKNIK:

_____

DREJTUESI I OBJEKTIT:

_____

AKT KONTROLLI

NR. _____

1.TAKIMI:

Emri i subjektit të mbikqyrur: "_____" sh.p.k"
Objekti: "_____"
Vendodhja: _____
Data: ___/___/_____
Ora: _____

2.PJESËMARRËSIT:

Mbikqyrësi i punimeve: _____

Drejtuesi teknik i punimeve: _____

Të tjerë: _____

3.OBJEKTIVAT :

_____
_____
_____
_____

4. KONSTATIME :

_____
_____
_____
_____

5.DETYRAT:

Përshkrimi i situatës	Zbatuar nga	Data e afatit të fundit
• • • •		

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE

Zbatuesi i Punimeve:_____

Objekti: _____

Datë: __/__/____

SITUACION PUNIMESH

Nr.	Nr. Analizës	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
Shuma						
TVSH						
Shuma						
Pajisje						
Shuma totale						

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE:
Përfaqësuar nga:

_____

ZBATUESI I PUNIMEVE
Shoqëria " _____ " sh.p.k

DREJTUES LIGJOR:
_____

DREJTUES TEKNIK:
_____

ZHVILLUESI/AUTORITETI KONTRAKTOR:

_____

Përfaqësuar nga:
_____

SHOQËRIA "_____" Sh.p.k
Adresa: _____

Më datë ___/___/_____

Lënda: **Njoftim mbi përfundimin e ndërhyrjeve mbrojtëse dhe ruajtëse në objektin pasuri kulturore "_____"**

Drejtuar: **Mbikqyrësit të punimeve**
Z/Znj. _____

Për dijeni: Autoritetit Kontraktor / Zhvilluesit
_____

Të nderuar,

Njoftojmë se më dt.___/___/_____ në objektin "_____", shoqëria "_____" sh.p.k, ka përfunduar punimet e restaurimit dhe ato mbrojtëse dhe ruajtëse në përputhje me afatet e përcaktuara në Kontratën e Restaurimit nr. ___ prot., dt.___/___/____, të lidhur me Autoritetin Kontraktor _____.

Kërkjomë nga ana juaj, të merren masat për të kryer verifikimet e duhura në objekt mbi përfundimin e punimeve të restaurimit si dhe të vijohet me procedurat e mëtejshme.

Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni relacion teknik mbi punimet e restaurimit të kryera nga ana e zbatuesit të punimeve shoqëruar me foto dhe video të proceseve të kryera.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZBATUESI I PUNIMEVE TË RESTAURIMIT
" _____ " sh.p.k

Drejtues Ligjor
_____(firma, vula)

Datë, ___/___/_____

Lënda: **Njoftim mbi përfundimin e ndërhyrjeve mbrojtëse dhe ruajtëse në objektin "_____"**

Drejtuar: **Autoritetit Kontraktor / Zhvilluesit**

_____

Për dijeni: **Kolaudatorit**

Z./Znj. _____

Zbatuesit të punimeve

"_____" sh.p.k

Drejtues ligjor Z. / Znj. _____

I nderuar z. / znj. _____,

Ju bëjmë me dije se më datë ___/___/____në objektin "_____", zbatuesi i punimeve shoqëria "_____" sh.p.k, ka përfunduar punimet e restaurimit në përputhje me afatet e përcaktuara në Kontratën e Restaurimit nr. _____ prot., dt. ___/___/____, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor "_____" dhe shoqërisë zbatuese "_____" sh.p.k.

Në cilësinë e mbikqyrësit të punimeve të restaurimit të emëruar (me shkresë nr. ___prot., dt. __/__/_____) /kontraktuar (kontratë nr. _____ prot., dt. ___/___/_____), pasi morëm njoftim zyrtar për përfundimin e punimeve nga ana e zbatuesit të punimeve me shkresë nr. ___prot., dt. __/__/_____, morëm të gjitha masat për të kryer verifikimet e duhura në objekt mbi përfundimin e punimeve të restaurimit.

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj vazhdimin e procedurave të mëtejshme mbi **kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të përkohëshme të punimeve** të objektit pasuri kulturore.

Bashkëlidhur gjeni raportin teknik përfundimtar të detajuar, mbi punimet e restaurimit të hartuar nga ana mbikqyrësit të punimeve të restaurimit në format shkresor dhe elektronik.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE

_____

ZBATUESI I PUNIMEVE:
Shoqëria "_____" SHPK

OBJEKTI: "_____"

DEKLARATË TEKNIKE E ZBATUESIT TË PUNIMEVE

Referuar:

- Nenit 72 i ligjit nr. 27/2018 *"Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";*
- Nenit ___, pika___ të Vendimit Nr. _____, Dt. ___/___/2020 të Këshillit të Ministrave, për *"Rregullat e projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikqyrjes dhe kolaudimit të tyre"*
- Nenit 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar;
- Pikës 15/d të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.3 datë 15/02/2001 *"Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar;

nënshkruesit e këtij dokumenti:
Z. Znj. _____ - Drejtues ligjor i shoqërisë zbatuese "_____" sh.p.k, me licencë për punime të restaurimit në trashëgiminë e arkitekturës për shoqëri ndërtimi nr._____.
Drejtuesi teknik i shoqërisë zbatuese "_____" sh.p.k, me licencë për punime të restaurimit në trashëgiminë e arkitekturës nr_____.

Deklarojmë sa më poshtë:

1. Në objektin "_____" që ndodhet në qarkun _____, bashkia/komuna me adresë _____, janë kryer punimet sipas projektit të zbatimit për punime restauruese dhe ndërhyrje ruajtëse e mbrojtëse (të miratuar me Vendim KKTKM nr.___, dt.__/__/____), në përputhje me normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore, si dhe specifikimeve teknike të evidentuara në kontratën e restaurimit dt. ___/___/_____, nr. ___prot., të lidhur midis Autoritetit Kontraktor/Zhvilluesit _____ dhe shoqërisë zbatuese "_____" sh.p.k.

2. Gjatë zbatimit të punimeve të restaurimit dhe ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse në pasuri kulturore janë respektuar kondicionet urbane dhe është kryer sistemimi i territorit.

3. Mbështetur në ecurinë e punimeve, kontrollin e cilësisë së materialeve, produkteve dhe punimeve të restaurimit, dokumentacionin e hartuar, kjo fazë e projektit të miratuar në organet përkatëse është zbatuar plotësisht, pa pakësime në drejtimin funksional të qëndrueshmërisë së punimeve dhe të destinacionit ose qëllimit,(*nëse është rasti:* "por me shtesa dhe pakësime të volumeve dhe zërave siç është gjykuar në vend nga nevoja dhe nga fakti pasi është rënë dakort me procesverbale të shkruar me mbikqyrësin e punimeve dhe zhvilluesin, si dhe me miratim të punimeve shtesë dhe rishikim të projektit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale").
Argumentat teknike mbi nevojën për ndryshime apo shtesa në projekt, të cilat preknin thelbin e projektit:
_____

_____
_____
_____

Bazuar në Ligjin *"Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"*, VKM dhe Udhëzimet për trashëgiminë kulturore ndryshimet apo shtesat në projekt duhet të rishikohen dhe miratohen në KKTKM. Për këto arsye projekt-preventivi u rishikua në:

- mënyrën e zgjidhjes së konstruksionit,

- metodologjinë e ndërhyrjes,

- materialet e përdorura,

- _____etj.

dhe u miratua në KKTKM me Vendim nr._____, dt. __/__/____.

4. Proceset kryesore të punës të kryera janë realizuar sipas specifikimeve, kërkesave e materialeve të miratuara në projekt dhe konsistojnë në:

- Punimet e restaurimit të arkitekturës
  - _____
  - _____
  - _____
- Punimet e restaurimit të artit
  - _____
  - _____
  - _____

Zbatuesi i punimeve, mban përgjegjësi për sa deklarohet me sipër në rast se në objekt shfaqen difekte gjatë kohës dhe kushtevetë përcaktuaranë aktet ligjore e nënligjorenë fuqi, të cilat nuk janë si pasojë e administrimit dhe/apo shfrytëzimit, kur këto të fundit janë kryer brenda kushteve të parashikuara në projekt, në kontratën e sipërmarrjes dhe kushteve teknike në fuqi.

Kjo deklaratë hartohet në 4 (katër) kopje, një kopje mbahet nga zbatuesi i punimeve në arkivin teknik në dosjen e objektit, një kopje i dërgohet mbikqyrësit të punimeve, një kopje i dërgohen autoritetit kontraktor/zhvilluesit dhe një kopje dërgohet pranë arkivës teknike të IKTK-së.

ZBATUESI I PUNIMEVE TË RESTAURIMIT

" _____ " sh.p.k

Drejtues Ligjor **Drejtues Teknik**

_____(firma, vula) _____(firma)

AKT – KOLAUDIMI

Datë ___/___/_____

OBJEKTI: _____

Emërtimi i pasurisë kulturore në të cilin janë kryer ndërhyrjet ruajtëse dhe mbrojtëse:

_____

Vendndodhja e objektit:

_____

Në bazë të nenit 72 të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", në mbështetje të Kartave Ndërkombëtare të Restaurimit, dhe VKM nr.....dt....të miratuar "Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave, teknike, kritereve dhe modeleve te ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore", hartohet ky akt-kolaudimi.

Kolaudatori/t: _____
emëruar me shkresë / kontratë
_____

Zbatuesi i punimeve: Shoqëria "_____" Sh.p.k
_____,
Drejtuesi ligjor _____
Drejtuesi teknik _____

Mbikëqyrësi/t e punimeve: _____
emëruar me shkresë / kontratë
_____

Autoriteti Kontraktor: _____
përfaqësuar nga _____

Kolaudimi ka zgjatur ___ (nr. i ditëve me fjalë) ditë dhe është realizuar mbi verifikimin e punimeve restauruese dhe ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në objekt, si dhe mbi bazën e dokumenteve të paraqitura nga zbatuesi i punimeve dhe miratuar e firmosur nga mbikëqyrësit e punimeve si më poshtë:

1. Kontrata e restaurimit
2. Projekti, Preventivi
3. Situacioni përfundimtar shoqëruar me relacionet shpjeguese
4. Libri i objektit
5. Libri i masave
6. Proçes verbalet e mbajtura gjatë restaurimit
7. Certifikata cilësie
8. Foto para-gjatë-pas punimeve
9. _____
10. _____

I. TË DHËNA PËR PROJEKTIN DHE ZBATIMIN E NDËRHYRJEVE RUAJTËSE E MBROJTËSE

Autor/t projektit:

_____

Vendim/et e Miratimit:

- Projekti _____ është miratuar me vendim nr. ___, dt. __/__/____ nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM);
- _____;
- Projekti i rishikuar (nëse ka) _____ është miratuar me vendim nr. ___, dt. __/__/____ nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM);

Konkluzione: Realizimi i ndërhyrjeve ruajstëse e mbrojtëse është kryer
_____
_____
_____
_____
_____

II. TË DHËNA PËR KOHËN E RESTAURIMIT (ndërhyrjes ruajtëse dhe mbrojtëse)

Afati i realizimit të punimeve: _____

Periudha e kryerjes së restaurimit: _____

Punimet dorëzohen më: _____

III. TË DHËNA PËR PUNIMET RESTAURUESE TË KRYERA

Realizimi i punimeve të restaurimit / ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse është bërë në përputhje me preventivin e miratuar dhe ndryshimet e miratuara nga ana e KKTKM dhe Autoritetit Kontraktor.

Vlera e e restaurimit sipas preventivit të ofertës:

_____ (vlera e shkruajtur me fjalë) lekë me TVSH.

Vlerën e restaurimit sipas situacionit përfundimtar:

_____ (vlera e shkruajtur me fjalë) lekë me TVSH.

IV. PARAQITJA E VERIFIKIMEVE TË BËRA MBI DOKUMENTET DHE REALIZIMI FAKTIK, SI DHE PËRFUNDIMET E PUNËS RESTAURUESE.

Procesverbale justifikuese, kur ka mospërputhje midis preventivit dhe situacionit

_____

_____

Janë hartuar tabelat e rakordimeve për të gjitha ndryshimet e bëra sipas zërave përkatës të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Garancia e punimeve restauruese 5% në vlerën _____ (vlera e shkruajtur me fjalë) lekë me TVSH, dhe një afat _____vite.

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi ligjore për të metat e konstatuara gjatë periudhës së garancisë së punimeve të cilat janë si rezultat i cilësisë së dobët të punimeve. Për çdo punë me cilësi të dobët që do të konstatohet gjatë garancisë së punimeve dhe që është për faj të zbatuesit të punimeve, të gjitha shpenzimet do të përballohen nga vetë ai.

Ky procesverbal mbahet në 5 (pesë) kopje, një kopje Autoriteti Kontraktor, një kopje mbikqyrësi i punimeve, një kopje kolaudatori, një kopje zbatuesi i punimeve, një kopje do të depozitohet pranë arkivit teknik të IKTK-së.

ZBATUESI I PUNIMEVE

_____

DREJTUES LIGJOR:

_____

DREJTUES TEKNIK

_____

MBIKQYRËSIT E PUNIMEVE:

_____

Përfaqësuar nga:

_____

_____

KOLAUDATORI I PUNIMEVE

_____

AUTORITETI KONTRAKTOR:

_____

DREJTOR/ADMINISTRATOR

_____

Datë:___/___/_____

CERTIFIKATË E MARRJES SË PËRKOHËSHME NË DORËZIM TË PUNIMEVE

OBJEKTI: "_____"

E mbajtur sot më datë ___/___/_____ në objektin "_____" mbi marrjen në dorëzim të përkohëshme të punimeve të restaurimit dhe ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurisë kulturore në prani të komisionit të ngritur me Urdhër Nr. _____Prot., datë ___/___/_____, i përbërë nga :

Komisioni/Përfaqësues të Autoritetit Kontraktor:

1. _____
2. _____
3. _____

Në prani të:
Zbatuesit të Punimeve - Shoqëria "_____" sh.p.k përfaqësuar nga drejtuesi ligjor z. / znj. _____,

Mbikqyrësit të Punimeve - _____
përfaqësuar nga _____,

Kolaudatorit të punimeve - _____
përfaqësuar nga _____,

Autoritetit Kontraktor - _____
përfaqësuar nga _____,

Mbështetur në kontratën e restaurimit dt. __/__/____, nr. ___ prot., të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor _____, përfaqësuar nga _____ dhe shoqërisë "_____" sh.p.k, përfaqësuar nga drejtuesi ligjor _____ me vlerë _____(vlera e shkruajtur me fjalë) lekë me TVSH, në situacionin përfundimtar të punimeve të kryera nga zbatuesi i punimeve me vlerë _____(vlera e shkruajtur me fjalë) lekë me TVSH dhe aktit të kolaudimit të datës __/__/____, mbajtur nga kolaudatori _____, procedohet sot për marrjen e përkohëshme në dorëzim të punimeve objekt të kësaj kontrate.

Fillimi i punimeve është realizuar më datën __/__/____
Përfundimi i punimeve është realizuar më datën __/__/____
Në bazë të aktit të kolaudimit të datës __/__/____ si dhe punimeve të kryera në fakt, sipas matjes së punimeve të kryera në bazë të situacionit të paraqitur nga zbatuesi i punimeve konstatohet:

1. Merret në dorëzim objekti duke i lindur e drejta zbatuesit të punimeve të çlirohet nga garancia e sigurimit të kontratës 10% sipas nenit ___ pika ___ të kontratës së restaurimit.
2. Periudha e garancisë së punimeve të kryera do të jetë _____ nga data e sotme e marrjes në dorëzim të objektit dhe 5% e vlerës së situacionit në vlerën _____ lekë do të ngurtësohet në llogarinë e Autoritetit Kontraktor.
3. Gjatë periudhës së garancisë së punimeve të kryera, zbatuesi i punimeve detyrohet të bëjë mirëmbajtjen e tyre në rast defekti të ndodhur për shkak të cilësisë së punimeve pa asnjë shpërblim (për punimet e marra në dorëzim dhe të situacionuara), mbi bazën e njoftimit të bërë me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
4. Për defektet që mund të ndodhin për faj të keq përdorimit nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe për ato që janë rezultat i forcave 'madhore' zbatuesi i punimeve nuk mban përgjegjësi. Në të gjitha rastet e konstatimit të defekteve nga të dy palët hartohet një proces verbal ku përcaktohet lloji i defektit, prejardhja, shkaku, faji i cilës palë, saksionet sipas këtij akti si dhe instruksionet teknike me detyrat për të ardhmen.

Përfundimisht duke gjykuar se objekti është realizuar me cilësi dhe konform normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore, si dhe KTP dhe KTZ në fuqi, pikave të kontratës dhe kërkesave të zhvilluesit duke u mbështetur në ligjet e VKM dhe udhëzimet përkatëse të trashëgimisë kulturore si dhe sipas deklaratës së zbatuesit të punimeve, grupi i marrjes së përkohëshme në dorëzim e konsideron objektin "_____" të përfunduar dhe e merr në dorëzim.

Këtij dokumenti i bashkëlidhet situacioni përfundimtar, akt kolaudimi.

Periudha e ekzekutimit të kontratës fiksohet _____ duke filluar nga data e lidhjes së kontratës më datë ___/___/_____.

Ditë vonese të kompesueshme **ska** (ditë kalendarike).

Ditë vonese pas afatit të caktuar përfundimtar **ska** ditë kalendarike të cilat penalizojnë kontraktuesin sipas kushteve të kontratës dhe vetëm defektet e kërkohen të riparohen nga zbatuesi i punimeve brenda periudhës së garancisë së defekteve.

Nëse ka ditë vonese, llogaritet kosto ditore sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe kjo shumë prej _____ lekë, i mbahet kontraktorit në situacionin përfundimtar.

Autoriteti Kontraktor dhe zbatuesi i punimeve marrin masat për kalimin e objektit dhe inventarin përkatës në dispozicion të Autoritetit Kontraktor.

Ky akt dorëzimi mbahet në 6 (gjashtë) kopje si më poshtë:

1. Një kopje për Autoritetin Kontraktor _____,
2. Një kopje për mbikqyrësin e punimeve,
3. Një kopje për kolaudatorin e punimeve,
4. Nje kopje për sipërmarrësin e punimeve, Shoqëria "_____" sh.p.k,
5. Një kopje për komisionin e marrjes në dorëzim,
6. Një kopje depozitohet në arkivën e IKTK-së.

Pasi u lexua nga të gjitha palët u nënshkrua me vullnet të lirë.

ZBATUESI I PUNIMEVE:
Për "_____" SH.P.K
Përfaqësuesi Ligjor

_____

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE:
_____
Përfaqësuar nga:

_____

KOMISIONI
Përfaqësues të Autoritetit Kontraktor

1. _____
2. _____
3. _____

KOLAUDATORI
_____
Përfaqësuar nga:

_____

AUTORITETI KONTRAKTOR
_____
Përfaqësuar nga:

_____

Nr.____Prot Datë:___/___/_____

CERTIFIKATË E MARRJES NË DORËZIM TË PUNIMEVE PËRFUNDIMTARE
(Pas përfundimit të garancisë së punimeve)

Objekti: "_____"

E mbajtur sot më datë ___/___/_____ në objektin "_____" mbi përfundimin e garancisë të punimeve në këtë objekt, në prani të komisionit të ngritur me Urdhër Nr. _____Prot., datë ___/___/_____, për kontrollin e cilësisë së punimeve pas mbarimit të garancisë së punimeve dhe përpilimin e çertificatës i përbërë nga :

Komisioni/Përfaqësues të Autoritetit Kontraktor:

1. _____
2. _____
3. _____

Në prani të:

Zbatuesit të Punimeve - Shoqëria "_____" sh.p.k përfaqësuar nga drejtuesi ligjor z. / znj. _____,

Mbikqyrësit të Punimeve - _____
përfaqësuar nga _____,

Kolaudatorit të punimeve - _____
përfaqësuar nga _____,

Autoritetit Kontraktor - _____
përfaqësuar nga _____,

Mbështetur në kontratën e restaurimit dt. __/__/____, nr. ___ prot., të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor _____, përfaqësuar nga _____ dhe shoqërisë "_____" sh.p.k, përfaqësuar nga drejtuesi ligjor _____ .

Vlera e kontratës së sipërmarjes : _____ lekë me T.V.SH
Vlera e situacionit përfundimtar: _____ lekë me T.V.SH
Periudha e garancisë së difekteve në bazë të kontratës ishte _____ nga përfundimi i punimeve.

Fillimi i punimeve është realizuar më datën __/__/____
Përfundimi i punimeve është realizuar më datën __/__/____
Kolaudimi i punimeve është kryer më datë __/__/____

Pas kërkesë për lirimin e vlerës 5% për garancinë e punimeve me shkresë nr. ____Prot., dt. __/__/____ nga zbatuesi i punimeve shoqëria "_____" me përfaqësues ligjor _____, dhe pas caktimit të komisionit për kontrollin e cilësisë së punimeve pas mbarimit të garancisë së punimeve, urdhër Nr. ___ Prot., datë __/__/____.

Nga kontrolli u konstatua se objekti është brenda kushteve teknike dhe specifikimeve në kontratë dhe si rjedhim, mund të zhbllokohet shuma e garancisë teknike prej 5% e vlerës së objektit.

ose

Nga kontrolli i datës __/__/____ u konstatua se objekti paraqiste defekte të cilat u pasqyruan në procesverbalin Nr. ___ Prot., datë __/__/____. Riparimi i këtyre defekteve është kryer dhe anëtarët e komisionit zhbllokojnë shumwn e garancisë teknike prej 5% e vlerës së objektit.

ose

Nga kontrolli i datës __/__/____ u konstatua se objekti paraqiste defekte të cilat u pasqyruan në procesverbalin Nr. ___ Prot., datë __/__/____. Riparimi i këtyre defekteve nuk merret përsipër të kryhet nga zbatuesi i punimeve dhe për këtë arsye dhe anëtarët e komisionit kanë llogaritur dëmin në ngarkim të zbatuesit të punimeve me vlerë_____, pjesa e mbetur nga shuma e garancisë teknike prej 5% e vlerës së objektit është _____lekë e cila mund t'i kthehet zbatuesit të punimeve.

Përfundimisht në mbështetje të kontratës së restaurimit dt. __/__/____, nr. ___ prot., komisioni merr në dorëzim përfundimtar objektin "_____", të zbatuar nga shoqëria "_____" sh.p.k.

Ky procesverbal dorëzimi pas periudhës së garancisë së punimeve mbahet mbahet në 6 (gjashtë) kopje origjinale me përmbajtje identike si më poshtë:

1. Një kopje për Autoritetin Kontraktor _____,
2. Një kopje për mbikqyrësin e punimeve,
3. Një kopje për kolaudatorin e punimeve,
4. Nje kopje për sipërmarrësin e punimeve, Shoqëria "_____" sh.p.k,
5. Një kopje për komisionin e marrjes në dorëzim,
6. Një kopje depozitohet në arkivën e IKTK-së.

Pasi u lexua nga të gjitha palët u nënshkrua me vullnet të lirë.

ZBATUESI I PUNIMEVE:
Për "_____" SH.P.K
Përfaqësuesi Ligjor

_____

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE:
_____
Përfaqësuar nga:

_____

KOMISIONI
Përfaqësues të Autoritetit Kontraktor

1. _____
2. _____
3. _____

KOLAUDATORI
_____
Përfaqësuar nga:

_____

AUTORITETI KONTRAKTOR
_____
Përfaqësuar nga:

_____

Projektuesi: _____
Objekti: _____
Datë: __/__/____

MIRATOI:
Sekretari i KKTKM
_____
(firma, vula)

PREVENTIVI

Nr.	Nr. Analizës	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
Shuma						
Fond rezervë 20%						
Shuma						
TVSH						
Shuma						
Pajisje						
Shuma totale						

PREVENTIVOI:
_____

ZHVILLUESI
Përfaqësuar nga:
_____

VENDIM
Nr. 1137, datë 16.12.2020

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT, 2021 – 2025, DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2021 – 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit, 2021 – 2025, dhe të planit të veprimit 2021 – 2023, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

2020 – 2025
DOKUMENTI STRATEGJIK FINAL
Dhjetor 2020, Tiranë

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KOMBËTARE E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT 2021 – 2025

PËRMBAJTJA

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK
1. Hyrja
1.1 Qëllimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit 2021 – 2025 dhe lidhja me dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare
1.2 Metodologjia
2.Kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, mësimet
2.1 Kuadri ligjor
2.1.1Instrumentet ligjore ndërkombëtare
2.1.1.1Konventat dhe protokollet ndërkombëtare
2.1.1.2 Marrëveshje dypalëshe në fushën e luftës kundër terrorizmit
2.2 Kuadri institucional
2.3 Arritjet, mësimet
2.3.1Analiza e situatës
2.3.2Faktorët e riskut dhe kërcënimet nga terrorizmi në Shqipëri
2.3.3Dënimet
2.3.4Masat e marra në luftën kundër terrorizmit
2.3.5Financimi i terrorizmit
2.3.6Të dhëna nga raporte ndërkombëtare për situatën e Shqipërisë në lidhje me terrorizmin
2.3.7Drejtimet kryesore që do të trajtohen në këtë strategji
3.Vizioni dhe misioni i strategjisë
3.1 Vizioni
3.2 Misioni
3.3 Treguesit e impaktit
PJESA II – QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË STRATEGJISË
4.Qasja 1: Parandalimi i terrorizmit dhe radikalizimit që çon në terrorizëm përmes sinjalizimit të hershëm
4.1 Qëllimi i politikës 1: Mbajtja e kërcënimit terrorist në nivel "të ulët"
4.1.1Objektivi specifik 1.1: Parandalimi i kërcënimeve terroriste
4.1.2Objektivi specifik 1.2: Parandalimi i financimit të terrorizmit
4.1.3Objektivi specifik 1.3: Intensifikimi i masave për ndjekjen dhe monitorimin e situatës lidhur me shtetasit shqiptarë LHT që mund të kthehen nga zonat e konfliktit Siri/Irak, si dhe çdo individi të dyshuar për vepra me qëllime terroriste
4.1.4 Objektivi specifik 1.4: Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit brenda strukturave të Policisë së Shtetit, agjencive inteligjente dhe ligjzbatuese në vend që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit
4.2 Qëllimi i politikës 2: Ndërprerja e aktiviteteve të faqeve dhe platformave digjitale, si dhe individëve që tërheqin njerëz në terrorizëm
4.2.1Objektivi specifik 2.1: Parandalimi i radikalizimit nëpërmjet internetit
4.2.2Objektivi specifik 2.2: Rritja e prezencës së strukturave të antiterrorit në mjedisin virtual përmes kontrollit dhe monitorimit të hapësirave virtuale përfshirë *darknet*-in

4.2.3Objektivi specifik 2.3: Parandalimi i radikalizimit dhe rekrutimeve terroriste duke rritur bashkëpunimin bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar dhe me prodhuesit e aplikacioneve në internet

4.3 Qëllimi i politikës 3: Kuptimi i kërcënimeve të terrorizmit në vendin tonë përmes identifikimit të hershëm të grupeve të synuara dhe metodave radikale

4.3.1 Objektivi specifik 3.1: Vlerësimi dhe analizimi i faktorëve që çojnë në radikalizim dhe ekstremizëm të dhunshëm

4.4 Qëllimi i politikës 4: Zgjerimi i kapaciteteve operacionale të policisë dhe kapaciteteve të inteligjencës

4.4.1 Objektivi specifik 4.1: Përmirësimi i parandalimit nëpërmjet zhvillimit të vlerësimeve të riskut, analizave dhe kërkimeve për radikalizimin dhe terrorizmin

4.5 Qëllimi i politikës 5: Zhvillimi i komunikimit strategjik

4.5.1Objektivi specifik 5.1: Shkëmbimi i përvojës dhe ekspertizës me vendet e rajonit

4.5.2Objektivi specifik 5.2: Krijimi i një rrjeti komunikimi të vazhdueshëm për shkëmbimin e informacioneve mes institucioneve dhe strukturave të përfshira me qëllim krijimin e programeve dhe manualeve për ndërgjegjësimin mbi terrorizmin

5. Qasja 2: Hetimi i veprave të terrorizmit, zbulimi dhe goditja e terroristëve/grupeve terroriste duke eliminuar kërcënimet e terrorizmit

5.1.1 Qëllimi i politikës 6: Identifikimi, hetimi, zbulimi i veprave penale në fushën e terrorizmit dhe financimit të tij dhe goditja e individëve e grupeve terroriste

5.1.2 Objektivi specifik 6.1: Hetimi i terrorizmit dhe burimeve të tij

5.1.3 Objektivi specifik 6.2: Bashkëpunimi dhe koordinimi me agjencitë inteligjente e ligjzbatuese dhe institucioneve që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit

5.1.4 Objektivi specifik 6.3: Përmirësimi dhe rritja sipas nevojës e kapaciteteve njerëzore, profesionale e logjistike të strukturave të antiterrorit

5.2 Qëllimi i politikës 7: Përmirësimi i sistemeve të mbledhjes, ruajtjes, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit

5.2.1 Objektivi specifik 7.1: Krijimi i një sistemi të sigurt të komunikimit për transmetimin e informacionit ndërmjet strukturave të përfshira në luftën kundër terrorizmit

5.2.2 Objektivi specifik 7.2: Vlerësimi periodik i nivelit të rrezikut/kërcënimit të faktorëve dhe fenomeneve që prodhojnë radikalizëm apo ekstremizëm, si derivate të terrorizmit

5.2.3 Objektivi specifik 7.3: Raporte dhe vlerësime nga agjencitë inteligjente dhe ligjzbatuese në luftën kundër terrorizmit, mbi përcaktimin e nivelit të kërcënimit terrorist në rrafshin ndërkombëtar *modus operandi* dhe ndikimi në vendin tonë

5.2.4 Objektivi specifik 7.4: Sigurimi i informacionit për terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, sabotazhin dhe armët e dëmtimit në masë dhe informimi i institucioneve vendimmarrëse, politikëbërëse, institucioneve dhe strukturave të tjera kompetente/përgjegjëse shtetërore dhe të zbatimit të ligjit

5.2.5 Objektivi specifik 7.5: Konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit, institucionet e sistemit të sigurisë kombëtare, shërbimet inteligjente të vendeve aleate dhe partnere

6. Qasja 3: Reagimi

6.1.1Qëllimi i politikës 8: Reagim nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të institucioneve përkatëse për t'iu përgjigjur sulmeve terroriste

6.1.2 Objektivi specifik 8.1: Konsolidimi i kapaciteteve të institucioneve, me qëllim uljen e impaktit të sulmeve terroriste, në mënyrë që të zbuten humbjet njerëzore ekonomike të shkaktuara nga këto sulme

6.1.3 Qëllimi i politikës 9: Reagim nëpërmjet reduktimit dhe lehtësimit të pasojave nga një sulm terrorist

6.1.4 Objektivi specifik 9.1: Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e dhënies së ndihmës viktimave të terrorizmit, sipas Konventës Evropiane për kompensimin e viktimave të terrorizmit

6.1.5 Qëllimi i politikës 10: Përgatitja për menaxhimin e incidenteve terroriste që përfshijnë përdorimin e materialeve CBRN

6.1.6 Objektivi specifik 10.1: Reagimi i shpejtë, sipas protokolleve ndërkombëtare, ndaj incidenteve terroriste që përfshijnë përdorimin e materialeve CBRN

7. Qasja 4: Mbrojtja

7.1.1 Qëllimi i politikës 11: Rritja e nivelit të sigurisë në fushën e transportit, tregtisë, shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve

7.1.2 Objektivi specifik 11.1: Reduktimi i rreziqeve që rrjedhin nga transferimet e ndaluara të mjeteve dhe materialeve që mund të përdoren për të kryer një sulm apo akt terrorist

7.1.3 Objektivi specifik 11.2: Rritja e aftësive për të zbuluar aktivitetin terrorist duke përfshirë kontrollin dhe mbrojtjen e materialeve kimike, biologjike, radiologjike, bërthamore dhe eksplozive (CBRN)

7.1.4 Qëllimi i politikës 12: Rritja e nivelit të mbrojtjes së infrastrukturës kritike

7.1.5 Objektivi specifik 12.1: Hartimi i planeve të bashkëpunimit për parandalimin e akteve të mundshme terroriste midis strukturave ligjzbatuese dhe institucioneve përgjegjëse që kanë në administrim infrastrukturën kritike të vendit

7.1.6 Qëllimi i politikës 13: Mbrojtja nga kërcënimet terroriste që cenojnë venddislokimet/infrastrukturën, pajisjet kritike dhe sistemet e mbrojtjes së Ministrisë së Mbrojtjes dhe FARSH-së

7.1.7 Objektivi specifik 13.1: Identifikimi i nevojave dhe standardeve të mbrojtjes nga kërcënimet terroriste

7.1.8 Objektivi specifik 13.2 Konsolidimi i kapaciteteve informative dhe operacionale

PJESA III: MASAT PRIORITARE

PJESA IV: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

4.1 Implementimi/zbatimi i strategjisë

4.2 Përgjegjësia e institucioneve dhe angazhimet institucionale

4.3 Llogaridhënia dhe raportimi

Pjesa IV: Plani i veprimit dhe burimet financiare për zbatim

Aneksi II: Pasaporta e indikatorëve

Lista e shkurtimeve

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AAPSK	Agjencia e Administrimit të Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara
ADM	Armë të Dëmtimit në Masë
AIS	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
AKSHE	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
BSH	Banka e Shqipërisë
CBRN	Armë të Shkatërrimit në Masë
CVE/QEDH	Qendra për Ekstremizmin e Dhunshëm
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DAT	Drejtoria e Antiterrorit
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DKEF	Drejtoria e Krimit Ekonomiko Financiar
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPKM	Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit
DPKOKR	Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e K. Organizuar dhe K. Rënda
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
DPRSP	Drejtoria e Përgjithshme e Rendit dhe për Sigurinë Publike
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë se Shtetit
DPSHTRR	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
FA	Forcat e Armatosura
FSP	Forca e Sigurisë Portuale
IFB	Instituti i Fizikës Bërthamore
ISIL	Shteti Islamik i Irakut edhe Levantit
FAj	Komanda e Forcës Ajrore
KFD	Komanda e Forcës Detare
KM	Këshilli i Ministrave
KMR	Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministra e Drejtësisë
ME	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MFE	Ministra e Financave dhe Ekonomisë
MTM	Ministra e Turizmit dhe Mjedisit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MB	Ministra e Brendshme
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
PKR	Prokuroria e Krimeve të Rënda
PP	Prokuroria e Përgjithshme
SSK	Strategjia e Sigurisë Kombëtare
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
ZMR	Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi

PËRKUFIZIME:

Ekstremizmi i dhunshëm - Procesi i adoptimit të pikëpamjeve radikale (politike, ideologjike ose fetare) dhe kthimit të tyre në veprime të dhunshme;

Radikalizim - Procesi i zhvillimit të ideologjive dhe pikëpamjeve ekstremiste. Radikalizimi mund të jetë i dhunshëm ose jo;

Radikalizimi fetar - Procesi i zhvillimit të ideologjive dhe të pikëpamjeve ekstremiste fetare;

Radikalizimi i dhunshëm - Procesi i përqafimit të opinioneve, pikëpamjeve dhe ideve që mund të çojnë në akte terrorizmi (KE: 2005 "Rekrutimi terrorist: trajtimi i faktorëve në ndikojnë në radikalizimin e dhunshëm" [*Terrorist Recruitment: addressing the factors contributing to violent radicalisation*]);

Terrorizëm - Akt i qëllimshëm që mund të dëmtojë seriozisht një vend apo një organizatë ndërkombëtare, i kryer me qëllim shkaktimin e frikës së madhe te popullata, duke detyruar në mënyrë të pandershme një qeveri apo organizatë ndërkombëtare të kryejë apo të mos kryejë një veprim, duke destabilizuar seriozisht apo duke shkatërruar strukturat bazë politike, kushtetuese, ekonomike apo sociale me anë të atentateve ndaj jetës së personit, sulmeve ndaj integritetit fizik të një personi, rrëmbimit, marrjes peng të njerëzve, avionëve apo anijeve, ose me anë të prodhimit, mbajtjes apo transportit të armëve dhe lëndëve shpërthyese (vendimi kuadër i BE-së për luftën kundër terrorizmit: 2002).

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrje

Terrorizmi në të gjitha format dhe mënyrën e shfaqjes së tij përbën një kërcënim të përgjithshëm për paqen dhe sigurinë botërore. Fenomeni i terrorizmit kombëtar dhe ndërkombëtar është një ndër sfidat më të vështira për të sotmen dhe për të ardhmen. Siguria kombëtare e Republikës së Shqipërisë përfaqëson tërësinë e mjeteve dhe instrumenteve shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga kërcënimet dhe rreziqet e jashtme e të brendshme. Terrorizmi vazhdon të mbetet një nga kërcënimet kryesore të sigurisë, si në nivel vendi po ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe vetë mënyrën e jetesës së shoqërisë. Trendi global i terrorizmit dhe shtrirja e tij, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, ka kërcënuar edhe vendin tonë, rajonin, Evropën dhe më gjerë. Pozicioni gjeostrategjik i Shqipërisë krijon kushte që vendi ynë të synohet si një pikë tranzitimi jo vetëm për trafiqet e paligjshme, por dhe për përhapjen e terrorizmit, kryesisht atij me baza fondamentaliste. Shqipëria është e renditur në forcat e koalicionit kundër terrorizmit dhe është e angazhuar në luftën kundër tij me të gjitha vlerat dhe aftësitë e saj, duke dhënë në këtë mënyrë kontributin e saj krahas shteteve të tjera e duke nënshkruar e ratifikuar të gjitha konventat e protokollet e OKB-së dhe Bashkimit Evropian.

Qeveria jonë, duke vlerësuar kërcënimet dhe pasojat nga terrorizmit, që nga viti 2014 ka krijuar në Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Antiterrorit e cila ka për mision dhe detyrë funksionale eliminimin dhe ndjekjen penale të veprave kundër terrorizmit. Nga viti 2013 dhe në vijim janë hartuar 3 strategji kundër terrorizmit të cilat përveçse kanë krijuar mekanizmat e nevojshëm, kanë ofruar edhe një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe goditjen e terrorizmit. Ky është dokumenti strategjik i katërt i hartuar kundër terrorizmit duke garantuar vazhdimësinë e strategjive të mëparshme dhe ka për qëllim fuqizimin e mëtejshëm të mekanizmave ekzistues, por dhe t'i përshtatet më mirë situatave dhe dinamikave aktuale të kërcënimeve nga terrorizmi.

1.1 Qëllimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit 2021 – 2025 dhe lidhja me dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare

Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021 – 2025 përfaqëson dokumentin themelor kombëtar strategjik në luftën kundër terrorizmit që kombinon agjendën e integrimit në Bashkimin Evropian në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të kapitullit 24, në fushën e luftës kundër terrorizmit, me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021 – 2025 inkuadrohet në shtyllën e parë të SKZHI II 2015 – 2020, Mirëqeverisja, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës. Ajo përbën dokumentin strategjik që përcakton vizionin kombëtar për krijimin e një shoqërie pa kërcënime terroriste, me imazhin e një vendi të sigurt dhe me

standarde evropiane të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë periudhës 2021 – 2025, duke mbështetur edhe aspiratat për integrim në Bashkimin Evropian. Vizioni i strategjisë bazohet në vizionin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020, "Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe me një imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë". Në kuadër të shtyllës së 'Mirëqeverisjes, Demokracisë dhe Shtetit të së Drejtës', SKZHI II 2015 – 2020 paraqet se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive që synojnë parandalimin dhe uljen e kërcënimeve terroriste nëpërmjet:

- rritjes së rezultateve në luftën kundër terrorizmit përmes vendosjes dhe përdorimit të një sistemi efikas të vlerësimit të riskut, shoqëruar me forcimin institucional të njësive të angazhuara në këtë fushë. Rezultatet e pritshme, përfshijnë: i. rritje në numrin e operacioneve që përdorin metoda të hetimeve speciale; ii. rritje në numrin e operacioneve ndërkombëtare të përbashkëta; dhe ii. rritje në shkallën e zbulimit dhe eliminimit të veprave penale terroriste;

- hartimit të një ligji organik në përputhje me standardet e BE-së për luftën kundër terrorizmit;

- ngritjes dhe funksionimit të Komitetit Ndërinstitucional për Bashkërendimin e Veprimeve në Luftën Kundër Terrorizmit"; dhe

- ngritjes së një rrjeti të sigurt komunikimi për shkëmbimin e informacionit midis agjencive të angazhuara në luftën kundër terrorizmit.

Ky dokument strategjik ndërlidhet me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, përkatësisht me objektivin 16, "Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet." ku qëllimi i politikave për realizimin e tij është:

16.1 Zvogëlimi i dukshëm i të gjitha formave të dhunës dhe normës së vdekshmërisë;

16.2 Ndalimi i abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe të torturës ndaj fëmijëve;

16.a Forcimi i institucioneve kombëtare relevante, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.

Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është orientimi i politikave dhe forcimi i qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj terrorizmit. Hartimi i kësaj strategjie e cila mbështetet në strategjinë e BE-së kundër terrorizmit[3], synon harmonizimin e veprimtarisë së strukturave, agjencive dhe institucioneve që kanë përgjegjësinë e luftës kundër terrorizmit. Parandalimi dhe goditja e terrorizmit vazhdon të mbetet një ndër prioritetet kryesore strategjike të Qeverisë Shqiptare. Strategjia e re kundër terrorizmit, si dhe masat e tjera legjislative dhe politike në kuadër të kësaj fushe janë të ndërlidhura me prioritetet e qeverisë të parashikuara në SKZHI 2015 – 2020 dhe në Programin e Qeverisë 2017 – 2021, ku një ndër prioritetet kryesore është rendi dhe siguria publike, duke synuar arritjen e standardit të vendeve të BE-së për sa i përket kësaj fushe. Fokusi i prioriteteve strategjike dhe veprimit në fushën e rendit dhe sigurisë së brendshme, bazuar në Programin e Qeverisë 2017 – 2021, është:

- forcimi i institucioneve përgjegjëse për rendin dhe sigurinë;

- ndryshimi cilësisht i sistemit të kontrollit të territorit dhe i policimit në komunitet, në funksion të parandalimit të kriminalitetit dhe shkeljeve të ligjit;

- konsolidimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me organizatat e specializuara në luftën kundër krimit;

- ngritja e skuadrave policore mobile të përbashkëta me vendet partnere, si mundësi për shkëmbimin e shpejtë të informacionit;

- kryerja e operacioneve të përbashkëta të hetimit penal, mbrojtja më mirë e të dhënave dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë;

- përdorimi i metodave dhe teknologjisë bashkëkohore, dhe aftësimin e mëtejshëm profesional të strukturave;

- krijimi i sistemeve të përbashkëta dhe të integruara të hedhjes dhe shkëmbimit të të dhënave për hetimin penal dhe inteligjencën.

[3] Strategjia e KE-së për Antiterrorizmin 2005 dhe strategjia e KE-së për Antiterrorizmin 2018 – 2022.

Gjithashtu ajo ndërlidhet me procesin e Integrimit Evropian dhe si e tillë është pjesë e PKIE-së, kapitulli 24, "Drejtësia, Liria dhe Siguria" dhe nënkapitullit, "Bashkëpunimi policor, lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmi, bashkëpunimi në çështjet e drogës". "Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit" është hartuar në harmoni me dokumentet e ngjashme dhe më të rëndësishme ndërkombëtare. Hartimi i kësaj strategjie e cila është në harmoni të plotë me strategjinë e BE-së kundër terrorizmit, në nenet 5, 82 dhe 84, të "Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit", ku është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet vendit tonë dhe BE-së në fushën kundër terrorizmit, do të bazohet në një qasje me katër komponentë:

a) Sinjalizimi/parandalimi;
b) Hetimi, zbulimi dhe goditja;
c) Reagimi;
d) Mbrojtja.

Strategjia bazohet njëkohësisht edhe në "Strategjinë e Sigurisë Kombëtare", në kuadër të fuqizimit të sigurisë dhe mbrojtjes, ku një ndër objektivat kryesore është ngritja e mekanizmave që garantojnë komunikimin, bashkërendimin dhe bashkëpunimin efektiv ndërinstitucional mes aktorëve kryesorë të sigurisë kombëtare, përmes forcimit të bashkëpunimit dypalësh dhe me institucionet e specializuara rajonale dhe ndërkombëtare për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin, trafiqet e paligjshme dhe terrorizmin.

Kjo strategji plotëson detyrimin që rrjedh nga "Strategjia e Sigurisë Kombëtare" për hartimin e strategjive sektoriale dhe është komplementare me:

- Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2016 – 2020;
- Strategjinë Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021 – 2025;
- Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2021 – 2027;
- Strategjinë e Sigurisë Publike 2021 – 2025;
- Strategjinë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë;

Bashkërendimi i "Strategjisë Kombëtare Kundër Terrorizmit" me strategjitë e tjera kombëtare e sidomos me atë "Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021 – 2025" etj., është i një rëndësie të veçantë pasi që në shumë vende është vërejtur një trend i afrimit të organizatave terroriste me organizatat kriminale. Përmes krimit të organizuar e sidomos pastrimit të parave, iu mundësohet terroristëve të fshehin dhe legjitimojnë produktet e krimit. Trafikimi me drogë dhe kultivimi i drogës u ofron terroristëve burim të vlefshëm të të ardhurave të cilat ata i shndërrojnë në fonde për qëllime trajnimi të terroristëve, sigurimin e pajisjeve logjistike dhe teknologjinë, si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme.

Për më tepër, Republika e Shqipërisë, si anëtare e koalicionit global kundër DAESH/ISIS dhe më gjerë ka treguar përkushtim dhe njëkohësisht ka marrë përgjegjësi dhe detyrime të caktuara, të cilat janë përfshirë në këtë strategji.

Dokumenti përmban objektivat strategjike dhe objektiva të tjera specifike për secilën nga shtyllat e sipërpërmendura. Strategjia do të shoqërohet me planin e veprimit për realizimin e objektivave dhe përcaktimin e mekanizmave implementues dhe koordinues.

1.2 Metodologjia

Strategjia bazohet në konceptin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës midis të gjithë aktorëve që mund të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjikë dhe që janë profilizuar në këtë drejtim bazuar në analizat dhe vlerësimet, si dhe studimeve në këtë fushë. Kjo qasje nënkupton bashkëpunim të ngushtë dhe shumëdimensional midis palëve të interesuara qeveritare dhe joqeveritare, përfshirë përfaqësuesit e shoqërisë civile, komunitetin akademik dhe shkencor dhe partnerët në nivelin kombëtar, çka sjell një qasje adekuate ndaj kërcënimit të terrorizmit dhe radikalizmit që çon në terrorizëm.

Strategjia përcakton objektivat strategjike që mbrojnë vlerat themelore dhe i grupon ato në katër fusha prioritare ose qasje: 1. Parandalimi i terrorizmit, ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizmi; 2. Mbrojtja me zbulimin dhe eliminimin e kërcënimeve të terrorizmit dhe dobësive të sistemit; 3. Ndjekja penale e terroristëve, duke respektuar të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe demokracinë; dhe 4. Përgjigja e sistemit në rast të një sulmi terrorist. Pika fillestare në zhvillimin e Strategjisë ishte fakti se kërcënimi i terroristëve organizatat, strukturat terroriste dhe individët manifestohen si terrorizëm i frymëzuar nga ana fetare, terrorizëm etnik-nacionalist dhe separatist, terrorizëm i krahut të majtë dhe anarkik dhe terrorizëm i djathtë. Elementet kryesore të terrorizmit si një fenomen

shoqëror, të cilat mund të njihen në të gjitha format e manifestimit që përfshijnë dhunën si metodë; nxitja e frikës dhe nxitja e ndryshimeve politike dhe shoqërore; arritja e objektivave të përcaktuara terroriste - detyrimi i qeverisë ose shoqërisë për të marrë ose mos marrë masa konkrete - arritja e objektivave politike, fetare ose ideologjike; një numër i madh i viktimave, të cilat tregojnë spektakolaritetin për të cilin aspirojnë terroristët, si dhe paligjshmërinë dhe papranueshmërinë shoqërore.

Faktorë të rëndësishëm shkaktarë të terrorizmit, të cilët ndikojnë në fushën dhe dimensionin e veprimtarive terroriste të organizatave terroriste, strukturave terroriste dhe individëve, janë të ndryshëm, duke filluar nga hendeku midis pritjeve dhe mundësisë së arritjes së objektivave të grupeve shoqërore në kushtet e ekzistencës sociale, ekonomike dhe ndryshimet politike, përfshirë tendencat separatiste, arritjen e monolitizmit etnik në një fushë të veçantë, aspektet ekonomike, sociale etj.

Në përcaktimin e objektivave strategjikë, u morën parasysh të gjithë elementët më të rëndësishëm të kësaj metodologjie, faktorët e rrezikut që ndikojnë në zhvillimin e një kërcënimi në rast të shfaqjes së radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm, specifikat me të cilat përballet Shqipëria në luftën kundër terrorizmit, përfshirë misionin dhe kapacitetet ekzistuese të forcave të sistemit të sigurisë në kuptimin më të gjerë, përfshirë shoqërinë civile dhe sektorin privat. Aktivitetet konkrete për arritjen e objektivave të kësaj strategjie do të përcaktohen në planin e veprimit për zbatimin e saj, dhe do të drejtohen kryesisht në zbutjen e faktorëve të ndërlidhur të rrezikut. Qasja gjithëpërfshirëse dhe konsolidimi i strukturave të inteligjencës vlerësohet si element thelbësor për suksesin në luftën kundër terrorizmit, ku të gjitha institucionet veprojnë së bashku në përgjigje të kërcënimeve terroriste duke u fokusuar kryesisht te parandalimi i akteve të tilla. Republika e Shqipërisë do të zhvillojë kapacitetet parandaluese por edhe ato të hetimit, zbulimit, reagimit dhe mbrojtjes nga aktet terroriste, duke rritur bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar dhe duke shkëmbyer eksperienca dhe praktika për identifikimin dhe parandalimin e akteve duke respektuar edhe standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi, dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike të këtij dokumenti, përputhet plotësisht me dokumentet strategjikë në nivel ndërkombëtar e kombëtar, të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, duke bërë që vizioni, objektivat strategjike dhe specifike të parashikuar të përputhen plotësisht me këta dokumente strategjike. Baza e suksesit të kësaj strategjie është ndjekja dhe zbatimi nga të gjitha institucionet në të gjitha nivelet (qendrore dhe lokale), duke siguruar dhe duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në lidhje me zbatimin e saj.

Nisma për hartimin e kësaj strategjie është ndërmarrë nga Ministria e Brendshme si institucion përgjegjës për fushën e rendit dhe sigurisë publike, bazuar kjo dhe në fushën e saj të përgjegjësisë të rregulluar me vendimin nr. 502, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme".

Strategjia është konceptuar bazuar në kontributet e ministrive të linjës si: Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria për Arsimin, Sportin dhe Rininë, Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe institucione të tjera ligjzbatuese me rol të rëndësishëm në fushën e luftës kundër terrorizmit, si: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (veçanërisht Drejtoria e Antiterrorit) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave por edhe institucionet e pavarura si: Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme SPAK, Shërbimi Informativ Shtetëror, Banka e Shqipërisë, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencia Kombëtare për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike kanë dhënë kontribut të veçantë gjatë procesit të hartimit të kësaj strategjie.

Në hartimin e këtij dokumenti, krahas infrastrukturës ligjore, programeve të ndryshme shtetërore, në analizën për vlerësimin e gjendjes dhe planifikimin e prioriteteve, objektivave dhe përcaktimit të vizionit për të ardhmen, janë marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e progresraporteve të Komisionit Evropian për përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian por edhe

analizat institucionale të institucioneve përgjegjëse për monitorimin e strategjisë së mëparshme të cilat kanë kontribuar në mënyrë thelbësore në përcaktimin e problematikave dhe sfidave në ardhmen bazuar në situatën aktuale dhe të pritshme të dinamikave në luftën kundër terrorizmit. Si të tilla përmendim analizën e riskut për financimin e terrorizmit nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, SHISH por edhe publikime të organizmave të tjerë si: publikimi i raportit të Komitetit të Helsinkit "Bashkë kundër Ekstremizmit Terrorizmit dhe Radikalizmit 2018", raportit "Radikalizmi i Dhunshëm dhe Ekstremizmi në Shqipëri (IDM 2015)", raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit, raportet e EUROPOL etj.

Dokumenti është shpërndarë për konsultim publik në faqen e Kryeministrisë, për konsultim publik në fillim të dhjetorit 2020, në adresën:

https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/312

Po ashtu, për arsye të masave parandaluese të emergjencës së COVID-19, dokumenti është diskutuar *online* dhe me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve fetare.

2. Kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, mësimet

2.1 Kuadri ligjor

Legjislacioni shqiptar në fushën e luftës kundër terrorizmit është mjaft i gjerë dhe ka pësuar ndryshime e përmirësime të dukshme, bazuar në legjislacionin ndërkombëtar dhe diktuar nga situata e terrorizmit në aspektin kombëtar e ndërkombëtar.

Në fushën e terrorizmit, Republika e Shqipërisë ka në zbatim një kuadër të plotë ligjor dhe mekanizma institucionalë efektivë, të cilat përfshijnë, edhe pse jo shteruese, aktet e mëposhtme:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, ligjin nr. 89/2017) ku në nenin 28 të të cilit: "Forma të veçanta të bashkëpunimit", në pikën 2, jepet përkufizimi i organizatës terroriste dhe në vijim parashikohen veprat penale të kryera me qëllime terroriste, parashikuar në kreun VII të këtij kodi, si dhe nenet 265/a,265/b dhe 265/c që parashikojnë sanksione për pjesëmarrësit në veprime luftarake në një shtet të huaj (ndryshime sipas ligjit nr. 98, datë 31.7.2014);

- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ku përcaktohet kompetenca e hetimit të veprave penale që lidhen me terrorizmin, si dhe ligji nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", në bazë të të cilit është krijuar Prokuroria e Posaçme, që ka në kompetencë hetimin e veprave të kryera nga grupet terroriste;

- Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar. Ky ligj ka për qëllim të parandalojë pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit. Ky ligj gjithashtu parashikon detyrime dhe procedura për raportimin, për subjektet e ligjit te strukturat përgjegjëse në funksion të zbatimit të tij, kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoritetit përgjegjës;

- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për eliminimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimin, nëpërmjet masave ndaluese kundër pasurisë", zbatohen edhe për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, edhe për pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura;

- Ligj nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit". Ky ligj është në përputhje me kërkesat e rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Zbatimi i këtij ligji bëhet nga një sërë institucionesh dhe agjencish si: Ministria e Drejtësisë, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP) dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ndërsa administrimi i llogarive dhe aseteve të ngrira/ sekuestruara/konfiskuara bëhet nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara;

- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 44, datë 10.6.2009, "Për miratimin e rregullores 'Për parandalimin e pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit';.

- VKM-ja nr. 140, datë 13.2.2008, "Për mënyrën e administrimit të pasurive të paluajtshme të sekuestruara, në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit";

- Rekomandimi i vendimit kuadër të KE-së, neni 5, Dënimet: "Masat e ndështkimit dhe dënimit të terroristëve", dhe të nenit 2 të tij, për krimet e lidhura me grupet terroriste;

- Ligji nr. 9110, datë 24.7.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda", u krijua Gjykata Për Krime të Rënda, dhe Prokuroria për Krimet e Rënda, e cila ka në kompetencë edhe hetimin e veprave penale në fushën kundër terrorizmit;

- Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë";

- Ligji nr. 108/2013, "Për të huajt", (ndryshuar me ligjin nr. 74/2016, datë 14.7.2016, dhe ligjin nr. 13/2020) i cili rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë;

- Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale";

- Ligji nr. 79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale";

- Ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile";

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare;

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020;

- Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013 – 2020 dhe Planit të Veprimit 2013 – 2016;

- Plani i Veprimit për vitet 2019 – 2020, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013 – 2020;

- Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2016-2020;

- Strategjia Kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, miratuar me VKM-në nr. 930, datë 18.11.2015;

- Prioritetet e Ministrisë së Brendshme;

- Plani i Përbashkët i Veprimit Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian.

2.1.1 Instrumentet ligjore ndërkombëtare

2.1.1.1 Konventat dhe protokollet ndërkombëtare

Republika e Shqipërisë, në kuadër të bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit, ka nënshkruar dhe ratifikuar konventat dhe protokollet ndërkombëtare që përbëjnë instrumentet e së drejtës ndërkombëtare në fushën e antiterrorizmit. Shqipëria u është bashkuar iniciativave të OKB-së për të luftuar terrorizmin dhe ka ratifikuar tashmë 12 prej tyre. Krahas tyre ekzistojnë edhe një sërë rezolutash të Këshillit të Sigurimit të OKB-së më vlerë detyruese për shtetet anëtare, si edhe konventa dhe protokolle të ashtuquajtura rajonale. Në këtë kuadër, Shqipëria aderon në të gjitha konventat dhe protokollet e Këshillit të Evropës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit (aktualisht 16 të tilla) dhe konkretisht:

1. "Konventa mbi Veprat Penale dhe aktet e tjera të kryera në bordin e avionit", Tokio, 14.9.1963, ratifikuar me ligjin nr. 8197, datë 6.3.1999, Fletore Zyrtare nr. 3, datë 28.3.1997, faqe 52;

2. "Konventa mbi shtypjen e akteve të paligjshme të rrëmbimit të avionit", Hagë, 16.12.1970, ratifikuar me ligjin nr. 8197, datë 6.3.1997. Fletore Zyrtare nr. 3, datë 28.3.1997, faqe 52;

3. "Konventa mbi shtypjen e akteve të paligjshme kundër sigurisë së Aviacionit Civil", Montreal, datë 23.9.1971, ratifikuar me ligjin nr. 8191, datë 6.3.1997. Fletore Zyrtare nr. 3, datë 28.3.997, faqe 52;

4. "Konventa mbi parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve kundër personave me imunitet ndërkombëtar, përfshirë Agjentët Diplomatikë", Nju Jork, 14.12.1973, ratifikuar me ligjin nr. 8832, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare nr. 56, datë 21.12.2001, faqe 1762;

5. "Konventa Evropiane mbi shtypjen e terrorizmit", Strasburg, 27.1.1979 ratifikuar me ligjin nr. 8642, datë 13.7.2000. Fletore Zyrtare nr. 22, datë 19.7.2000, faqe 1087;

6. "Konventa ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve", Nju Jork 17.12.1979, ratifikuar me ligjin nr. 8837, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare nr. 22, datë 19.7.2000, faqe 1087;

7. "Konventa mbi mbrojtjen fizike të materialit bërthamor", Vjenë, më datë 3.3.1980, ratifikuar me ligjin nr. 8853, datë 31.1.2002. Fletore Zyrtare nr. 12, datë 8.2.2002, faqe 19;

8. "Protokolli Mbi Shtypjen e akteve të paligjshme të dhunës në aeroport që i shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar", Montreal, 24.2.1991 ratifikuar me ligjin nr. 8835, datë

22.11.2001. Fletore Zyrtare nr. 56, datë 21.12.2001, faqe 1785;

9. "Konventa mbi shtypjen e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar", Romë, 10.03.1998, ratifikuar me ligjin nr. 8850, datë 27.12.2001. Fletore Zyrtare nr. 60, datë 31.12.2001, faqe 1886;

10. "Protokolli mbi shtypjen e akteve të paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse, të Vendosura në Platformën Kontinental", Romë, 10.3.1988, ratifikuar me ligjin nr. 8850, datë 27.12.2001. Fletore Zyrtare nr. 60, datë 31.12.2001, faqe 1886;

11. "Konventa mbi etiketimin e eksplozivëve plastik për qëllim zbulimi", Montreal, 1.3.1991, ratifikuar me ligjin nr. 9020, datë 6.3.2003. Fletore Zyrtare nr. 21, datë 28.3.2003, faqe 649;

12. "Konventa ndërkombëtare mbi ndalimin e bombardimeve terroriste", Nju Jork, 15.12.1997, ratifikuar me ligjin nr. 8836, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare nr. 57, datë 21.12.2001, faqe 1801;

13. "Konventa ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit, Nju Jork, 10.01.2000, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 8865, datë 14.3.2002. Fletore Zyrtare, nr. 7, datë 5.4.2002, faqe 170;

14. "Konventa Evropiane (Strasburgut), për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit", ratifikuar me ligjin nr. 8646, datë 20.7.2000. Fletore Zyrtare, nr. 23, datë 4.8.2000, faqe 1183;

15. "Konventa e Këshillit të Evropës, mbi pastrimin, kërkimin dhe konfiskimin e procedurave të krimit të organizuar dhe financimit të terrorizmit", datë 6.5.2005, nënshkruar me 22 dhjetor 2005, hyrë në fuqi me 1 maj 2008;

16. "Konventa e Këshillit të Evropës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit", ratifikuar me ligjin nr. 9646, datë 27.11.2006. Fletore Zyrtare nr. 134, datë 22.12.2006, faqe 5221;

17. Ratifikimi i "Protokollit ndryshues të Konventës Evropiane për shtypjen e terrorizmit", ratifikuar me ligjin nr. 9230, datë 13.5.2004. Fletore Zyrtare nr. 38, datë 16.6.2004, faqe 2793;

18. Për ratifikimin e "Konventës Evropiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme" me ligjin nr. 9265, datë 29.7.2004;

19. "Konventa Ndërkombëtarë për shtypjen e akteve të terrorizmit nuklear (bërthamor) (2005) ", nënshkruar nga vendi ynë.

2.1.1.2 Marrëveshje dypalëshe në fushën e luftës kundër terrorizmit

Planifikimi dhe kryerja e aktiviteteve terroriste është një proces i vështirë që rrallë herë ndodh brenda territorit të një vendi dhe në zbatim të Strategjisë Globale të OKB-së "Për terrorizmin" e cila kërkon bashkëpunim në nivel global, rajonal dhe kombëtar, në zbatim të rekomandimit të rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 49/60 (1995). Shqipëria ka nënshkruar dhe po zbaton 21 marrëveshje bashkëpunimi me vende të rajonit, Evropës dhe SHBA-të, në fushën e sigurisë dhe shkëmbimit të informacionit për verifikimin dhe luftën kundër terrorizmit, konkretisht:

1. Me Sllovenínë – "Mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogës dhe krimit të organizuar", nënshkruar me 24.11.1993, në Tiranë;

2. Me Kroacinë – "Për bashkëpunimin policor", 20 janar 2014;

3. Me Egjiptin – "Protokoll mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit", nënshkruar në Kajro, më 24.10.1995.;

4. Me Hungarinë – "Mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar", nënshkruar në shkurt 1999 dhe ratifikuar me ligjin nr. 8623, datë 15.6.2000;

5. Me Rumaninë – "Mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope, si edhe aktivitete të tjera ilegale", nënshkruar më 7.6.2002, në Bukuresht;

6. Me Malin e Zi - "Mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm, si dhe veprimtarive të tjera të paligjshme", nënshkruar në Podgoricë, Mal i Zi, me 31 tetor 2003;

7. Me Maqedoninë – "Mbi bashkëpunimin në luftën ndaj terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme", nënshkruar në Shkup, Maqedoni, më 17.6.2004.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal në luftën kundër terrorizmit, protokolli ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së

Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë "Për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit", më 3.2.2018, në Ohër, Maqedoni;

8. Me Bullgarinë – "Mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe akteve të tjera kriminale", nënshkruar në Tiranë, më 29 janar 2007.

9. Me Francën – "Mbi bashkëpunimin në fushën e sigurisë së brendshme", nënshkruar në Paris, më 15.5.2008.

10. Me Gjermaninë – "Mbi bashkëpunimin në fushën e sigurisë", nënshkruar më 31 maj 2013, dhe ratifikuar me ligj më 23 janar 2014.

11. Me Bosnjë Hercegovinën – "Mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar", nënshkruar me 24.3.2009, hyrë në fuqi më 4.3.2010.

12. Me Kosovën – "Mbi bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë". Miratuar me VKM-në nr. 429, datë 20.5.2015.

13. Me Sllovakinë – "Mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve të drogës dhe krimeve të tjera". Miratuar me VKM-në nr. 485, datë 10.6.2015.

14. Me SHBA – Marrëveshja e bashkëpunimit midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së SHBA, "Për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit", si dhe Protokollit Operacional, të ratifikuara me ligjin nr. 72, datë 7.7.2016, memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, "Për rritjen e bashkëpunimit për të parandaluar udhëtimin e terroristëve dhe për të luftuar migracionin e paligjshëm dhe krimet e rënda që lidhen me to", miratuar në parim me VKM-në nr. 153, datë 1.3.2017.

15. Me Serbinë – "Mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm ndërkombëtar të drogës dhe terrorizmit ndërkombëtar", nënshkruar më 11.3.2010, hyrë në fuqi më 1.3.2012.

16. Me Letoninë – "Mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve", nënshkruar më 16.12.2009.

17. Me Italinë - protokolli mes Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës Italiane "Mbi forcimin e bashkëpunimit dypalësh në luftën kundër terrorizmit dhe trafikimit të qenieve njerëzore", nënshkruar më 3 nëntor 2017, në Tiranë, hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit.

2.2 Kuadri institucional

Në luftën kundër terrorizmit përfshihen një numër i madh i institucioneve shqiptare, si:

Ministria e Brendshme:

Policia e Shtetit:

Në përbërje të Policisë së Shtetit funksionon Drejtoria e Antiterrorit, me shtrirje strukturore në të gjithë territorin e vendit. Funksionet kryesore të Drejtorisë janë parandalimi, identifikimi, gjurmimi dhe hetimi i personave të dyshuar si të përfshirë në vepra terroriste.

Agjencia e Administrimit të Aseteve Kriminale (AAPSK) për administrimin e fondeve dhe të pasurive të sekuestruara e konfiskuara;

Shërbimi Informativ Shtetëror:

Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH), i krijuar me ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998, mbledh informacion nga jashtë në funksion të sigurimit kombëtar, kryen veprimtari kundërzbulimi për ruajtjen e integritetit, të pavarësisë e të rendit kushtetues. SHISH-i mbledh informacion për terrorizmin, për prodhimin dhe trafikun e narkotikëve, për prodhimin e armëve të dëmtimit në masë, për krimet kundër mjedisit, mbledh informacion për krimin e organizuar, krime që cenojnë sigurinë kombëtare;

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar:

Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykata vetë posaçme për veprat penale. Çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata

kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktime vetë Kodit Penal.

Prokuroria e Përgjithshme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit për veprat penale në lidhje me terrorizmin. Gjithashtu, në Prokurorinë e Përgjithshme funksionon edhe Zyra e Përgjimeve të Komunikimeve Elektronike. Me memorandum të përbashkët ndërinstitucional, funksionojnë strukturat e hetimit të krimit financiar në Prokurorinë e Rretheve Gjyqësore, 8 njësitë e përbashkëta hetimore, të ngritura në Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Elbasan e Gjirokastër;

Ministria e Mbrojtjes:

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në varësi të ministrit të Mbrojtjes dhe funksionon bazuar në ligjin nr. 65/2014, "Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes". Ligji përcakton mënyrat e marrjes, administrimit dhe shpërndarjes së informacionit të klasifikuar kundër terrorizmit;

Ministria e Financave:

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave të financimit të terrorizmit. Në kuadër të ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse, të kontrollojë zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) bashkëvepron me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të realizimit të misionit të saj për garantimin e sigurisë dhe të rendit publik në porte dhe aeroporte, duke përfshirë dhe masat në kuadër të luftës kundër terrorizmit;

Banka e Shqipërisë:

Banka e Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të funksioneve si autoritet mbikëqyrës, për subjektet nën juridiksionin e saj, të kontrollojë zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

Ministria e Drejtësisë:

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet strukturave të saj, siguron bashkëpunimin e nevojshëm mes Prokurorisë, Interpolit dhe autoriteteve të huaja të drejtësisë në çështje që lidhen me luftën kundër krimit të organizuara po kundër terrorizmit dhe financimit të tij, në zbatim të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale".

2.3 Arritjet dhe mësimet

Në eksperiencën tonë të promovimit të vlerave të përbashkëta të paqes, dialogut, parandalimit të konflikteve, dhe luftës kundër terrorizmit, ka mbizotëruar ideja e "parandalimit" të dhunës dhe terrorizmit.

Ndaj në luftën tonë kundër terrorizmit, kemi mbështetur idenë e veprimit të gjithë bashkë, me një qasje gjithëpërfshirëse dhe të balancuar, në nivel global, rajonal dhe kombëtar.

Qeveria Shqiptare, e ka vlerësuar luftën kundër terrorizmit si një prioritet kombëtar, duke qenë ndër vendet e para që në zbatim të rezolutës 2178 (2014) ndërmori hapa konkretë të reflektuara në legjislacionin kombëtar. Duke ndryshuar Kodin e Procedurës Penale, u synua forcimi i aftësisë së adresimit të problemit të luftëtarëve të huaj terroristë, duke e konsideruar të paligjshme dhe të ndëshkueshme pjesëmarrjen, organizmin apo çdo nxitje për pjesëmarrje në veprime ushtarake të një vendi të huaj. Të vendosur për të arritur rezultate të prekshme dhe për të treguar progres real, janë marrë masa për rishikimin, forcimin dhe ndryshimin e mekanizmave aktualë të kontrollit të financimit të terrorizmit dhe ngrirjes së aseteve për individë dhe subjekte të përfshirë në aktivitet terrorist.

Bazuar në studimet dhe raportet e riskut, rezulton se kërcënimi real prej terrorizmit në Shqipëri është në nivel të ulët me përjashtim të disa rasteve kur niveli i kërcënimit është rritur në "mesatar". Shqipëria nuk ka regjistruar akte e viktima terroriste të mirëfillta por është prekur nga fenomeni i pjesëmarrjes së luftëtarëve terroristë, zhvendosur së bashku me familjet e tyre në zonat në konflikt. Aktualisht, evidentohen shtetas shqiptarë, kryesisht gra dhe fëmijë, të strehuar në qendrat e pritjes për t'u riatdhesuar.

Për Policinë e Shtetit parandalimi dhe lufta kundër terrorizmit mbetet një fushë kyçe për bashkëpunimin operacional dhe shkëmbimin e informacionit me shërbimet antiterror në vendet e rajonit, Itali, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni, me INTERPOL, EUROPOL, Qendrën Evropiane

Antiterrorizëm, Oficerët Ndërlidhës, Qendrën për Verifikimin e Terrorizmit (TSC-SHBA), agjencitë ligjzbatuese dhe shërbimet partnere në BE.

Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar të gjitha rezolutat, konventat dhe protokollet kundër terrorizmit, të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, dhe "Protokollin shtesë të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin e terrorizmit".

Shqipëria merr pjesë dhe përfaqësohet me kontribut konkrete në të gjitha aktivitetet, grupet e punës së Koalicionit Global D-ISIS dhe forumet e organizatave ndërkombëtare, ku vendet anëtare shkëmbejnë praktikat më të mira që lidhen me zbatimin e Strategjisë Globale të luftës kundër terrorizmit (UNGCTS) të OKB-së dhe Planin e Veprimit të Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm.

Shqipëria radhitet në ato vende që e kanë mbështetur fuqimisht GCTS-në dhe Planin e Veprimit, me bindjen se do të shërbente si një udhëzues i suksesshëm në përpjekjet tona të përbashkëta të luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Në zbatim edhe të kërkesave të këtij plan veprimi, edhe planet tona kombëtare, duhet të parashikojnë hapa konkrete në fusha prioritare, si:

- dialogu dhe parandalimi i konflikteve;
- forcimi i qeverisjes së mirë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe forcimit të shtetit ligjor;
- pjesëmarrja e të rinjve;
- barazia gjinore dhe forcimi i rolit të grave;
- komunikimi strategjik në internet dhe median sociale, etj.;

Shqipëria ka ofruar kontributin e saj në realizimin e Platformës Rajonale të luftës kundër Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm dhe fenomenit të Luftëtarëve të Huaj Terroristë, në Europën Juglindore, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC).

Strategjia e BE-së Kundër Terrorizmit dhe Plani i Përbashkët i Veprimit Kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor, nënshkruar nga BE dhe të gjithë partnerët e Ballkanit Perëndimor, në Tetor 2018, është dokumenti kryesor politik në këtë fushë.

Ky plan ka si objektiv shkëmbimin efektiv të informacionit dhe bashkëpunimin operacional mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe agjencive ligjzbatuese të BE.

Angazhimi kryesor i strukturave të luftës kundër terrorizmit në kuadër të prioriteteve të Qeverisë, mbetet zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia e BE-së kundër terrorizmit, si dhe nga Plani i Përbashkët i Veprimit kundër terrorizmit në Ballkanin Perëndimor.

Në këtë kuadër në 9 tetor 2019, midis Shqipërisë dhe KE, u firmos marrëveshja mbi veprimet parësore që do ndjekë Shqipëria gjatë viteve 2019 – 2020, për secilin nga pesë objektivat e përcaktuara në Planin e Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit në BP.

Për të siguruar përparimin në zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit, është parashikuar që të përmirësohet rregullisht kjo marrëveshje dhe të përfshijë veprime të mëtejshme parësore, të cilat do të jenë të nevojshme të zbatohen në kuadër të Planit të Përbashkët të Veprimit.

Strukturat e antiterrorit tashmë kanë kapacitetet operacionale, logjistikën e nevojshme për kryerjen e operacioneve speciale të cilat ndihmojnë në parandalimin dhe goditjen e veprave penale me karakter terrorist, por në këtë drejtim ka nevojë për investime dhe mbështetje të vazhdueshme në përshtatje me zhvillimit teknologjike dhe dinamikat e zhvillimit të kërcënimeve terroriste. Njëkohësisht po punohet për përsosjen e mëtejshme të këtyre kapaciteteve, në bashkëpunim me misionet policore të atashuara prej vitesh në vendin tonë, si: PAMECA V dhe ICITAP.

Në vazhdimësi janë kryer trajnime duke rritur kapacitetet e duhura profesionale dhe logjistike të të gjithë strukturave për të përballuar me sukses situatat e ndryshme që janë objekt i punës së tyre në fushën kundër terrorizmit.

Vendi ynë ka bërë analizën totale dhe nen për nen të legjislacionit për luftën kundër terrorizmit dhe po punon për përputhjen plotësisht të kuadrit ligjor për luftën kundër terrorizmit dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, me "*Acquis*" të BE-së.

Në funksion të strukturave antiterror është krijuar Njësia për Verifikimin e Terrorizmit dhe Sigurinë, e cila shërben për shkëmbimin e informacioneve me Qendrën Ndërkombëtare Kundër Terrorizmit (TSC) dhe me Qendrën Evropiane Kundër Terrorizmit (ECTC) në Europol, për verifikimin e shtetasve shqiptarë dhe të huaj të përfshirë/lidhur në veprimtari terroriste, si dhe njësia për Hetimin e Financimit të

Terrorizmit, bazuar kjo edhe në rekomandimet e bëra nga MONEYVAL.

Duke qenë se ashpërsimi i masave ligjore pengon por nuk eliminon fenomenin, çështja e ndalimit të pjesëmarrjes së qytetarëve shqiptarë në konflikte të huaja është synuar të trajtohet në rrënjët e problemit, që janë mungesa e kohezionit social, zhvillimi ekonomik, mangësitë në fushën e edukimit në zonat e thella rurale, të cilat përbëjnë shtysën dhe motivin për radikalizim.

Me rëndësi të theksohet se, masat e marra nga Shqipëria respektojnë parimet themelore të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht ato të lirisë së shprehjes dhe informacionit.

Për kriminalizimin dhe ndëshkimin e terrorizmit, strukturat e specializuara të luftës kundër terrorizmit, në vazhdimësi e kanë trajtuar e ndjekur fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë dhe janë zhvilluar hetime për individë organizatorë, financues dhe pjesëmarrës në konflikte jashtë vendit.

Krijimi dhe zhvillimi i një rrjeti rajonal të sigurisë, në funksion të forcimit të kapaciteteve të shkëmbimit të informacionit ndërmjet vendeve të rajonit për çështje që kanë të bëjmë me luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar janë konsideruar me shumë rëndësi.

Në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, zhvillimi i strategjive gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar, është thelbësor, jo vetëm për luftën kundër radikalizmit dhe rekrutimit, por edhe për të vlerësuar siç duhet dhe mundësinë e riintegrimit.

Duke synuar gjithnjë parandalimin, dhe bashkërendimin e përpjekjeve globale të luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, institucionet shqiptare e kanë mbështetur suksesin e veprimit në pasurinë e vlerave dhe traditave tona kombëtare e fetare dhe në hartimin e zbatimin e paketave të posaçme strategjike, sociale, politike, ligjore, edukative dhe ekonomike.

Për të mundësuar mbështetjen e viktimave të terrorizmit, në bashkëpunim me vendet partnere dhe agjencitë e inteligjencës, Shqipëria ka marrë masat e kontrollit të kufirit, pritjes dhe intervistimit të të kthyerve potencialë në pikat e kalimit në kufi, mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave me Interpol dhe partnerët strategjikë, për identifikimin në terren dhe kryerjen e procesit të riatdhesimit të tyre.

Aktualisht, veçanërisht në këtë kontekst, do të tregohet vëmendje e shtuar për të vënë në jetë politika efikase shtetërore, jo vetëm për hetimin dhe çuarjen përpara drejtësisë, por edhe për riatdhesimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e qytetarëve shqiptarë dhe familjarëve të tyre, që u bashkuan me kauzën e ISIL dhe kanë marrë pjesë në konfliktin në Siri.

Me zbatimin e masave e politikave të parandalimit të rrezikut terrorist, Shqipëria nuk është përballur me akte e viktima terroriste të mirëfillta, por si përmendur edhe më lart, me fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë, të shoqëruar edhe me gra e fëmijë, në zonat në konflikt në Siri/Irak, duke u përballur këta të fundit me tmerrin e luftës dhe humbjen e prindërve dhe të afërmve të tyre.

Përmes urdhrit nr. 169, datë 1.11.2018, të Kryeministrit, është hartuar një Plan Ndërinstitucional Veprimi "Për pritjen dhe trajtimin e shtetasve shqiptarë që kthehen nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak", ku për të gjitha institucionet shqiptare parashikohen detyra konkrete, për asistencë mjekësore, psikologjike, sociale, ekonomike, si dhe ngritjen e kapaciteteve logjistike e njerëzore për pritjen, shoqërimin, si dhe masat për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre.

Republika e Shqipërisë, përveç se është sfiduar me ekstremizmin me bazë radikale religjioze ballafaqohet edhe me forma tjera, siç janë ato me motive nacionaliste apo etnike për të arritur qëllime të caktuara politike. Si pasojë e indoktrinimit nga ideologjitë radikale/ekstremiste, qoftë ato nacionaliste apo fetare, një numër i caktuar i shtetasve shqiptarë kanë përfunduar në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, të rekrutuar në radhët e organizatave terroriste.

Ndër kërcënimet kryesore vazhdon të mbetet ekstremizmi me bazë radikale religjioze, si rezultat i indoktrinimit me ideologji radikale ekstremiste islamiste të importuara në Shqipëri nga rryma të ndryshme shkollimi të vendeve të Lindjes së Mesme. Pasojat nga këto ideologji tashmë janë evidente, duke filluar nga bashkimi i dhjetëra shtetasve Shqiptarë në zonat e konfliktit në radhët e organizatave terroriste. Disa prej tyre tashmë të vrarë, familje që vazhdojnë të mbesin në zonat e konfliktit, tendencë për përhapjen e ideologjive ekstremiste të dhunshme, krijimin e barrierave ndaj harmonisë dhe njëkohësisht pengesë e tolerancës

religjioze dhe pengesës të mos tolerancës, si dhe ajo që është më shqetësuese rritjen e kërcënimeve për sulme terroriste.

Ekstremizmi me bazë fetare në rajon, ka filluar të përhapet në vitet 90. Në Shqipëri ka filluar po në këtë periudhë përmes disa organizatave joqeveritare të ardhura nga vendet e Lindjes së Mesme me radikalizëm të theksuar. Këto organizata në programeve sociale dhe humanitare, duke përfituar nga ndjeshmëria e një pjese të popullatës në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, kanë përhapur doktrinat dhe ideologjitë radikale me bazë fetare, të bazuara në mostolerancë, ndarje, urrejtje, si dhe kundërshtim të sistemit dhe vlerave demokratike përmes promovimit të rrymave radikale të inspiruara nga religjionet e ndryshme, në veçanti ai me matricë islamiste.

Propaganda përmes internetit është shfrytëzuar në masë të madhe nga ekstremistët për përhapjen e ideologjive të tyre.

Pavarësisht kundërshtimit të vazhdueshëm dhe rezistencës ndaj këtyre ideologjive, pjesë të caktuara të shoqërisë që ishin më të cenueshme, të gjendur të ekspozuar ndaj këtyre ideologjive, kanë rënë viktimë e tyre duke vazhduar thellimin në ekstremizëm dhe radikalizëm.

Më tej prirjet globale në aspektin e ekstremizmit, si dhe fillimi i konflikteve në Lindje të Mesme, veçanërisht në Siri dhe Irak, ku u konsoliduan grupet dhe organizatat terroriste, është shfrytëzuar si moment për radikalizim të theksuar dhe këto konflikte u shndërruan në një fushë veprimi për luftëtarët e huaj terroristë (LHT) nga gjitha Evropa dhe më gjerë, duke përfshirë Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Shqipërisë.

Si rezultat i bashkimit të këtyre shtetasve shqiptarë në organizata terroriste janë shënuar edhe thirrje publike nga ana e tyre për sulme terroriste në Shqipëri dhe rajon, por edhe janë shënuar tentativa për kryerjen e akteve terroriste të parandaluara nga institucionet e sigurisë në Shqipëri.

Me gjithë faktin që organizatat terroriste janë duke humbur territor dhe kontroll në vatrat e krizës, në aspektin ideologjik ato vazhdojnë të kenë mbështetje dhe të shtrijnë ndikimin në vende tjera, duke përfshirë edhe rajonin tonë dhe më gjerë.

Rreziku me të cilin përballet Shqipëria janë personat e kthyer nga zona e konfliktit, si dhe personat e përfshirë në vepra penale të terrorizmit, me interes për ta dëmtuar Shqipërinë si një shtet me shoqëri me diversitet etnik dhe fetar dhe me një qeveri demokratike dhe shoqëri laike.

Siç është parë nga shembuj të shumtë në Evropë, individët e radikalizuar mund të kryejnë akte të dhunës ekstreme edhe ndaj popullsisë dhe institucioneve edhe në shtetin e tyre të origjinës, prandaj dhe rreziku që Shqipëria do të mund të jetë në shënjestër për një sulm të tillë terrorist nuk mund të përjashtohet.

2.3.1 Analiza e situatës

Republika e Shqipërisë si anëtare e koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit nga viti 2001 e në vazhdim, ka mbështetur aleatët dhe partnerët në luftën antiterror, e ka konsideruar luftën kundër terrorizmit si një prioritet kombëtar dhe për këtë qëllim ajo ka analizuar, hartuar e miratuar kuadrin e nevojshëm ligjor në përputhje me ACQUIS të BE, si dhe ka ngritur kapacitetet e nevojshme operacionale e logjistike për të parandaluar dhe luftuar çdo kërcënim ndaj sigurisë kombëtare e ndërkombëtare nga veprimtari terroriste.

Terrorizmi konsiderohet kërcënim nga të gjitha shtetet e rajonit e më gjerë. Vlerësohet se grupet terroriste ndërkombëtare nuk kanë mundur deri tani të shtrijnë rrjetet e tyre në Shqipëri, por vendi ynë mund të përdoret si strehë apo transit për grupe të tilla.

Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Terrorizmit 2016 – 2020, është vazhdim i Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit 2011 – 2015, si detyrim i vendit për përmbushjen e prioriteteve të përcaktuara për të luftuar terrorizmin me të gjitha format e shfaqjes së tij, si dhe nevoja e implementimit të objektivave që dilnin nga detyrimet ndërkombëtare të miratuara nga KS të OKB-së, Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit dhe Konventën Evropiane dhe Protokollin shtesë të saj për parandalimin e terrorizmit, ku adresohet edhe fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë (LHT).

2.3.2 Faktorët e riskut dhe kërcënimet nga terrorizmi në Shqipëri

Zhvillimet e kohëve të fundit, si ato në Lindjen e Mesme, në Afrikën e Veriut, sulmet e organizatave të terrorit ndërkombëtar të ISIS, Al Kaedës apo të tjerë, e kanë çuar në një nivel tërësisht të ri, sfidën kundër terrorizmit dhe financimit të terrorizmit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në Shqipëri nuk janë evidentuar grupe terroriste që zhvillojnë aktivitet brenda vendit apo më gjerë, por gjatë viteve 2012 – 2015, rreth 144 shtetas[4] shqiptarë shkuan në Siri dhe Irak për luftuar në konfliktet e armatosura në këto vende. Numri i këtyre luftëtarëve nga Shqipëria që largohen për të marrë pjesë në konfliktin në Siri dhe Irak ra në zero në fund të vitit 2015. Nuk përjashtohet mundësia e aktivizimit të tyre duke marrë në konsideratë zhvillimet aktuale në konfliktin sirian (humbja e territoreve dhe kontrollit të ISIL/DAESH).

Po sipas këtij raporti disa prej këtyre luftëtarëve rreth 45 janë kthyer në Shqipëri dhe në këtë kuadër sfidë përbën deradikalizimi dhe riintegrimi i luftëtarëve të huaj pas kthimit në atdhe. Për këtë arsye, qeveria shqiptare ka kërkuar dhe ka siguruar nga parlamenti ndryshimin e kodit penal (neni 265/a, b, c) mbi pjesëmarrjen e shtetasve shqiptarë në konflikte të armatosura në vende të tjera.

Rreziku i paraqitur prej luftëtarëve të rikthyer konsiston në lidhjet e tyre potenciale me ekstremistët në rajon apo Evropë, në lidhjet që mund të mbajnë me ekstremistët në zonat e konfliktit, në mundësinë e përdorimit të mediave sociale për thirrje për t'iu bashkuar luftimeve, në informacionin që disponojnë sesi mund të shkohet në Siri. Nga ana tjetër, personat e kthyer mund të konsiderohen të trajnuar dhe me eksperiencë në përdorimin e armëve dhe të eksplozivëve, duke rritur gjasat e aktivitetit terrorist brenda vendit, apo edhe në rajon.

Në vitin 2016 përfundoi gjykimi dhe u shpallën fajtorë 9 të pandehur, të akuzuar për "Rekrutim të personave për kryerjen e veprimeve terroriste". Ky grup personash ishte rasti i parë i hetimit dhe i gjykimit për rekrutimin e të ashtuquajturve "Luftëtarë të Huaj".

Në lidhje me këtë fenomen (shtetas shqiptar që kanë udhëtuar drejt vendeve të konfliktit nuk është evidentuar ndonjë zinxhir apo fluks financimesh, por mendohet se i kanë mbuluar vetë këto shpenzime.

Faktorët që mund të ndikojnë në rekrutimin e shtetasve shqiptarë drejt vendeve të konfliktit janë: situata aktuale në nivel ndërkombëtar e sipërpërmendur, niveli i ulët ekonomik, papunësia, varfëria, niveli i ulët arsimor, ndikimi i komuniteteve fetare jo zyrtare me tendencë radikale dhe përdorimit i mjeteve *online* të propagandës.

Shqipëria në historikun e saj nuk ka qenë objekt i akteve terroriste, por në nëntor të vitit 2016 një operacion i koordinuar rajonal kundër terrorizmit çoi në arrestimin e katër individëve në Shqipëri. Operacioni ndërpreu një sulm potencial për një ndeshje të futbollit për kualifikueset e Kupës së Botës nga Shqipëria dhe Izraeli, që u zhvillua në Shkodër. Gjithashtu, në vitin 2017 janë kryer pesë operacione të tjera, ku 12 të dyshuar janë arrestuar me akuza për vepra terroriste.

Si rrjedhojë e zhvillimeve ndërkombëtare, në Shqipëri janë futur koncepte të tilla si, radikalizimi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm, të cilat mund të përbejnë një kërcënim të mundshëm për akte terroriste.

Rrezikshmëria e radikalizimit dhe ekstremizmit me frymëzim ideologjik, fetar apo nacionalist konsiston pikërisht në faktin se ushqejnë veprimtaritë terroriste. Në ditët tona vëmendja kryesore është e fokusuar pikërisht në terrorizmin që shfrytëzon radikalizmin me bazë religjioze fetare.

Ndër metodat e radikalizimit dhe rekrutimit në vendin tonë përmendim propagandën nëpërmjet përdorimit të internetit, ligjëratës e predikimeve në ambiente jashtë juridiksionit të autoriteteve fetare të njohura në Republikën e Shqipërisë. Grupet më të targetuara mendohet të jenë moshat 20 – 35 vjeç. Nga një perspektivë gjeografike rezulton se fenomeni është përqendruar në qytetet Elbasan, Pogradec, Librazhd, Bulqizë, Cërrik, Kukës, Dibër dhe në zonat rurale që rrethojnë këto qytete.

Faktorët që kanë ndikuar mendohet të jenë: radikalizimi i hershëm, niveli i ulët arsimor dhe teologjik, probleme ekonomike dhe sociale, premtimet për dhënie ndihme financiare.

Për sa i përket faktorëve që kanë ndikuar ndjeshëm në minimizimin e rrezikut të përfshirjes së shtetasve të vendit tonë në fenomenet e radikalizmit/ekstremizmit
ekstremizmit/radikalizmit me matricë religjioze, janë toleranca reciproke dhe bashkëjetesa shekullore mes besimeve në vend, fakti se besimi fetar në vendin tonë ka një kuptim krejt perëndimor dhe nuk nënkuptohet si mënyrë jetese, fakti se dukshëm dominon identiteti kombëtar mbi atë fetar.

[4] Raporti i vitit 2018 i Komisionit Evropian.

Në kuadër të një sërë masash që Qeveria Shqiptare ndërmori për të trajtuar shfaqjen e ekstremizmit të dhunshëm te shtetasit shqiptarë që u bashkuan në radhët e organizatave ekstremiste në konfliktet në Lindjen e Mesme në korrik të vitit 2018 u bë funksionale Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

Kjo qendër u krijua pas miratimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, për koordinimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve kryesorë, në përpjekjet për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri dhe rajon.

Duke iu referuar publikimit të Komitetit të Helsinkit "Bashkë kundër Ekstremizmit Terrorizmit dhe Radikalizmit 2018", sipas një sondazhi të kryer nga Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtarë për sa i përket arsyeve të radikalizimit dhe ekstremizmit rezulton se 41.3% e pjesëmarrësve fajësojnë varfërinë ekstreme, 21.1% e lidhin me arsyet financiare, 10% me nivelin e ulët të arsimit dhe 12% fajësojnë vetë ideologjinë islamike radikale.

Disa nga faktorët të cilët mund të ndikojnë për shfaqjen e akteve terroriste janë:

- anëtarësimi në NATO dhe pjesëmarrja e R.SH në koalicionin global kundër terrorizmit;
- përfshirja nga viti 2012 i disa personave nga Shqipëria në konfliktin e armatosur Siri/Irak;
- pozita gjeostrategjike e vendit tonë dhe tensionet e konfliktet me bazë etnike në rajon;
- keqpërdorimi i lehtësive që krijon lëvizja e lirë e shtetasve;
- rreziku i depërtimit nëpërmjet imigrantëve legalë, të personave me tendenca terroriste, të larguar nga vendet në konflikt për të shkuar në Evropë;
- interneti, rrjetet sociale dhe teknologjia e përparuar, ndihmojnë në propagandimin dhe përhapjen e radikalizmit/ekstremizmit.

Ndër kërcënimet e mundshme me të cilat mund të ballafaqohet vendi ynë janë:

- sulmet terroriste qoftë nga pjesëtarët e organizatave terroriste përmes luftëtarëve të huaj terroristë, celulave të fjetura, por edhe nga simpatizantët dhe mbështetësit që mund të inspirohen për kryerjen e akteve të dhunshme;
- indoktrinimi me ideologji radikale/ekstremiste e bazuar kryesisht përmes propagandës në internet të cilat indoktrinojnë dhe rekrutojnë personat në moshë të re për t'i përdorur për qëllime të organizatave terroriste.
- kërcënimi nga terrorizmi kibernetik – sfidat që burojnë nga epoka kibernetike të cilat cenojnë elementët e sigurisë kombëtare;
- migracioni i parregullt - duke marrë parasysh pozitën gjeografike të vendit tonë e cila favorizon lëvizjet migratore shqetësim ngelet mundësia që luftëtarët e huaj terroristë nga vendet tjera të shfrytëzojnë kalimin tranzit, duke u përzierë edhe me emigrantët e parregullt me synim udhëtimin e tyre drejt vendeve të BE-së;
- prania në vendin tonë e shtetasve të huaj, pjesëtarë të organizatave të ndryshme të strehuara në Shqipëri për qëllime humanitare dhe që janë në konflikt me regjimet aktuale në vendet e origjinës;
- organizatat nacionaliste me baza etnike, të cilat janë të predispozuara që kohë pas kohe të përdorin dhunën, të provokojnë incidente ndëretnike, ndonjëherë edhe me mbështetjen e vendeve të treta për arritjen e qëllimeve politike;
- deradikalizimi dhe vështirësitë lidhur me riintegrimin e mundshëm mbeten sfidë për kundërshtimin e akteve ekstremiste që mund të çojnë në terrorizëm (VERLT).

Situata aktuale e ndjekjes penale të veprave me qëllime terroriste

Në një analizë mbi të dhëna statistikore e raportime të Prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, gjendja e hetimeve të veprave me qëllime terroriste në vitin 2019 dhe 9-mujorin 2020, është si më poshtë:

Vepra penale me qëllime terroriste	Viti 2019				9-mujori 2020		
	Nr. proc. regj.	Nr. proc. për gjykim	Nr. pand. dërg. gjykim		Nr. proc. regj.	Nr. proc. për gjykim	Nr. pand. dërg. gjykim
Neni 230, vepra me qëllime terroriste	3	0	0		3	0	0
Neni 230/a, financimi i terrorizmit	3	0	0		2	0	0
Neni 230/b, fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin	0	0	0		0	0	0
Neni 230/c, dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit	0	0	0		0	0	0
Neni 230/ç, kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur	0				0	0	0
Neni 231, rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit	0	0	0		1	0	0
Neni 232, stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	2	0	0		0	0	0
Neni 232/a, nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0		4	1	1
Neni 232/b, kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0		1	0	0
Neni 233, krijimi i turmave të armatosura	0	0	0		0	0	0
Neni 234, prodhimi i armëve luftarake	0	0	0		0	0	0
Neni 234/a, organizata terroriste	2	0	0		0	0	0
Neni 234/b, banda e armatosur	0	0	0		0	0	0

2.3.3 Dënimet

Nga raportet vjetore të Prokurorisë së Përgjithshme, për intervalin kohor 2015 – 2018, për veprat penale me qëllime terroriste, rezulton informacioni si më poshtë:

Veprat Penale me qëllime terroriste

	Veprat penale me qëllime terroriste	Neni 230 - Vepra me qëllime terroriste	Neni 230/a - Financimi i terrorizmit	Neni 230/b - Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin	Neni 230/c - Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës e profesionit	Neni 230/ç - Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur	Neni 231 - Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit	Neni 232 - Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	Neni 232/a - Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me ...	Neni 232/b - Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	Neni 233 - Krijimi i tufmave të armatosura	Neni 234 - Prodhimi i armëve luftarake	Neni 234/a - Organizata terroriste	Neni 234/b - Banda e armatosur	Totali
2015	Nr. proc. regj.	6	0	0	0	0	1	0	5	0	0	0	0	0	12
	Nr. proc. për gjykim	0	0	0	0	0	1	0	2	0	0	0	0	0	3
	Nr. pand. regj.	0	0	0	0	0	1	0	7	0	0	0	0	0	8
	Nr. pand. për gjykim	0	0	0	0	0	1	0	10	0	0	0	0	0	11
	Nr. pand. dënuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2016	Nr. proc. regj.	1	0	0	0	0	0	3	0	1	0	1	0	0	6
	Nr. proc. për gjykim	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
	Nr. pand. regj.	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
	Nr. pand. për gjykim	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
	Nr. pand. dënuar	0	1	0	0	0	9	0	0	0	0	0	0	0	10
2017	Nr. proc. regj.	1	3	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	6
	Nr. proc. për gjykim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. pand. regj.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. pand. për gjykim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. pand. dënuar	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
2018	Nr. proc. regj.	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
	Nr. proc. për gjykim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. pand. Regj.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. pand. për gjykim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. pand. dënuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Siç vihet re edhe nga sa më sipër, për periudhën 2015 – 2018, rezultojnë 11 persona të dënuar për kategorinë e veprave të mësipërme, nga të cilët 10 persona për veprën penale të parashikuar nga neni 231, i Kodit Penal, "Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit". Në total këta individë janë dënuar me 126 vjet burg, ku dënimet për secilin prej tyre varion 7 – 18 vjet. Ndërkohë rezulton vetëm një i dënuar për veprën penale të "Financimit të terrorizmit".

2.3.4 Masat e marra në luftën kundër terrorizmit

Gjatë implementimit të strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2016 – 2020, janë ndërmarrë masa të rëndësishme në kuadrin ligjor, institucional dhe të ngritjes së kapaciteteve.

Reagimi i Shqipërisë ndaj rrezikut për akte terroriste apo financimin e tij deri tani ka qenë nëpërmjet masave, si më poshtë:

- ndryshimet ligjore me ligjin nr. 144/2013 dhe ligjin nr. 98/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, 'Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë'", ku përveç nenit 265, të Kodit Penal, "Nxitja e urrejtjes ose grindjeve", u shtuan nenet 265/a, 265/b dhe 265/c përkatësisht: "Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj", "Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj", "Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj";

- kalimi i veprës penale "Financim i terrorizmit", si objekt i punës së Drejtorisë së Antiterrorit dhe ngritja e Njësisë për Hetimin e Financimit të Terrorizmit, në përbërje të kësaj drejtorie, në zbatim të rekomandimeve të MONEYVAL, të KE-së;

- hartimi dhe miratimi i "Strategjisë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020", miratuar me VKM-në nr. 930, datë 18.11.2015;

- hartimi i "Strategjisë së Sigurisë Kombëtare", me VKM-në nr. 930, datë 18.11.2015, e cila përfshin një sërë veprimesh, që synojnë:

a) zgjerimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor shqiptar për përcaktimin si vepër penale të të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe të rekrutimit të luftëtarëve të huaj terroristë;

b) forcimin e kapaciteteve dhe ekspertizës së zyrtarëve të zbatimit të ligjit, për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm;

c) nxitjen e institucioneve shtetërore për t'ua angazhuar me bashkësitë vendore, përfaqësuesit fetarë dhe aktorë të tjerë, me qëllim identifikimin e grupeve në nevojë, që janë apo mund të bëhen shënjestër e ekstremizmit të dhunshëm;

d) identifikimin dhe kuptimin e shqetësimeve sociale të komuniteteve lokale, në mënyrë që të bëhet i mundur trajtimi i shkaqeve rrënjësore të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;

e) hartimi i programeve dhe politikave specifike të përshtatura, për të parandaluar përhapjen e dhunës dhe ekstremizmit dhe njëkohësisht, për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë mbi këto dukuri;

- miratimi i "Strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013 – 2020" dhe Planit të Veprimit për vitet 2013 – 2016, me VKM-në nr. 663, datë 17.7.2013, strategji e cila synon të zhvillojë politikat e duhura për të përmirësuar më tej standardet e sigurisë në vend, nëpërmjet:

- rritjes së efikasitet të standardeve të menaxhimit të personelit në çdo agjenci apo strukturë;

- rritjes dhe forcimit të masave në drejtim të parandalimit të akteve terroriste dhe ekstremizmit;

- rritjes së kapaciteteve operacionale dhe goditjes së krimit të organizuar bazuar në vlerësimin e kërcënimeve dhe hetimeve proaktive;

- rritjes së bashkëpunimit me strukturat e brendshme dhe partnerët rajonale të BE-së, si dhe institucionet relevante të sistemit të Kombeve të Bashkuara për luftën ndaj krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme, krimit financiar dhe korrupsionit;

- rritjes së kapaciteteve investiguese dhe orientimin e këtyre strukturave drejt inteligjencës;

- krijimi i "Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)", si institucion në varësi të Kryeministrisë;

- një vit më vonë nga hartimi i VKM-së nr. 930, datë 18.11.2015 u emërua Koordinatori Kombëtar Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (KEDH), me qëllim bashkërendimin e zbatimit të strategjisë kombëtare. Pothuajse dy vjet më vonë (VKM 737, dhjetor 2018), Zyra Kombëtare e Koordinatorit të KEDH-së u shndërrua në Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH e

njohur edhe si qendra CVE) si agjenci në varësi të Kryeministrisë;

- qëllimet e Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm janë:

a) forcimi i koordinimit, bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërmjet agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, sektorit privat, komuniteteve fetare dhe mediave, në identifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve efektive;

b) inkurajimi i hulumtimit vendor si mjet për të kuptuar kushtet, faktorët dhe shkaqet që nxisin radikalizimin, që mund të kalojë në dhunë dhe qëndresën e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm;

c) forcimi i qëndresës së komunitetit dhe zvogëlimi i tërheqjes ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet programeve dhe politikave të arsimit, punësimit dhe parandalimit nga policia në komunitet;

d) ulja e ndikimit të propagandës ekstremiste në rrjetet sociale dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar mediat sociale si kanale të komunikimit për të promovuar narrativa alternative dhe mesazhe pozitive;

- në kuadër të procesit të riatdhesimit të shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, miratuar me VKM-n nr. 826, datë 26.10.2020, qendra CVE ka për detyrim koordinimin ndërinstitucional me partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë, mbështetjen e institucioneve vendase, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të të gjithë procesit;

- kryerja e disa hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta ndërkombëtare të cilat janë finalizuar me ndalimin, arrestimin dhe dënimin e individëve të dyshuar për veprimtaritë ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit;

- Anëtarësimi i strukturave të Policisë së Shtetit në pikat fokale "HYDRA", "DOLPHIN" dhe "TRAVELLERS";

- rritja e bashkëpunimit në nivel operacional dhe në shkëmbimin e shpejtë të informacionit midis strukturave ligjzbatuese në vend;

- monitorimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, të individëve shtetas shqiptarë dhe të huaj, të dyshuar për përfshirje në konfliktin e armatosur jashtë vendit, në bashkëpunim me shërbimet partnere të huaja dhe agjencitë inteligjente e ligjzbatuese në vend, si SHISH, Prokuroria e Përgjithshme dhe të Rretheve Gjyqësore, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, AISM, etj.;

- përfshirja e 18 individëve nga Shqipëria, të dyshuar për veprimtari kriminale në fushën e terrorizmit, në "Lista e brendshme e personave të shpallur", me VKM, bazuar në ligjin nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit";

- implementimi nga Policia e Shtetit e programit "Kundër ekstremizmit të dhunshëm përmes policimit në komunitet";

- hartimi dhe implementimi nga institucionet përgjegjëse i Planit dhe Planit Shtesë të Veprimit Ndëristitucional, "Për pritjen dhe riintegrimin e shtetasve që pritet të kthehen nga vendet e konfliktit Siri-Irak", miratuar me urdhër të Kryeministrit nr. 169, datë 1.11.2018, dhe nr. 148, datë 5.11.2019;

- në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit midis qeverive të Shqipërisë dhe SHBA për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit, si dhe Protokollit Operacional është krijuar dhe funksionon Njësia për Verifikimin e Terrorizmit dhe Sigurinë në Drejtorinë e Antiterrorit, e cila shërben si kanal komunikimi me Qendrën për Verifikimin e Terrorizmit (TSC– *Terrorist Screening Center*), në SHBA, në lidhje me shkëmbimin e informacioneve për shtetas shqiptarë dhe të huaj të dyshuar për terrorizëm;

- vendi ynë së fundmi ka aprovuar Strategjinë për Mbrojtje Kibernetike 2018-2020 qëllimi i të cilës është mbajtja e një hapësire kibernetike të besueshme e të sigurt, strategji e cila shtrin efektet edhe në parandalimin e terrorizmit kibernetik;

- aplikimi i programit për "Shkollat për Komunitete më të Sigurt" me qëllim edukimin e mësuesve në të gjithë Shqipërinë për rreziqet e radikalizimit të dhunës në mesin e të rinjve;

- nënshkrimi, implementimi dhe zbatimi i disa marrëveshjeve e protokolleve të bashkëpunimit me disa vende të rajonit, Evropës dhe SHBA–së, në fushën e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit (aktualisht 21 marrëveshje e protokolle bashkëpunimi);

- ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 parashikuan krijimin e një gjykate të posaçme penale dhe një prokurorie të posaçme, me kompetencë lëndore sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës. Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar, në nenin 75/a të tij, detajon

kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke përcaktuar kompetencën për kategori të caktuara të veprave penale dhe kompetencën për kategori të caktuara subjektesh. Sa më sipër, veprat penale me qëllime terroriste që ishin në kompetencë të gjykatës për krime të rënda, nuk përfshihen në kompetencë të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, por gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për pasojë edhe kompetenca në hetim e tyre i takon prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në shkronjën "b", të nenit 75/a, përcaktohet se përfshihen në kompetencën e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal. Si rrjedhim, kompetenca lëndore e hetimit të veprave me qëllime terroriste, me krijimin e Prokurorisë së Posaçme, i përket gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa çdo vepër penale e kryer nga organizata terroriste (një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste), sipas përcaktimeve të Kodit Penal, është në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme. Në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, të cilat janë pjesërisht në kompetencë të gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe pjesërisht në kompetencë të gjykatave të zakonshme dhe kur rezulton se subjekt i procedimit është një organizatë terroriste, në bazë të nenit 80, të Kodit të Procedurës Penale, kompetente do të jetë gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këto kushte ishte e nevojshme ekzistenca e një qasje të unifikuar e në përputhje me parimet ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit, në ushtrimin e ndjekjes penale në gjithë sistemin e prokurorisë. Në zbatim të sa më lart u krijua edhe rrjeti antiterrorizëm në prokurori. Me udhëzimin e përgjithshëm nr. 10, datë 17.7.2020, "Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm" të Prokurorit të Përgjithshëm, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë në rrethet Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë dhe Korçë, janë krijuar seksionet e posaçme kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimeve pasurore. Kurse në prokuroritë ku nuk është i mundur krijimi i seksionit është caktuar një prokuror për të ndjekur këtë grup veprash penale. Gjithashtu, janë caktuar pikat e kontaktit në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme, për koordinimin, monitorimin dhe shkëmbimin e informacionit. Nga prokurorët pikë kontakti realizohet shkëmbimi i informacionit brenda sistemit të prokurorisë dhe me institucionet. Këto seksione janë krijuar ndër të tjera edhe në përmbushje të rekomandimeve të KSA (14 nëntor 2019) sipas të cilave Shqipëria do të ndjekë përpjekjet për të kryer hetime paralele për financimin e terrorizmit, që do të thotë hetim pasuror krahas hetimit të veprës penale. Në veprat penale që do hetohen nga këto seksione bëjnë pjesë edhe veprat penale të parashikuara nga nenet 230/a, "Financimi i terrorizmit" dhe 230/b, "Fshehja e fondeve dhe pasurive të tjera që financojnë terrorizmin". Hartimi i këtij udhëzimi të përgjithshëm është realizuar mbi bazë të legjislacionit shqiptar, në përqasje me rekomandimet dhe standardet evropiane, si dhe Memorandumin e Bashkëpunimit nr. 1079, datë 15.7.2020, mes palëve Prokurori i Përgjithshëm, Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme.

Prioritet i Prokurorisë në luftën kundër terrorizmit është goditja në të gjitha format e shfaqjes së tij dhe përmbushja e këtij angazhimi ka në fokus rritjen e cilësisë së hetimit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë e specializuara në këtë fushë, si dhe orientimi drejt një politike të ashpër dënimi.

Kjo është e lidhur ngushtësisht me forcimin e kapaciteteve për hetimin e veprave penale që lidhen me terrorizmin nëpërmjet përmirësimit të teknologjisë dhe trajnimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore që hetojnë këto vepra. Ndjekja e praktikave më të mira të luftës kundër terrorizmit, si dhe analizimi i legjislacionit shqiptar, duhet të përbëjnë bazën për procesin e trajnimit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të ngarkuar për hetimin e veprave penale që lidhen me terrorizmin.

2.3.5 Financimi i terrorizmit

Faktorët që ndikojnë në cenueshmëri (dobësi) të sistemit dhe që mund të shfrytëzohen apo mund të lehtësojnë veprimtarinë e terroristëve:

1. Pozicioni gjeostrategjik i Shqipërisë (flukse të mëdha të qarkullimit të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve ndërkombëtare), krijon kushte që vendi të synohet jo vetëm si një pikë transiti i mundshëm për trafiqet dhe aktivitetet e paligjshme, por edhe për përhapjen e sindromës së terrorizmit, veçanërisht atij me baza fondamentaliste;

2. Prania e individëve dhe grupeve që mbështesin ose promovojnë ekstremizmin e dhunshëm.

Në vendin tonë ka të dhëna për ekzistencën e mbështetësve të veçantë të ideologjive radikale. Nuk janë evidentuar figura drejtuese në radhët e mbështetësve dhe nuk operojnë në formë të mirëorganizuar por veprimtaria zhvillohet nga grupime të fragmentizuara që zhvillojnë aktivitet të pakoordinuar me njëri tjetrin;

3. Vështirësitë në kontrollet e kufijve

Mbetet problem niveli i ulët i deklarimeve në kufi. Edhe gjatë 2015 – 2018, ndër të tjera, është venë re se:

- paraja fizike ka një përdorim të lartë, mirëpo deklarimet në kufi janë ende të ulëta dhe në pika të veçuara kufitare,
- disporporcion midis numrit të deklarimeve në hyrje (numër i vogël) dhe deklarimeve në dalje;
- rastet sporadike të dedektimit të mosdeklarimit, ndështkimi në nivel të ulët dhe mos konfiskimi i shumave.

Edhe nga një analizë sektoriale e kryer nga DPPPP-ja, për periudhën janar – tetor 2016, vihet re se situata është e njëjtë.

Fluksi i madh e pasagjerëve dhe automjeteve sidomos gjatë sezonit të pushimeve, shton mundësinë për kalim të sasive të parasë fizike të padeklaruar.

4. Përdorimi i gjerë i parasë fizike

Ekzistenca e një ekonomie ku përdorimi i parasë fizike është i lartë, krijon mjaft avantazhe për personat e përfshirë në veprimtari kriminale duke siguruar anonimitet dhe mundësinë për të mos lënë gjurmë.

5. Përdorimi i mjeteve të reja të komunikimit për propagandë

Hapësira kibernetike, të cilën çdo njeri mund ta përdorë pa kufij kohorë dhe gjeografikë, jep në mënyrë të padiskutuar avantazhe dhe mundësi për hakerat. Propaganda terroriste vazhdimisht po zhvendoset në platforma të reja dhe të ndryshme dhe sasia e informacionit të shkëmbyer, qoftë publikisht apo në hapësira private, po rritet.

Në funksion të rekrutimit të anëtarëve të rinj kërkohen fonde, që më pas shfrytëzohen duke përdorur rrjetet sociale, të cilat përveç rekrutimit shërbejnë dhe si një instrument efikas propagande dhe mbledhje fondesh. Përdorimi i internetit siguron një mekanizëm me kostoja të ulët në fazat fillestare të rekrutimit ndërkohë që për hapat e mëtejshëm ka kostoja shtesë. Shfrytëzimi i mediave sociale për qëllime të rekrutimit dhe propagandës terroriste, është bërë një çështje prioritare për luftën kundër financimit të terrorizmit, pasi shumë organizata terroriste kanë shfrytëzuar mediat sociale për të siguruar fonde nga mbështetësit. Organizatat terroriste më komplekse, investojnë fonde të konsiderueshme në drejtim të operacioneve të sofistikuara propagandistike, që përfshijnë botimin e revistave dhe gazetave, administrimin e faqeve të internetit dhe përdorimin e programeve audio-vizive për të promovuar mesazhet dhe pikëpamjet e tyre.

Sektorët financiarë më vulnerabël

Duke marrë në konsideratë madhësinë dhe llojshmërinë e produkteve që ofrojnë, sektorët më vulnerabël për sa i përket financimit të terrorizmit, janë sektori bankar dhe ai i subjekteve financiare jobankë për shërbimin e transfertës së parave.

Fluksi i lartë i transaksioneve, fakti se transaksionet për financim terrorizimi mund të jenë në vlera të vogla, prania e transfertave me vende të cilësuara me risk, përbën një sfidë kyçe për bankat dhe subjekteve financiare jobankë për shërbimin e transfertës së parave në drejtim të monitorimit dhe identifikimit të aktivitetit të dyshimtë. Në veçanti, numri i transaksioneve ndërkombëtare krijon mundësi për keqpërdorim, sidomos kur origjina apo rruga e këtyre fondeve nuk është zbuluar plotësisht. Risku i mundshëm për financim të terrorizmit (FT) i lidhur me transaksione të tilla ndërkombëtare rritet kur fondet vijnë nga juridiksione të cilat mund të kenë rregullime dhe kontrolle jo adekuate të AML/FT.

Bankat ofrojnë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh me karakteristika që rrisin rrezikun e FT. Si p.sh:

- mundësi për kryerje pagesash *online*. Duke iu referuar sistemit bankar në vendin tonë nga 12 banka, 11 prej tyre ofrojnë shërbimin e *e-banking*;

- mundësia e përdorimit të kartave të kredit/debitit qoftë edhe nga individë të tretë (jo nga mbajtësi i kartës). Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, në vitin 2018, numri i kartave (*Visa*, *Mastercard*, etj.) është 1,128,026, numër ky i lartë krahasuar me numrin e popullsisë[5].

Për sa i përket SFJB për shërbimin e transfertës së parave, vulnerabiliteti i tyre qëndron pikërisht në faktin se këto shërbime kanë një shtrirje të gjerë gjeografike dhe ofrojnë lehtësi në përdorimin e tyre. Gjithashtu, volumi i lartë i transfertave (edhe pse në vlera të vogla) që ekzekutojnë dhe përdorimi i parasë fizike përbën një dobësi të rëndësishme për shoqëritë e transfertave.

Në vendin tonë është vënë re një rritje e numrit të agjentëve që ofrojnë këtë shërbim, kështu rezulton se në vitin 2018 kemi një rritje me 172 agjenci, që nga viti 2013.

Fluksi i transfertave të kryera nga subjektet financiare jo-bankë për shërbimin e transfertës së parave që operojnë në vendin tonë gjatë 2017 – 2018 është përafërsisht 4,440,000 transferta, nga të cilat 3,500,000 transferta janë në hyrje (në një vlerë prej 120,000 mln lekë) dhe 940,000 transferta në dalje (19,000 mln lekë).

Gjithashtu, ndryshe nga sistemi bankar ku vendoset një marrëdhënie e qëndrueshme me klientin, nuk mund të themi të njëjtët gjë për SFJB për shërbimin e transfertës së parave.

Listimi i brendshëm

Një nga ligjet me karakter administrativ në bazë të së cilit funksionon dhe ushtron detyrat DPPPP është ligji nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", i cili ka si objektiv kryesor bllokimin dhe sekuestrimin e fondeve/pasurive, nëpërmjet parandalimit dhe goditjes së veprimtarive të terroristëve dhe e atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin apo të atyre, për të cilët ka dyshime që kanë kryer, po kryejnë ose kanë qëllim/tentojnë të kryejnë veprimtari të tillë.

Për të kryer këtë detyrim, në ligj parashikohen dy mënyra listimi (nenet 14 dhe 15) sipas të cilave, në mënyrë të shkurtuar:

- e para, ka lidhje me miratimin me VKM të listave të personave të shpallur bazuar në vendimet/rezolutat detyruese të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, proces i cili tashmë kryhet në vendin tonë.

- e dyta, ka lidhje me procedurën e brendshme të shpalljes, e pavarur nga e para, sipas të cilës listimi bëhet me indicie të brendshme nga institucione të mirë përcaktuara6, bazuar në parimet dhe/ose detyrimet:

- e Rezolutës 1373 (2001)7 të Këshillit të Sigurimit (KS) të Kombeve të Bashkuara,

- të çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë apo të vendimeve të BE apo vendimit të një shteti tjetër, që lidhen me luftën kundër terrorizmit dhe financimit të tij.

Procedura e dytë, pra shpallja e brendshme, e cila nuk ka lidhje me të parën, është thelbi i sistemit parandalues pasi parashikon detektimin proaktiv, shpalljen dhe njoftimin e KS të OKB dhe është e

[5] Konkretisht në 1 janar 2018, popullsia e Shqipërisë rezulton të jetë 2, 870, 324 banorë.

[6] Neni 15. Procedura e brendshme e shpalljes

Organet përgjegjëse, organet e zbatimit të ligjit, shërbimet informative, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave që, gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre, kanë marrë dijeni ose kanë dyshime të bazuara në indicie për përfshirje personash, në çdo formë, në vepra të terrorizmit dhe të financimit të tij, të kryera apo që tentohet të kryhen, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara t'i propozojnë menjëherë ministrit të Financave përfshirjen e tyre në listën e personave të shpallur, si dhe marrjen e masave të parashikuara në këtë ligj.

Për shqyrtimin e rasteve të propozuara, sipas pikës 1 të këtij neni, dhe ato të parashikuara në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji, ministri i Financave mund të thërrasë një komitet të posaçëm këshillimor, me përfaqësues në nivel të lartë drejtues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi Informativ i Shtetit, Banka e Shqipërisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Ministri i Financave mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave përfshirjen e personave të propozuar sipas pikës 1 të këtij neni, në listën e personave të shpallur.

Këshilli i Ministrave, brenda 15 ditëve nga marrja e propozimit nga ministri i Financave, mund të vendosë për përfshirjen e personave apo subjekteve të propozuara nga ministri i Financave, sipas pikës 3 të këtij neni, në listën e personave të shpallur.

[7] Rezolutë bazë me karakter të përgjithshëm e cila ju bën thirrje shteteve që të bashkëpunojnë, detektojnë dhe të bëjnë propozime për listim në KS të OKB-së për personat e dyshuar si terrorist/financues etj.

pandikuar nga procedimi i mundshëm penal apo pasuror8.

Gjatë viteve 2015 – 2018, në zbatimin e detyrimit për propozim për listim sipas procedurës së brendshëm janë listuar si persona të shpallur 20 individë. Nga viti 2018 e në vijim nuk rezultojnë që nëpërmjet kësaj procedure të jenë shpallura subjekte të tjera.

Tab. 17: Lista me personat e shpallur

Viti 2015[9]	Viti 2016[10]	Viti 2017[11]	Viti 2018
2 individë të shpallur	13 individë të shpallur	5 individë të shpallur	-

Në vitet 2015 – 2017, nga 20 individë të shpallur, 2 individë janë përfshirë në listën e brendshme në bazë të propozimit të një institucioni të huaj dhe pjesa tjetër në bazë të propozimeve të institucioneve vendase.

Raportet e Aktivitetit të Dyshimtë (RAD) për financim të terrorizmit (FT)

DPPPP si njësi e inteligjencës financiare ka si detyrë thelbësorë mbledhjen e rasteve të dyshimta/sinjalizimet, analizimin e tyre, sigurimin e të dhënave shtesë kur duhen dhe referimin e këtyre rasteve në agjencitë e zbatimit të ligjit dhe në Shërbimin Informativ të Shtetit (SHISH). Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me raportet e aktivitetit të dyshimte të dërguar në DPPPP nga subjektet raportuese dhe rastet e referuara.

Tab. 18: RAD të dërguar në DPPPP nga subjektet raportuese dhe rastet e referuara nga DPPPP-ja

Viti	Nr. i RAD me dyshime për FT	Nr. i referimeve me dyshime për FT
2015	6	2
2016	29	8
2017	12	5
2018	2	2
2019	5	4
Totali	54	21

Duke iu referuar tabelës së mësipërme rastet kur subjektet raportuese kanë dyshuar për financim terrorizmi janë të pakta në numër.

RAD me këto tipologji kryesisht janë dërguar nga subjektet banka (57%) dhe nga subjektet financiare jobankë për shërbimin e transfertës së parave (38%).

Pas analizimit të rasteve të dërguara, DPPPP gjatë 2015 – 2019 ka referuar në total 21 raste. Megjithëse pas analizimit të mirëfilltë që DPPPP ka bërë ndaj RAD-ve dhe mbledhjes së të dhënave shtesë për to, kryesisht nuk kanë rezultuar dyshime për FT.

Tab. 19: Nr. i referimeve të dërguara nga DPPSH për kategorinë e veprave penale në fushën e terrorizmit

Viti	Nr. i referimeve
2018	5 raste
2019 (3 M)	3 raste

2.3.6 Të dhëna nga raporte ndërkombëtare për situatën e Shqipërisë në lidhje me terrorizmin

Më poshtë paraqitën disa të dhëna të marra kryesisht në burime të hapura, në lidhje me vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare për luftën kundër terrorizmit në vendin tonë.

Sipas raportit të Komisionit Evropian të vitit 2018[12] rezulton se:

- Shqipëria ka një kuadër gjithëpërfshirës ligjor për parandalimin dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
- që nga viti 2015, Shqipëria ka një strategji kombëtare për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm (CVE), me fokus në shtrirjen e komunitetit, policimin, arsimin dhe kundërshtimin e propagandës ekstremiste;
- drejtoria kundër terrorizmit ka përmirësuar kapacitetin e saj përmes trajnimeve, personelit dhe pajisjeve të specializuara shtesë. Sidoqoftë, kapaciteti i saj operativ dhe logjistik mbetet i kufizuar, sidomos për hetime dhe operacione të veçanta siç janë mbikëqyrja dhe përgjimet;
- bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i informacionit me partnerët ndërkombëtarë është i kënaqshëm;
- përmbajtja e radikalizimit *online* në shqip është në rritje.

[8] Neni 26, "Procedimi penal dhe pasuror". "Pavarësisht nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, prokuroria dhe gjykata, në zbatim të dispozitave procedurale penale apo atyre të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", mund të procedojnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e fondeve dhe të pasurive të tjera të bllokuara përkohësisht ose të sekuestruara, në zbatim të këtij ligji".

[9] VKM-ja nr. 589, datë 1.7.2015.

[10] VKM-ja nr. 769, datë 2.11.2016.

[11] VKM-ja nr. 228, datë 21.3.2017.

[12] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf.

Më datë 26 mars 2020, Këshilli i BE-së vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë, duke marrë parasysh progresin e arritur mbi reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara mbështetur dhe në raportin e përditësuar të Komisionit, mars 2020 i cili vlerëson dukshëm progresin e bërë nga Shqipëria.

Progresraporti më i fundit i Komisionit Evropian, i cili u publikua më datë 6 tetor 2020, ka evidentuar rezultate të dukshme në luftën kundër krimit të organizuar. Raporti citon se:

"Rezultate të prekshme janë arritur në luftën kundër krimit të organizuar, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe në zbatimin e Planit të Veprimit për adresimin e kërkesave të FATF. Operacionet policore për shkatërrimin e grupeve kriminale janë intensifikuar më tej. Shqipëria ka vazhduar të tregojë angazhim të fortë për të shkatërruar edhe trafikimin e drogës. Shqipëria lejoi monitorimin ajror nga një shtet anëtar i BE-së (mbikëqyrje ajrore nga *Guardia di Finanza* Italiane, bashkëfinancuar nga BE-ja). Bashkëpunimi policor me Shtetet Anëtare të BE dhe Europol u intensifikua më tej, duke çuar në një numër të konsiderueshëm të operacioneve të suksesshme dhe arrestimin e drejtuesve të grupeve të organizuara kriminale. Bashkëpunimi midis policisë dhe prokurorëve u intensifikua më tej".

Vlerësime janë bërë dhe në fushën e migracionit dhe terrorizimit[13], ku evidentohet se:

"Është bërë progres në përmirësimin e kapacitetit institucional në menaxhimin e kufirit, azilit, luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmin e dhunshëm. Shqipëria është i vetmi vend në rajon që ka vendosur marrëveshje pune me të gjitha agjencitë e BE-së për drejtësinë dhe punët e brendshme. Kapaciteti i pritjes për t'u marrë me flukset e migracionit u përmirësua më tej dhe mbeti i mjaftueshëm për të akomoduar numrin e rritur të hyrjeve".

Sipas raporteve të viteve 2017 – 2018[14], të DASH-it:

- Shqipëria ishte një mbështetëse e fortë e përpjekjeve kundër terrorizmit në 2017 dhe vazhdoi pjesëmarrjen e saj në Aleancën Globale për të mposhtur ISIS-in;

- Shqipëria penalizon veprimet terroriste, financimin e terrorizmit, kryerjen e transaksioneve me personat në listat e sanksioneve të Kombeve të Bashkuara (UN), rekrutimin dhe trajnimin e njerëzve për kryerjen e veprimeve terroriste, nxitjen e akteve terroriste, krijimin dhe pjesëmarrje në organizata terroriste;

- zbatimi i ligjit në Shqipëri ka rritur përpjekjet për të luftuar kërcënimet e mundshme terroriste;

- Shqipëria vazhdoi të punojë me FATF dhe MONEYVAL për të adresuar dobësitë e identifikuara në pastrimin e parave/luftën kundër financimit të regjimit të terrorizmit;

- qeveria e Shqipërisë zbatoi një program për "Shkollat për Komunitete më të Sigurta" me qëllim edukimin e mësuesve në të gjithë Shqipërinë për rreziqet e radikalizimit të dhunës në mesin e të rinjve;

- Shqipëria është anëtare e OKB-së, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal për Evropën Juglindore, Këshilli i Evropës dhe Organizata e Bashkëpunimit Islamik;

- Shqipëria ka kontribuar në sigurinë rajonale dhe globale. Shqipëria ka siguruar trupa ushtarake për aksionet e udhëhequra nga SHBA në Afganistan dhe Irak dhe ka mbështetur përpjekjet amerikane kundër terrorizmit duke kontribuar në Koalicionin Global për të luftuar ISIL-in.

Departamenti Amerikan i Shtetit në raportin e tij vjetor në lidhje me terrorizmin në botë vlerëson suksesin e arritur nga SHBA dhe aleatët e tij për sa i përket shkatërrimit të të ashtuquajturit Kalifat të ISIS në Irak dhe Siri. Për sa i përket Shqipërisë, në raportin e Departamentit të Shtetit thuhet se kërcënim kryesor mbeten luftëtarët e ISIS që kthehen në vend, komplotet e Iranit ndaj MEK, si dhe radikalizimi i të rinjve.

"Kërcënimi nga terrorizmi në Shqipëri konsiston te luftëtarët të huaj që kthehen nga Iraku dhe Siria, radikalizimi nga terrorizmi i të rinjve shqiptarë dhe komplotet e Iranit kundër grupit opozitar *Mujahedeen-e-Khalq* (MEK), anëtarë të të cilit strehohen në Shqipëri…"

Departamenti i Shtetit vlerëson se në 2019, Shqipëria plotësoi kuadrin legjislativ për të adresuar shqetësimet lidhur me "efektivitetin e ulët" në drejtim të konfiskimit, hetimit dhe ndjekjen ligjore për financat nga terrorizmi dhe sanksionet

[13] Progresraporti i Komisionit Evropian 2019, f. 31-32.
[14] https://www.state.gov/r/pa/ei/bgn/3235.htm.

financiare (të ngritura nga Komisioni i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave).

Sipas raportit të vitit 2017, të EUROPOL-it, për situatën e terrorizmit:

- Në disa pjesë të rajonit të Ballkanit Perëndimor, ideologjia radikale islamike e promovuar nga predikuesit radikalë dhe/ose udhëheqësit e disa grupeve selafist, duke sfiduar dominimin tradicional të islamit të moderuar në rajon, ka fituar terren të konsiderueshëm. Bosnja dhe Hercegovina, e ashtuquajtura rajoni i Sanxhakut (me Serbinë dhe Malin e Zi), territoret shqipfolëse në Serbi, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Kosovë dhe në Shqipëri, kohët e fundit u konsideruan si pikat kryesore të radikalizmit, rekrutimit dhe aktiviteteve lehtësuese të FTF-ve të destinuara për Sirinë.

Në nëntor të vitit 2016, autoritetet kompetente të Shqipërisë, Kosovës dhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut penguan shfaqjen e dy sulmeve terroriste të planifikuara për t'u kryer në territorin e tyre, me 19 arrestime në Kosovë dhe gjashtë në Shqipëri dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sipas raportit të EUROPOL-it[15] për terrorizmin në vitin 2020:

"Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Veriu Maqedonia dhe Serbia nuk raportuan sulme terroriste xhihadiste në vitin 2019. Në Kosovë, nuk u shënuan sulme terroriste xhihadiste në 2019. Rajoni i Ballkanit Perëndimor mbeti strehë për komunitetet e radikalizuara. Hungaria vlerësoi se radikalizimi fetar ishte më i përhapur në Bosnjë dhe Hercegovinë, por gjithashtu i pranishëm edhe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Përveç kthimit të FTF-ve, kërcënimi i terrorizmit gjithashtu buron nga radikalizimi i grupeve dhe individëve, përfshirë në atyre që vuajnë dënimin në burg. Këto mjedise përfshijnë anëtarë të organizatave terroriste të njohura dhe grupe informale, por gjithashtu edhe individë që vetëradikalizohen në internet, për shembull përmes kontakteve me ideologë xhihadistë."

15 file:///C:/Users/User/Downloads/european_union_terrorism_situation_and_trend_report_te-sat_2020_0.pdf.

2.3.7 Drejtimet kryesore që do të trajtohen në këtë strategji

Detyrimi i organit të prokurorisë që në përputhje me legjislacionin penal vendas, të ushtrojë ndjekjen penale për luftëtarët e huaj, kur merr dijeni për kryerjen e veprave penale.

Vëmendja e shtuar në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera shtetërore në zbatimin e programeve të përshtatshme për të dënuarit që kanë kryer vepra me qëllime terroriste.

Kujdes i veçantë i duhet kushtuar kohës dhe vendit të caktuar për paraburgimin dhe vuajtjen e dënimit, duke mbajtur në vëmendje të drejtat e njeriut dhe nevojat e sigurisë.

Duke mbajtur në konsideratë garantimin e një procesi që respekton të drejtat e njeriut dhe mbi të gjitha mosdiskriminimin, kërkesat në caktimin e masave të sigurimit dhe dënimit, si dhe caktimi i vendit të vuajtjes së dënimit, duhet të sigurojnë ndëshkimin e duhur që të pengojë veprimtarinë terroriste, të parandalojë radikalizimin brenda sistemit të burgjeve, të ulë recidivizmin dhe të synojë riintegrimin.

Mbrojtja e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë

Dëshmitarëve, informatorëve, bashkëpunëtorëve duhet t'u sigurohet mbrojtje në përputhje me ligjin, në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja në procesin penal dhe mbrojtja e integritetit fizik të tyre dhe i familjarëve. Në këtë kuptim, përfshirja në programin e mbrojtjes mund të jetë një alternativë, ashtu si konsiderimi si dëshmitar me identitet të fshehur, etj. Rol të rëndësishëm në proces kanë edhe viktimat e këtyre veprave dhe mbrojtja e asistenca ndaj tyre duhet të jetë e garantuar.

Koordinimi dhe analizimi i informacionit të agjencive të ndryshme

Sigurimi i bashkëpunimit dhe koordinimi është vendimtar për të parandaluar terrorizmin. Shkëmbimi i informacionit në kohë reale nga burime të ndryshme si agjenci ligjzbatuese, agjenci bankare, shërbime inteligjente, partnerë ndërkombëtarë etj., dhe analiza e kujdesshme e tij, duke përdorur edhe ekspertizën e këtyre institucioneve, është një mjet i rëndësishëm në këtë drejtim. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet institucioneve informative në parim është informacion "sekret shtetëror" e për pasojë ka një sërë masash të posaçme mbrojtjeje. Kur është rasti kërkohen

masat e përshtatshme mbrojtëse edhe gjatë procesit penal, si gjykimi me dyer të mbyllura, teknika të veçanta të marrjes në pyetje, etj.

Përdorimi i metodave speciale të hetimit

Kuadri ynë ligjor mundëson përdorimin e mjeteve të posaçme për kërkimin e mbledhjen e provave për të hetuar një çështje penale dhe parandaluar pasojat e saj. Këto mjete, janë veçanërisht eficiente në hetimin e veprave penale me qëllime terroriste.

Goditja e mjeteve të tjera që përdoren për të përgatitur e kryer vepra terroriste.

Lufta ndaj veprave të tjera penale që shërbejnë për të përgatitur terrenin për kryerjen e veprave me qëllime terroriste, është një nga kushtet më të rëndësishme në luftën ndaj terrorizmit. Kështu, informacioni mbi aktivitetet financiare të të dyshuarve terroristë mund të japë të dhëna me vlerë në hetimet kundër terrorizmit, duke ndihmuar në zbulimin e planeve të rrjeteve terroriste, identifikimin e bashkëpunëtorëve etj.; ndjekja e veprave penale që lidhen me kultivimin e trafikimin e drogës ndërpret një burim të ardhurash që shndërrohen në fonde për trajnimin e terroristëve; hetimi e dënimi i mbajtjes e trafikut të armëve, armëve shpërthyese e municionit, mbajtjes e trafikimit të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese apo radioaktive, kalimit të paligjshëm të kufirit, krimit kibernetik.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar duhet të jetë eficiient në kohë dhe në mjete të përdorura, jo vetëm nëpërmjet kërkesave për ekstradim, letërporosi etj., por edhe nëpërmjet ndarjes së informacionit në kohë reale nëpërmjet pikave të kontaktit, ngritjes së skuadrave të përbashkëta hetimore etj., në përputhje me kuadrin ligjor konkret.

3. Vizioni i strategjisë

3.1 Vizioni

"Shqipëria, një shoqëri e sigurtë pa kërcënime terroriste, me realitetin dhe imazhin e një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë"

. Vizioni i strategjisë bazohet në vizionin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020 "Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe me një imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë". Në kuadër të shtyllës së 'Mirëqeverisjes, Demokracisë dhe shtetit të së Drejtës', SKZHI II 2015 – 2020 paraqet se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive që synojnë parandalimin dhe uljen e kërcënimeve terroriste nëpërmjet:

- rritjes së rezultateve në luftën kundër terrorizmit përmes vendosjes dhe përdorimit të një sistemi efikas të vlerësimit të riskut, shoqëruar me forcimin institucional të njësive të angazhuara në këtë fushë.

Rezultatet e pritshme, përfshijnë:

i. rritje në numrin e operacioneve që përdorin metoda të hetimeve speciale;

ii. rritje në numrin e operacioneve ndërkombëtare të përbashkëta; dhe

iii. rritje në shkallën e zbulimit dhe eliminimit të veprave penale terroriste;

- hartimit të një ligji organik në përputhje me standardet e BE-së për luftën kundër terrorizmit;

- ngritjes dhe funksionimit të Komitetit Ndërinstitucional për Bashkërendimin e Veprimeve në Luftën Kundër Terrorizmit"; dhe

- ngritjes së një rrjeti të sigurt komunikimi për shkëmbimin e informacionit midis agjencive të angazhuara në luftën kundër terrorizmit.

Theksi për arritjen e këtij vizioni do të vihet në parandalimin e akteve terroriste, duke përdorur një përgjigje të koordinuar nga shteti në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin. Çdo reagim duhet patjetër të marrë në konsideratë faktin se një sulm terrorist nuk mund të jetë i suksesshëm nëse ekzistojnë planet e parandalimit të sulmeve terroriste dhe strukturat e reagimit të shpejtë.

Për të arritur këtë objektiv, do të jetë e nevojshme që të evitohen dëmit nga aktet e mundshme terroriste dhe ekstremiste duke:

- ndjekur sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme persona të përfshirë në terrorizëm;

- mbrojtur zonat që janë shumë të rëndësishme për funksionimin e vendit dhe duke reaguar në mënyrë efektive në rastin e një incidenti.

Të parashikohen e përfundojnë aktet e nevojshme ligjore dhe normative për objektet e infrastrukturën kritike të vendit që mund të jenë objekt i sulmeve terroriste dhe që mund të sjellin pasoja të rënda për vendin. Për këtë fakt të parashikohen edhe rrugët për zgjidhjet e situatave që mund të lindin nga përgatitjet apo tentativat e mundshme terroriste.

3.2 Misioni

"Krijimi i kapaciteteve, sistemeve efektive kombëtare dhe koordinimi e bashkëpunimi kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për sinjalizimin, hetimin dhe goditjen e terrorizmit"

3.3 Indikatorët e impaktit dhe indikatorët e rezultatit

- Impakti ekonomik

Krijimi i një mjedisi më të sigurt për sektorin privat dhe investimet e huaja.

- Impakti social

Forcimi i aspektit social dhe etik të shoqërisë shqiptare, duke promovuar vlerat morale dhe normat shoqërore, integritetin dhe etikën, sferën private, perceptimin e sigurisë publike, etj.

- Impakti mjedisor

Forcimi i kontrollit të lëndëve me natyrë toksike, radioaktive, kimike dhe biologjike të rrezikshme dhe rritjen e sigurisë për parandalimin e përdorimit të tyre në mjedis por edhe përdorimi i armëve të shkatërrimit në masë duke kontrolluar trafikimin e tyre dhe transportimin e tyre. Garantimi i mbrojtjes së zonave mjedisore me rëndësi të veçantë dhe e burimeve të tyre natyrore e biologjike.

- Impakti ndërsektorial

Angazhimi i një sërë institucionesh shtetërore dhe kapacitetesh njerëzore, rritja e shkëmbimit të informacionit dhe aksesueshmërisë së tij, si dhe rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional.

PJESA II: QËLLIMI I STRATEGJISË DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Institucionet e Republikës së Shqipërisë me kohë kanë identifikuar kërcënimet dhe kanë ngritur shqetësime mbi pasojat e mundshme nga përhapja e ideologjive ekstremiste dhe radikaliste që çojnë në terrorizëm në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në këto shqetësime dhe kërcënimet e identifikuara, institucionet e Republikës së Shqipërisë, ndër të parat në rajon, kanë ndërmarrë veprime dhe aktivitetet konkrete, në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që çojnë në terrorizëm, kryesisht të fokusuara në një qasje strategjike me katër komponentë:

- parandalimi/sinjalizimi;
- hetimi dhe goditja;
- reagimi;
- mbrojtja.

Qasja 1: Parandalimi i terrorizmit dhe radikalizimit që çon në terrorizëm përmes sinjalizimit të hershëm

Parandalimi i terrorizmit lidhet me ndalimin e përhapjes së ideologjive ekstremiste dhe radikalizimit. Institucionet e vendit në bashkëpunim e koordinim shumë të ngushtë me shoqërinë civile dhe komunitetin fetar kanë hartuar strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm, e cila është e fokusuar në parandalimin, minimizimin e faktorëve shtytës që mund të ndikojnë në radikalizëm, de-radikalizimin e personave të radikalizuar, si dhe riintegrimi i tyre në shoqëri. Për këtë qëllim, është bërë i mundur fuqizimi i aktorëve të vijës së parë në bashkëpunim me ministritë e linjës, agjencitë ligjzbatuese, autoritetet vendore, komunitetet fetare, shoqëria civile, sektorin privat, etj., në përputhje me objektivat dhe synimet e Strategjisë Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, si dhe kanalizimin e problematikave nëpërmjet Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike, si një platformë që trajton çështjet e sigurisë në nivel vendor.

Qëllimi i politikës 1: Mbajtja e kërcënimit terrorist në nivel "të ulët"

Kjo do të arrihet me forcimin dhe rritjen e masave për ndjekjen dhe monitorimin e situatës lidhur me shtetasit shqiptarë LHT që mund të kthehen nga zonat e konfliktit Siri/Irak, si dhe çdo individi të dyshuar për vepra me qëllime terroriste dhe forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit brenda strukturave të policisë së shtetit, agjencive inteligjente dhe ligjzbatuese në vend që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit.

Objektivi specifik 1.1: Parandalimi i kërcënimeve terroriste

Masa 1.1.1: Kryerja e hetimeve proaktive për parandalimin e akteve të mundshme terroriste, ndaj grupeve dhe individëve ekstremistë që nxisin dhe mbështesin dhunën.

Masa 1.1.2: Kryerja e trajnimeve bashkëkohore të strukturave antiterror në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, mbi teknologjitë dhe sistemet e reja për përdorimin e metodave speciale të hetimit.

Masa 1.1.3: Kryerja e analizave të përbashkëta midis institucioneve të gjurmimit, hetimit, lidhur me grupe kriminale dhe terroriste në hetim dhe të hetuara/gjykuara për terrorizëm.

Masa 1.1.4: Vlerësimi i Kërcënimeve Lokale në venddislokimet e përhershme të FARSH-së, si instrumenti informues për Autoritetet e Drejtimit dhe Komandimit të FARSH-së.

Masa 1.1.5: Bashkëpunimi me MM/FARSH në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit (*awareness*) të personelit ndaj kërcënimit terrorist në vendin tonë dhe vendeve ku angazhohen në kuadër të misioneve ndërkombëtare.

Masa 1.1.6: Analiza e profileve të riskut dhe reagimi i shpejtë i strukturave ndërkufitare për parandalimin e personave të dyshuar për terrorizëm ose akteve terroriste përmes implementimit efektiv të API-t (Automativ Passenger Information/PNR (*Passenger Name Register*).

Indikatorë të matshëm:

- indeksi i rritjes së rasteve terroriste të parandaluara, përmes hetimeve proaktive;

- indeksi i rritjes së kapaciteteve profesionale për përdorimin e metodave speciale të hetimit.

Rezultate të pritshme:

- rritja e numrit të rasteve të parandaluara, ndër rastet e mundshme terroriste në vendin apo nëpërmjet vendit tonë, përmes hetimeve proaktive ndaj grupeve dhe individëve ekstremistë që nxisin dhe mbështesin dhunën;

- rritja e numrit të trajnimeve bashkëkohore të strukturave antiterror në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, mbi tekonologjitë dhe sistemet e reja për përdorimin e metodave speciale të hetimit;

- rritja e numrit të rasteve të parandaluara për akte/vepra të mundshme terroriste në vendin apo nëpërmjet vendit tonë, përmes analizave të përbashkëta midis institucioneve të gjurmimit, hetimit, lidhur me grupe kriminale të hetuara dhe gjykuara për terrorizëm.

Objektivi specifik 1.2: Parandalimi i financimit të terrorizmit

Masa 1.2.1: Kryerja e hetimeve për parandalimin e financimit të terrorizmit.

Masa 1.2.2: Rritja e numrit të trajnimeve të specializuara në fushën e hetimit të financimit të terrorizmit.

Masa 1.2.3: Kryerja e analizës mbi individë/grupe që dyshohet se kryejnë vepra penale lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit.

Masa 1.2.4: Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera midis DPPPP, DPT, DPD, dhe institucioneve të tjera të sigurisë me institucionet e tjera ligjzbatuese në vend për shkeljet në fushën e krimeve ekonomike dhe pastrimit të parave në kuadër të luftës të lidhura me financimin e terrorizmit.

Masa 1.2.5: Analizimi i Raporteve të Aktivitetit të Dyshuar për Financim të Terrorizmit dhe dërgimi i informacioneve në organet ligj zbatuese nëse pas verifikimeve përmbajnë dyshime për Financim të Terrorizmit.

Indikatorë të matshëm:

- indeksi i rritjes së referimeve për financim të terrorizmit;

- indeksi i rritjes së kapaciteteve profesionale për të detektuar dhe hetuar financimin e terrorizmit;

- indeksi i rritjes së hetimeve të përbashkëta të strukturave të antiterrorit me homologet dhe partnerët;

- indeksi i rritjes së ndërveprimit midis PSH/ DAT, DPT, DPD, DPPPP dhe institucioneve të tjera të sigurisë me institucionet e tjera ligjzbatuese në vend për financimin e terrorizmit.

Rezultate të pritshme:

- dhënia e aksesit të strukturave të antiterrorit në databazat e çdo institucioni pjesë e kësaj strategjie dhe strategjive të tjera përbërëse për shkëmbimin e të dhënave që ndihmojnë në hetimin dhe parandalimin e terrorizmit dhe financimit të tij;

- zbatimi i standardeve dhe mekanizmave të përshtatshme për hetimin e financimit të terrorizmit, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në standardet e BE, kërkesave që rrjedhin nga rezolutat e KS të OKB dhe instrumentet e tjerë ndërkombëtarë në këtë fushë;

- rritja e numrit të trajnimeve të specializuara në fushën e hetimit të financimit të terrorizmit;

- rritja e numrit të rasteve të parandaluara përmes identifikimit dhe analizës së situatës së grupeve kriminale që kryejnë apo dyshohet se kryejnë vepra penale lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit;

- rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera midis DPT, PD, DPPPP dhe institucioneve të tjera të sigurisë me institucionet e tjera ligjzbatuese në vend për shkeljet në fushën e krimeve ekonomike dhe pastrimit të parave në kuadër të luftës të lidhura me financimin e terrorizmit;

- rritja e numrit të hetimeve të përbashkëta të strukturave të antiterrorist.

Objektivi specifik 1.3: Intensifikimi i masave për ndjekjen dhe monitorimin e situatës lidhur me shtetasit shqiptarë LHT që mund të kthehen nga zonat e konfliktit Siri/Irak, si dhe çdo individi të dyshuar për vepra me qëllime terroriste.

Masa 1.3.1: Mbajtja nën monitorim të vazhdueshëm të personave të kthyer LHT dhe ata që mund të kthehen nga zonat e konfliktit.

Masa 1.3.2: Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit/operacioneve të përbashkëta me agjencitë inteligjente në vend dhe ato ndërkombëtare lidhur me LHT.

Masa 1.3.3: Monitorimi i rrjeteve sociale dhe mediave elektronike në lidhje me LHT dhe individët e dyshuar për terrorizëm.

Indikatorë të matshëm:

- indeksi i rritjes së nivelit të parandalimit të kërcënimeve terroriste nga LTH, si rrjedhojë e monitorimit të situatës së personave të kthyer nga zonat e konfliktit.

Rezultate të pritshme:

- krijimi i sistemeve për monitorimin e vazhdueshëm të personave të kthyer dhe ata që mund të kthehen nga zonat e konfliktit;

- rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit/operacioneve të përbashkëta me agjencitë inteligjente në vend dhe ato ndërkombëtare lidhur me LHT;

- identifikimi dhe parandalimi i rasteve të terrorizmit përmes monitorimit të rrjeteve sociale dhe mediave elektronike në lidhje me LHT dhe individët e dyshuar për terrorizëm.

Objektivi specifik 1.4: Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit brenda strukturave të Policisë së Shtetit, agjencive inteligjente dhe ligjzbatuese në vend që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit.

Masa 1.4.1: Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera ndërmjet strukturave të PSH dhe institucioneve inteligjente e ligjzbatuese në vend.

Masa 1.4.2: Rritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacioneve për verifikimin e terrorizmit në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me të gjitha shërbimet homologe e partnere: Europol, SELEC, INTERPOL, Interforza, TSC-SHBA.

Masa 1.4.3: Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera për identifikimin e vendndodhjes dhe kapjen e personave në kërkim ndërkombëtar për vepra me qëllime terroriste.

Masa 1.4.4: Kryerja e hetimeve/operacioneve të përbashkëta me partneret ndërkombëtare për individë/grupe të dyshuara për veprimtari që lidhen me terrorizmin brenda dhe jashtë vendit.

Masa 1.4.5: Përdorimi me proaktivitet i produkteve, shërbimeve e platformave të komunikimit të Qendrës Evropiane Kundër Terrorizmit Europol.

Masa 1.4.6: Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave informative mbi treguesit/indikatorët e veprimtarive/aktiviteteve terroriste si radikalizimi dhe ekstremizmi me natyrë fetare, etnike dhe ideologjike me qëllim sinjalizimin e veprimtarive të dyshimta me natyrë terroriste.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i efektivitetit të informacioneve të shkëmbyera midis institucioneve brenda vendit, si dhe me shërbimet partnere.

Rezultate të pritshme:

- rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera midis institucioneve brenda vendit, si dhe me shërbimet e specializuara në BE, Europol, SELEC dhe INTERPOL;

- rritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacioneve për verifikimin e terrorizmit në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me të gjitha shërbimet homologe sipas nevojës;

- rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera për identifikimin e vendndodhjes dhe kapjen e personave në kërkim ndërkombëtar për vepra me qëllime terroriste;

- rritja e numrit të hetimeve/operacioneve të përbashkëta me partneret ndërkombëtare për individë/grupe të dyshuara për veprimtari që lidhen me terrorizmin brenda dhe jashtë vendit;

- forcimi i kapaciteteve hetimore/identifikuese dhe parandaluese përmes përdorimit me proaktivitet të produkteve, shërbimeve e platformave të komunikimit të Qendrës Evropiane Kundër Terrorizmit Europol.

Qëllimi i politikës 2: Ndërprerja e aktiviteteve të faqeve dhe platformave digjitale, si dhe individëve që tërheqin njerëz në terrorizëm

Objektivi specifik 2.1: Parandalimi i radikalizimit nëpërmjet internetit

Masa 2.1.1: Krijimi i një sistemi të aksesit të kontrolluar për grupmoshat e reja në site dhe faqe *online* të cilat mund të kenë përmbajtje propagandiste.

Masa 2.1.2: Krijimi i hapësirave për denoncimin e faqeve/profileve të dyshimta në faqet zyrtare të P.SH, AKCESK, CVE etj.

Masa 2.1.3: Zhvillimi i spoteve ndërgjegjësuese për t'u shpërndarë te përdoruesit e internetit, nëpërmjet profileve zyrtare të agjencive shtetërore apo faqeve zyrtare të internetit.

Masa 2.1.4: Kryerja e monitorimeve të faqeve të internetit nga agjencitë ligj-zbatuese për mesazhe/profile radikale, ekstremiste e terroriste.

Masa 2.1.5: Inspektimet në distancë dhe në mjediset e punës së sipërmarrësit.

Indikatorë të matshëm:

- indeksi i uljes së ekspozimit të grupmoshave të reja në site dhe faqe *online* të cilat me përmbajtje propagandiste;

- indeksi i rritjes së identifikimit të profileve me përmbajtje terroriste përmes monitorimit të burimeve të hapura.

Rezultate të pritshme:

- bllokimi i të gjitha faqeve (*links*; në raste të caktuara edhe *domain*-e) apo i aplikacioneve që në përmbajtje kanë propagandë terroriste, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike (ofruesit e shërbimit internet – ISP), sipas përcaktimeve ligjore;

- rritja e kontrollit dhe ulja e ekspozimit të grupmoshave të reja ndaj propagandës që çon në radikalizim përmes internetit dhe faqeve me këtë përmbajtje

Objektivi specifik 2.2: Rritja e prezencës së strukturave të antiterrorit në mjedisin virtual përmes kontrollit dhe monitorimit të hapësirave virtuale përfshirë *darknet*-in.

Masa 2.2.1: Rritja e kapaciteteve për identifikimin e profileve në rrjete sociale me përmbajtje terroriste.

Objektivi specifik 2.3: Parandalimi i radikalizimit dhe rekrutimeve terroriste duke rritur bashkëpunimin bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar dhe me prodhuesit e aplikacioneve në internet.

Masa 2.3.1: Zhvillimi i takimeve bilaterale, rajonale dhe ndërkombëtare.

Masa 2.3.2: Lidhja e marrëveshjeve për bashkëpunim brenda fushës.

Masa 2.3.3: Pjesëmarrja në konferenca, *workshop*-e etj.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi rritjes së nivelit të bashkëpunimit bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar brenda fushës.

Rezultate të pritshme:

- rritja e numrit të takimeve bilaterale, rajonale dhe ndërkombëtare të zhvilluara;

- rritja e numrit të marrëveshjeve të lidhura për bashkëpunim brenda fushës për shkëmbimin e informacionit;

- rritja e pjesëmarrjes në konferenca, *workshop*-e etj. duke sjellë rritjen e nivelit të informimit dhe ekspertizës.

Qëllimi i politikës 3: Kuptimi i kërcënimeve të terrorizmit në vendin tonë përmes identifikimit të hershëm të grupeve të synuara dhe të metodave radikale

Objektivi specifik 3.1: Vlerësimi dhe analizimi i faktorëve që çojnë në radikalizim dhe ekstremizëm të dhunshëm.

Masa 3.1.1: Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për identifikimin e faktorëve që çojnë individët drejt radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 3.1.2: Hartimi i protokolleve dhe sistemeve të ndarjes së informacionit për të mbledhur, sistemuar dhe ndarë të dhëna nga një gamë e gjerë burimesh, me qëllim që të mundësohen reagime dhe përpjekje parandaluese efektive dhe në kohë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 3.1.3: Zhvillimi i protokolleve specifike për personat e radikalizuar në Shqipëri, duke iu përshtatur karakteristikave dhe veçorive që mbart ky fenomen në vendin tonë dhe shpërndarja e tyre profesionistëve të vijës së parë, për evidentimin dhe sinjalizimin e hershëm të tyre.

Masa 3.1.4: Krijimi i një databaze për rastet e identifikuara dhe mbledhja e të dhënave për nxënësit e shkollave që shfaqin sjellje me risk të lartë.

Masa 3.1.5: Zhvillimi i takimeve periodike me përfaqësues të Zyrës Vendore Arsimore, Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës dhe përfaqësues të Policisë së Shtetit.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së nivelit analitik dhe të përpunimit të informacionit.

Rezultate të pritshme:

- rritja e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për identifikimin e faktorëve që çojnë individët drejt radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm;

- reagime dhe përpjekje parandaluese efektive dhe në kohë ndaj radikalizimit.

Qëllimi i politikës 4: Zgjerimi i kapaciteteve operacionale të policisë dhe të kapaciteteve të inteligjencës

Objektivi specifik 4.1: Rritja e parandalimit nëpërmjet zhvillimit të vlerësimeve të riskut, analizave dhe kërkimeve për radikalizimin dhe terrorizmin.

Masa 4.1.1: Kryerja e analizave dhe vlerësimeve të riskut.

Masa 4.1.2: Krijimi i profileve të subjekteve të dyshuar për veprimtari radikale/ekstremiste dhe terroriste.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së kapaciteteve për vlerësimin e riskut nga radikalizimi.

Rezultate të pritshme:

- rritja e parandalimit nëpërmjet zhvillimit të vlerësimeve të riskut, analizave dhe kërkimeve për radikalizimin dhe terrorizmin;

- identifikim i shpejtë dhe efektiv për parandalimin përmes përdorimit të profileve të riskut të përcaktuara.

Qëllimi i politikës 5: Zhvillimi i komunikimit strategjik

Objektivi specifik 5.1: Shkëmbimi i përvojës dhe ekspertizës me vendet e rajonit

Masa 5.1.1: Zhvillimi i takimeve dhe *webinar*-eve të vazhdueshme me profesionistë nga vendet e rajonit për shkëmbimin e eksperiencave.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së përvojës dhe ekspertizës në fushën e terrorizmit dhe radikalizmit.

Objektivi specifik 5.2: Krijimi i një rrjeti komunikimi të vazhdueshëm për shkëmbimin e informacioneve mes institucioneve dhe strukturave të përfshira me qëllim krijimin e programeve dhe manualeve për ndërgjegjësimin mbi terrorizmin.

Masa 5.2.1: Krijimi i kundërnarrativave për terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, duke pasqyruar rreziqet dhe dëmet që këto fenomene i shkaktojnë shoqërisë por edhe trajtimi i grupeve në rrezik dhe shtresave më vulnerabël, për t'u shpërndarë në hapësirat mediatike dhe ato të rrjeteve sociale.

Masa 5.2.2: Krijimi i programeve dhe manualeve për ndërgjegjësimin mbi terrorizmin.

Masa 5.2.3: Tryeza bashkëbisedimi me këshillin dhe bordin e prindërve në institucionet arsimore për shkëmbim informacioni dhe parandalimi.

Masa 5.2.4: "Ndërgjegjësim pro sjelljeve të shëndetshme dhe minimizimit të prirjes për të përdorur dhunën për zgjidhjen e çdo konflikti duke zhvilluar:

- sesione informuese me mësues dhe nxënës, zhvilluara nga përfaqësues të organizatës;

- seminare informimi dhe ndërgjegjësimi në klasa".

Masa 5.2.5: Hartimi i broshurave informuese për prindërit mbi njohjen dhe menaxhimin e shenjave të ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 5.2.6: Zhvillimi i aktivitetit informues dhe ndërgjegjësues "Ditë e hapur edukative dhe ndërgjegjësuese" me nxënës, mësues, prindër dhe përfaqësues të komunitetit.

Masa 5.2.7: Zhvillimi i programit "Njohja me konceptin dhe praktikën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve".

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së shkallës së informimit dhe ndërgjegjësimit të shtresave vulnerabël për ekspozim ndaj radikalizimit që çon në terrorizëm.

Qasja 2: Hetimi i veprave të terrorizmit, zbulimi dhe goditja e terroristëve/grupeve terroriste duke eliminuar kërcënimet e terrorizmit

Qëllimi i politikës 6: Identifikimi, hetimi, zbulimi i veprave penale në fushën e terrorizmit dhe financimit të tij dhe goditja e individëve, grupeve terroriste

Kjo do të arrihet nëpërmjet hetimit dhe zbulimit të veprave penale në fushën e terrorizmit dhe

financimit të tij duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Bashkëpunimit dhe koordinimit me agjencitë inteligjente e ligj-zbatuese SHISH, AISM, Prokurorinë, DPPPP-FIU, DP Burgjeve, dhe CVE, si dhe institucione që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit.

Përmirësimit dhe rritjes sipas nevojës e kapaciteteve njerëzore, profesionale e logjistike të Drejtorisë së Antiterrorit.

Objektivi specifik 6.1: Hetimi i terrorizmit dhe burimeve të tij.

Masa 6.1.1: Përgatitja dhe përqasja e legjislacionit sipas standardeve të BE, në lidhje me luftën kundër terrorizmit bazuar në mangësitë e konstatuara nga analizimi në kuadër të kapitullit 24.

Masa 6.1.2: Finalizimi i hartimit të ligjit për pastrimin e parave.

Masa 6.1.3: Zhvillimi hetimeve proaktive ndaj individëve/grupeve të dyshuar për veprimtari terroriste dhe financim të tij, nëpërmjet metodave speciale të hetimit.

Masa 6.1.4: Zhvillimi hetimeve paralele për financimin e terrorizmit për çdo rast referimi për vepra me qëllime terroriste sipas rekomandimit të FAFT/ICRG dhe *Moneyval.*

Masa 6.1.5: Zhvillimi hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta me institucionet homologe/partnere ndërkombëtare.

Masa 6.1.6: Zhvillimi hetimeve të përbashkëta me agjencitë ligjzbatuese lidhur me individë/grupe kriminale të krimit të organizuar që mund të përfshihen edhe në aktivitete terroriste në Shqipëri, vendet e BE-së dhe më gjerë.

Masa 6.1.7: Shkëmbimi informacionit me homologët e partnerët ndërkombëtarë për shtetas shqiptarë e të huaj, pjesë e grupeve të krimit të organizuar që mund të përfshihen edhe në aktivitete terroriste në Shqipëri, vendet e BE-së dhe më gjerë.

Masa 6.1.8: Zbatimi i praktikave më të mira të vendeve të BE –së për hetimin e financimit të terrorizmit, si dhe kërkesave që rrjedhin nga rezolutat e KS të OKB dhe instrumentet e tjerë ndërkombëtarë në këtë fushë.

Masa 6.1.9: Ndjekja penale e LHT dhe individëve të dyshuar për terrorizëm dhe financimin të tij.

Masa 6.1.10: Kryerja e trajnimeve bashkëkohore të prokurorëve e OPGJ-ve që kryejnë hetimet e këtyre veprave penale dhe përmirësimi i teknologjisë.

Masa 6.1.11: Bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme për kalimin e procedimeve sipas kompetencës së përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale.

Indikatorë të matshëm:

- indeksi i eficiencës së hetimeve në fushën e terrorizmit;
- indeksi i përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e BE për luftën kundër terrorizmit në kuadër të kapitullit 24;
- indeksi i rritjes së hetimit për financimin e terrorizmit paralel me hetimin për krime në fushën e pastrimit të parave.

Rezultate të pritshme:

- realizimi i hetimeve proaktive ndaj individëve/grupeve të dyshuar për veprimtari terroriste dhe financim të tij;
- referime për terrorizmin dhe financimin e terrorizmit;
- rritja e numrit të hetimeve paralele për financimin e terrorizmit për çdo rast referimi për vepra me qëllime terroriste sipas rekomandimit të FAFT/ICRG dhe Moneyval;
- rritja e numrit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta me institucionet homologe/partnere ndërkombëtare;
- rritja e numrit të rasteve të parandaluara si pasojë e identifikimit të individëve pjesë e organizatave kriminale ose grupeve të krimit të organizuar që mund të përfshihen edhe në aktivitet terroriste në Shqipëri dhe vendet e BE-së dhe më gjerë;
- ndjekja penale e LHT dhe individëve të dyshuar për terrorizëm.

Objektivi specifik 6.2: Bashkëpunimi dhe koordinimi me agjencitë inteligjente e ligjzbatuese dhe institucione që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit.

Masa 6.2.1: Kryerja e analizave të përbashkëta midis institucioneve të gjurmimit, hetimit lidhur me grupe kriminale të hetuara e gjykuara për terrorizëm, në funksion të marrjes së masave parandaluese.

Masa 6.2.2: Shkëmbimi i informacioneve dhe analizave të përbashkëta ndërmjet Drejtorisë së Antiterrorit dhe DPPPP, DPT, DPD, dhe institucione të tjera ligj zbatuese në vend, për

hetimet e veprave penale në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe financimit të tij.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së efektivitetit të hetimit, gjurmimit lidhur me grupe kriminale të hetuara e gjykuara për terrorizëm.

Rezultate të pritshme:

- rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera mes këtyre agjenci;

- analiza të përbashkëta pune në funksion të hetimit të terrorizmit.

Objektivi specifik 6.3 Përmirësimi dhe rritja sipas nevojës e kapaciteteve njerëzore, profesionale e logjistike të strukturave të antiterrorit.

Masa 6.3.1: Trajnimi i vazhdueshëm me praktikat e teknikat më të mira bashkëkohore të strukturave të Drejtorisë së Antiterrorit.

Indikatorë të matshëm:

- Numri i trajnimeve të strukturave të Drejtorisë së Antiterrorit mbi praktikat e teknikat më të mira bashkëkohore.

Rezultate të pritshme:

- Rritja e nivelit të ekspertizës dhe kapaciteteve operacionale – hetimore.

Qëllimi i politikës 7: Përmirësimi i sistemeve të mbledhjes, ruajtjes, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit

Objektivi specifik 7.1: Krijimi i një sistemi të sigurt të komunikimit për transmetimin e informacionit ndërmjet strukturave të përfshira në luftën kundër terrorizmit.

Masa 7.1.1: Përmirësimi i standardeve të sigurisë (fizike, informacionit dhe sigurisë së rrjeteve të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit).

Indikatorë të matshëm:

- indeksi i rritjes së sigurisë së transmetimit të informacionit ndërmjet strukturave të përfshira në luftën kundër terrorizmit;

Objektivi specifik 7.2: Vlerësimi periodik i nivelit të rrezikut/kërcënimit të faktorëve dhe fenomeneve që prodhojnë radikalizëm apo ekstremizëm, si derivate të terrorizmit.

Masa 7.2.1: Hartimi i raporteve periodike të vlerësimit të nivelit të rrezikut/kërcënimit të faktorëve dhe fenomeneve që prodhojnë radikalizëm apo ekstremizëm, si derivate të terrorizmit.

Masa 7.2.2: Ndërtimi i Sistemit të Qendërzuar të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe brenda vendit për të dhënat kriminale. Realizimi i procedurës së prokurimit të sistemit të përbashkët të të dhënave mes strukturave relevante për çështjet e terrorizmit.

Masa 7.2.3: Vënia në funksion të sistemit të përbashkët të të dhënave dhe gjenerimi i raporteve me vlerë vendimmarrëse.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së cilësisë së analizimit të informacionit.

Objektivi specifik 7.3 Raporte dhe vlerësime nga agjencitë inteligjente dhe ligjzbatuese në luftën kundër terrorizmit, mbi përcaktimin e nivelit të kërcënimit terrorist në rrafshin ndërkombëtar *modus operandi* dhe ndikimi në vendin tonë.

Masa 7.3.1: Shkëmbimi i ndërsjellë i informacioneve me agjencitë homologe ndërkombëtare mbi *modus operandi* të terroristëve dhe grupeve terroriste.

Masa 7.3.2: Mundësimi i aksesit në raporte apo studime të vendeve të rajonit apo ndërkombëtare për zhvillimet e terrorizmit mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Masa 7.3.3: Pjesëmarrje në takime, konferenca ose vizita studimore mbi dinamikat dhe format e reja të kërcënimeve terroriste.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së aksesit në raporte/vlerësime burimeve dhe programe të organizatave ndërkombëtare ose të vendeve të rajonit apo ndërkombëtare për *modus operandi* të kërcënimit terrorist ndërkombëtar.

Objektivi specifik 7.4: Sigurimi i informacionit për terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, sabotazhin dhe Armët e Dëmtimit në Masë dhe informimi i institucioneve vendimmarrëse, politikëbërëse, institucioneve dhe strukturave të tjera kompetente/përgjegjëse shtetërore dhe të zbatimit të ligjit.

Masa 7.4.1: Shkëmbimi i informacionit, përdorimi i burimeve dhe programeve të organizatave ndërkombëtare për zbulimin terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, sabotazhit dhe trafikimit të Armëve e Dëmtimit në Masë

Masa 7.4.2: Informimi i strukturave vendimmarrëse mbi problematikat e raporteve të riskut ose zhvillimeve aktuale/të pritshme kombëtare ose të huaja në fushën e terrorizmit

Masa 7.4.3: Propozimi i zgjidhjeve dhe metodave bazuar në ekspertizën mbi zhvillimet dhe metodat bashkëkohore të inteligjencës

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së shpejtësisë së shkëmbimit të informacionit me efekte vendimmarrëse

Objektivi specifik 7.5: Konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me: strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit; institucionet e sistemit të sigurisë kombëtare; shërbimet inteligjente të vendeve aleate dhe partnere.

Masa 7.5.1: Identifikimi i nevojave për marrëveshje dy ose shumëpalëshe për rritjen e bashkëpunimit në fushën e hetimit të terrorizmit dhe financimit të tij.

Masa 7.5.2: Krijimi i rrjetit të pikave të përbashkëta të kontaktit dhe sistemeve elektronike të sigurta për shkëmbime dinamike të informacionit në funksion të hetimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për terrorizmin.

Qasja 3: Reagimi

Qëllimi i politikës 8: Reagim nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të institucioneve përkatëse për t'iu përgjigjur sulmeve terroriste

Objektivi specifik 8.1: Konsolidimi i kapaciteteve të mbrojtjes civile, në nivelin qendror dhe atë lokal.

Masa 8.1.1: Krijimi i kapaciteteve për përballimin e akteve terroriste brenda Republikës së Shqipërisë përmes trajnimit të personelit të Forcave Speciale për reagimin ndaj sulmeve të mundshme terroriste.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së kapaciteteve të reaguese ndaj sulmeve të mundshme terroriste.

Qëllimi i politikës 9: Reagim nëpërmjet reduktimit dhe lehtësimit të pasojave nga një sulm terrorist

Objektivi specifik 9.1: Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e dhënies së ndihmës viktimave të terrorizmit sipas konventës evropiane për kompensimin e viktimave të terrorizmit.

Masa 9.1.1 Hartimi i Planit për koordinimin ndërinstitucional në menaxhimin e krizave pas një akti terrorist.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së mekanizmave koordinues ndërinstitucional në menaxhimin e krizave pas një akti terrorist.

Qëllimi i politikës 10: Përgatitja për menaxhimin e incidenteve terroriste që përfshijnë përdorimin e materialeve CBRN

Do të hartohet procedura dhe zbatohen programe bashkëkohore ushtrimesh për zhvillimin e aftësive në gatishmërinë, parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive, duke vënë në provë të plotë sistemet, praktikat dhe procedurat. Për këtë qëllim të evidentohen praktikat më të mira, të evidentohen pikat e dobëta dhe të sanksionohen ose të përcaktohen reagimet e duhura efikase ndaj një sulmi terrorist me përdorimin e materialeve CBRN".

Objektivi specifik 10.1: Reagimi i shpejtë sipas protokolleve ndërkombëtare ndaj incidenteve terroriste që përfshijnë përdorimin e materialeve CBRN.

Masa 10.1.1: Përmirësimi i kapaciteteve për kryerjen e hetimeve kriminale pas incidenteve / akteve terroriste që përfshijnë përdorimin e materialeve CBRN.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i uljes së kohës së shkëmbimit të informacionit në rastet e emergjencës ku përfshihen CBRN.

Qasja 4: Mbrojtja

Qëllimi i politikës 11: Rritja e nivelit të sigurisë në fushën e transportit, tregtisë, shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve

Objektivi specifik 11.1: Reduktimi i rreziqeve që rrjedhin nga transferimet e ndaluara të mjeteve dhe materialeve që mund të përdoren për të kryer një sulm apo akt terrorist.

Masa 11.1.1: Shfrytëzimi i kapaciteteve kombëtare, për zbulimin në kohë të materialeve të përshtatshme dhe jashtë kontrollit, për prodhimin apo përdorimin e armëve të zjarrit, lëndëve shpërthyese, armëve të dëmtimit në masë.

Masa 11.1.2: Shfrytëzimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative, për zbulimin e rrjeteve financiare kriminale që tentojnë përhapjen e armëve të zjarrit, lëndëve shpërthyese, armëve të dëmtimit në masë.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional për parandalimin e akteve terroriste që rrezikojnë infrastrukturën kritike në vend.

Objektivi specifik 11.2: Rritja e aftësive për të zbuluar aktivitetin terrorist duke përfshirë

kontrollin dhe mbrojtjen e materialeve kimike, biologjike, radiologjike, bërthamore dhe eksplozive (CBRNE).

Masa 11.2.1: Mbikëqyrja e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në traktatet ndërkombëtare për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe sistemet e lëshimit të tyre, transferimin e armëve konvencionale dhe zbatimi i masave që synojnë parandalimin e përdorimit të këtyre mallrave për qëllime ushtarake.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i përmbushjes së detyrimeve në traktatet ndërkombëtare që synojnë parandalimin e përdorimit të këtyre mallrave të ndaluara për qëllime ushtarake.

Qëllimi i politikës 12: Rritja e nivelit të mbrojtjes së infrastrukturës kritike

Objektivi specifik 12.1: Reduktimi i rreziqeve që rrjedhin nga transferimet e ndaluara të mjeteve dhe materialeve që mund të përdoren për të kryer një sulm apo akt terrorist.

Masa 12.1.1: Bashkëpunimi në ndarjen e informacioneve kritike mbi aktivitete të karakterit terrorist, me agjencitë ligjzbatuese dhe të inteligjencës në vend dhe ato të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së zbulueshmërisë materialeve të përshtatshme dhe jashtë kontrollit, për prodhimin apo përdorimin e Armëve të zjarrit, lëndëve shpërthyese, armëve të dëmtimit në masë.

Qëllimi i politikës 13: Mbrojtja nga kërcënimet terroriste që cenojnë venddislokimet/infrastrukturën, pajisjet kritike dhe sistemet e mbrojtjes së ministrisë së mbrojtjes dhe FARSH-së

Objektivi specifik 13.1: Identifikimi i nevojave dhe standardeve të mbrojtjes nga kërcënimet terroriste.

Rishikimi i planeve të mbrojtjes të venddislokimve, infrastrukturës kritike, sistemeve dhe pajisjeve kritike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FARSH-së.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i përputhshmërisë me standardet evropiane të mbrojtjes së venddislokimeve, infrastrukturës kritike, sistemeve dhe pajisjeve kritike të strukturave të mbrojtjes kombëtare.

Objektivi specifik 13.2: Konsolidimi i kapaciteteve informative dhe profesionale – operacionale.

Masa 13.2.1: Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit të klasifikuar me strukturat ligjzbatuese të RSH-së, si dhe me ato të NATO-s.

Indikatorë të matshëm:

Indeksi i konsolidimit të kapaciteteve informative dhe operacionale të strukturave të mbrojtjes kombëtare.

Masa 13.2.2: Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme me partnerët për strukturat parandaluese, reaguese dhe pjesëmarrësve në misione paqeruajtëse të FA, në luftën kundër terrorizmit.

PJESA III: MASAT PRIORITARE

Bazuar në objektivat specifike të parashikuar në këtë dokument strategjik, me qëllim përmbushjen e tyre, ndër masat prioritare përmendim, si më poshtë:

- Vënia në zbatim të sistemit ATS-G të të dhënave të pasagjerit.

Kjo masë synon sigurimin e një sistemi funksional të shkëmbimit të të dhënave të pasagjerit. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet përgatitjes dhe miratimit të "Procedurave Standarde të Punës" për grumbullimin dhe përpunimin e Informacionin Paraprak të Pasagjerëve dhe trajnimit të personelit të Komisariatit të Policisë Kufitare Rinas për grumbullimin dhe përpunimin e Informacionin Paraprak të Pasagjerëve. Përdorimi i këtij sistemi nga Njësia e Informacionit të Pasagjerit synon parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave terroriste dhe krimeve të rënda, të parashikuara nga Kodi Penal, të veprave penale me qëllime terroriste, që parashikohen nga kreu VII, i Kodit Penal, si dhe krimet që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, të parashikuara në nenin 19/3, të ligjit nr. 71/2016, "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar. Qëllimi kryesor i përdorimit të sistemit është analiza e profileve të riskut dhe reagimi i shpejtë i strukturave ndërkufitare për parandalimin e personave të dyshuar për terrorizëm ose akteve terroriste përmes implementimit efektiv të API-t (*Automativ Passenger Information*/PNR (*Passenger Name Register*).

Efekti financiar për implementimin e sistemit dhe kostoja për sigurimin e këtij sistemi që do të

mundësojë transmetimin e të dhënave të pasagjerit, për 3 – 5 vitet e para do të mbulohet nga mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë, nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit që Ministria e Brendshme ka negociuar dhe ka finalizuar me shtetin amerikan. Në vijim, për periudhën pas mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë, do të shoqërohet me efekte financiare në sigurimin e programeve të nevojshme për përdorim, në transmetimin dhe marrjen e të dhënave nga kompanitë e transportit të pasagjerëve, si dhe në mirëmbajtjen e sistemit në vazhdimësi, e cila do të vlerësohet dhe përballohet nga buxheti i shtetit për vitet përkatëse.

Sa i përket ngritjes dhe funksionimit të "Njësisë së Informacionit të Pasagjerëve" (NIP) dhe aksesit në Bazën e të Dhënave të Pasagjerit, kostot e ngritjes dhe funksionimit të kësaj strukture ngritja e kësaj strukture e cila do të shoqërohet me kosto, duke llogaritur shtesat e punonjësve me qëllim mbulimin gjatë 24 orëve, ku përfshihen dhe pagesa të ndryshme sipas turneve të natës apo ditëve të pushimit, kostot e parashikuara nga ky program për realizimin e këtyre masave, por edhe komponentëve të tjerë janë përfshirë në aneksin e Planit të Veprimit.

PJESA IV: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

4.1 Implementimi/zbatimi i strategjisë

Për të implementuar me efektivitet Strategjinë do të synohet përmbushja e objektivave strategjikë, atyre specifikë dhe indikatorëve/aktiviteteve nëpërmjet zbatimit të Planit të Veprimit.

4.2 Përgjegjësia e institucioneve dhe angazhimet institucionale

Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike:

- të marrë përgjegjësinë e hartimit të nismave për koordinim, si dhe bashkëveprim midis institucioneve të ndryshme të përmendura në këtë strategji;

- të grumbullojë planet e veprimit apo programet e punës të të gjithë institucioneve të tjera dhe t'i bëjë pjesë të kësaj strategjie. Për këtë, të administrohet një dosje të veçantë sipas standardeve, e cila të mbahet nga Drejtoria e Antiterrorit;

- të ndjekë dhe marrë iniciativën për ripunimin e azhurnimin e strategjive të tjera sektoriale me politikat dhe objektivat e parashikuara në këtë strategji;

- të mundësojë ngritjen e kapaciteteve me burime njerëzore e logjistike të mirë trajnuara kundër terrorizmit me qëllim parandalimin dhe goditjen e këtyre dukurive në Shqipëri;

Policia e Shtetit: është mekanizëm institucional në kuadër të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike e cila parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre;

Drejtoria e Antiterrorit: të hartojë detyra që ndihmojnë në sigurimin e informacioneve dhe masave policore dhe procedurale për parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha aktiviteteve terroriste;

Drejtoria për Krimet Ekonomike dhe Financiare: të hartojë objektiva dhe aktivitete strategjike në drejtim të përmirësimit ligjor dhe operacional të masave parandalimin dhe goditjen e individëve/grupeve të përfshirë në financimin e terrorizmit, si dhe shënjestrimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të tyre;

- Sektori i Krimeve Kompjuterike: të hartojë objektiva dhe aktivitete strategjike në drejtim të përmirësimit ligjor dhe operacional të masave për parandalimin dhe goditjen e individëve/grupeve të përfshirë në krimin kibernetik;

- Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana: të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë partnere nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të informacioneve dhe numrit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta kundër terrorizmit;

- Zyra Kombëtare Europol Tirana: të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të rritjes së bashkëpunimit me agjencitë partnere të Europol nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të informacioneve dhe numrit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta kundër terrorizmit;

Drejtoria e Bashkëpunimit Koordinimit Ndërkombëtar dhe Marrëdhënieve me Publikun: të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, administrative dhe teknike të masave për bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar;

Departamenti për Sigurinë Publike: të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të masave të zgjerimit dhe rritjes së aftësive të policimit në

komunitet për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin: të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të masave të sigurisë në kufi, mbikëqyrjes së lëvizjes së qytetarëve, migracionit të paligjshëm dhe fluksit të refugjatëve dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, si dhe armëve të shkatërrimit në masë;

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara: të planifikojë detyra për administrimin e pasurive të sekuestruara të subjekteve të shpallura si financuese të terrorizmit, duke bllokuar burimet e të ardhurave të krijuara nëpërmjet tyre;

Ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë: të planifikojë objektiva dhe aktivitete për bashkëpunimin e nevojshëm mes Prokurorisë, Interpolit dhe autoriteteve të huaja të drejtësisë në çështje që lidhen me luftën kundër terrorizmit dhe financimit të tij;

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve: të planifikojë dhe zbatojë detyrat që lidhen me rritjen e sigurisë përreth individëve/grupeve të burgosurve për aktivitete që lidhen me ekstremizmin për të parandaluar ata nga rekrutimi i të burgosurve të tjerë;

Ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë: të planifikojë dhe të zbatojë detyrat që lidhen me aktet ligjore e normative sipas drejtimeve përkatëse të institucioneve në varësi, në funksion të parandalimit të akteve terroriste;

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave: të planifikojë objektiva dhe aktivitete si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave të financimit të terrorizmit;

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave: të planifikojë detyra bashkëveprimi me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të garantimit të sigurisë dhe të rendit publik në porte dhe aeroporte, duke përfshirë dhe masat në kuadër të luftës kundër terrorizmit;

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve: të planifikojë detyra për identifikimin e rasteve të pastrimit të parave, si dhe të krimeve në fushën ekonomike në kuadër të luftës kundër terrorizmit;

Banka e Shqipërisë: të planifikojë inspektime për subjekte nën juridiksionin e saj, detyra për kontrolluar zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

Ministria përgjegjëse për mbrojtjen: të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të strategjisë për këtë institucion, sidomos në drejtim të shkëmbimit të informacionit, në krijimin e kapaciteteve dhe aseteve ushtarake, për përdorim të integruar të tyre edhe nga institucionet e tjera shtetërore, si dhe për vënien e tyre në dispozicion të organizmave ndërkombëtare në kuadër të luftës kundër terrorizimit;

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes: të hartojë objektiva dhe aktivitete për përmirësimin e metodave teknike/speciale për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacioneve me qëllim të parandalimit të aktiviteteve terroriste që zhvillohen në dëm të sigurisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve partnere dhe atyre aleate brenda kuadrit të tyre ligjor. Thellim të marrëdhënieve të bashkëpunimit institucional me agjencitë/institucionet që kanë detyra të luftës kundër terrorizmit brenda dhe jashtë vendit;

Forcat e Armatosura: të hartojë objektiva dhe aktivitete për ndërmarrjen e veprimeve operacionale në raste të incidenteve të ndodhura nga veprimtaria e akteve terroriste;

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve: të hartojë objektiva dhe aktivitete për zbatimin e regjimit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë;

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile: të kontribuojë në zbatimin e kësaj strategjie nëpërmjet planifikimit të detyrave dhe aktiviteteve, të cilat ndihmojnë për përballimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive, të shkaktuara si pasojë e akteve terroriste;

Ministria përgjegjëse për Evropën dhe Punët e Jashtme: të ndihmojë me detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie, sidomos në fushën e bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me homologët e huaj e organizatat ndërkombëtare;

Ministria përgjegjëse për arsimin: të kontribuojë në zbatimin e kësaj strategjie duke u fokusuar në edukimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për fenomenin e ekstremizmit dhe radikalizmit, si dhe

në trajtimin e këtij fenomeni në institucionet arsimore dhe në komunitet;

Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit: të hartojë detyra për ndjekjen dhe të analizojë problemet mjedisore dhe vatrat e rrezikshme nga ku mund të vijnë pasoja infektive të rënda, duke informuar dhe marrë masat për eliminimin dhe parandalimin e përhapjes së pasojave;

Ministria e përgjegjëse për shëndetësinë: të hartojë detyra për ndjekje me përparësi funksionimin e sistemit të njoftimit, izolimit apo transportimit (të mostrave biologjike), si dhe analizimin e medikamenteve për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse me karakter të veçantë;

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet: është autoriteti kompetent kombëtar për mbrojtjen nga rrezatimet, si dhe organi që rekomandon veprimet mbrojtëse për përballimin e emergjencave radiologjike. KMR në bashkëpunim me IFB dhe DPE dhe nëpërmjet Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Rrezatimeve" të riformulohet "KMR-ja në bashkëpunim me IFBZ-në. IFBZ-ja verifikon situatat e emergjencës dhe vlerëson ato nëpërmjet Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Rrezatimeve;

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet: të mbikëqyrë zbatimin e të gjitha rregullave dhe procedurave që lidhen me sigurinë në punën me burime të rrezatimeve jonizuese për shmangien e aksidenteve radiologjike të hartojë dhe ndjekë detyrat në lidhje me sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive;

Instituti i Fizikës Bërthamore: siguron të gjitha shërbimet e nevojshme teknike dhe shkencore për monitorimin e situatave emergjente gjatë çdo lloj aksidenti radiologjik nëpërmjet skuadrave të tij të emergjencave në terren dhe në laborator, si dhe nëpërmjet informacionit të siguruar nga Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Rrezatimeve;

Ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë: të hartojë detyra për ndjekje për monitorimin e masave ligjore e normative për parandalimin e përhapjes së rrezikut bioterrorist kryesisht efekteve të sëmundjeve të ndryshme me origjinë mjedisore;

Prokuroria (e Përgjithshme dhe e Posaçme): si institucion përgjegjës për hetimin, ndjekjen penale të terroristëve, ndëshkimin përfundimtar të tyre, konfiskimin e pasurisë dhe aseteve të fituara me anë të aktiviteteve terroriste;

Shërbimi Informativ Shtetëror: të hartojë detyra për intensifikim të mbledhjes dhe përpunimit të informacionit në fushën e terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në funksion të vendimmarrjes strategjike, si dhe të paralajmërimit në kohë të organeve ligjzbatuese. Përgatitja periodike e vlerësimeve analitike mbi kërcënimin nga terrorizmi, radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Thellim të marrëdhënieve të bashkëpunimit me shërbimet partnere dhe strukturat e sigurisë së NATO_s. Të vendosë dhe të mbajë bashkëpunim të përhershëm me strukturat e specializuara dhe të dedikuara të Policisë së Shtetit që merren me luftën kundër terrorizmit, si dhe me agjencitë e tjera ligjzbatuese në vend;

Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë:

të ndihmojë në planifikimin e detyrave për monitorimin dhe parandalimin e akteve terroriste ndaj infrastrukturës energjetike në vend;

të hartojë aktivitete për koordinimin dhe zbatimin e masave përkatëse të sigurisë për parandalimin akteve dhe ndërhyrjeve të jashtëligjshme në aviacionin civil, transportin rrugor, hekurudhor dhe portual;

të hartojë aktivitete në bashkëpunim me mekanizma të pushtetit lokal për parandalimin e akteve dhe ndërhyrjeve të jashtëligjshme në infrastrukturën e furnizimit me ujë të popullatës. Të hartojë aktivitete dhe detyra për ndjekje për monitorimin e masave ligjore e normative për koncesione dhe privatizime në infrastrukturën e rëndësishme në vend;

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor: të hartojë aktivitete për ndjekjen dhe zbatimin e rregullave standarde të kontrollit, duke garantuar kryerjen e veprimtarisë se transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, sipas kuadrit ligjor në fuqi në përputhje me standardet evropiane;

Forca e Sigurisë Portuale: të hartojë aktivitete për ndjekje për monitorimin e sistemeve elektronike të kontrollit të hyrjeve dhe daljeve të gjithë personave, si dhe sistemeve automatike të kontrollit të trafikut të mjeteve detare, që futen dhe dalin në territoret e porteve të Shqipërisë;

Autoriteti Aviacionit Civil: të hartojë dhe të mbikëqyrë aktivitetet që lidhen me organizimin e sigurisë në aviacionin civil në zbatim të legjislacionit kombëtar në fuqi dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Të ndërmarrë masat e nevojshme

për zbatimin e Programit Kombëtar të Sigurisë në Aviacionin Civil;

Inspektorati qendror:

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor: të hartojë aktivitete për ndjekje për forcimin e mekanizmave për sigurinë dhe mbrojtjen e instalimeve kryesore, impianteve, objekteve të rëndësishme dhe mjetet e transportit publik (trena) për parandalimin e akteve terroriste;

Ministria përgjegjëse për arsimin: të hartojë aktivitete mbi evidentimin dhe adresimin e problemeve në komunitet, si dhe të ndërhyjë për zgjidhjen e problemeve sociale, pasi një ndër arsyet e rekrutimit është dhe gjendja ekonomike e vështirë dhe niveli i ulët arsimor;

Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE): të hartojë programe, politika të arsimit, punësimit dhe informimit në kuadër të parandalimit përmes policisë në komunitet të ekstremizmit dhe radikalizimit që çon në ekstremizëm, si dhe uljen e ndikimit të propagandës ekstremiste në rrjetet sociale dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar mediat sociale si kanale të komunikimit për të promovuar narrativa alternative dhe mesazhe pozitive. Në vijim të miratimit të VKM-së 826, datë 26.10.2020 lidhur me procesin e riatdhesimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, Qendra CVE ka si detyrim koordinimin ndërinstitucional, mbështetjen dhe monitorimin e procesit të riatdhesimit dhe zhvillimin e programeve rehabilituese dhe riintegruese;

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP): si institucioni rregullator dhe koordinues i rrjeteve të shpërndarjes së shërbimeve të komunikimeve elektronike, kryesisht shërbimeve të internetit dhe të telefonisë, të mbikëqyrë sigurinë e rrjeteve fizike dhe infrastrukturave të internetit dhe telefonisë nga sulme të gjithfarëllojshme, përfshirë këtu edhe ato me synime terroriste, me qëllim parandalimin e cenimit, paralizimit apo keqpërdorimit të rrjeteve dhe shërbimeve fizike përmes të cilëve personat juridikë, publikë apo privatë, si edhe qytetarët, kanë akses të pandërprerë dhe cilësor në përdorimin e internetit dhe të telefonisë.

4.3 Llogaridhënia dhe raportimi

Llogaridhënia

Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës që udhëheq në hartimin, koordinimin dhe bashkërendimin e institucioneve të përfshira në këtë strategji.

Përqasja dhe rishikimi i dokumentit strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM-së nr. 290, datë 11.4.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS".

Procesi i llogaridhënies, monitorimit dhe analizës vlerësuese do të bëhet nga strukturat koordinuese, si më poshtë:

- Grupi i menaxhimit të integruar të politikave (GMIP);

- Komiteti Drejtues Sektorial (KDS) për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, i cili do të shqyrtojë dhe miratojë raportet në zbatim të politikave dhe objektivave të përcaktuar në këtë dokument strategjik.

Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës që udhëheq hartimin, koordinimin dhe bashkërendimin e institucioneve të përfshira në këtë strategji.

Monitorimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara, për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto dokumente, konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tyre dhe për të mbikëqyrur implementimin periodik, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive.

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së autoriteteve, që kanë detyrime për zbatimin e "Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit", do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të vlerësuar shkallën e realizimit të politikave, objektivave të saj dhe përmbushjes së masave dhe aktiviteteve.

Monitorimi i "Planit të Veprimit të Luftës Kundër Terrorizmit" do të kryhet nga grupi për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP), të miratuar me urdhrin e kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar".

Procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet/agjencitë e inteligjencës, hetimit dhe mbrojtjes përgjegjëse për

luftën kundër terrorizmit, donatorë dhe shoqëria civile, (përfaqësues të organizatave joqeveritare).

Me synim garantimin e përmbushjes së objektivave strategjikë të sigurisë në komunitet, bazuar në këtë dokument strategjik, do të merren masat e mëposhtme:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;
- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe rreziqet, si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progresraporteve të Bashkimit Evropian;
- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- do të jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe integrimit të politikave dhe masave të sigurisë në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Monitorimi do të kryhet bazuar në raporte 6-mujore dhe vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe të vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioriteteve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikat e vendit të lidhura sigurinë në komunitet. Fuqizimi dhe zgjerimi i kuadrit statistikor si në MB, DPPSH dhe institucionet e tjera përgjegjëse do të lehtësojë hartimin e politikave bazuar në evidenca/të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv për përmbushjen e objektivave.

Raportimi

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6-mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatin Teknik Ndërinstitucional.

Të gjithë institucionet të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit dhe Planin e Veprimit do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe një vjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

Ministria e Brendshme do të jetë institucioni lider, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe 1 vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Komiteti Drejtues Sektorial "punët e brendshme", drejtuar nga ministri i Brendshëm, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar", do të shqyrtojë, diskutojë dhe miratojë raportet e progresit, të monitorimit të arritjes së synimeve dhe prioriteteve në zbatim të këtij dokumenti strategjik dhe planit të veprimit. Në vijimësi të takimeve të zhvilluara, KDS-ja analizon situatën e përmbushjes së detyrimeve nga çdo institucion përgjegjës duke bërë dhe sugjerimet përkatëse për përmirësim.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm, progresi në përmbushjen e qëllimeve të Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit do të matet nëpërmjet dy mënyrave të vlerësimit, atë të vlerësimit afatmesëm, që do të kryhet në përfundim të trevjeçarit, në fund të vitit 2023, që do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë për ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social, do të vlerësojë nëse qëllimet janë të qenësishme, duke krahasuar kontekstin fillestar dhe do të identifikojë veprimet e nevojshme.

Bazuar në këtë vlerësim, do të hartohet Plani i Veprimit për vitet 2024 – 2025 për të arritur objektivat e vendosura në strategji.

Një vlerësim përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit, do të analizojë të gjithë strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm, ku do të vlerësohen rezultatet e masave të ndërmarra, burimeve të investuara dhe masën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive të sigurisë në komunitet. Po në këtë kuadër do të shërbejnë edhe raportet e vlerësimit të impaktit, si dhe raporte e studime të kryera nga shoqëria civile dhe donatorët.

Monitorimi i brendshëm do të vlerësojë progresin e bërë duke u mbështetur tek ecuria e indikatorëve:

Si indikatorë të brendshëm do të jenë indikatorët e parashikuar sipas objektivave specifikë.

Si indikatorë të jashtëm do të jenë:

Qëllimi i politikës II	764,173,000	0	764,173,000	20
Qëllimi i politikës III	505,032,000	0	505,032,000	13
Qëllimi i politikës IV	62,500,000	0	62,500,000	2
Qëllimi i politikës V	707,923,000	0	707,923,000	18
Qëllimi i politikës VI	1,025,581,200	0	1,025,581,200	26
Qëllimi i politikës VII	77,805,000	53,662,400	131,467,400	3
Qëllimi i politikës VIII	21,300,000	0	21,300,000	1
Qëllimi i politikës IX	17,500,000	0	17,500,000	0
Qëllimi i politikës X	4,500,000	0	4,500,000	0
Qëllimi i politikës XI	23,178,000	0	23,178,000	1
Qëllimi i politikës XII	4,920,000	0	4,920,000	0
Qëllimi i politikës XIII	26,820,000	0	26,820,000	1
			3,885,644,600	

Kostoja korente	3,831,982,200
Kostoja kapitale	53,662,400
Totali i kostos	3,885,644,600


KOSTO E PLANIT TË VEPRIMIT NDARJA E SHPENZIMEVE
Buxheti 2024-2025
31%
Hendek financiar
2021-2025
0%
Financim I Huaj
0%
PBA 2021-2023
69%


NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE TË PLANIT TË VEPRIMIT
Kosto kapitale 1%
Kosto Korente 99%
Kosto Korente
Kosto kapitale



VENDIM
Nr. 1141, datë 24.12.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ORGANIZATAVE RINORE DHE/OSE PËR TË RINJTË, QË PËRFITOJNË FINANCIME NGA FONDET GRANT NGA BUXHETI I SHTETIT, TË DEDIKUARA PËR RININË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 75/2019, "Për rininë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Agjencia Kombëtare e Rinisë (në vijim AKR-ja), nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, financon projektet e propozuara nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë apo njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) "Autoriteti financues", Agjencia Kombëtare e Rinisë;

b) "Kandidat", çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, organizatë rinore apo organizatë për të rinjtë, përfitues të cilët marrin pjesë në një procedurë konkurrimi, sipas këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi;

c) "Grant", shuma e përcaktuar e fondit për mbështetjen e nismave dhe projekteve për të rinjtë, e shpallur në dokumentet e konkurrimit gjatë një procedure të parashikuar. Kjo shumë i jepet subjektit përfitues nga AKR-ja, në përputhje me kriteret e vendosura sipas këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi;

ç) "Dokumentet e konkurrimit", dokumentet që AKR-ja vë në dispozicion të të gjithë kandidatëve të interesuar për përgatitjen e projektpropozimeve.

3. Organizatat rinore, që do të përfitojnë mbështetje financiare, duhet të plotësojnë kriteret e

përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr. 75/2019, "Për rininë", si dhe kriteret e mëposhtme:

a) të kenë zbatuar, për një periudhë të paktën 2-vjeçare, projekte e programe me impakt te të rinjtë;

b) të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

c) të mos kenë detyrime tatimore;

ç) të mos jenë të dënuar, organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

4. Organizatat për të rinjtë, që do të përfitojnë mbështetje financiare, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 75/2019, "Për rininë", si dhe kriteret e mëposhtme:

a) të mos kenë detyrime tatimore;

b) të mos jenë të dënuar, organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të aplikojnë për t'u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, pas plotësimit të kritereve, si më poshtë vijon:

a) të paraqesin projektpropozimin për zhvillimin e projekteve rinore;

b) të paraqesin shprehjen e interesit të miratuar nga kryetari i bashkisë.

6. Në procesin e shqyrtimit, të përzgjedhjes së subjekteve përfituese dhe të shpërndarjes së fondeve për mbështetjen e nismave dhe projekteve për të rinjtë, AKR-ja dhe Bordi Përzgjedhës i Projekteve mbështeten në parimet e mëposhtme:

a) lirisë në pjesëmarrje e konkurrim;

b) mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë;

c) transparencës së procedurave e të vendimmarrjes, duke u ofruar të gjithë kandidatëve informacionin dhe procedurën përkatëse;

ç) përputhshmërisë me objektivat e grantit dhe me efektivitetin e përdorimit të burimeve, në bazë të sistemit të konkurrimit dhe të kritereve, që mundësojnë vlerësimin e projektpropozimit dhe të specifikimeve teknike e financiare për përzgjedhjen dhe shpërndarjen e grantit;

d) mungesës së prapaveprimit, duke përjashtuar mundësinë e shpërndarjes së fondeve për veprimtari tashmë të realizuara në datën e vendimmarrjes;

dh) paanshmërisë së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe parandalimit të konfliktit të interesave;

e) përjashtimit e mbivendosjes, që nënkupton shmangien e financimit të së njëjtës veprimtari për të njëjtin interes konkret, më shumë se një herë, brenda të njëjtit vit financiar.

II. PROCEDURA DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR MBËSHTETJEN E NISMAVE DHE TË PROJEKTEVE

7. AKR-ja harton dhe publikon, si më poshtë vijon:

a) programin vjetor të financimit;

b) njoftimin paraprak e botimin e çdo procedure konkurrimi për një grant të caktuar dhe vënien në dispozicion të dokumenteve përkatëse të konkurrimit;

c) ndryshimet dhe sqarimet e bëra gjatë procedurës;

ç) dorëzimin e projektpropozimit dhe regjistrimin e kandidatëve pjesëmarrës nga AKR-ja;

d) shqyrtimin e pranueshmërisë së plotësimit të aftësive teknike e financiare e të regjistrimit dhe vlerësimin e projektpropozimit;

dh) njoftimin e rezultateve të konkurrimit, përfshirë kushtet për përshtatje ose ndryshime;

e) në rast refuzimi të aplikimeve, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;

ë) negocimin e mundshëm për ndryshimet e përcaktuara, si kusht për miratimin e projektpropozimit fitues;

f) negocimin dhe nënshkrimin e kontratës;

g) botimin e informacionit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

8. AKR-ja, brenda muajit korrik të çdo viti, harton programin vjetor të financimit të projekteve rinore për vitin pasardhës dhe brenda muajit janar të çdo viti, skemën e shpërndarjes së pjesës së fondit grant, që do të përdoret për financimin e projekteve rinore.

9. AKR-ja konsulton me Këshillin Kombëtar të Rinisë dhe grupet e interesit programin vjetor të financimit të projekteve rinore, si dhe skemën e shpërndarjes së pjesës së fondit grant, që do të përdoret për financimin e projekteve rinore.

10. Programi vjetor dhe skema e shpërndarjes i dërgohen për miratim ministrisë përgjegjëse për rininë.

11. AKR-ja shpall programin vjetor, si dhe skemën e miratuar për shpërndarjen e pjesës së fondit grant, që do të përdoret për financimin e projekteve rinore, në faqen e saj zyrtare në internet.

12. AKR-ja përgatit dokumentet e konkurrimit, në të cilat përfshihen:

a) të dhëna të përgjithshme për AKR-në;

b) kriteret minimale të kualifikimit dhe dokumentacioni i nevojshëm për të provuar këto kritere;

c) kushtet e grantit;

ç) udhëzime për afatet dhe formalitetet që duhet të respektohen;

d) të dhëna për kriteret e përdorura për përzgjedhjen e kandidatëve;

dh) njoftimi për thirrje për propozime, me afatet kohore të secilës fazë të thirrjes dhe fondi në dispozicion për çdo thirrje për projektpropozime;

e) formulari i aplikimit;

ë) formulari i zërave në terma financiarë;

f) kontrata tip.

13. Aplikimi për mbështetje financiare, dërgimi i projektpropozimit dhe i dokumentacionit shoqërues nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore realizohet elektronikisht, përmes portalit përkatës të shërbimeve publike apo në faqen zyrtare të AKR-së.

14. Subjektet konkurruese duhet të plotësojnë dhe të ngarkojnë elektronikisht dokumentet e mëposhtme:

a) formularin e aplikimit, ku të përcaktohet qartësisht qëllimi i projektit dhe veprimtaritë specifike që do të kryhen, në funksion të tij;

b) aktin e regjistrimit në gjykatë;

c) kopjen e statutit, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë zhvillimi i aktiviteteve rinore;

ç) dokumentacionin që provon përvojë në zhvillimin e aktiviteteve rinore;

d) vërtetimin nga organet tatimore që i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;

dh) vërtetimin nga gjykata të 3 (tre) muajve të fundit se nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;

e) vërtetimin bankar të 3 (tre) muajve të fundit nga data e mbylljes së aplikimit;

ë) vërtetim nga gjykata të 3 (tre) muajve të fundit që nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor;

f) bilancin vjetor të tyre, si një kriter për të shpërndarë në mënyrë jo vetëm cilësore por dhe të drejtë grantin për financim;

g) projektpropozimin përkatës dhe/ose dokumentet shoqëruese të tij.

15. Kushtet e grantit përmbajnë:

a) karakteristikat e projektit;

b) fushën e veprimit;

c) objektivat specifikë;

ç) veprimtaritë e nevojshme që duhen kryer;

d) kriteret e vlerësimit të rezultateve.

16. Granti nuk do të përdoret në asnjë rast për financimin e kostove operative të tjera të kandidatit përfitues, jashtë projektit të përzgjedhur.

17. AKR-ja duhet të përcaktojë dhe të përfshijë, në njoftimin për pjesëmarrje në një procedurë konkurrimi, afatin e dorëzimit të projektpropozimeve. Ky afat nuk mund të jetë më i vogël se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga data e botimit të njoftimit.

Afati për vlerësimin e projektpropozimeve dhe shpalljen e rezultateve është jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga afati i përcaktuar në dokumentet e konkurrimit për dorëzimin e projektpropozimeve.

Kandidatët njoftohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të vlerësimit të rezultateve të konkurrimit.

AKR-ja dhe kandidati përfitues nënshkruajnë kontratën brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të rezultateve të konkurrimit.

18. Subjektet konkurruese, projektpropozimet e të cilave janë përjashtuar nga mundësia për financim, kanë të drejtë të paraqesin ankim në përputhje me legjislacionin në fuqi.

19. Vlerësimi i përmbushjes së kritereve të projektpropozimeve dhe subjekteve konkurruese kryhet nga AKR-ja, e cila ka për detyrë:

a) të administrojë aplikimet nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, si dhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) të vlerësojë respektimin e parimeve dhe përmbushjen e kritereve të subjekteve konkurruese dhe të projektpropozimeve, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;

c) të hartojë listën e projektpropozimeve, që plotësojnë kriteret, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga afati i fundit i dorëzimit të tyre;

ç) të monitorojë projektet fituese, brenda afateve të caktuara dhe në përmbushje të qëllimit e objektivave të paraqitura në projektpropozim.

20. Përzgjedhja e projektpropozimeve, që plotësojnë kriteret dhe janë pjesë e listës sipas shkronjës "c", të pikës 19, të këtij vendimi, bëhet nga Bordi Përzgjedhës i Projekteve, i cili ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

21. Bordi Përzgjedhës i Projekteve ka këto detyra:

a) hap, shqyrton dhe vlerëson kriteret e kualifikimit të projektpropozimeve të marra, në përputhje me kriteret dhe afatet e përcaktuara në dokumentet e konkurrimit;

b) shpall rezultatet e konkurrimit dhe vë në dijeni kandidatët pjesëmarrës për projektet jofituese, duke dhënë dhe arsyet përkatëse.

22. Vlerësimi mbështetet në përputhje me projektpropozimin e paraqitur nga kandidati aplikues në procedurat e konkurrimit për financime me grante me qëllimin e organizatës/aplikantëve dhe programin që zbaton, në kapacitetet e kandidatit/aplikantit, në efektshmërinë e aktiviteteve, në pritshmërinë dhe koston e tyre.

23. Projektet përmbajnë të dhëna për qëllimin, objektivat specifikë, veprimtaritë, buxhetin, rezultatet e synuara. Vlerësimi i tyre parashtrohet sipas treguesve të qartë e përcaktimeve të argumentuara. AKR-ja, për çdo thirrje për projektpropozime, vendos në dispozicion të aplikuesve *template*/shembull, i cili përmban strukturën dhe elementet bazë që duhet të ketë në përmbajtje të tij projekti që do të propozohet.

24. Në kontratë përcaktohen mënyra e transferimit të fondit, dokumentacioni dhe mënyra e raportimit financiar dhe performancës, llojet e shpenzimeve të njohura e të pranueshme, format e kontrollit, përfshirë detyrimin e subjektit përfitues për të vënë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacionin për veprimtarinë financiare të kryer, mënyra e dokumentimit të shpenzimeve dhe e produktit/rezultateve të projektpropozimit të financuar, si dhe kushtet apo përgjegjësitë e tjera të ndërsjella.

25. Pagesat nga fondi buxhetor kryhen për organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë me 3 këste:

a) kësti I, deri në 50% të vlerës së financimit menjëherë pas shpalljes fitues të projektit.

b) kësti II, deri në 40% të vlerës së projektit, menjëherë pas përfundimit dhe vlerësimit pozitiv mbi realizimin e fondeve të kështit I.

c) kësti III, 10% e vlerës së projektit, në përfundim të projektit, pas përfundimit dhe vlerësimit të suksesshëm të projektit.

26. AKR-ja shpall në faqen e saj zyrtare të internetit emrat e të gjithë përfituesve të projekteve, përmbledhjen e projekteve të financuara dhe shumat përkatëse të granteve.

27. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1149, datë 24.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 175, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË JOMËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve"; të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) lidhja nr. 1, "Struktura e pagës për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar", që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) lidhja nr. 3, "Struktura e pagës për punonjësit mësimorë të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve", që përmendet në pikën 2/2, zëvendësohet me

lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2021, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", për politikat e reja të pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

Struktura e pagës për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar

	EMËRTIMI/POZICIONI	PAGA MUJORE			
		Paga individuale			**Shtesa e pozicionit**
		Paga e Grupit (PG)	**Shtesa për vjetërsi (SHV)**	**Shtesa për kualifikim (SHK)**	
	1	2	3	4	5
1	Drejtor i shkollës së mesme me mbi 700 nxënës; Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë; Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë; Drejtor në shkollat e specializuara.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	70150
2	Drejtor i shkollës së mesme me 301 deri në 700 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	68750
3	Drejtor i shkollës së mesme me deri në 300 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	67560
4	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme me mbi 700 nxënës; Përgjegjës i bazës prodhuese; Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë; Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë; Zëvendësdrejtor në shkollat e specializuara.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	62700
5	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme me 301 deri në 700 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	61550
6	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme me deri në 300 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	60660
7	Drejtor i shkollës 9-vjeçare me mbi 700 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	58500
8	Drejtor i shkollës 9-vjeçare me 301 deri në 700 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	56950
9	Drejtor i shkollës 9-vjeçare me deri në 300 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	55770
10	Drejtor i shkollës fillore klasa I – IV. Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive; Zëvendësdrejtor i shkollës 9-vjeçare.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	55200
11	Mësues në shkollat e mesme; Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë; Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë; Mësues në shkollat e specializuara; Mësues i praktikës profesionale.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	51750

12	Mësues në arsimin e mesëm të ulët në shkollat 9-vjeçare.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	48300
13	Mësues në arsimin fillor në shkollat 9-vjeçare.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	45200
14	Mësues në arsimin fillor në shkollat 9-vjeçare.	2	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	42200
15	Mësues në arsimin fillor në shkollat 9-vjeçare; Instruktor i praktikës profesionale	3	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	39100

Lidhja nr. 3

Struktura e pagës për punonjësit mësimorë të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve

	EMËRTIMI/POZICIONI	PAGA MUJORE			
		Paga individuale			**Shtesa e pozicionit**
		Paga e Grupit (PG)	**Shtesa për vjetërsi (SHV)**	**Shtesa për kualifikimin (SHK)**	
	1	2	3	4	5
1	Drejtor i konvikteve.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	70150
2	Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	58650
3	Drejtor i kopshtit me ushqim.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	51750
4	Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	50600
5	Drejtor i kopshtit pa ushqim.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	48900
6	Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	48900
7	Edukator konvikti. Kujdestar konvikti	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	45200
8	Edukator në kopësht fëmijësh.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	42200
8	Edukator konvikti; Kujdestar konvikti.	2	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	42200
9	Edukator në kopësht fëmijësh.	2	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	39100

UDHËZIM
Nr. 476, datë 16.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 289, DATË 2.9.2020, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR PAJISJEN ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË SHTETASVE SHQIPTARË"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të nenit 6 dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 8668, datë 23.11.2000, "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", të ndryshuar; të ligjit nr. 9972, datë 28.7.2008, "Për ratifikimin e 'Kontratës koncesionare për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike', ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit SAGEM Security dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve", të ndryshuar; të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", bëhen ndryshimet si vijojnë:

1. Pika 2 e udhëzimit nr. 289, datë 2.9.2020, ndryshon si vijon:

"2. Shtetasi, i cili aplikon për herë të parë për t'u pajisur me pasaportë biometrike, sipas germës "a", të pikës 1, të këtij udhëzimi, plotëson *online* nëpërmjet portalit *e-Albania*, formularin e vetëdeklarimit me fotografi. Formulari i vetëdeklarimit *online*, i përcillet elektronikisht Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Formularin e vetëdeklarimit *online* e plotësojnë dhe shtetasit që nuk aplikojnë për herë të parë, të cilët janë pajisur me pasaportë biometrike para datës 31.12.2011.".

2. Pika 3 e udhëzimit nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", ndryshon si vijon:

"3. Shtetasi, i cili aplikon për herë të parë për t'u pajisur me pasaportë biometrike, sipas germës "b", të pikës 1, të këtij udhëzimi, plotëson *online* nëpërmjet portalit *e-Albania* formularin e vetëdeklarimit me fotografi. Formulari i vetëdeklarimit *online* i përcillet elektronikisht Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në rastet kur shtetasi shqiptar nuk disponon dokumente, të cilat mund të shërbejnë për identifikimin e tij, procesi i verifikimit kryhet nga nëpunësit e autorizuar konsullorë, të cilët përcjellin dokumentacionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Kjo procedurë përcaktohet me udhëzim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Formularin e vetëdeklarimit *online* e plotësojnë dhe shtetasit, që nuk aplikojnë për herë të parë, të cilët janë pajisur me pasaportë biometrike para datës 31.12.2011.".

3. Pika 4, e udhëzimit nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", ndryshon si vijon:

"4. Në aplikimin për herë të parë për pasaportë biometrike, sipas germës "a", të pikës 1, të këtij udhëzimi, të dhënat e formularit të vetëdeklarimit me fotografi, verifikohen nga strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe përcillen elektronikisht në zyrën e aplikimit, brenda:

a) 7 ditëve, për aplikimin me procedurë normale;

b) 1 dite, për aplikimin me procedurë të përshpejtuar".

4. Në pikën 6, të udhëzimit nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", fjala "vend", zëvendësohet me fjalën "subjekt".".

5. Pika 11-të e udhëzimit nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", ndryshon si vijon:

"11. Tërheqja e pasaportës kryhet pranë drejtorive vendore të policisë, nga shtetasi ose i ngarkuari me prokurë të posaçme, apo nga kujdestari ligjor për të miturit dhe për shtetasit të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, sipas procedurës përkatëse.

Për raste të parashikuara, sipas germës "b", pika 1, të këtij udhëzimi, dokumenti pasaportë mund të dërgohet nëpërmjet shërbimit postar të sigurt të

shtetit të huaj, në bazë të parapagimit të kryer nga vetë shtetasit që kanë aplikuar.

Me kërkesë të personave të autorizuar, pasaporta dërgohet nëpërmjet shërbimit postar, në vendbanimin, adresën e deklaruar prej tyre. Dërgimi i pasaportës me postë ofrohet vetëm nëse të dhënat e vendbanimit/adresës së deklaruar në formularin e identifikimit përputhen me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.".

6. Pika 13 e udhëzimit nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", hiqet.

7. Pika 14 e udhëzimit nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", hiqet.

8. Pika 17 e udhëzimit nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", ndryshon si vijon:

"17. Në rastin e parashikuar në shkronjën "d", të pikës 15 të këtij udhëzimi, shtetasi plotëson në 2 (dy) kopje formularin e vetëdeklarimit të humbjes së pasaportës në zyrën e aplikimit. Një kopje e formularit i dërgohet brenda 24 orëve strukturës përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Vetëdeklarimi i humbjes së pasaportës mund të kryhet në zyrat e aplikimit, edhe në rastet kur shtetasit nuk aplikojnë për t'u pajisur me pasaportë biometrike.

Për raste të riaplikimit jashtë vendit, shtetasi plotëson në 2 (dy) kopje formularin e vetëdeklarimit të humbjes së pasaportës, 1 (një) kopje e të cilit i përcillet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe 1 (një) kopje i përcillet zyrës së aplikimit.".

9. Në pikën 18 të udhëzimit nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", pas fjalëve Policia e Shtetit shtohen fjalët ose policia përgjegjëse.

10. Pika 21 e udhëzimit nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", ndryshon si vijon:

"21. Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit për prodhimin e pasaportës biometrike, bëhet si më poshtë:

Formularët e vetëdeklarimit me fotografi dhe formularët e aplikimit arkivohen fizikisht nga zyra e aplikimit, e cila krijon dhe bazën e të dhënave për këto dokumente. Ministrisë së Brendshme i sigurohet akses elektronik në këtë bazë të dhënash.".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

UDHËZIM
Nr. 1, datë 8.1.2021

PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË SKEMËS SË MBËSHTETJES ME NAFTË PËR BUJQËSINË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 137/2021, "Për buxhetin e vitit 2021"; të pikës 16, të vendimit nr. 1142, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e kritereve bazë, masës së përfitimit dhe mënyrës së përdorimit të fondit për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë, për vitin 2021",

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Skema e mbështetjes me naftë për bujqësinë mbulon kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore dhe sezonet përkatëse të mbjelljeve, sipas përcaktimeve në aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Në këtë udhëzim, termat dhe shkurtimet e mëposhtëm, kanë këto kuptime:

a) "AKSHI" është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

b) "AMTP" është Akti i marrjes së tokës në pronësi.

c) "AREB" janë agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor.

d) "ASHK" është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

e) "AZHBR" është Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

f) "Aplikues/subjekt përfitues" është fermeri individual, Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor, personi fizik apo juridik, të cilët kryejnë veprimtari bujqësore.

g) "Kulturë bashkëshoqëruese" është ajo bimë që mbillet njëkohësisht me një bimë tjetër, të quajtur bimë kryesore (p.sh., fasulja është një bimë bashkëshoqëruese, nëse mbillet bashkë me misrin që konsiderohet kulturë kryesore).

h) "Kulturë e dytë" është ajo bimë, që në të njëjtin vit bujqësor, por në periudha të ndryshme, mbillet në të njëjtën sipërfaqe toke me një bimë tjetër, e cila është ekonomikisht më e rëndësishme (e emërtuar si kulturë e parë). Mbjellja e kulturave të dyta nuk është e njëkohshme me kulturat e para (p.sh., misri hamullor konsiderohet kulturë e dytë kur mbillet në të njëjtën tokë mbas grurit që është kulturë e parë).

i) "MBZHR" është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

j) "NIPT" është numri i identifikimit të personit të tatueshëm.

k) "NIPT fermeri" është NIPT-i me status aktiv me të cilin pajiset fermeri individual, sipas procedurës që ndjekin strukturat e tatimeve për këtë kategori të veçantë.

l) "NUIS" është numri unik i identifikimit të subjektit.

m) "Parcelë me kulturë bujqësore dominuese" do të quhet një parcelë e mbjellë me më shumë se një bimë, por që sipërfaqja e mbjellë me njërën nga bimët (bima dominuese) zë të paktën 70% të sipërfaqes së parcelës.

n) "Parcelë me mbjellje mikse" do të quhet një parcelë e mbjellë, në të cilën asnjëra prej bimëve të mbjella në këtë parcelë nuk mbulon më tepër se 70% të sipërfaqes së parcelës.

o) "Sezoni i mbjelljes" lidhet me kohën e mbjelljes. Sezoni i parë përfshin mbjelljet e kulturave bujqësore në periudhën e vjeshtës dhe të pranverës (1 tetor 2020 deri më 31 maj 2021). Sezoni i dytë përfshin mbjelljet në periudhën 1 qershor deri më 30 shtator 2021.

p) "SMI" është Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për të menaxhuar procesin e zbatimit të skemës mbështetëse të naftës për bujqësinë.

q) "Viti bujqësor" fillon në 1 tetor dhe përfundon në 30 shtator të vitit kalendarik pasardhës.

II. KRITERET DHE NORMATIVAT E PËRFITIMIT

1. Subjektet përfituese të skemës mbështetëse të naftës për bujqësinë janë ato subjekte, të cilët për aktivitetin e tyre bujqësor kryejnë punime të mekanizuara në kulturat bujqësore dhe plotësojnë përkatësisht kriteret si më poshtë:

a) fermerët individualë duhet të jenë të pajisur me NIPT-in e fermerit me status aktiv;

b) personat fizikë dhe juridikë të jenë të pajisur me NIPT/NUIS me status aktiv.

2. Çdo subjekt përfitues, duhet të provojë se ka tokë bujqësore në pronësi apo përdorim, sipas përcaktimeve dhe dokumentacionit të kërkuar në kreun IV të këtij udhëzimi.

3. Aplikuesi vetëdeklaron kulturat bujqësore të mbjella ose që parashikon të mbjellë, sipas përcaktimeve të formularit të aplikimit, të paraqitur në aneksin 2.

4. Për të gjitha llojet e subjekteve përfituese, madhësia minimale e sipërfaqes së deklaruar për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, duhet të jetë jo më pak se 0.4 ha, e përbërë nga parcela/ngastra me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

5. Normativat e konsumit të naftës për punimet e mekanizuara dhe sasia e naftës që përfitohet falas nga çdo subjekt përfitues, sipas kulturave bujqësore/grup-kulturave, paraqiten në aneksin 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Përfitimi i sasisë së naftës falas, për sipërfaqen që kultivohet, është si më poshtë:

a) aplikuesit me sipërfaqe deri në 10 ha, përfitojnë 100% sasinë e naftës, sipas normativave të përcaktuara në aneksin 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

b) aplikuesit me sipërfaqe mbi 10 ha, për sipërfaqen mbi 10 ha, marrin sasinë e naftës me normativë të korrektuar/reduktuar, kur sasia e naftës në dispozicion nuk plotëson të gjithë kërkesën për këto sipërfaqe.

Normativa e reduktuar del nga raporti i normativës të konsumit të naftës (sipas pikës 5 më sipër) me një herës. Herësi del nga raporti: i. i nevojave për naftë të aplikuesve me sipërfaqe mbi 10 ha, por jo më shumë se normativa e lejuar; me ii. sasinë e mbetur të naftës në dispozicion për vitin 2021, pasi janë plotësuar nevojat e të gjithë aplikuesve deri në 10 ha që janë kualifikuar si subjekte përfituese.

7. Sasia e naftës falas duhet të tërhiqet nga përfituesit brenda muajit nëntor 2021.

8. Përcaktimi i sasisë së naftës që përfiton aplikuesi është i lidhur me sipërfaqen e kultivuar

dhe llojin e kulturës bujqësore sipas vetëdeklarimit. Në rast se këto sipërfaqe nuk janë të kultivuara apo nuk kultivohen sipas vetëdeklarimit, subjekti përfitues nuk duhet të tërheqë sasinë respektive të naftës, në të kundërt, përbën element penalizues në momentin e verifikimit.

III. PËRLLOGARITJA E MASËS SË PËRFITIMIT

1. Formula mbi përllogaritjen e masës së përfitimit, në përputhje me kriteret dhe normativat e përfitimit, është si vijon:

a) për parcela me kulturë bujqësore dominuese dhe mbi 1 dynym, sasia e naftës = sipërfaqe parcele e mbjellë/kultivuar * normativën e naftës falas për kulturën kryesore.

b) për parcela me mbjellje mikse mbi 2 dynymë, sasia e naftës = shuma e sasive të llogaritura të naftës për çdo kulturë (sasia e naftës për çdo kulturë = sipërfaqe e mbjellë me bimën përkatëse * normativën e naftës falas për këtë kulturë).

c) Për parcelat mikse 1–2 dynymë, sasia e naftës = sipërfaqe parcele e mbjellë/kultivuar * normativën fikse. Normativa fikse është 8 litra për dynym.

Shembuj shpjegues mbi kualifikimin/ moskualifikimin dhe mënyra e llogaritjes së masës së përfitimit përcaktohen në aneksin 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

IV. APLIKIMI PËR SKEMËN E NAFTËS PËR BUJQËSINË

1. Çdo subjekt që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, duhet të bëjë aplikimin *online*, duke plotësuar të dhënat nëpërmjet vetëdeklarimit dhe duke ngarkuar në sistem dokumentacionin e kërkuar.

2. Aplikimet do të bëhen në portalin *e-Albania*, brenda afatit të përcaktuar. Afati i fundit i aplikimit dhe i ngarkimit të dokumentacionit në *e-Albania* është data e përfundimit të aplikimeve.

3. Periudha e aplikimit është nga data 15 janar 2021 deri më 25 shkurt 2021.

4. Aplikimi *online* është i mundshëm përgjatë 24-orëve, nga ora 00:01 e datës së hapjes deri në orën 24:00 të datës së përfundimit të periudhës së aplikimit.

5. Aplikuesi/përfaqësuesi i tij ligjor duhet të jetë i regjistruar ose të bëjë regjistrimin në portalin *e-Albania*, me status si "Biznes", në mënyrë që të vijojë me aplikimin *online*.

Regjistrimi në *e-Albania,* në kategorinë me status "Biznes", duhet të bëhet edhe nga fermerët me NIPT fermeri. Ky regjistrim ka të bëjë vetëm me mënyrën e aplikimit sipas këtij udhëzimi dhe jo me trajtime fiskale apo administrative të tjera.

6. Formulari i aplikimit *online* nëpërmjet *e-Albania* plotësohet nga aplikuesi mbi bazë vetëdeklarimi, në lidhje me:

a) parcelat që kultivohen gjatë vitit;

b) kulturat e mbjella apo që do të mbillen në ato parcela gjatë vitit.

Formulari i plotë i aplikimit së bashku me udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij, jepet në aneksin 2.

7. Deklarimi i mbjelljeve nga aplikuesi bëhet si vijon:

Fermeri do të deklarojë sipërfaqet e mbjella për vitin bujqësor (1 tetor 2020–30 shtator 2021).

Sezoni i parë përfshin mbjelljet e kulturave bujqësore në periudhën e vjeshtës dhe të pranverës (1 tetor 2020 deri më 31 maj 2021). Sezoni i dytë përfshin mbjelljet në periudhën 1 qershor deri më 30 shtator 2021.

Deklarimi i mbjelljeve nga aplikuesi, bëhet si vijon:

a) Për perimet e serrës, fermeri do të deklarojë 2 mbjellje në vit. Fermeri do të deklarojë si mbjellje të parë sipërfaqet që ka të mbjella me perime serre në momentin e aplikimit dhe/ose sipërfaqet që do të mbjellë deri më 31 maj 2021 dhe, si mbjellje të dytë, sipërfaqet që do të mbjellë me perime serre nga 1 qershori 2021 deri më 30 shtator 2021. Në këtë kuadër, ai do të deklarojë sipërfaqet e mbjella me perime vetëm për dy mbjellje, pa deklaruar llojin e bimës së mbjellë.

b) Për drufrutorët, fermeri do të deklarojë sipërfaqen ekzistuese të mbjellë me këto bimë në momentin e kryerjes së deklarimit, si dhe sipërfaqet që do të mbillen deri më 30 shtator 2021, me kusht që sipërfaqet e reja të mos jenë zëvendësime të sipërfaqeve të deklaruara të mbjella me të njëjtat bimë ose me bimë të tjera. Sipërfaqja e deklaruar që është zënë me këto bimë do të llogaritet e kultivuar vetëm një herë.

c) Për kulturat në fushë të hapur, për bimët njëvjeçare të arave dhe perimet e fushës, fermeri do të deklarojë sipërfaqet: i. me bimët e arave të mbjella në vjeshtën 2020 (fakt në momentin e aplikimit) dhe/ose që do të mbillen deri më 31 maj 2021; ii. me perimet e fushës që ka mbjellë (fakt në

momentin e aplikimit) ose që do të mbjellë deri në 31 maj 2021. Për efekt të përfitimit të naftës për bimët e arave, fermeri do të deklarojë edhe sipërfaqet e mbjella ose që do mbillen me kultura të dyta dhe që e zënë tokën deri më 30 shtator të vitit 2021. Llogaritja e naftës për kulturat e dyta do të jetë sa 70% e sasisë që llogaritet për të njëjtat bimë si kultura të para. Në rastin e bimëve bashkëshoqëruese, sipërfaqja do të deklarohet vetëm një herë, vetëm për bimën kryesore. Në të gjitha rastet, sipërfaqja e parcelës me bimë arash nuk mund të deklarohet e kultivuar më shumë se dy herë. Për bimët foragjere shumëvjeçare dhe bimët aromatike-mjekësore, fermeri do të deklarojë sipërfaqen e mbjellë me këto bimë në momentin e kryerjes së deklarimit, si dhe sipërfaqet që do të mbillen deri 30 shtator 2021, me kushtet e përcaktuara në pikën "b" për drufrutorët.

Sezonet e mbjelljeve, sipas kulturave bujqësore / grup-kulturave, përcaktohen në aneksin 1.

8. Gjatë aplikimit *online*, çdo dokument i kërkuar, sipas këtij udhëzimi, do të skanohet dhe ngarkohet në mënyrë elektronike nga aplikuesi, me përjashtim të dokumentit/dokumenteve që ofrohen automatikisht nga portali *e-Albania*).

9. Dokumentacioni i kërkuar për t'u ngarkuar *online,* sipas këtij udhëzimi, duhet të jetë në origjinal ose i noterizuar, si dhe të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj, të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar dhe i vërtetuar nga noteri.

10. Dokumentacioni që duhet të ngarkohet në sistem është në varësi të statusit të pronësisë apo përdorimit të tokës bujqësore për të cilën aplikohet dhe statusit të regjistrimit të saj në ASHK. Në mënyrë të përmbledhur, dokumentacioni i kërkuar sipas skenarëve të ndryshëm, është si më poshtë:

Skenari	**Dokumentacioni i skanuar që duhet të ngarkohet nga aplikuesi**	**Dokumentacioni që ngarkohet automatikisht nga *e-Albania***
Aplikuesi e ka në pronësi tokën bujqësore (në emër të tij) dhe ka marrë certifikatën e pronësisë.	Certifikatën e pronësisë shoqëruar me kartelën e pasurisë dhe hartën treguese	Vërtetimi negativ/pozitiv nga ASHK-ja
Aplikuesi ka AMTP për tokën bujqësore të lëshuar në emër të tij si përfaqësues i familjes bujqësore.	AMTP	Vërtetimi negativ/pozitiv nga ASHK-ja
Aplikuesi është anëtar i familjes bujqësore që ka marrë tokën në pronësi.	AMTP Certifikatë familjare e gjendjes më 1.8.1991 Marrëveshje dakordësie e shumicës së anëtarëve të familjes bujqësore në gjendjen aktuale, në lidhje me punimin/përdorimin e tokës nga aplikuesi	Certifikatë familjare e gjendjes aktuale
Aplikuesi e ka marrë tokën bujqësore me qira ose në përdorim.	Kontratë qiraje ose kontratë huapërdorjeje e noterizuar	Nuk ka

11. Procedura e aplikimit nëpërmjet portalit *e-Albania* përfundon me dërgimin e suksesshëm të formatit elektronik të formularit të aplikimit në sistem dhe aplikuesi njoftohet me një mesazh elektronik.

Aplikimi elektronik do të ketë kushte të programuara në formë, që nuk do të lejojnë vazhdimin e plotësimit të aplikimit, nëse nuk përmbushen kriteret bazë të kualifikimit në lidhje me madhësinë e sipërfaqes totale të deklaruar, madhësinë e parcelave, kulturat e mbjella dhe tipin e dokumentacionit në lidhje me tokën bujqësore.

12. Të gjitha aplikimet e kryera nëpërmjet *e-Albania*, i nënshtrohen procesit të verifikimit administrativ nga AREB-të, sipas kreut V të këtij udhëzimi, që do të shqyrtojnë përputhjet e vetëdeklarimeve, në lidhje me parcelat, sipërfaqet, kulturat dhe dokumentacionin që i mbështet këto deklarime.

13. Pas dërgimit të suksesshëm të aplikimit, përgjigjja mbi rezultatin e aplikimit (i kualifikuar/i skualifikuar), dërgohet tek aplikuesit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të periudhës së aplikimeve.

14. Informacion i nevojshëm për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe të procedimit deri në përfitimin e mbështetjes me naftë për bujqësinë, do të ofrohet pranë Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB-ve), pranë agropikave të AZHBR-së, si dhe në faqet zyrtare të internetit të MBZHR-së dhe AZHBR-së.

15. Aplikuesit, kur e kanë të nevojshme, gjatë procesit të aplikimit asistohen nga specialistët e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor, agropikave, si dhe nëpërmjet numrit jeshil: 08008383. Në këtë proces, asistencë do të sigurohet edhe nëpërmjet bashkëpunimit me bashkitë/njësitë administrative përkatëse.

16. Të dhënat elektronike të dërguara gjatë aplikimit administrohen respektivisht nga MBZHR-ja, AREB-të apo AZHBR-ja, sipas legjislacionit në fuqi.

V. PROCEDURA QË DO TË NDIQET PËR KUALIFIKIMIN, VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E MBËSHTETJES ME NAFTË PËR BUJQËSINË

1. AREB-të bëjnë kontrollin administrativ të vetëdeklarimit dhe të dokumentacionit të aplikuesit, të ngarkuar/gjeneruar nga sistemi *online* dhe në përputhje me kriteret, bëhet miratimi/skualifikimi i aplikimeve përkatëse dhe përllogaritet sasia e naftës për bujqësinë që përfiton aplikuesi.

2. AREB-të përcaktojnë punonjësit që do të merren me kontrollin administrativ dhe qarkun që do të mbulojnë ato, brenda zonës së AREB-së. Bazuar në pritshmëritë e aplikimeve, referuar numrit të atyre që kanë marrë NIPT, fermeri[16], numri orientues i punonjësve për kontrollin administrativ të aplikimeve, për mbulimin e qarqeve të ndryshme, jepet në tabelën e aneksit 5 (pika 5.1), bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Punonjësit e AREB-ve që do të merren me kontrollin administrativ, do të aksesojnë aplikimet *online* nëpërmjet *e-Albania* ose Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të naftës për Bujqësinë, me anë të kredencialeve të përcaktuara nga *e-Albania*/AKSHI.

4. Të gjithë punonjësit, që do të merren me kontrollin administrativ, si dhe drejtorët e AREB-ve do të pajisen me të drejtat për mundësinë e nënshkrimit elektronik nga AKSHI. Çdo veprim që rezulton në vendimmarrje mbi aplikimet do të nënshkruhet elektronikisht nga nivelet respektive vendimmarrëse, sipas këtij udhëzimi. Vetëm në rast të mosfunksionimit të SMI-së, vendimmarrja mbi aplikimet mund të firmoset edhe në formë fizike.

5. Kontrolli administrativ nga AREB-të do të shqyrtojë përputhjet e vetëdeklarimeve në lidhje me parcelat, sipërfaqet, kulturat dhe dokumentacionin që i mbështet këto deklarime. Punonjësi i AREB-së kontrollon sa më poshtë:

a) nëse dokumentacioni i ngarkuar në aplikim është dokumentacioni i duhur, me karakteristikat dhe elementet e kërkuara sipas këtij udhëzimi;

b) nëse të dhënat e dokumentacionit të ngarkuar në aplikim, përkojnë me të dhënat e identitetit të aplikuesit;

Pas kontrollit, sipas shkronjës "a" dhe shkronjës "b", punonjësi i AREB-së lë një shënim në sistem, duke:

i. konfirmuar që dokumentacioni i ngarkuar ËSHTË sipas kërkesave që lidhen me llojin e dokumentacionit.

ii. konfirmuar që dokumentacioni i ngarkuar NUK ËSHTË sipas kërkesave mbi llojin e dokumentacionit. Në këtë rast punonjësi i AREB-së do të shënojë në sistem çfarë problematike ka ky dokumentacion;

c) nëse sipërfaqet e vetëdeklaruara për mbjellje janë të mbështetura me dokumentacionin e duhur pronësor apo të përdorimit të tokës. Për këtë, punonjësi i AREB-së kontrollon formularin e aplikimit mbi sipërfaqet e çdo parcele dhe verifikon nëse kjo parcelë është dokumentuar në dokumentet e ngarkuar në sistem. Në aneksin 5 (pika 5.2), paraqiten veprimet për çdo rast specifik që mund t'i dalë punonjësit gjatë këtij verifikimi;

d) gabime të tjera të mundshme.

Pas kontrollit, sipas shkronjës "c" dhe shkronjës "d", punonjësi lë një shënim në sistem, duke:

i. konfirmuar që sipërfaqet dhe mbjelljet e deklaruara JANË sipas kërkesave të këtij udhëzimi dhe të bazuara në dokumentacion;

ii. konfirmuar që sipërfaqet dhe mbjelljet e deklaruara NUK JANË sipas kërkesave të këtij udhëzimi dhe nuk janë të bazuara në dokumentacion. Në këtë rast, punonjësi i AREB-së do të shënojë në sistem arsyet e këtij konstatimi dhe do të kërkojë nga aplikuesi që të plotësojë dokumentacionin në afatin e përcaktuar sipas këtij udhëzimi;

[16] Sipas të dhënave deri në nëntor 2020, janë rreth 49 148 fermerë me NIPT.

iii. shënime mbi gabime të tjera, të identifikuara nga punonjësi i AREB-së.

6. Në përfundim të procesit të verifikimit administrativ të mësipërm, aplikuesi merr një mesazh i cili deklaron një nga situatat e mundshme si më poshtë:

a) aplikimi është gjykuar i vlefshëm dhe ka kaluar në fazën e përllogaritjes së përfitimit të naftës për bujqësinë;

b) aplikimi ka mangësi dhe kërkon veprime shtesë nga aplikuesi, të cilat ai duhet t'i kryejë brenda 10 ditëve kalendarike, nga momenti i lajmërimit të marrë në sistem për plotësim.

7. Pas kthimit të përgjigjes elektronike nga aplikuesi ose në mungesë të kësaj përgjigjeje brenda afateve zyrtare, në lidhje me plotësimet dokumentare apo plotësimet e fushave të caktuara të formës në afatin e kërkuar, punonjësi i AREB-së që ka trajtuar aplikimin përkatës bën ndryshimet e nevojshme në formën dhe dokumentacionin, dhe në bazë të informacionit shtesë të paraqitur ose mungesës së tij, merr vendimet e mëposhtme:

a) aplikimi gjykohet i vlefshëm në mënyrë tërësore;

b) aplikimi gjykohet i vlefshëm në mënyrë pjesore (vetëm për ato sipërfaqe dhe të mbjella që kanë rezultuar në respektim të kërkesave të këtij udhëzimi);

c) aplikimi refuzohet.

8. E gjithë lista e aplikuesve me statusin e secilit aplikim, sipas pikës 7 më sipër, i kalon për shqyrtim dhe miratim drejtorit të AREB-së. Drejtori, pasi shqyrton/kontrollon listën, mund të bëjë ndryshime të argumentuara, duke lënë shënim në sistem dhe në përfundim të këtij procesi:

a) miraton me nënshkrim elektronik listën e aplikimeve të miratuara (tërësore ose pjesore);

b) miraton me nënshkrim elektronik listën e aplikimeve të refuzuara.

9. Lista e aplikimeve të miratuara dhe e atyre të skualifikuara nga AREB-të, i kalon MBZHR-së, e cila e akseson këtë ose në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të naftës për bujqësinë ose në një formë tjetër elektronike.

Këto lista dërgohen zyrtarisht pranë MBZHR-së edhe në formë shkresore.

10. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me urdhër të ministrit, krijohet një njësi e posaçme ku mund të angazhohen edhe burime *ad hoc*, për të garantuar zbatimin, monitorimin dhe koordinimin e të gjithë procesit që lidhet me skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë.

11. Për të menaxhuar procesin e zbatimit të skemës për mbështetjen e fermerëve me naftë për bujqësinë, ngrihet Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (SMI), i cili administrohet nga MBZHR-ja dhe që do të mundësojë:

a) menaxhimin e aplikimeve *online,* duke mundësuar grumbullimin dhe shqyrtimin administrativ të tyre;

b) vlerësimin e sasisë së naftës që përfitohet, mbështetur në vetëdeklarim dhe duke u bazuar te sipërfaqet e tokës bujqësore dhe kulturat e deklaruara;

c) menaxhimin e shpërndarjes së kartave individuale të naftës te subjektet përfituese;

ç) gjurmimin e tërheqjeve të naftës nga subjektet përfituese;

d) përzgjedhjen e subjekteve përfituese që do t'i nënshtrohen kontrollit në terren.

dh) menaxhimin e procesit të kontrollit në terren që do të vlerësojë përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale në terren;

e) gjenerimin e raportimeve të ndryshme në faza të caktuara të zbatimit të skemës, sipas kërkesave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

12. Vetëm në rast se vlera totale e kërkesave/nevojave sipas aplikimeve, tejkalon sasinë e naftës së vënë në dispozicion për skemën mbështetëse, atëherë zbatohet parimi: "Kush vjen i pari, shërbehet i pari".

13. Bazuar në listat e dërguara zyrtarisht nga AREB-të, njësia e posaçme në MBZHR publikon në faqen zyrtare të internetit të ministrisë, listën e përfituesve dhe masën përkatëse të përllogaritur të naftës për subjektet përfituese.

Lista publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të AZHBR-së.

14. Sasia e naftës së përfituar nga subjektet përkatëse do të ndahet në dy periudha brenda vitit dhe tërheqja e sasisë respektive bëhet vetëm brenda periudhës së përcaktuar, por jo më vonë se data 30 nëntor 2021.

15. Lista me subjektet përfituese, sasitë respektive të naftës për secilin prej tyre dhe ndarjen e sasive të lejueshme për t'u tërhequr për çdo sezon, i dërgohen operatorit furnizues të naftës të kontraktuar nga MBZHR-ja. Operatori është i detyruar të prodhojë kartat e naftës për çdo subjekt

përfitues. Sasia e kartave të prodhuara do t'i dorëzohet MBZHR-së, e cila organizon dërgimin e tyre sipas rajoneve të mbuluara nga AREB-të.

16. Shpërndarja e kartave te subjektet përfituese bëhet pranë AREB-ve, të cilat njoftojnë subjektet brenda rajonit përkatës që mbulojnë. AREB-të dorëzojnë kartat duke firmosur procesverbalin përkatës dhe hedhin në sistemin SMI të naftës për bujqësinë, informacionin për dorëzimin e kartës te subjekti përfitues. Formulari për procesverbalin e dorëzimit të kartës dhe të formës për t'u hedhur në SMI, gjendet në aneksin 6.

17. Nafta për bujqësinë, që do të tërhiqet nga subjektet përfituese, mundësohet nëpërmjet operatorëve furnizues të kontraktuar nga MBZHR-ja, në bazë të përzgjedhjes sipas procedurave ligjore prokuruese (në zbatim të VKM-së nr. 889, datë 11.11.2020, "Për disa shtesa në vendimin nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, 'Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime"', të ndryshuar), nëpërmjet pikave të tyre të shpërndarjes, ku subjektet përfituese paraqiten me kartën individuale në të cilën është hedhur sasia e naftës, që ka të drejtë të tërheqë subjekti përfitues përkatës. Procedurat për regjistrimin dhe dokumentimin e tërheqjeve nga operatori shpërndarës, përcaktohen në kontratën që MBZHR-ja ka lidhur me këtë operator.

VI. KONTROLLI I ZBATIMIT TË SKEMËS NGA AZHBR-ja

1. AZHBR-ja është institucioni përgjegjës për verifikimin dhe kontrollin e subjekteve përfituese, sipas kritereve të përcaktuar në këtë udhëzim.

2. AZHBR-ja gëzon të drejtën për të kërkuar çdo informacion shtesë nga subjektet përfituese, në rast se e gjykon të arsyeshme brenda kritereve dhe procedurave të miratuara.

3. Çdo subjekt përfitues i naftës për bujqësinë është subjekt potencial kontrolli nga ana e AZHBR-së. Kontrollet kryhen pas shpalljes së listës së përfituesve dhe vazhdojnë në varësi të periudhave të deklaruara për mbjelljen e kulturave.

4. Kontrolli i subjekteve përfituese të naftës për bujqësinë mund të jetë i plotë ose me zgjedhje rastësore. Kontrolli do të jetë i plotë për të gjitha subjektet përfituese me sipërfaqe mbi 10 ha dhe me zgjedhje rastësore për subjektet përfituese me sipërfaqe deri në 10 ha. Kontrolli me zgjedhje rastësore duhet të bëhet sipas kritereve të zgjedhjes përfaqësuese, duke pasur parasysh shpërndarjen gjeografike të përfituesve, madhësinë e fermës përfituese, kulturën bujqësore përfituese dhe sezonin e mbjelljeve. Kontrolli në terren duhet të bëhet për jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e të gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha.

5. Grupi i kontrollit në terren bën verifikimin në vend, duke lajmëruar paraprakisht subjektin përfitues për praninë e tij ose përfaqësuesin ligjor të pajisur me prokurë. Grupi i kontrollit paraqitet te subjekti përfitues për t'u kontrolluar me formularin e vetëdeklarimit të sipërfaqeve të planifikuara për t'u kultivuar prej tij.

6. Grupi i kontrollit, në prani të subjektit përfitues ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson raportin e verifikimit. Raporti i verifikimit firmoset nga subjekti përfitues/përfaqësuesi i tij ligjor dhe i gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast që subjekti përfitues nuk pranon vendimin e grupit të verifikimit, ai mund të bëjë shënimet/komentet e nevojshme dhe të firmosë për to. Formularët/raportet e verifikimit në terren, sipas aneksit 7, përgatiten nga AZHBR-ja, në përputhje dhe në zbatim të këtij udhëzimi.

7. Kur grupi i verifikimit ka mendime të ndryshme me subjektin përfitues, në lidhje me gjetjet faktike në terren, përkundrejt formularit të vetëdeklarimit, një ekip i Drejtorisë së Kontrollit të AZHBR-së qendër, bën riverifikim të rastit, vendimi i argumentuar i të cilit është i pakontestueshëm administrativisht nga palët.

8. Informacioni i raportit të verifikimit, ngarkohet në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit (SMI) për skemën mbështetëse të naftës për bujqësinë, sipas kërkesave të sistemit.

9. Në vlerësimin e përputhshmërisë së vetëdeklarimeve me situatën reale në terren, shmangia e lejuar e faktit të verifikuar të kulturave dhe e sipërfaqes së kultivuar, në raport me naftën e tërhequr sipas aplikimit të miratuar, duhet të jetë jo më e madhe se 20%. Devijimi mban parasysh, si diferencën në sipërfaqen e kulturave, ashtu edhe ndryshimet në kulturat e kultivuara, sipas aneksit 1, aneksit 2 dhe aneksit 3.

10. Në rast se vlerësohet një devijim më i madh se 20% (sipas përcaktimit të pikës 9 më sipër) ose

konstatohen deklarime/dokumente të pasakta, subjekti përfitues:

a) përjashtohet për 3 vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit;

b) referuar shkronjës "a" të kësaj pike, subjektet me status fizik dhe juridik shpallen edhe debitor për vlerën e përfituar në mënyrë të padrejtë.

11. AZHBR-ja dërgon zyrtarisht në mënyrë periodike në MBZHR listën sipas përcaktimeve të pikës 10 të këtij kreu.

12. Trajtimi i ankesave bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

13. Procedurat mbi procesin e verifikimeve sipas këtij kreu, përcaktohen në një manual të veçantë nga AZHBR-ja.

VI. NDËRGJEGJËSIMI, INFORMIMI DHE ASISTENCA

1. MBZHR-ja, AREB-të dhe AZHBR-ja, në bashkëpunim me AKSHI-n, hartojnë dhe zbatojnë një plan trajnimi për të gjithë stafin që do të përfshihet në procesin e implementimit të skemës së shpërndarjes së naftës për bujqësinë.

2. MBZHR-ja, AREB-të dhe agropikat/AZHBR hartojnë dhe zbatojnë një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjitha grupet e interesit për skemën e përfitimit dhe kriteret që duhet të plotësojnë të gjithë aplikuesit e skemës mbështetëse me naftë falas për bujqësinë.

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Të gjitha përcaktimet për punimet e mekanizuara në bujqësi të udhëzimit nr. 1, datë 29.12.2005, "Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 703, datë 16.11.2005, 'Për furnizimin me karburant, pa akcizë, për mekanikën bujqësore, serrat me ngrohje dhe subjektet që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit'", që janë në kundërshtim me këtë udhëzim, shfuqizohen.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen AREB-të, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

Lista e anekseve bashkëlidhur udhëzimit:

- Aneksi 1. Kulturat bujqësore/grup-kulturat që mbështeten nga skema e naftës për bujqësinë
- Aneksi 2. Formulari i vetëdeklarimit të aplikuesit
- Aneksi 3. Normativat e konsumit të naftës të punimeve të mekanizuara, sipas grupimeve kryesore dhe sasia e naftës që përfitohet falas
- Aneksi 4. Shembuj shpjegues mbi kualifikimin/moskualifikimin dhe llogaritjen e naftës falas sipas skenarëve të ndryshëm
- Aneksi 5. Numri i punonjësve dhe procedurat e kontrollit administrativ nga AREB-të
- Aneksi 6. Pajisja me kartë
- Aneksi 7. Formularët/raportet e verifikimit në terren

ANEKSI 1
KULTURAT BUJQËSORE/GRUP-KULTURAT QË MBËSHTETEN NGA SKEMA E NAFTËS PËR BUJQËSINË

Grupi	Kodi	Nëngrupi	Specifikime	Sezoni I (1.10.'20–31.5.'21)		Sezoni II Kultura të dyta (1.6–30.9.'21)
				Mbjellë në vjeshtë 2020	Mbjellje pranverore 2021	
Bime arash	A.1	Pranverore	Misër		x	x
			Fasule		x	x
			Luledielli		x	
			Sojë		x	
			Sorgum		x	
	A.2	Të lashta	Grurë	x		
			Tërshërë	x		
			Thekër	x		
			Elb	x	x	
		Foragjere njëvjeçare		x	x	x
		Industriale	Patate		x	x
			Duhan		x	
			Panxhar		x	
			Pambuk		x	
	A.3	Foragjere Shumëvjeçare		x	x	
		Bimë Aromatike-mjekësore		x	x	
Drufrutorë	B.1	Molla		x	x	
	B.2	Drufrutorë, të tjera	Të gjitha llojet e frutave, agrume dhe vreshta (përjashtuar ullirin)	x	x	
	B.3	Arrore	Arra, bajame, lajthi dhe gështenjë (të kultivuara)	x	x	
	B.4	Prodhim fidanësh drufrutorë	Për të gjithë fidanët e bimëve farore, bërthamore, arrore, agrume dhe vreshta (përjashtuar ullirin)	x	x	
Perime	C.1	Perime fushe, sezoni 1	Të gjitha llojet e perimeve, përfshirë shalqi, pjepër, luleshtrydhe	x	x	
	C.2	Perime fushe Sezoni 2	Të gjitha llojet e perimeve			x
	C.3	Perime serre, sezoni 1	Të gjitha llojet e perimeve	x	x	
	C.4	Perime serre, sezoni 2	Të gjitha llojet e perimeve			x

ANEKSI 2
FORMULARI I VETËDEKLARIMIT TË APLIKUESIT

EKRANI 1 - I. Të dhënat identifikuese

Mbasi aplikanti hyn (*log-in* me NIPT) shfaqet ekrani i parë me të dhënat identifikuese, të gjitha të dhënat këtu janë të plotësuara automatikisht (dhe nuk mund të ndryshohen).



EKRANI 2 - II. Të dhënat e aplikimit



Instruksione (i) të automatizuara për mbushjen e formularit – Faqja 2

Instruksionet janë sipas numrave pas shenjës "?" në formë.

1. Përcaktoni adresën ku gjendet toka bujqësore për të cilën do të aplikoni. Nëse keni toka në më shumë se një adresë, fillimisht mbaroni me parcelat në një adresë dhe pastaj shtoni një adresë të re.

2. Sipërfaqja e parcelës duhet të korrespondojë me sipërfaqen që ka kjo parcelë në dokumentet e pronësisë ose të përdorimit. Për t'u kualifikuar sipërfaqja duhet të jetë më e madhe ose baras ≥ 1000 m^2.

3. "Nëse keni serrë në këtë parcelë shënoni sipërfaqen e mbuluar me serrë. Nëse jo, shënoni 0".

4. Shënoni, nëse sipas dokumenteve të pronësisë apo të përdorimit e keni informacionin për këtë parcelë. Nëse parcela është me dokument AMTP dhe nuk e keni këtë informacion zgjidhni "Nuk e di".

5. (Në rast se certifikata e pronësisë)

Certifikata e pronësisë duhet të jetë e shoqëruar me kartelën e pasurisë dhe hartën treguese.

EKRANI 3 - III. Informacione për parcelën



Instruksione (i) të automatizuara për mbushjen e formularit – faqja 3

Instruksionet janë sipas numrave pas shenjës "?" në formë.

Deklarimi i kulturave në serrë

1. Në këtë seksion vendosni mbjelljet ekzistuese në serrë (nëse ka) dhe ato që do të mbillni gjatë 2021-shit. Gjithsej dy mbjellje do të pranohen për serrën. Të gjitha llojet e perimeve të kultivuara në serë janë futur në një grupim "Perime serre".

2. Vendosni sipërfaqen përkatëse për perimet që keni aktualisht në serë ose që do të mbillni deri në 31 Maj 2021.

3. Vendosni sipërfaqen përkatëse për mbjelljen e dytë të perimeve, që planifikoni të bëhet nga 1 Qershori deri në 30 Shtator 2021.

Deklarimi i Pemëtoreve

4. Në këtë seksion vendosni sipërfaqet e zëna me drufrutorë ose vreshta të sistemuara në bllok (të mekanizuar)

5. Vendosni llojin e drurit frutor dhe sipërfaqen përkatëse për pemëtoret/vreshtat ekzistuese në momentin e aplikimit. Nëse nuk keni mos e plotësoni këtë fushë.

Te "Drufrutorë, të tjera" përfshihen "Të gjitha llojet e frutave, agrume dhe vreshta".

6. Vendosni llojin e drurit frutor dhe sipërfaqen përkatëse për pemëtoret/vreshtat që planifikoni të mbillni deri më 30 Shtator 2021. Nëse nuk planifikoni, mos e plotësoni këtë fushë.

Te "Drufrutorë, të tjera" përfshihen "Të gjitha llojet e frutave, agrume dhe vreshta".

Deklarimi i kulturave në fushë të hapur

7. Në këtë seksion vendosni kulturat që janë të mbjella në momentin e aplikimit dhe/ose që do të mbillen në parcelë. Në rastin e bimëve bashkë-shoqëruese, sipërfaqja do të deklarohet vetëm një herë, vetëm për bimën kryesore. Në të gjitha rastet, sipërfaqja e parcelës me bimë arash nuk mund të deklarohet e kultivuar më shumë se dy herë

8. Vendosni kulturat dhe sipërfaqet përkatëse që keni aktualisht në arë si edhe ato që planifikoni të mbillni deri në 31 Maj 2021. Këtu përfshihen:

i. bimët e arave të mbjella në vjeshtën 2020 dhe/ose që do të mbillen deri në 31 Maj 2021

ii. perimet e fushës që ka mbjellë ose do të mbjellë deri në 31 Maj 2021,

iii. bimët shumëvjeçare.

Nëse nuk keni, mos e plotësoni këtë fushë.

9. Vendosni llojin e kulturave dhe sipërfaqet përkatëse, në rast se planifikoni të mbillni kultura të dyta gjatë vitit 2021 (deri në 30 Shtator 2021). Këtu përfshihen edhe perimet e fushës të sezonit të dytë të mbjelljes. Nëse nuk planifikoni, mos e plotësoni këtë fushë.

EKRANI 4 - IV. Dërgimi i aplikimit



KUSHTET LOGJIKE TË PROGRAMUARA NË FORMULARIN E APLIKIMIT

EKRANI 3 – III. Informacione për parcelën



Kontrollet logjike për Siperfaqet, si edhe Formulat

Variabli	Shpjegimet dhe formulat	Kushte logjike	Shënimi që del
ParSx	Sipërfaqja e parcelës		
SRx	Sipërfaqja e serrës	SRx <= ParSx	Sipërfaqja e serrës nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e parcelës
Sr1	Sipërfaqja e serrës e mbjellë në sezonin 1	Sr1 <= SRx	Sipërfaqja e mbjellë në serrë nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e serrës
Sr2	Sipërfaqja e serrës e mbjellë në sezonin 2	Sr2 <= SRx	Sipërfaqja e mbjellë në serrë nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e serrës
Sp1x	Sipërfaqja: Pemëtore ekzistuese me një kulturë drufrutore	SP1x <= ParSx - SRx	Sipërfaqja me drufrutorë ekzistues nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e mbetur e parcelës
Sp2x	Sipërfaqja: Pemëtore e re me një kulturë drufrutore	SP2x <= ParSx - SRx	Sipërfaqja me drufrutorë të rinj nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e mbetur e parcelës
SP1	Total (pemëtore ekzistuese) Sum (Sp1x)	SP1 <= ParSx - SRx	Sipërfaqja me drufrutorë ekzistues nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e mbetur e parcelës
SP2	Total (pemëtore e re) Sum (Sp2x)	SP2 <= ParSx - SRx	Sipërfaqja me drufrutorë të rinj nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e mbetur e parcelës
SP	SP1 + SP2	SP <= ParSx - SRx	Sipërfaqja totale me drufrutorë (ekzistues + të rinj) nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e mbetur e parcelës
Sf1x	Sipërfaqja e mbjellë në fushë të hapur në sezonin vjeshtë 2020-pranverë 2021 (për bimë)	Sf1x <= ParSx – SRx - SP	Sipërfaqja e mbjellë me bimë arash apo perime fushe nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e mbetur e parcelës
SF1	Total (fushë/arë) Sum (Sf1x)	SF1 <= ParSx – SRx - SP	Sipërfaqja e mbjellë me bimë arash apo perime fushe nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e mbetur e parcelës
Sf2x	Sipërfaqja e mbjellë në fushë të hapur për kultura të dyta (për bimë)	Sf2x <= ParSx – SRx - SP	Sipërfaqja e mbjellë me kultura të dyta nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e mbetur e parcelës
SF2	Total ("kulturë e dytë" në arë) Sum (Sf2x)	SF2 <= ParSx – SRx - SP	Sipërfaqja e mbjellë me kultura të dyta nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e mbetur e parcelës
TotMbj1	Total = Sr1+SP+SF1	TotMbj1 <= ParSx	Sipërfaqja e mbjellë me të gjitha kulturat nuk mund të jetë më e madhe së sipërfaqja e parcelës
TotMbj2	Total = Sr2+SP+SF2	TotMbj2 <= ParSx	Sipërfaqja e mbjellë me të gjitha kulturat nuk mund të jetë më e madhe së sipërfaqja e parcelës

Kushte logjike të tjera

(duhet të jetë)	
IF SRx > 0 THEN ((Sr1 > 0 AND Sr1 <= SRx) OR (Sr2 > 0 AND Sr2 <= SRx))	Nëse ka serrë, duhet të ketë mbjellje të paktën në një sezon, dhe sip. totale e mbjellë në sezon duhet të jetë më e vogël ose baras <= sip. e serrës
IF SRx = 0 THEN (Sr1 = 0 AND Sr2 = 0)	Nëse nuk ka serrë, nuk ka sip. të mbjellë në serrë
IF (SRx=0 AND SP=0) THEN (SF1 <= ParSx AND SF1 > 0)	Në rast se ka vetëm arë, atëherë duhet të ketë sipërfaqe të mbjellë në arë (mbjellje të para ose ekzistuese)
IF (SRx + SP < ParSx) AND (SRx>0 OR SP>0) THEN ((SF1 <= ParSx – (SRx+SP) AND SF1 >= 0) AND (SF2 <= ParSx – (SRx+SP) AND SF2 >= 0)	Nëse ka arë dhe (serrë ose pemëtore), në raste të veçanta mund të ketë sip. are të pambjellë (djerrë)
TotMbj1 <= ParSx AND TotMbj2 <= ParSx AND (TotMbj1 > 0 OR TotMbj2 > 0)	Duhet të ketë sipërfaqe të mbjellë (të paktën për një sezon)

ANEKSI 3
NORMATIVAT E KONSUMIT TË NAFTËS TË PUNIMEVE TË MEKANIZUARA, SIPAS GRUPIMEVE KRYESORE DHE SASIA E NAFTËS QË PËRFITOHET FALAS

Nr./ Kodi	**Kultura bujqësore/grup-kulturash**	**Normativa e e konsumit të naftës të punimeve të mekanizuara**	**Sasia e naftës që përfitohet falas***	**Specifikime**
		L/ha	**L/ha**	
A	**Bimë arash**			
A.1	Grupi 1	190	**106**	Pranverore (misër, fasule, luledielli, sojë, sorgum)
A.2	Grupi 2	130	**73**	Të lashta (grurë, tërshërë, thekër, elb), Foragjere njëvjeçare, industriale (patate, duhan, panxhar, pambuk)
A.3	Grupi 3	90	**50**	Foragjere shumëvjeçare, bimë aromatike-mjekësore
B	**Drufrutorë**			
B.1	Mollë	190	**106**	
B.2	Drufrutorë, të tjera	160	**90**	Të gjitha llojet e frutave, agrume dhe vreshta
B.3	Arrore	140	**78**	Arra, bajame, lajthi dhe gështenja (të kultivuara)
B.4	Prodhim i fidanëve frutorë, agrume e arrore	170	**95**	Për të gjithë fidanët e bimëve farore, bërthamore dhe arrore
C	**Perime**			
C.1	Perime fushe, sezoni 1	150	**84**	Të gjitha llojet e perimeve, përfshirë shalqi, pjepër, luleshtrydhe
C.2	Perime fushe, sezoni 2	120	**67**	Të gjitha llojet e perimeve
C.3	Perime serre, sezoni 1	170	**95**	Të gjitha llojet e perimeve
C.4	Perime serre, sezoni 2	140	**78**	Të gjitha llojet e perimeve

*** Nga çmimi mesatar vjetor i naftës, zbriten:**
- Akciza 37 lekë/L
- Taksa e qarkullimit 27 lekë/L
- Taksa e karbonit 3 lekë/L

Nëntotal 67 lekë/L
TVSH respektive (20%)13,4 lekë/L

TOTAL 80,4 lekë/L
**** Koeficienti i përfitimit të naftës falas mbi normativë = 80,4 lekë/144.217 *100 = 56%**

ANEKSI 4
SHEMBUJ SHPJEGUES MBI KUALIFIKIMIN/MOSKUALIFIKIMIN DHE LLOGARITJEN E NAFTËS FALAS, SIPAS SKENARËVE TË NDRYSHËM

4.1 Kualifikimi i aplikuesve

Kriteret për kualifikimin e aplikuesve për përfitimin e naftës falas për bujqësinë, janë:

1. Çdo parcelë e deklaruar me të mbjella duhet të jetë të paktën 1 dynym (0.1 ha);
2. Shuma e sipërfaqes së parcelave të deklaruara me të mbjella (që plotësojnë kriterin 1), duhet të jetë të paktën 4 dynymë (0.4 ha);

Tabela e mëposhtme (01), përmban shembuj të përmbushjes (ose mospërmbushjes) së kritereve më sipër dhe rrjedhimisht edhe të kualifikimit (moskualifikimit) për përfitim.

Tabela 01: Shembuj mbi kualifikimin e subjekteve

Raste te mundëshme	Rasti 1: Bimë arash një vjeçare	Rasti 2: Bimë arash një vjeçare	Rasti 3: Bimë arash një vjeçare dhe pemtore ekzistuese	Rasti 4: Bimë arash një vjeçare dhe pemtore e re	Rasti 5: Bimë arash një vjeçare dhe foragjere shumë-vjeçare
Parcela	Siperfaqja (dn)	Siperfaqja (dn)	Siperfaqja (dn)	Siperfaqja (dn)	Siperfaqja (dn)
Parcela 1	3.2	2.3	1.5	1.4	2.3
Parcela 2	0.7	0.9	0.3	0.7	0.7
Parcela 3	4.7	0.7	1.4	1.4	0.9
Parcela 4	2.3	1.1	0.5	0.5	1.2
Parcela 5		0.6	1.2	1.5	1.1
Parcela 6		0.3	Pemtore ekzistuese	Pemtore e re	
Sip totale e deklaruar	10.9	5.9	4.9	5.5	6.2
Sip e kualifikuar (cdo parcele >=1 dn) >4dn	10.2	3.7	4.1	2.8	4.6
Vendimi =>	Kualifikohet =>	Nuk kualifikohet =>	Kualifikohet =>	Nuk kualifikohet =>	Kualifikohet =>

Foragjere shumë-vjeçare ekzistuese

Foragjere shumë-vjeçare e re; jo zëvendësim

Nuk plotëson kriterin e madhësisë së parcelës/fermës: nuk kualifikohet
Plotëson kriterin e madhësisë së parcelës/fermës: kualifikohet

[17] Çmimi mesatar vjetor i naftës është përllogaritur mbi të dhënat e publikuara nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP), për periudhën janar-tetor 2020.

4.2 Llogaritja e sasisë së naftës falas për bujqësinë
4.2.1 Llogaritja për subjektet përfituese me madhësi ferme deri në 10 ha

Tabela 02: Llogaritja e sasisë së naftës për bujqësinë për parcelat me bimë dominuese

Parcela	Sip parc (dn)	Bima 1		Bima 2		Bima 3		Tipi i mbjelljeve	Formula	Sasia e naftës falas	
		Lloji	Sip	Lloji	Sip	Lloji	Sip				
Parcela 1	1.5	Mollë	1.2	Grurë	0.3			Kulturë dominuese	SipParc*Nor_Fal _Kult_Kryes	15.9	=C5*L12
Parcela 2	3.7	Mollë	2.8	Grurë	0.9			Kulturë dominuese	SipParc*Nor_Fal _Kult_Kryes	39.2	
Parcela 3	3	Mollë	1.5	Grurë	0.9	Fasule	0.6	Mikse > 2 dn	Sum (SipKult i *Norm i)	28.8	28.8
Parcela 4	1.5	Molle	0.8	Grurë	0.5	Fasule	0.2	Mikse 1-2 dn	SipParc* PagFikse	11.8	
Total	9.7		6.3		2.6		0.8			95.7	

Shkurtime

Sip	Sipërfaqja
Nor_Fal	Normativa e naftës falas për dynym
Sip_Parc	Sipërfaqja e parcelës
PagFikse	Normativë nafte që përdroret per parcelat mikse, e barabartë me normativën mesatare
Kult_Kryes	Kultura kryesore për parcelat me bimë dominuese nëse sipërfaqja e bimës >=70% e sipërfaqes së parcelës

Normativat e naftës falas për dynyme (litra)

Mollë	10.6
Grurë	7.3
Fasule	10.6
Lumpsum	7.8

Tabela 03: Llogaritja e sasisë së naftës për bujqësinë për parcelat mikse mbi 2 dynymë

Parcela	Sip parc (dn)	Bima 1		Bima 2		Bima 3		Tipi i mbjelljeve	Formula	Sasia e naftës falas	
		Lloji	Sip	Lloji	Sip	Lloji	Sip				
Parcela 1	1.5	Mollë	1.2	Grurë	0.3			Kulturë dominuese	SipParc*Nor_Fal _Kult_Kryes	15.9	15.9
Parcela 2	3.7	Mollë	2.8	Grurë	0.9			Kulturë dominuese	SipParc*Nor_Fal _Kult_Kryes	39.2	
Parcela 3	3	Mollë	1.5	Grurë	0.9	Fasule	0.6	Mikse > 2 dn	Sum (SipKult i *Norm i)	28.8	=E7*L12+G7*L13+I7*L14
Parcela 4	1.5	Molle	0.8	Grurë	0.5	Fasule	0.2	Mikse 1-2 dn	SipParc* PagFikse	11.8	
Total	9.7		6.3		2.6		0.8			95.7	

Shkurtime

Sip	Sipërfaqja
Nor_Fal	Normativa e naftës falas për dynym
Sip_Parc	Sipërfaqja e parcelës
PagFikse	Normativë nafte që përdroret per parcelat mikse, e barabartë me normativën mesatare
Kult_Kryes	Kultura kryesore për parcelat me bimë dominuese nëse sipërfaqja e bimës >=70% e sipërfaqes së parcelës

Normativat e naftës falas për dynyme (litra)

Mollë	10.6
Grurë	7.3
Fasule	10.6
Lumpsum	7.8

4.2.2 Llogaritja e naftës për aplikuesit mbi 10 ha, për sipërfaqen mbi 10 ha

Sipërfaqja e deklaruar nga fermeri 1

	Sipërfaqja e deklaruar (ha) nga fermeri
Grurë	30.0
Mollë	1.0
Perime fushe	0.5
Jonxhë	2.0

Faza I: përfshihen në llogaritje kulturat me intensive me mekanikë deri ne 10 ha

	Sipërfaqja e konsideruar në fazën 1	Normativa e naftës falas për dynym	Litra naftë falas
Grurë	8.0	73	584.0
Mollë	1.0	106	106.0
Perime fushe	0.5	84	42.0
Jonxhë	0.0	50	0.0
		Shuma	732.0

Llogaritja e herësit

1. Nevojat për naftë për të përballuar nevojat e subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha			
	Siperfaqja e mbetur	Normativa e naftës falas për dynym	Litra naftë falas
Fermeri 1			
Grurë	22.0	73.0	1606.0
Mollë	0.0	106.0	0.0
Perime fushe	0.0	84.0	0.0
Jonxhë	2.0	50.0	100.0
		Shuma fermeri 1	1706.0
Fermeri 2			2000.0
…			
Fermeri n			3100.0
	Shuma për gjithe fermerët mbi 10 ha		**2000000.0**
2. Shuma e mbetur mbasi janë plotësuar nevojat e femerëve deri në 10 ha			**500000.0**
		Herësi	**4.0**

Faza II: Sasia e naftës që përfiton fermeri - diferenca e sipërfaqeve * normën e naftës/herës

Fermeri 1	Sipërfaqja e mbetur nga faza I	Normativa e korrektuar me herësin	Litra naftë
Grurë	22.0	18.3	401.5
Mollë	0.0	26.5	0.0
Perime fushe	0.0	21.0	0.0
Jonxhë	2.0	12.5	25.0
		Litra total	426.5
Totali	Sasia Faza I (732.0) + Sasia Faza II (426.5)		1158.5

User:
Normativa e korrektuar= Normative falas (D14)/herësin (E36)
Nk=73/4

ANEKSI 5
NUMRI I PUNONJËSVE DHE PROCEDURAT E KONTROLLIT ADMINISTRATIV NGA AREB-të

5.1 Numri orientues i punonjësve për kontrollin administrativ të aplikimeve, për mbulimin e qarqeve të ndryshme, sipas AREB-ve, jepet në tabelën e mëposhtme:

Mbulimi	Nr. i punonjësve
AREB Tiranë - Total	**3**
Qarku Tiranë	1
Qarku Durrës	1
Qarku Dibër	1
AREB Shkodër - Total	**5**
Qarku Shkodër	3
Qarku Lezhë	1
Qarku Kukës	1
AREB Korçë - Total	**16**
Qarku Korçë	6
Qarku Elbasan	5
Qarku Berat	5
AREB Lushnjë - Total	**16**
Qarku Fier	12
Qarku Vlorë	2
Qarku Gjirokastër	2
TOTALI	**40**

5.2. Në tabelën e mëposhtme gjenden skenarët e ndryshëm me të cilët mund të përballet kontrolli administrativ i aplikimeve dhe veprimet/vendimet respektive, që duhet të merren sipas çdo rasti.

Parimi kryesor është që për çdo rast në sistem duhet të ketë të shënuar informacion mbi arsyet e vendimmarrjes.

Statusi i pronësisë	Dokumenti	Dokumente për t'u ngarkuar nga aplikuesi	Dokumente që gjeneron automatikisht *e-Albania*	Shpjegime për kontrollin administrativ	Skenarët	Statusi i parcelës pas kontrollit	Veprimi	Veprimi pas afatit të kthimit të përgjigjes
Në pronësi	Certifikatë pronësie	Certifikata e pronësisë + kartela e pasurisë + hartën treguese	Vërtetim negativ/pozitiv për pasuritë	Aplikuesi duhet të ngarkojë në sistem certifikatën e pasurisë së bashku edhe me faqet e "kartelës së pasurisë" dhe "hartën treguese" që e shoqërojnë. Certifikata e pasurisë duhet të jetë në emër të aplikuesit. Sipërfaqja e pasurisë duhet të jetë njëjte me sipërfaqen e deklaruar në aplikim. Vërtetimi negativ/pozitiv duhet të ketë informacion mbi pasurinë që përkon me certifikatën e pronësisë.	Mungon një nga pjesët e kërkuara të dokumentacionit (ose certifikata, ose kartela, ose harta)	Për plotësim	Në mesazhin që i niset aplikuesit, kërkohet plotësimi i dokumentacionit dhe dërgimi me *email.*	1. Nëse nuk kthehet përgjigje brenda afatit - Parcela përjashtohet. 2. Nëse dërgohet informacioni dhe është në përputhje - Pranohet, 3. Nëse dërgohet informacioni dhe nuk është në përputhje - Përjashtohet
					Informacioni në një nga dokumentet e skanuara nuk është i dallueshëm	Për plotësim	Kërkohet dërgimi i dokumentit me informacion të dallueshëm me *email*	1. Nëse nuk kthehet përgjigje brenda afatit - Parcela përjashtohet. 2. Nëse dërgohet informacioni, është i dallueshëm dhe është në përputhje - Pranohet. 3. Nëse dërgohet informacioni dhe nuk është në përputhje - Përjashtohet
					Certifikata nuk është në emër të aplikuesit	Përjashtohet	Shënohet arsyeja	
					Sipërfaqja e pasurisë në certifikatë nuk përkon me sipërfaqen e deklaruar në aplikim	Për plotësim	Aplikuesit i kërkohet konfirmim për këtë gjë	1. Nëse nuk kthehet përgjigje brenda afatit - Parcela përjashtohet. 2. Nëse dërgohet konfirmimi - Pranohet
					Informacioni në vërtetimin negativ/pozitiv nuk konfirmon informacionin e certifikatës	Përjashtohet	Shënohet arsyeja	
					Dokumentet e dërguara janë sipas kërkesave dhe sip., dhe identifikimi i parcelës në aplikim përkon me certifikatën dhe informacioni	Pranohet		

					i vërtetimit negativ/pozitiv e vërteton			
Në pronësi	AMTP	AMTP	Vërtetim negativ/pozitiv për pasuritë	Aplikuesi duhet të ngarkojë në sistem AMTP e skanuar. AMTP duhet të jetë në emër të aplikuesit. Parcela e deklaruar duhet të identifikohet në AMTP nëpërmjet sipërfaqes së njëjtë. Vërtetimi negativ/pozitiv është për kontroll dhe konfirmim shtesë. Nëse vërtetimi negativ/pozitiv nuk i ka pasuritë që tregon AMTP-ja, kjo nuk do të thotë që AMTP-ja nuk është e saktë, sepse ato pasuri mund të mos kenë kaluar fazën e regjistrimit fillestar. Në rastin që vërtetimi negativ/pozitiv i ka pasuritë që tregon AMTP-ja, atëherë të dhënat identifikuese të pronës (zone kadastrale, volum dhe nr. pasurie) hidhen në sistem nga punonjësi i AREB-së	Dokumenti i dërguar nuk është AMTP	Përjashtohet	Shënohet arsyeja	
					AMTP nuk është në emër të aplikuesit	Përjashtohet	Shënohet arsyeja	
					Informacioni në dokumentin e skanuar nuk është i qartë	Për plotësim	Kërkohet dërgimi i dokumentit me informacion të dallueshëm me *email*	1. Nëse nuk kthehet përgjigje brenda afatit - Parcela përjashtohet. 2. Nëse dërgohet informacioni, është i dallueshëm dhe është në përputhje - Pranohet. 3. Nëse dërgohet informacioni dhe nuk është në përputhje - Përjashtohet
					Parcela nuk identifikohet në AMTP (sipas sipërfaqes)	Për plotësim	Kërkohet specifikimi/identifikimi në AMTP i parcelës dhe konfirmimi i sipërfaqes	1. Nëse nuk kthehet përgjigje brenda afatit - Parcela përjashtohet. 2. Nëse dërgohet informacioni dhe është në përputhje - Pranohet. 3. Nëse dërgohet informacioni dhe nuk është në përputhje - Përjashtohet
					AMTP është në emër të aplikuesit dhe parcela identifikohet në të me sipërfaqe	Pranohet		
Ne përdorim	AMTP	AMTP, Certifikatë familjare e 1.8.1991, marrëveshje dakordësisë e shumicës së anëtareve të familjes bujqësore	Certifikata e gjendjes familjare aktuale	Ky është rasti më kompleks. AMTP-ja duhet të jetë në emër të kryefamiljarit, sipas certifikatës së vitit 1.8.1991. Aplikuesi duhet të jetë pjesë e familjes bujqësore, sipas certifikatës 1.8.1991. Certifikata e gjendjes familjare aktuale duhet të jetë vazhdimësi e familjes bujqësore të vitit 1991. Shumica e anëtareve të familjes	Mungon një nga dokumentet e kërkuara	Për plotësim	Kërkohet plotësimi i dokumentacionit dhe dërgimi me *email*	1. Nëse nuk kthehet përgjigje brenda afatit - Parcela përjashtohet. 2. Nëse dërgohet informacioni dhe është në përputhje - Pranohet. 3. Nëse dërgohet informacioni dhe nuk është në përputhje - Përjashtohet

				bujqësore aktuale duhet të kenë nënshkruar një marrëveshje që i japin të drejtën aplikuesit të përdorë tokën sipas AMTP-së.	Aplikuesi nuk është anëtar i familjes bujqësore, sipas certifikatës së vitit 1.8.1991	Perjashtohet	Shënohet arsyeja	
					Nuk provohet vazhdimësia e familjes bujqësore, sipas certifikatës së gjendjes familjare	Perjashtohet	Shënohet arsyeja	
					Marrëveshja e dakordësisë nuk përfshin shumicën e anëtarëve të familjes bujqësore, sipas gjendjes aktuale	Perjashtohet	Shënohet arsyeja	
Në përdorim	Kontratë huapërdorimi	Kontrata huapërdorimi e noterizuar	Nuk ka	Kontrata e huapërdorimit duhet të jete e noterizuar dhe të identifikojë aplikuesin si subjektin që ka të drejtë të përdorë tokën. Kontrata duhet të specifikojë të gjitha parcelat e dhëna në përdorim me informacionin identifikues dhe sipërfaqet e tyre. Ky informacion duhet të përkojë me informacionin e dhënë nga aplikuesi për parcelat në aplikim	Dokumenti i dërguar nuk është kontratë huapërdorimi	Perjashtohet	Shënohet arsyeja	
					Kontrata e huapërdorimit nuk është e noterizuar	Për plotësim	Kërkohet dërgimi i kontratës së noterizuar me *email*	1. Nëse nuk kthehet përgjigje brenda afatit - Parcela përjashtohet. 2. Nëse dërgohet informacioni dhe është në përputhje - Pranohet. 3. Nëse dërgohet informacioni dhe nuk është në përputhje - Përjashtohet
					Parcelat e deklaruara në aplikim nuk përkojnë me informacionin e pasurive të specifikuara në kontratën e huapërdorjes	Për plotësim	Kërkohet informacioni i plotësuar me *email*	1. Nëse nuk kthehet përgjigje brenda afatit - Parcela përjashtohet. 2. Nëse dërgohet informacioni dhe është në përputhje - Pranohet. 3. Nëse dërgohet informacioni dhe nuk është në përputhje - Përjashtohet
					Kontrata e huapërdorimit është e noterizuar dhe sipërfaqja e parcelës dhe identifikimi i saj në aplikim përkojnë me ato të dhëna në kontratë.	Pranohet		

Me qira	Kontratë qiraje	Kontratë qiraje e noterizuar	Nuk ka	Kontrata e qirasë duhet të jetë e noterizuar dhe të identifikojë aplikuesin si subjektin që ka marrë tokën me qira. Kontrata duhet të specifikojë të gjitha parcelat e dhëna me qira me informacionin identifikues dhe sipërfaqet e tyre. Ky informacion duhet të përkojë me informacionin e dhënë nga aplikuesi për parcelat në formularin e aplikimit	Dokumenti i dërguar nuk është kontratë qiraje për tokën bujqësore	Perjashtohet	Shënohet arsyeja	
					Kontrata e qirasë nuk është e noterizuar	Për plotësim	Kërkohet dërgimi i kontratës së noterizuar me *email*	1. Nëse nuk kthehet përgjigje brenda afatit - Parcela përjashtohet. 2. Nëse dërgohet informacioni dhe është në përputhje - Pranohet. 3. Nëse dërgohet informacioni dhe nuk është në përputhje - Përjashtohet
					Parcelat e deklaruara në aplikim nuk përkojnë me informacionin e pasurive të specifikuara në kontratën e qirasë	Për plotësim	Kërkohet informacioni i plotësuar me *email*	1. Nëse nuk kthehet përgjigje brenda afatit - Parcela përjashtohet. 2. Nëse dërgohet informacioni dhe është në përputhje - Pranohet. 3. Nëse dërgohet informacioni dhe nuk është në përputhje - Përjashtohet
					Kontrate e qirasë është e noterizuar dhe sipërfaqja e parcelës dhe identifikimi i saj në aplikim përkojnë me ato të dhëna në kontratë.	Pranohet		

ANEKSI 6
PAJISJA ME KARTË

6.1 Në lidhje me dorëzimin e kartave të naftës për bujqësinë, në sistem duhet të hidhet informacioni/dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Data e dorëzimit;
2. Numri i kartës së naftës;
3. Emri, mbiemri i subjektit përfitues;
4. Nr. ID i subjektit përfitues;
5. NIPT;
6. Skanimi i ID-së;
7. Skanimi i prokurës së përfaqësimit (nëse ka).

6.2 Përpara dorëzimit të kartës, mbahet nga palët një procesverbal në formë fizike sipas modelit të mëposhtëm, i cili pasi firmoset, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

(*Logoja e institucionit*)

Procesverbal dorëzimi

Sot, më datë ....., u paraqit personalisht/me prokurë përfaqësimi, z./znj. ..... dhe mori në dorëzim kartën e naftës për bujqësinë me nr. ....., në emër të subjektit përfitues .....

Sasia e naftës totale të përfituar nga subjekti është .....L.

Kjo sasi do të tërhiqet:

.....L brenda datës _____ 2021.

.....L nga data _____deri në datën _____ 2021.

Karta e naftës për bujqësinë do të bëhet aktive brenda 1 jave nga data e dorëzimit.

Bashkëngjitur këtij procesverbali (shëno):

- fotokopje e kartës së identitetit;
- prokurë përfaqësimi.

Dorëzoi specialisti i AREB-së:	Marrësi në dorëzim:
(emër, mbiemër, firmë)	(emër, mbiemër, firmë)
_____	_____

(

ANEKSI 7
FORMULARËT/RAPORTET E VERIFIKIMIT NË TERREN

7.1 Akt verifikimi/kontrolli

Data __ .__ .____

Emri Atësia Mbiemri		Numër kontakti i subjektit përfitues	
NIPT		Periudha e aplikimit	
Bashkia			

Parcela	Sip parcelës (dynyme)	Mbjellja	Bima 1			Bima 2			Bima 3		
			Lloji bimës **	Sip (Dyn)		Lloji bimës	Sip (Dyn)		Lloji bimës	Sip (Dyn)	
				Deklaruar	Fakt		Deklaruar	Fakt		Deklaruar	Fakt
Parcela 1		Perime sere* Mbjellje I (-31 maj 2021)									
		Perime sere Mbjellje II (1 qershor-30shtator 2021)									
		Pemë frutore ekzistuese									
		Pemë frutore - mbjellje të reja									
		Kultura në fushë të hapur*** -mbjellje të para (vjeshtë pranvere) ose ekzistuese									
		Kulture e dytë për bimë arash dhe perime									
Parcela 2		Perime sere Mbjellje I (-31 maj 2021)									
		Perime sere Mbjellje II (1 qershor-30shtator 2021)									
		Pemë frutore ekzistuese									
		Pemë frutore - mbjellje të reja									
		Kultura në fushë të hapur -mbjellje të para (vjeshtë pranvere) ose ekzistuese									
		Kulture e dytë për bimë arash dhe perime									
Parcela …		Perime sere Mbjellje I (-31 maj 2021)									
		Perime sere Mbjellje II (1 qershor-30shtator 2021)									
		Pemë frutore ekzistuese									
		Pemë frutore - mbjellje të reja									
		Kultura në fushë të hapur -mbjellje të para (vjeshtë pranvere) ose ekzistuese									
		Kulture e dytë për bimë arash dhe perime									

* Nëse kemi perime, lloji i bimës do lihet bosh dhe do të vendoset vetëm sipërfaqja për dy mbjellje (Sezoni I dhe Sezoni II)
** Nëse ka devijime nga bima e deklaruar (mbjellë një bimë tjetër), ajo shtohet në vijim të listës së bimëve, duke vendosur 0 në kolonën e "Deklaruar" dhe sipërfaqja e mbjellë në kolonën "Fakt"
*** Në kultura në fushë të hapur do të konsiderohen bimët e arave, permimet e fushës, foragjeret shumë-vjeccare dhe bimët aromatike e mjekësore

Komente nga subjekti përfitues/përfaqësuesi ligjor: _____
Komente nga grupi i verifikimit: _____

Firma e subjektit përfitues Firma e inspektorit

7.2 Mbi llogaritjen e devijimit

Llogaritja e devijimit

Kulturat	Sipërfaqja e deklaruar	Sipërfaqja faktike
Perime	5	3
Misër	6	2
Grurë	2	7
Nafta	107.5	87
Sasia e tërhequr (litra)		
Devijim		

Skenari I	Skenari II	Skenari III
107.5	103	90
1.24	1.18	1.03
Penalizim	OK	OK

URDHËR
Nr. 1, datë 5.1.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 682, DATË 21.12.2020, "PËR NDALIMIN E LËVIZJES PËRMES RRUGËVE AJRORE ME BRITANINË E MADHE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 3, germa "a', të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive', në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si dhe vendimit të Komitetit të përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, datë 5.1.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 682, datë 21.12.2020, "Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Britaninë e Madhe", bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi: "deri në datën 6.1.2021" zëvendësohet me togfjalëshin: "deri në datën 18.1.2021".

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 1, datë 5.1.2021

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të nenit 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore"; të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. Elird Qendro, me detyrë drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. Kompetencat e deleguara të Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2021.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi

URDHËR
Nr. 15, datë 11.1.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e disa kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, si më poshtë:

a) Autorizimet e inspektimeve dhe shkresat njoftuese të institucioneve për këto inspektime, në rastin kur janë të njëjta me planin mujor të miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, do të nënshkruhen nga drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve.

b) Dërgimi i kopjeve të procesverbaleve të marrjes në dorëzim dhe të inventarëve, pas përfundimit të procesit të dorëzimit do të nënshkruhen nga drejtori i Arkivave Shtetërore Vendore.

c) Autorizimet për marrjen në dorëzim në arkivin përkatës do të nënshkruhen nga drejtori i Arkivave Shtetërore Vendore ose drejtori i Arkivit Qendror Shtetëror, sipas fushës së përgjegjësisë.

2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen deri në një urdhër të dytë.

3. Në rast të mungesës së personit të përcaktuar në këtë urdhër, kompetencat do të ushtrohen vetëm nga drejtori i përgjithshëm.

4. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve dhe drejtori i Arkivave Shtetërore Vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 5
Datë: 2021/01/13 14:22:16
28f36109-f011-4360-876d-c2019bc93507

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 944 lekë